UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE

DEPARTAMENTI I PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE

# FAMILJA SHQIPTARE NË TRANZICION: POLITIKAT SOCIALE NË FUNKSION DHE MBËSHTETJE TË NDRYSHIMEVE TË SAJ (RASTI I NDIHMËS EKONOMIKE NË BASHKINË DURRËS)

PARAQITUR NË KËRKIM
TË GRADËS SHKENCORE
"DOKTOR"
NGA

nga Blerina Xhakolli (Reçi)

UDHËHEQËS SHKENCOR

**Prof. Dr. Edmond Dragoti**

# DEKLARATË STATUORE

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

NËNSHKRIMI, DATA

Blerina Xhakoli (Reçi)

**E drejtë e autorit © 2014. Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit.**

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE
DEPARTAMENTI I PUNES DHE POLITIKES SOCIALE

**PROGRAM I DOKTORATËS**

# **Tema:** Familja shqiptare në tranzicion: Politikat sociale në funksion dhe mbështetje të ndryshimeve të saj

(Rasti i ndihmës ekonomike në bashkinë Durrës)

Paraqitur në kërkim të gradës shkencore "Doktor"

nga Blerina Xhakolli (Reçi)

Udhëhequr nga Prof. Dr. Edmond Dragoti

Juria e mbrojtjes

1._____Kryetar Jurie (oponent)

2._____Anëtar (oponent)

3._____Anëtare

4._____Anëtare

5._____Anëtar

Tiranë 2014

# ABSTRAKT

Studimi synon të vlerësojë kushtet për ndryshimin e strukturës së familjes në vendin tonë, të përshkruajë politikat sociale dhe efektivitetin e skemës së ndihmës ekonomike (NE), si dhe vlerësimin e barrierave për përfitimin e saj në mënyrë që të mbështeten politikë-bërësit për përshtatjen më të mirë të politikave sociale në përputhje me ndryshimet e strukturës së familjes në Shqipëri.

Për përmbushjen e qëllimit të punimit, një studim kros-seksional u realizua në qershor 2014 midis 232 përfituesve të NE, të paraqitur në mënyrë të njëpasnjëshme në zyrat e NE në të pesë njësitë administrative të Bashkisë Durrës. Për mbledhjen e të dhënave u përdor një pyetësor gjysmë i strukturuar. Qëndrueshmëria e brendshme e pyetësorit u vlerësua nëpërmjet testit të Cronbach'alpha dhe split-half. Për të identifikuar barrierat kryesore për përfitimin e NE u përdor analiza faktoriale. Për të përcaktuar faktorët e lidhur me barrierat për përfitimin e NE u përdor Modeli Linear i Përgjithshëm, duke kontrolluar për efektet konfonduese. Gjithashtu, u konsultua dhe literatura përkatëse.

Mosha mesatare e subjekteve ishte 46.5 vjeç ± 10.8 vite dhe 53% e tyre ishin femra. Sipas opinionit të subjekteve në studim, më pak të sinqertë dhe më pak të besueshëm janë zyrtarët e qeverisë qendrore dhe lokale. Femrat ishin mesatarisht më pak të kënaqura me gjendjen aktuale dhe politikat sociale aktuale, më pak të angazhuara në jetën politike dhe raportuan një numër mesatar më të lartë të barrierave për përfitimin e NE krahasuar me meshkujt. Të gjithë subjektet deklaruan se NE nuk mjafton për të mbuluar nevojat bazë. Barrierat kryesore për përfitimin e NE ishin ato që kanë të bëjnë me thjeshtësinë e procedurave, transparencën e tyre, sasinë e dokumentacionit dhe qartësinë e informacionit të ofruar në media apo institucionet të ndryshme. Edukimi ishte faktori i vetëm universal i lidhur në mënyrë domethënëse me numrin e barrierave për përfitimin e NE.

Vendi ynë po përjeton tranzicionin e dytë demografik, që nënkupton ndryshime të rëndësishme në strukturën e familjes. Politika aktuale e ndihmës ekonomike nuk i adreson këto ndryshime. Një sërë ndërhyrjesh të thjeshta mund të lehtësojnë aksesin e subjekteve në nevojë ndaj skemës së NE.

***Fusha:*** *politikat sociale, tranzicioni, ndryshimet e strukturës së familjes shqiptare, mbrojtja dhe mbështetja sociale, ndihma ekonomike, Bashkia Durrës.*

***Fjalët kyçe:*** *familjet në nevojë, politikat sociale, ndihma ekonomike, tranzicioni i dytë demografik, mbrojtje sociale.*

# ABSTRAKT

This research aims to evaluate the circumstances of the family structure change in our country, describe the social policies and the impact of the social assistance as well as the listing of the obstacles to benefit from this scheme, in order to support policy-makers in creating social policies which will better correspond to the family structure changes in Albania.

In order to meet the aim of this research a cross-section study was implemented in June 2014 among 232 beneficiaries of the social assistance listed by Social Assistance Offices in the five administrative units of Durres Municipality. A half-structured questionnaire was used to collect the data. The inner constancy of the questionnaire was evaluated by Cronbach'alpha and split-half. To identify the main obstacle to benefit from the SA the factorial analysis was used. To define the factors related to the obstacles to benefit from the SA the General Linear Model was used by checking the confounding effects. The relevant literature was taken in the due reference.

The average age of the beneficiaries was 46.5 years old ± 10.8 years and 53% of them were women. According to the opinion of the study subjects the officials working in the central and local structures of the government are not trustworthy. Generally, the women were averagely or not at all satisfied with the actual situation and the social policies. They were not involved in the policy-making and reported a higher number of obstacle for them than for men to benefit from the SA. All the interviewed beneficiaries declared that the SA was not enough to meet their basic needs. The main obstacles to benefit from the SA consist in the complexity of the procedures, their transparency, the quantity of required documents and the clarity of the information offered by the media and different institutions. Education was the only universal factor very much related to the number of the obstacles to benefit from the SA.

Our country is going through a second demographic transition, which consists in major changes of the family structure. The actual social assistance does not address these changes. Minor simple interventions might facilitate the access into the SA of the subjects in need.

***Field:*** *social policy, transition, the Albanian family structure changes, the social protection and assistance, the economical assistance, Durres Municipality.*

***Key words:*** *families in need, social policies, economical assistance, second demographic transition, social protection.*

# TABELA E PËRMBAJTJES

**Abstrakt** iv
**Parathënie** xiv
**Falënderime** xvi
**Lista e grafikëve** xii

**KAPITULLI I - HYRJE**
1.1 Përshkrimi i situatës dhe ravijëzimi i problemit 1
1.2 Qëllimi i kërkimit 2
1.3 Objektivat e kërkimit 2
1.4 Pyetjet kërkimore 7
1.5 Rëndësia e kërkimit 7

**KAPITULLI II – RISHIKIMI I LITERATURËS LIDHUR ME NDRYSHIMIN E STRUKTURËS FAMILJARE DHE POLITIKAT E MBËSHTETJES SOCIALE**
2.1 Ndryshimi i strukturës familjare në nivel ndërkombëtar 10
2.2 Shpjegimet strukturore të ndryshimit të familjes 11
2.2.1 Organizimi i jetës ekonomike, edukimi, urbanizimi dhe migrimi 12
2.2.2 Të ardhurat dhe konsumi, komunikimi, teknologjia dhe transporti 13
2.3 Shpjegimet ideore të ndryshimit të familjes 15
2.4 Ndryshimet në strukturën e familjes në nivel botëror 17
2.5 Struktura familjare në Europë: Europa Qendrore dhe Lindore 18
2.5.1 Konteksti politik, social dhe ekonomik i vendeve të Europës Lindore 18
2.5.2 Ndryshimet në strukturën e familjes në Europë: Europa Qendrore dhe Lindore 19
2.5.3 Martesa, lindja e fëmijëve, bashkëjetesa dhe divorci 20
2.6 Tranzicioni i Dytë Demografik në Europën Qendrore dhe Lindore 22
2.7 Tendencat dhe variacionet në modelet familjare 24

2.8 Ndryshimi i strukturës familjare – Implikime për politikat sociale 25
2.9 Mirëqenia dhe politikat sociale 26
2.10 Politikat e mbrojtjes sociale në Europë 28
2.10.1 Politikat e familjes në Europë 28
2.10.2 Politikat e kujdesit ndaj fëmijëve 30
2.10.3 Politikat e lejes nga puna 30
2.10.4 Shërbimet e kujdesit ndaj fëmijëve 31
2.10.5 Përfitimet financiare 32
2.10.6 Mbrojtja sociale për të moshuarit 34
2.10.7 Politikat lokale të mbështetjes sociale 36
2.10.8 Masa financiare apo institucionale të mbrojtjes sociale? 36
*2.10.8.1 Qëndrimet e publikut për masat financiare dhe institucionale të politikave sociale* 38
*2.10.8.2 Faktorët që ndikojnë në preferencat për masat financiare apo institucionale të politikave sociale* 39
2.10.9 Përmbledhje 40
2.11 Sfidat e politikave të mbrojtjes sociale 41
2.11.1 Mungesa e mbulimit me shërbime sociale 42
2.11.2 Mënyra për zgjerimin e mbulimit me shërbime të mbrojtjes sociale 43
2.12 Politikat e mbështetjes sociale dhe varfëria 45
2.13 Politikat e mbrojtjes sociale në Shqipëri 47
2.13.1 Vështrim i shkurtër historik mbi Shqipërinë 47
2.13.2 Indikatorët e tranzicionit të dytë demografik në Shqipëri 48
2.13.3 Historiku i politikave të mbrojtjes/përfshirjes sociale në Shqipëri 50
*2.13.3.1 Panoramë e përgjithshme 50*
*2.13.3.2 Historiku i bazave ligjore të mbrojtjes sociale në Shqipëri* 51
*2.13.4 Strategjia e mbrojtjes/përfshirjes sociale në Shqipëri* 54

**KAPITULLI III-METODOLOGJIA E STUDIMIT**
3.1 Tipi i studimit dhe metoda kërkimore e përdorur 62
3.2 Popullata në studim dhe kampionimi 62
3.3 Mbledhja e të dhënave 65
3.3.1 Instrumenti për mbledhjen e të dhënave 65
3.4 Përkufizimi i ndryshorëve në studim 67
3.5 Analiza statistikore e të dhënave 78
3.6 Kufizimet e studimit 81

**KAPITULLI IV- REZULTATET E STUDIMIT**

4.1 Karakteristika të përgjithshme të subjekteve në studim 83
4.2 Karakteristikat e familjes të subjekteve në studim 85
4.3 Kënaqësia me gjendjen aktuale, fuqizimin dhe pjesëmarrjen 87
4.4 Rrjetet sociale, besimi dhe solidariteti në komunitet 95
4.5 Të dhëna lidhur me ndihmën ekonomike (NE) 98
4.6 Barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike (NE) 107
4.7 Numri i barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike 110
4.8 Rëndësia e llojeve të ndryshme të barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike – rezultatet e analizës faktoriale 114
4.9 Lidhja (shoqërimi) i numrit të barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike me faktorët e përzgjedhur- rezulatet e Modelit Linear të Përgjithshëm 117

**KAPITULLI V- DISKUTIMI**

5.1 Vlerësimi i efektivitetit të ndihmës ekonomike në vendin tonë 120
5.2 Vlerësimi i politikave të mbrojtjes sociale në Shqipëri dhe rajon 134
5.3 Tendencat e politikave sociale në Europë 138

**KAPITULLI VI – PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

6.1. Përfundime 141
6.2 Rekomandime 148

**REFERENCAT** **151**

**SHTOJCA** **167**

# LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Shpërndarja e subjekteve sipas karakteristikave socio-demografike 83
Tabela 2. Shpërndarja e subjekteve sipas karakteristikave socio-ekonomike 84
Tabela 3. Shpërndarja e subjekteve sipas strukturës së familjes 85
Tabela 4. Opinionet e subjekteve lidhur me gjendjen aktuale, sipas gjinisë 87
Tabela 5. Opinionet e subjekteve lidhur me gjendjen aktuale, sipas numrit të personave të disavantazhuar në familje 89
Tabela 6. Shpërndarja e subjekteve sipas pjesëmarrjes në aktivitete politike 91

Tabela 7. Opinionet e subjekteve lidhur me sinqeritetin e punonjësve të shtetit, sipas gjinisë 93
Tabela 8. Mbështetja tek miqtë apo të njohurit në rast nevoje 95
Tabela 9. Opinionet e pjesëmarrësve lidhur me besimin tek punonjësit e shteti 97
Tabela 10. Shpërndarja e subjekteve sipas kohëzgatjes së përfitimit të ndihmës ekonomike 98
Tabela 11. Kohëzgjatja e përfitimit të ndihmës ekonomike sipas variableve të përzgjedhur 99
Tabela 12. Arsyet për marrjen e ndihmës ekonomike dhe opinionet e subjekteve lidhur me aspekte të ndryshme të ndihmës ekonomike 101
Tabela 13. Opinionet e pjesëmarrësve lidhur me efektivitetin e NE për të mbuluar nevojat e përditshme 103
Tabela 14. Opinionet e pjesëmarrësve lidhur me efektivitetin e NE për të mbuluar nevojat e përditshme, sipas gjinisë 104
Tabela 15. Opinionet e pjesëmarrësve lidhur me efektivitetin e NE për të mbuluar nevojat e përditshme, sipas nivelit të edukimit 105
Tabela 16. Opinionet e pjesëmarrësve lidhur me efektivitetin e NE për të mbuluar nevojat e përditshme, sipas kohëzgjatjes së përfitimit të ndihmës ekonomike 106
Tabela 17. Barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike, sipas gjinisë 108
Tabela 17. Barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike, sipas gjinisë (vazhdim) 109
Tabela 18. Numri i barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike 110
Tabela 19. Koeficientët e korrelacionit midis numrit të barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe variableve numerikë të përzgjedhur 111
Tabela 20. Të dhënat lidhur me besueshmërinë e pyetjeve që eksplorojnë barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike 112
Tabela 21. Numri mesatar i barrierave për përfitimin e NE sipas karakteristikave të subjekteve në studim 112
Tabela 22. Numri i barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike sipas variableve të përzgjedhur 113
Tabela 23. Shpjegimi i variancës totale me anë të komponentëve të përfshirë në studim – rezultatet e analizës faktoriale 115
Tabela 24. Matriksi i komponenteve – rezultatet e analizës faktoriale 115
Tabela 25. Matriksi i komponenteve i rrotulluar – rezultatet e analizës faktoriale 116
Tabela 26. Matriksi i koeficientëve të rezultateve të komponentëve – rezultatet e analizës faktoriale 116

Tabela 27. Lidhja (shoqërimi) i numrit të barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike me variablet demografikë dhe socio-ekonomikë; vlerat mesatare të numrit të barrierave sipas Modelit Linear të Përgjithshëm 116
Tabela 28. Lidhja (shoqërimi) i numrit të barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike me besimin në punonjësit e shtetit; vlerat mesatare të numrit të barrierave sipas Modelit Linear të Përgjithshëm 119
Tabela 29. Fondi mesatar mujor i ndihmës ekonomike sipas madhësisë së familjes në Bashkitë e vendit, tremujori IV 2013 131
Tabela 30. Rritja (në %) e pagesës mesatare për person kundrejt rritjes 132
(në %) të madhësisë së familjeve në Bashkitë e vendit , tremujori IV 2013 132

## LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1. Shpërndarja e subjekteve në studim sipas madhësisë së familjes së tyre 86
Grafiku 2. Shpërndarja e subjekteve në studim sipas pranisë së personave të disavantazhuar në familjet e tyre 86
Grafiku 3. Shpërndarja e subjekteve në studim sipas numrit të personave vulnerabël në familjen e tyre 87
Grafiku 4. Shpërndarja e subjekteve sipas gjinisë dhe kënaqësisë me politikat sociale aktuale 88
Grafiku 5. Shpërndarja e subjekteve sipas kënaqësisë me politikat sociale aktuale dhe numrit të personave vulnerabël në familje 90
Grafiku 6. Shpërndarja e subjekteve sipas pjesëmarrjes në evente të ndryshme 91
Grafiku 7. Pjesëmarrja e meshkujve dhe femrave në evente të ndryshme 92
Grafiku 8. Shpërndarja e opinioneve rreth sinqeritetit të punonjësve të shtetit 94
Grafiku 9. Shpërndarja e opinioneve lidhur me shkallën që politikanët marrin parasysh shqetësimet e ngritura nga komuniteti, sipas gjinisë 94
Grafiku 10. Shpërndarja e opinioneve lidhur me mbështetjen tek miqtë në rast nevoje, sipas gjinisë 96
Grafiku 11. Shpërndarja e subjekteve sipas besimit që kanë në kategori të ndryshme të punonjësve të shtetit, sipas gjinisë 97
Grafiku 12. Kohëzgjatja e përfitimit të ndihmës ekonomike sipas edukimit 100
Grafiku 13. Kohëzgjatja e përfitimit të ndihmës ekonomike sipas numrit të personave vulnerabël në familje 100
Grafiku 14. Shpërndarja e subjekteve sipas arsyeve për përfitimin e ndihmës ekonomike 102

Grafiku 15. Burimet alternative të të ardhurave kur ndihma ekonomike nuk mjafton 103
Grafiku 16. Proporcioni i meshkujve dhe femrave që nuk kanë plotësuar dot nevojat bazë për shkak të mungesës së parave 104
Grafiku 17. Mosplotësimi i nevojave bazë për shkak të mungesës së parave sipas viteve të edukimit 106
Grafiku 18. Mosplotësimi i nevojave bazë për shkak të mungesës së parave sipas kohëzgjatjes së përfitimit të ndihmës ekonomike (NE) 107
Grafiku 19. Proporcioni i meshkujve dhe femrave që mendojnë se aspektet e mësipërme janë barriera për përfitimin e ndihmës ekonomike (NE) 108
Grafiku 20. Proporcioni i meshkujve dhe femrave që mendojnë se aspektet e mësipërme janë barriera për përfitimin e ndihmës ekonomike (NE) 109
Grafiku 21. Shpërndarja e subjekteve në studim sipas numrit të barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike të identifikuar prej tyre 111
Grafiku 22. Numri i barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike (NE) sipas nivelit të edukimit 114

# PARATHËNIE

Shekulli i kaluar është karakterizuar nga ndryshime të vrullshme në një numër të madh të fushave të jetës, duke përfshirë ndryshimin e organizimit të jetës ekonomike dhe industrializimin, përhapjen e edukimit dhe proceseve të urbanizimit dhe migrimit, rritjen e të ardhurave dhe konsumit, zhvillimin e jashtëzakonshëm të sistemeve të komunikimit, teknologjisë dhe transportit. Këto shpesh janë shoqëruar me ndryshimin e botëkuptimit të njerëzve për botën dhe jetën në përgjithësi, duke bërë që autonomia dhe liritë personale të marrin gjithnjë e më tepër rëndësi. Këto ndryshime kanë mbizotëruar kryesisht perëndimin, por në mënyra dhe shkallë të ndryshme kanë gjetur jehonë pothuajse në të gjithë komunitetet në botë.

Këto ndryshime strukturore dhe ideore të shoqërisë kanë ndikuar fuqishëm për ndryshimin e strukturës së familjes. Sot, vende të ndryshme janë në faza të ndryshme të tranzicionit të dytë demografik, të karakterizuar nga shtyrja në kohë e martesës dhe e lindjes së fëmijëve, parapëlqimin ndaj bashkëjetesës kundrejt martesës, uljen e nivelit të fertilitetit dhe rritjen e ritmeve të divorcit. I instaluar prej disa dekadash në Europën Perëndimore, tranzicioni i dytë demografik ka prekur ish vendet komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore gjithashtu. Bazuar në analizën e të dhënave zyrtare mund të pohojmë pa mëdyshje që edhe Shqipëria po përjeton tranzicionin e dytë demografik.

Ndërkohë që ndryshimet në strukturën e familjes janë reflektuar në adaptimin përkatës të politikave të mbrojtjes sociale në vendet e zhvilluara, kjo përshtatje duket se nuk ka ndodhur në mënyrë të natyrshme në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, për shkak të kontekstit të tyre historik, kulturor, social, politik dhe ekonomik. Shqipëria nuk bën përjashtim nga grupi i dytë. Konteksti historik i pafavorshëm në lidhje me sfondin politik, ekonomik dhe kulturor shënjuan prapambetjen e Shqipërisë në shumë drejtime, përfshirë dhe atë të politikave të mbështetjes sociale për grupet në nevojë. Për këtë arsye, strategjitë e mirëfillta të mbrojtjes sociale në Shqipëri e kanë zanafillën shumë vonë, pas viteve ’90. Përgjatë viteve, legjislacioni për mbrojtjen dhe mbështetjen sociale të grupeve në nevojë është përmirësuar dukshëm, duke u përafruar me parimet Europiane të solidaritetit. Megjithatë, pavarësisht legjislacionit pothuajse të plotë, problematike për vendin tonë mbetet moszbatueshmëria e plotë e kuadrit ligjor.

Raporte të ndryshme vlerësuese të politikave sociale në përgjithësi dhe ndihmës ekonomike në veçanti kanë rezultuar në mungesë efektiviteti ndaj reduktimit të

varfërisë për grupet në nevojë të vendit. Megjithatë, shumë pak informacion ka lidhur me faktin nëse politikat sociale kanë ndryshuar në mënyrë që t'i përshtaten ndryshimeve të strukturës së familjes në Shqipëri, dhe faktorët e lidhur me barrierat që individët në nevojë hasin për të pasur akses ndaj këtyre shërbimeve. Studimi aktual synon të analizojë situatën aktuale, në mënyrë që të mbështeten politikë-bërësit për përshtatjen më të mirë të politikave sociale në përputhje me ndryshimet e strukturës së familjes në Shqipëri.

# FALËNDERIME

Eshtë nder, detyrim dhe kënaqësi për mua,  arritur në këtë fazë të studimit të konkludoj dhe paraqes falenderimet e mia, mirënjohjen time për këtë rrugëtim profesional në realizimin e këtij punimi shkencor.

Falenderimi i parë, mirënjohja e thellë i drejtohet Prof.Dr. Edmond DRAGOTI, udhëheqësi im shkencor në këtë punim. Faleminderit për mbështetjen, përkrahjen dhe mbi të gjitha besimin që pati në punën time dhe  në angazhimet e mia profesionale.

Falë udhëheqjes, mbështetjes së tij në gjithë ecurinë time profesionale, unë kam arritur këto nivele profesionale, duke realizuar një punim shkencor dinjitoz,  punim i cili është një bashkpunim i pandërprerë profesional me shumë koleget, miket e mia të Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale, U.Tiranës, të cilat kanë qenë një mbështetje e vërtetë  për mua. Eksperienca dhe shembujt e tyre më kanë ndihmuar edhe mua në këtë rrugëtim.

Falenderimi i rradhës i përket familjes sime. Bashkshortit tim Adrian Reçi, pa ndihmën e të cilit nuk do kisha arritur deri këtu. Mbështetja e tij, inkurajimi i tij, ka qenë motiv më shumë, shtytje më shumë për të realizuar një punim të tillë shkencor. Një përgjegjësi më shumë për mua, për të përmbushur me dinjitet detyrat e mia profesionale në punën time të përditshme  dhe kryesisht në përfundimin e këtij punimi.

Në falenderimet për  realizimin e  këtij punimi, më lejoni të përmend edhe vajzat e mia, të cilave i detyrohem shumë. I detyrohem në kohën dhe vëmendjen, kushtuar tyre.

Duke shpresuar ti nderoj me punimin tim, me punën time, uroj që të jem një shembull i mirë mamaje, gruaje dhe profesioniste.  Emma dhe Alessia, Faleminderit !

Prindërve të mi, vëllait tim falenderimet më të ngrohta për ndihmën e pakursyer që më kanë dhënë gjithmonë. Shembulli, dashuria, përkushtimi i tyre kudrejt familjes dhe punës janë burim krenarie dhe frymëzimi për mua.

Faleminderit !!!

KAPITULLI
1

# HYRJE

## 1.1 PËRSHKRIMI I SITUATËS DHE RAVIJËZIMI I PROBLEMIT

Struktura e familjes ka ndryshuar në të gjithë botën, duke prekur aspektet e sjelljes, qëndrimeve, besimeve dhe marrëdhënieve. Në përëndim, ndryshimet e strukturës familjare janë shumë më të theksuara dhe paraqiten tashmë në stade të avancuara të tyre. Një numër i madh faktorësh janë përgjegjës për këto ndryshime, ku mund të përmendim faktorët strukturorë dhe ideorë, të cilët do t'i sqarojmë në mënyrë më të detajuar në vijimësi të këtij punimi shkencor. Megjithatë, këta faktorë "shtytës" të këtyre ndryshimeve kanë filluar të kenë ndikimin e tyre edhe në pjesë të tjera të botës, duke prekuar virtualisht të gjitha shoqëritë dhe komunitetet sociale.

Në mënyrë të pashmangshme ndryshimet në strukturën familjare janë shoqëruar me adaptimin e politikave sociale në mënyrë që këto politika t'i përgjigjen sa më mirë realitetit të ri të krijuar, veçanërisht në përëndim. Ndërkohë, adaptimi i politikave sociale ndaj ndryshimeve strukturore të familjes në më të shumtën e rasteve nuk ka ndodhur në mënyrë të përshtatshme në vendet më pak të zhvilluara. Për këtë përgjegjës janë një sërë faktorësh historikë, kulturorë, politike dhe ekonomikë.

Në këtë kontekst, ky studim synon të hedhë dritë mbi faktorët që kanë nxitur ndryshimet strukturore të familjes në përgjithësi në botë dhe përëndim, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në vendet ish komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore, sepse këto të fundit janë të ngjashme me Shqipërinë. Më pas, studimi synon të ofrojë një panoramë të detajuar të ndryshimeve në politikat sociale që kanë ndodhur në këto vende, në përgjigje të ndryshimeve strukturore të familjes dhe të hedhë dritë për efektivitetin e politikave sociale në përgjithësi, për reduktimin e varfërisë, bazuar në rishikimin e literaturës përkatëse. Gjithashtu, studimi ofron një pamje retrospektive të historisë së Shqipërisë, duke u përqendruar në perspektivën e politikave të mbrojtjes sociale, në mënyrë që të kuptohen më mirë ndryshimet, zhvillimet dhe stadi aktual i këtyre politikave dhe shërbimeve. Për më tepër shqyrtohen me imtësi faktorët madhorë që mund të kenë pasur ndikim në ndryshimin e strukturës familjare në vendin tonë, bazuar në analizimin e indikatorëve përkatës, tregues të këtyre ndryshimeve, si dhe për të vijuar më pas me shqyrtimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes sociale dhe vlerësimet paraprake të efektivitetit të tij me synimin për t'i ardhur në ndihmë grupeve në nevojë.

Këto të dhëna ofrojnë sfondin e duhur për të shqyrtuar të dhënat aktuale të marra në subjektet e intervistuar në studimin tonë dhe për të arritur në konkluzione lidhur me efektivitetin real të këtyre politikave dhe ndërhyrjeve dhe barrierave për të pasur akses ndaj këtyre shërbimeve. Së fundmi, gjetjet e studimit tonë kontekstualizohen kundrejt raportimeve të studimeve të tjera apo raporteve të institucioneve të tjera.

Detyra shkencore e këtij studimi mund të përmblidhet në shqyrtimin e prirjeve të ndryshimeve strukturore të familjes në Shqipëri dhe analizimin e shkallës në të cilën politikat e mbrojtjes sociale i janë përshtatur këtyre ndryshimeve, me fokus të veçantë tek ndihma ekonomike (NE) si shtylla kryesore e politikave sociale për reduktimin e varfërisë. Në funksion të kësaj detyre shkencore, në këtë pjesë hyrëse të studimit paraqiten faktorët strukturorë dhe ideorë përgjegjës për ndryshimin e strukturës familjare në përgjithësi, si dhe tendencat kryesore të këtyre ndryshimeve në botë, Europë dhe veçanërisht në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, në mënyrë që të krijohet një bazë logjike për shpjegimin e prirjeve ndërkombëtare të tranzicionit të familjes dhe politikave sociale në funksion të këtyre ndryshimeve.

## 1.2 QËLLIMI I KËRKIMIT

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë kushtet për ndryshimin e strukturës së familjes në Shqipëri, të përshkruajë politikat sociale në vend për mbështetjen e grupeve në nevojë, të vlerësojë efektivitetin e skemës së ndihmës ekonomike si një ndër politikat sociale për mbështetjen e familjeve në nevojë, si dhe vlerësimin e barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike në vendin tonë sipas perspektivës së përfituesve në mënyrë që të hidhet dritë mbi këto fenomene, duke i ardhur në ndihmë politikë-bërësve për të adresuar siç duhet problemet që ulin efektivitetin e skemës së ndihmës ekonomike me qëllim përshtatjen e elementeve të politikave sociale në përputhje me ndryshimet e strukturës së familjes në Shqipëri.

## 1.3 OBJEKTIVAT E KËRKIMIT

**Objektivi i përgjithshëm I**

- Të përshkruhet tranzicioni i strukturës së familjes në arenën ndërkombëtare dhe në vendin tonë.

**Objektivat specifike të objektivit të përgjithshëm I**

- Të identifikohen faktorët strukturorë dhe ideorë të ndryshimit të

strukturës së familjes në arenën ndërkombëtare.

- Të përshkruhen prirjet kryesore të ndryshimit të strukturës së familjes në botë, rajon dhe në vendet ish komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore.
- Të vlerësohet përshtatja e politikave sociale në varësi të ndryshimeve të strukturës së familjes në arenën ndërkombëtare dhe roli i politikave të mbështetjes sociale për reduktimin e varfërisë.

**Objektivi i përgjithshëm II**

- Të identifikohen, të vlerësohen dhe të përshkruhen politikat e përfshirjes dhe mbrojtjes sociale që aplikohen në vendin tonë.

**Objektivat specifike të objektivit të përgjithshëm II**

- Të vlerësohen faktorët strukturorë dhe ideorë që ndikojnë në ndryshimin e strukturës së familjes shqiptare duke u bazuar në kontekstin historik.
- Të përshkruhen politikat e mbështetjes sociale në Shqipëri në një kontekst historik.
- Të vlerësohet efektiviteti, roli dhe rëndësia e politikave të mbrojtjes sociale në mbështetje të familjeve në nevojë në Shqipëri nëpërmjet rishikimit të dokumenteve përkatëse.

**Objektivi i përgjithshëm III**

- Të përshkruhen karakteristikat e përfituesve të ndihmës ekonomike midis subjekteve të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në vitin 2014.

**Objektivat specifike të objektivit të përgjithshëm III**

- Të përshkruhen dhe krahasohen karakteristikat sociodemografike bazë (mosha, edukimi, përkatësia fetare, përkatësia etnike, gjendja civile), ekonomike (statusi i punësimit, shtresa sociale, gjendja ekonomike) dhe karakteristikat e strukturës së familjes (me kë jetojnë, numri i anëtarëve të familjes, prania e personave të disavantazhuar në familje), të përfituesve të ndihmës ekonomike të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në qershor 2014, sipas gjinisë.
- Të përshkruhen dhe krahasohen opinionet e përfituesve të ndihmës ekonomike të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në qershor 2014 lidhur me kënaqshmërinë me gjendjen aktuale (lumturia, kënaqësia lidhur me gjendjen ekonomike dhe politikat sociale) dhe pjesëmarrjen në aktivitete politike dhe sociale

(pjesëmarrja në votime, mbledhje të këshillit bashkiak, protesta, fushata informuese dhe politike, takime me politikanët e zonës, ndërveprimi me median dhe policinë) në zonën e tyre të banimit, sipas gjinisë dhe numrit të anëtarëve të disavantazhuar në familje.

- Të vlerësohen dhe krahasohen opinionet e përfituesve të ndihmës ekonomike të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në qershor 2014 lidhur me sinqeritetin e nëpunësve të shtetit (përfaqësuesit e qeverisë, kryeplaku, mjekët, mësuesit, punonjësit e policisë dhe shërbimeve sociale), rrjetin social, besimin dhe solidaritetin (numri i miqve, numri i miqve ku mund të mbështeten në rast nevoje financiare, përkujdesje për fëmijët, fatkeqësie, numri i miqve që kanë kërkuar ndihmë, ndihma kundrejt qytetarëve të tjerë në lagje) dhe besimin e tyre tek punonjësit e shtetit (punonjësit e bashkisë dhe shërbimeve sociale, qeveritarët, mjekët, mësuesit, punonjësit e policisë), sipas gjinisë.

**Objektivi i përgjithshëm IV**

- Të vlerësohen karakteristikat e ndihmës ekonomike midis subjekteve të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në vitin 2014.

**Objektivat specifike të objektivit të përgjithshëm IV**

- Të përcaktohet dhe krahasohet kohëzgjatja e përfitimit të ndihmës ekonomike sipas karakteristikave bazë socio-demografike, ekonomike dhe shëndetësore (gjinia, mosha, edukimi, gjendja civile, numri i personave të disavantazhuar në familje, statusi i shëndetit, sëmundjet kronike) midis përfituesve të ndihmës ekonomike të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në qershor 2014.
- Të përshkruhen dhe krahasohen arsyet për përfitimin e ndihmës ekonomike të personave të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në qershor 2014, sipas gjinisë.
- Të përshkruhen dhe krahasohen opinionet e përfituesve të ndihmës ekonomike të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në qershor 2014, lidhur me efektivitetin e ndihmës ekonomike për të mbuluar nevojat e përditshme dhe burimet alternative të mjeteve financiare, sipas gjinisë.

- Të përshkruhen dhe krahasohen vështirësitë e shfaqura për shkak të mungesës së parave (vonesë në pagimin e qirasë apo energjisë elektrike, ndërrim vendbanimi, pamundësi për të siguruar kujdes shëndetësor për një familjar të sëmurë, pamundësi për të siguruar ushqimin bazë) të përfituesve të ndihmës ekonomike të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në qershor 2014, sipas gjinisë, nivelit të edukimit dhe kohëzgjatjes së përfitimit të ndihmës ekonomike.

**Objektivi i përgjithshëm V**

- Të përshkruhen barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike midis subjekteve të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në vitin 2014.

**Objektivat specifike të objektivit të përgjithshëm V**

- Të përshkruhen barrierat (thjeshtësia dhe transparenca e procedurave, sasia e dokumenteve, pagesat nën dorë, miqësia për marrjen e NE, afatet kohore, abuzime me procedurat, përfitimi i padrejtë i NE, ndihma e punonjësve të shërbimit social, informacioni në media, prirjet politike) për përfitimin e NE midis përfituesve të ndihmës ekonomike të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në qershor 2014, sipas gjinisë.
- Të përcaktohet shpërndarja e përfituesve të ndihmës ekonomike të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në qershor 2014, sipas numrit të barrierave të ndeshura për përfitimin e NE.
- Të përcaktohet numri mesatar i barrierave të hasura për përfitimin e ndihmës ekonomike sipas gjinisë, moshës, nivelit të edukimit, numrit të personave të disavantazhuar në familje, statusit të shëndetit dhe pranisë së sëmundjeve kronike midis përfituesve të ndihmës ekonomike të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në qershor 2014.
- Të llogariten koeficientët e korrelacionit të numrit të barrierave të hasura për përfitimin e ndihmës ekonomike me variablat numerikë të tillë si mosha, edukimi, gjendja shëndetësore, numri i personave të disavantazhuar në familje, kohëzgjatja e përfitimit të ndihmës ekonomike dhe niveli i lumturisë midis përfituesve të ndihmës ekonomike të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në qershor 2014.

- Të vlerësohet besueshmëria (qëndrueshmëria e brendshme dhe koeficienti i korrelacionit split-half) e pyetjeve të përdorura për eksplorimin e barrierave të hasura për përfitimin e ndihmës ekonomike midis përfituesve të ndihmës ekonomike të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në qershor 2014.

**Objektivi i përgjithshëm VI**

- Të krahasohet numri i barrierave të hasura për përfitimin e ndihmës ekonomike midis përfituesve të ndihmës ekonomike të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në qershor 2014.

**Objektivat specifike të objektivit të përgjithshëm VI**

- Të përshkruhet dhe krahasohet numri i barrierave të hasura për përfitimin e ndihmës ekonomike sipas gjinisë, moshës, nivelit të edukimit, numrit të personave të disavantazhuar në familje, gjendjes shëndetësore dhe pranisë së sëmundjeve kronike midis përfituesve të ndihmës ekonomike të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në qershor 2014.

**Objektivi i përgjithshëm VII**

- Të vlerësohet pesha specifike e barrierave të hasura për përfitimin e ndihmës ekonomike midis përfituesve të ndihmës ekonomike të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në qershor 2014.

**Objektivat specifike të objektivit të përgjithshëm VII**

- Të përcaktohet pesha specifike (në përqindje) e çdo barriere të hasur për përfitimin e ndihmës ekonomike midis përfituesve të ndihmës ekonomike të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në qershor 2014.
- Të evidentohen 4 barrierat kryesore për përfitimin e ndihmës ekonomike midis përfituesve të ndihmës ekonomike të paraqitur në zyrat e ndihmës ekonomike në pesë njësitë bashkiake në qytetin e Durrësit në qershor 2014.

**Objektivi i përgjithshëm VIII**

- Të hartohen rekomandimet për përshtatjen e politikave të mbrojtjes sociale në funksion të ndryshimeve strukturore të familjeve shqiptare, bazuar në gjetjet e studimit.

**Objektivat specifike të objektivit të përgjithshëm VIII**

- Të diskutohet lidhur me rëndësinë dhe domethënien e barrierave kryesore për përfitimin e ndihmës ekonomike të evidentuara në studimin tonë dhe mënyrat për përmirësimin e tyre.
- Të hartohen rekomandimet përkatëse për përshtatjen e politikave të mbrojtjes sociale bazuar në ndryshimet strukturore të familjes shqiptare dhe barrierave të identifikuara në studimin tonë.

## 1.4 PYETJET KËRKIMORE

Pyetjet kërkimore të studimit janë listuar në vijim:

1. Si është situata lidhur me ndryshimin e strukturës së familjes në arenën ndërkombëtare?
2. Në ç'mënyrë kanë evoluar politikat e mbështetjes sociale në varësi të këtyre ndryshimeve në arenën ndërkombëtare?
3. Si kanë ndikuar vitet e tranzicionit ekonomik në strukturën familjare në Shqipëri?
4. Cilat janë politikat sociale në ndihmë të familjeve në nevojë në vendin tonë dhe si kanë evoluar ato në kohë?
5. A i janë përshtatur politikat e mbështetjes sociale ndryshimeve të strukturës së familjes shqiptare?
6. Si ka evoluar përkrahja sociale ndër vite në varësi të ndryshimit të strukturës së familjes në vendin tonë, nëse kjo ka ndodhur?
7. Në ç'masë politika e NE ka përmbushur misionin e saj për të reduktuar varfërinë e familjeve në nevojë dhe përmbushjen e nevojave jetike bazë të tyre në vendin tonë?
8. Cili ka qenë roli i NE në mbështetje të familjeve në nevojë, sipas karakteristikave të tyre?
9. Cilat janë barrierat për të pasur akses në skemën e NE dhe si mund të tejkalohen ato?

## 1.5 RËNDËSIA E KËRKIMIT

Rëndësia e këtij punimi është e shumëfishtë. Pikësëpari, nëpërmjet rishikimit të kujdesshëm të literaturës hidhet dritë mbi faktorët të cilët kanë qenë promotorë të ndryshimit të strukturës së familjes në arenën ndërkombëtare, kryesisht në perëndim, duke u përhapur më pas, në shkallë të ndryshme në pothuaj të gjitha komunitetet e tjera të globit. Gjithashtu, ky punim shkencor hedh dritë mbi mënyrën sesi politikat e mbështetjes sociale kanë pësuar

ndryshime rrënjësore në varësi të ndryshimit të strukturës së familjes. Në fund të fundit, synimi i politikave sociale është pikërisht: t'i vijë në ndihmë sa më mirë individëve dhe familjeve në nevojë. Në këtë kontekst, ndryshimet në strukturën familjare duhet të shoqërohen domosdoshmërish me përshtatjen përkatëse të politikave sociale në mënyrë që ato të përmbushin misionin e tyre.

Së dyti, ky kërkim shkencor paraqet një përmbledhje konçize të sfondit historik, politik, social dhe ekonomik të Shqipërisë, çka është e domosdoshme për të kuptuar natyrën e politikave të mbështetjes sociale në vendin tonë dhe evoluimin e tyre në kohë duke filluar që pas shpalljes së Pavarësisë, periudhës së Luftës së Dytë Botërore, periudhës së regjimit komunist dhe deri në ditët tona. Gjithashtu, studimi ofron po ashtu një panoramë të saktë të parimeve kryesore ky bazohet aktualisht strategjia e mbrojtjes sociale në vendin tonë, duke përmendur politikat kryesore të mbrojtjes sociale dhe bazën ligjore përkatëse.

Së treti, mendojmë se për herë të parë studimi ynë shkencor paraqet fakte konkrete shkencore, të bazuara në burime serioze dhe zyrtare të informacionit, lidhur me tranzicionin e dytë demografik që po përjeton vendi ynë, duke nënkuptuar ndryshime të strukturës familjare të ngjashme me ato të hasura në vendet e zhvilluara të perëndimit. Në fakt, indikatorët e tranzicionit të dytë demografik në Shqipëri deri tani janë paraqitur të veçuar nga burime të ndryshme të informacionit.

Prandaj, merita e këtij punimi shkencor është që ka ofruar për herë të parë një analizë të integruar të të gjithë indikatorëve kryesorë  të tranzicionit demografik.

Një tjetër meritë e studimit tonë shkencor është dhe analiza e integruar e ndryshimeve, tregues të tranzicionit të dytë demografik në kontekstin e stimujve strukturorë dhe ideorë të ndryshimit të strukturës së familjes në Shqipëri. Kështu, duke u bazuar në një numër të madh burimesh zyrtare të informacionit, kemi vënë në dukje në mënyrë të padyshimtë që të gjithë faktorët kryesorë strukturorë që ndikojnë në ndryshimin e strukturës familjare janë të pranishëm në Shqipëri. Gjithashtu janë të pranishëm dhe fakorët ideorë, përfshirë ndryshimin e botëkuptimit për familjen dhe jetën në përgjithësi, duke dëshmuar që vendi ynë po përjeton të njëjtat procese, ndikime dhe ndryshime të vërejtura në vendet e zhvilluara.

Së katërti, ky punim shkencor paraqet një përmbledhje të argumenteve pro dhe kundër efektivitetit të ndihmës ekonomike në lidhje me eficiencën e tyre për të reduktuar varfërinë. Diçka e tillë është e domosdoshme në kuadër të rekomandimit të vijueshmërisë së NE edhe në vendin tonë. Në mënyrë të padyshimtë, bazuar në rishikimin e literaturës, arrihet në përfundimin që ndihma ekonomike duhet të jetë e përkohshme dhe të përdoret nga individët

si një mjet për të lehtësuar kërkimin dhe gjetjen e punës nga ana e tyre dhe jo si një mjet afat-gjatë jetese.

Së pesti, ky studim shkencor paraqet një profil të detajuar të familjeve në nevojë në Shqipëri, duke u bazuar në Bashkinë Durrës, si dhe një panoramë të gjerë të strukturës familjare të tyre, rrjeteve sociale, pjesëmarrjen në jetën politike dhe besimin e tyre në kategori të caktuara të nëpunësve të shtetit. Përveç kësaj, janë paraqitur dhe opinionet e pjesëmarrësve lidhur me efektivitetin e NE për përballimin e nevojave bazë dhe vështirësitë e hasura prej tyre për shkakt të mungesës së mjeteve financiare. Një tjetër pikë e fortë e studimit është që në çdo tabelë janë realizuar testet përkatëse të domethënies statistikore.

Së gjashti, rëndësia kryesore e këtij punimi shkencor është evidentimi i barrierave lidhur me përfitimin e ndihmës ekonomike nga familjet në nevojë dhe përcaktimin e barrierave kryesore si dhe peshën specifike të tyrë bazuar në një test statistikor robust, siç është rasti i analizës faktoriale. Për më tepër, për herë të parë, ky studim shkencor ofron një analizë të detajuar të lidhjes midis numrit mesatar të barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike me faktorë të pavarur socio-demografikë dhe ekonomikë, duke axhustuar (kontrolluar) njëkohësisht për disa faktorë konfondues, në mënyrë që të përftohen rezultate sa më afër realitetit. Gjithashtu, numri i barrierave është analizuar edhe në varësi të shkallës së besimit të pjesëmarrësve tek nëpunësit e shtetit, duke kontrolluar sërish për efektet konfonduese të disa faktorëve të pavarur. Në dijeninë tonë, ky është i pari studim shkencor i cili adreson në mënyrë kaq të detajuar barrierat për përfitimin e NE, duke shërbyer në këtë mënyrë si një aspekt shtesë drejt qëllimit final të vlerësimit të efektivitetit të politikës së ndihmës ekonomike në Shqipëri.

Së fundmi, një tjetër pikë shumë e rëndësishme e studimit është diskutimi i integruar dhe i plotë në studimin tonë. Gjetjet kryesore të këtij punimi shkencor janë vënë në kontekst të studimeve të mëparshme kombëtare dhe ndërkombëtare duke na lejuar qartësimin e situatës, krahasimin me eksperiencat e vendeve të tjera dhe me raportet e mëparshme kombëtare, të cilat kanë vlerësuar politikat e mbështetjes sociale në vendin tonë, duke ndërmarrë dhe disa analiza shtesë bazuar në informacionin e disponueshëm. Diskutimi i gjerë na lejoi të bënim një vlerësim të drejtë dhe të paanshëm të efektivitetit të ndihmës ekonomike në vendin tonë.

Në opinionin tonë, kjo është hera e parë që një studim shkencor analizon në këtë shkallë thellësie dhe gjerësie fenomenin e politikës së ndihmës ekonomike në vendin tonë dhe vlerësimin e efektivitetit të saj duke u bazuar në teste statistikore robuste të papërdorura më parë në këto lloj punimesh dhe një diskutim mjaft kompleks dhe të integruar të gjetjeve të studimit tonë kundrejt studimeve të mëparshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

KAPITULLI
2

# RISHIKIMI I LITERATURËS MBI NDRYSHIMIN E STRUKTURËS FAMILJARE DHE POLITIKAT E MBËSHTETJES SOCIALE

## 2.1 NDRYSHIMI I STRUKTURËS FAMILJARE NË NIVEL NDËRKOMBËTAR

Shumë dimensione të familjes kanë ndryshuar në mënyrë të jashtëzakonshme gjatë shekullit të kaluar, dhe veçanërisht gjatë dekadave të kaluara. Këto ndryshime kanë qenë të gjera jo vetëm në kuptimin gjeografik, duke prekur pjesën më të madhe të popullatave në botë, por edhe në dimensionet e familjes që ato kanë prekur. Për shembull, në shumë pjesë të botës, mosha e martesës është rritur, është rritur niveli i marrëdhënieve seksuale përpara martesës, përfshirja e fëmijëve në përzgjedhjen e partnerit është rritur, është dobësuar autoriteti prindëror, familjet me shumë anëtarë janë pakësuar, marrëdhëniet midis burrave dhe grave kanë ndryshuar, është rritur përdorimi i kontraceptivëve dhe është ulur fertiliteti. Megjithëse qëndrimet dhe besimet që prekin familjen janë më pak të dokumentuara sesa ndryshimet e sjelljeve, edhe ato kanë ndryshuar përgjatë kohës.

Këto ndryshime janë kaq të dukshme saqë shpesh konsiderohen si tendenca apo shkaqe globale. Globalizimi dhe ndërkombëtarizimi janë terma që po përdoren gjithnjë e më shumë për të përshkruar ndryshimet përtej shkaqeve ekonomike dhe zhvillimore. Ata që mbështetin globalizimin e familjeve dhe veçanërisht shfaqjen e një kulture të re globale (1), argumentojnë se ndryshimet sociale të udhëhequra kryesisht nga media dhe teknologjitë e reja, po prodhojnë ngjashmëri të konsiderueshme në modelet dhe qëndrimet familjare në të gjithë botën.

Teoritë e ndryshimit të familjes janë përqendruar kryesisht në ndikimet strukturore, si për shembull zhvendosja nga ekonomia bujqësore në atë industriale dhe më pas në atë të shërbimeve, lëvizja e popullatave nga zonat rurale drejt atyre urbane, përhapja e edukimit, rritja e të ardhurave, ndryshimet e teknologjisë, rritja e njohurive në përgjithësi, si dhe rënia e niveleve të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë. Të gjitha këto teori konvergojnë për faktin që ndryshimet dhe kufizimet në rrethanat sociale dhe ekonomike – për shembull, industrializimi dhe përhapja e edukimit – kanë pasoja komplekse në të gjithë shoqërinë. Këto ndryshime të mëdha sociale dhe ekonomike modifikojnë mënyrat se si individët lidhen më anëtarët e familjes, duke ndikuar në marrëdhëniet burrë-grua, influencën e prindërve tek fëmijët, marrëdhëniet midis motrave dhe vëllezërve apo rolin e fëmijëve në kujdesin ndaj të moshuarve.

Megjithëse shpjegimet strukturore dominojnë ende teoritë e tranzicionit të familjes, po pranohet gjithnjë e më shumë që vetëm forcat strukturore janë të pamjaftueshme për të shpjeguar ndryshimet e familjes në botë dhe se lidhjet empirike midis shumë prej këtyre ndryshimeve strukturore dhe tendencave të ndryshimeve në jetën familjare, janë më pak të qarta nga ç'mendohej më parë. Për shembull, shumë modele dhe marrëdhënie familjare kanë vazhduar të ekzistojnë edhe në kuadër të ndryshimeve të mëdha strukturore, ndërsa sjellje të tjera familjare kanë ndryshuar mjaft edhe në mungesë të ndryshimeve strukturore që mund t'i shpjegonin ato.

Prandaj me rëndësi janë edhe forcat ideore të tilla si: rritja e rëndësisë së lirisë personale, barazisë sociale, dhe të drejtave individuale kudo në botë. Këto forca janë të lidhura me idetë e reja rreth vendit dhe rolit të individëve kundrejt familjes dhe komunitetit, si dhe me ndryshimin e normave lidhur me martesën, marrëdhëniet midis burrave dhe grave, lidhjet midis brezave dhe vendin e fëmijëve në familje. Të rëndësishme janë dhe idetë rreth martesës dhe mënyrat se si ajo lidh dhe ndikon mbi burrat dhe gratë dhe marrëdhëniet midis brezave, si dhe idetë rreth vendit të fëmijëve në familje, përfshirë numrin dhe distancën midis tyre, mënyrat për t'i rritur ata dhe përgjegjësitë e tyre ndaj motrave, vëllezërve dhe prindërve të tyre ndërkohë që pjesëtarët e familjes moshohen. Gjithashtu, për shkak se historikisht familja ka qenë mjeti kryesor social nëpërmjet të cilit individët influencojnë dhe influencohen nga çdo dimension tjetër i jetës, ndryshimi i besimeve lidhur me faktorët e tjerë përbërës të tillë si feja, edukimi dhe ekonomia, luan rolin e tij për të kuptuar ndryshimet e familjes. Besimet fetare, idetë për lirinë dhe barazinë, vlerat dhe besimet lidhur me jetën familjare si dhe vlerat dhe besimet individuale janë të lidhura me ndryshimet e familjes në nivel makro dhe mikro (2-5).

Prandaj, shkurtimisht do përmendim disa nga shpjegimet kryesore strukturore të ndryshimeve të familjes dhe më pas do vazhdojmë me përshkrimin e faktorëve ideorë dhe rolin e tyre në këto ndryshime, si dhe faktorët mediatorë që kalojnë kufijtë ndërkombëtarë. Sot është e pamundur të kuptohen ndryshimet në një shtet apo komunitet të caktuar pa marrë parasysh forcat e globalizimit që veprojnë midis kufijve apo ndikimeve lokale.

## 2.2 SHPJEGIMET STRUKTURORE TË NDRYSHIMIT TË FAMILJES

Sociologët kanë dhënë një sërë shpjegimesh për ndryshimet në strukturën e familjes në perëndim dhe pjesën tjetër. Në pjesën më të madhe, këto shpjegime kanë theksuar ndryshimet në strukturat sociale, ekonomike dhe politike të shoqërisë, kryesisht nëpërmjet rritjes së procesit të industrializimit, urbanizimit,

edukimit, të ardhurave dhe konsumit, komunikimit, transportit dhe formave të reja të teknologjisë.

### 2.2.1 Organizimi i jetës ekonomike, edukimi, urbanizimi dhe migrimi

Shpjegimi i parë dhe ndoshta më i rëndësishëm i ndryshimit të familjes është përqendruar në ndryshimin e mënyrave të prodhimit ekonomik (6,7). Kjo perspektivë thekson rëndësinë e zhvendosjes së mënyrave të mbijetesës nga uria ose të jetuarit në tufë, drejt bujqësisë dhe më pas prodhimit industrial për transformimin e elementeve të tjerë të shoqërisë. Një vend veçanërisht të rëndësishëm në këtë argument kohët e fundit zë procesi i industrializimit, i cili ka transferuar shumë aspekte të prodhimit ekonomik nga sipërmarrjet familjare drejt organizatave burokratike dhe mbështetej më tepër mbi punën e paguar. Industrializimi e zhvendosi prodhimin ekonomik dhe konsumin nga një aktivitet që zhvillohej kryesisht brenda familjes dhe që drejtohej zakonisht nga babai apo burri i shtëpisë, në një aktivitet që ndodhte kryesisht jashtë njësisë familjare dhe jashtë kontrollit të babait.

Mbi këtë aspekt bazohet edhe një teori tjetër e cila e përqendron vëmendjen tek ndryshimi i mënyrave të organizimit dhe pjesëmarrjes në aktivitetet sociale. Teoria e "modeleve të organizimit social" përfshin një spektër më të gjerë aktivitetesh njerëzore dhe ndërveprimesh krahasuar me modelet ekonomike. Kjo teori përqendrohet në: 1) shkallën në të cilën individët janë të përfshirë në aktivitetet e organizuara nga familja kundrejt aktiviteteve që kryhen jashtë shtëpisë, si për shembull në shkollë, fabrika, vende jofamiljare të punësimit dhe institucionet qeveritare; si dhe, 2) nivelin e informimit dhe aftësive të përftuara nëpërmjet burimeve familjare kundrejt atyre të përftuara nga burime jofamiljare, të tilla si media, shteti dhe shkollat (8). Kjo zhvendosje nga shoqëritë e organizuara kryesisht përreth familjeve tek shoqëritë në të cilat aktivitetet themelore ndodhin jashtë familjes, është vënë re në pjesën më të madhe të botës gjatë dy shekujve të kaluar, si dhe ka marrë një rëndësi gjithnjë e më të madhe në vendet perëndimore gjatë dekadave të fundit.

Përhapja e edukimit formal/zyrtar në shkolla është një element tjetër i rëndësishëm në transformimin e organizimit social të shoqërisë. Në fakt, edukimi është konsideruar si motori kryesor që ka udhëhequr transformimin e shoqërisë dhe përmirësimin e mirëqenies ekonomike dhe sociale (9). Rritja e mundësive për t'u arsimuar është një nga fenomenet më të dukshme gjatë shekullit të kaluar, duke qenë se një përqindje e madhe e fëmijëve të botës ndjekin tashmë shkollën fillore, një përqindje e konsiderueshme frekuentojnë shkollën e mesme dhe një pjesë tjetër dhe universitetin. Edhe pse edukimi varion së tepërmi nga një shtet në tjetrin dhe ka diferenca të theksuara gjinore, shkalla e edukimit është rritur në të gjithë rajonet e botës dhe midis vajzave

dhe djemve gjithashtu. Kjo rritje, së bashku me vonesën e hyrjes në tregun e punës, mendohet se modifikon, ndër të tjera, marrëdhëniet midis gjinive, ul autoritetin e anëtarëve më të vjetër në moshë të familjes, si dhe shtyn në kohë vendimin për t'u martuar.

Rritja e numrit dhe llojeve të shkollave dhe përqindjes së nxënësve që ndjekin shkollën mund të ndryshojë marrëdhëniet e familjes me anëtarët e komunitetit (8,10). Me rritjen e shkallës së frekuentimit të shkollës, fëmijët filluan ta shpenzojnë pjesën më të madhe të ditës duke u socializuar dhe nën mbikëqyrjen e mësuesve sesa të prindërve, çka krijon struktura alternative të autoritetit. Gjithashtu, boshllëku pasues në nivelin e edukimit midis brezave mund të çonte në reduktimin e prestigjit të të moshuarve, të cilët në sytë e fëmijëve tashmë konsideroheshin si "brezi më pak i arsimuar". Me rritjen e nivelit të edukimit rriten dhe aftësitë, duke krijuar kështu më shumë shanse për punësim. Nga ana tjetër, frekuentimi i shkollës është edhe një aktivitet që konsumon kohë duke çuar në shtyrjen e vendimit për t'u martuar, pasur fëmijë dhe futjen në tregun e punës.

Procesi i industrializimit shoqërohet shpesh nga ai i urbanizimit, duke përfshirë si zgjerimin e qyteteve të vjetra, ashtu dhe themelimin dhe krijimin e qyteteve të reja, procese që shpesh shoqërohen nga migrimi i individëve nga zonat bujqësore rurale drejt zonave industriale urbane. Megjithëse ndonjëherë e gjithë familja zhvendoset, më shpesh janë të rinjtë ata të cilët migrojnë drejt qyteteve duke përfituar nga mundësitë e punësimit që ofrojnë zonat e reja urbane. Procesi i migrimit zakonisht shoqërohet me organizime të reja të mënyrës së jetesës (11-13). Përveç kësaj, dendësia e popullsisë në zonat urbane shpesh ndryshon modelet e marrëdhënieve dhe komunikimit, prandaj dhe zakonisht marrëdhëniet bëhen shumë më të specializuara dhe jofamiljare (14).

### 2.2.2 Të ardhurat dhe konsumi, komunikimi, teknologjia dhe transporti

Nje element themelor që ka ndikuar në ndryshimin social në pjesën më të madhe të shoqërive njerëzore në botë është dhe rritja e të ardhurave financiare dhe konsumit. Zakonisht rritja e konsumit zgjeron llojin e mallrave të disponueshme, kurse rritja e të ardhurave mund të lejojë dhe të jetuarit në mënyrë të pavarur dhe mundësinë për t'i ndërprerë lidhjet familjare gjithashtu (15-18). Është argumentuar që ndërsa rritja e të ardhurave dhe konsumit plotëson disa nevoja njerëzore bazë, shfaqen nevoja të tjera edhe më të rëndësishme (18,19), çka çon në një kufizim të kohës dhe parave që shpenzohen për aktivitete familjare në mënyrë që të kënaqen aspiratat e reja të konsumit.

Në pjesën më të madhe të shoqërive në të kaluarën, aksesi i individëve ndaj informacionit rreth botës dominohej kryesisht nga njerëzit në mjedisin lokal, veçanërisht anëtarët e familjes dhe fqinjët. Por një gjë e tillë ndryshoi

thellësisht gjatë dekadave të fundit kur njerëzit në të gjithë botën janë bërë pjesë e sistemeve të avancuara kombëtare dhe ndërkombëtare të transportit dhe komunikimit (7). Mallrat dhe shërbimet, si dhe njerëzit, tani lëvizin shumë më lirshëm dhe më lehtë brenda vendit dhe midis shteteve të ndryshme duke kaluar kufijtë ndërkombëtarë. Përveç kësaj, lajmet dhe produksionet televizive të prodhuara në një vend shpërndahen në të gjithë botën duke mbërritur shpesh në qytete të vogla dhe fshatra ku deri pak kohë më parë aksesi ndaj mediave ndërkombëtare ishte shumë i vogël. Pikërisht kjo infrastrukturë e re e transportit dhe komunikimit ka ndryshuar rrënjësisht aksesin e njerëzve ndaj produkteve dhe ideve të reja, duke përfshirë këtu dhe pikëpamjet që kanë të bëjnë me familjen.

Teknologjitë e reja kanë ndikuar gjithashtu në ndryshimin e natyrës dhe botës, duke pasur implikime të drejtpërdrejta dhe në ndryshimet e familjes. Midis këtyre bëjnë pjesë masat e reja mjekësore dhe të shëndetit publik, të cilat kanë reduktuar në mënyrë të konsiderueshme vdekshmërinë dhe kanë rritur jetëgjatësinë e pritshme. Këto masa pothuajse kanë zhdukur vdekshmërinë fëminore në shumë rajone të botës duke u kthyer në një faktor të rëndësishëm për reduktimin e fertilitetit, pasi fëmijët tashmë mbijetojnë dhe nuk është nevoja për të lindur fëmijë të tjerë për të zëvendësuar ata që nuk mbijetojnë dot. Këto ndryshime kanë çuar në formimin e një periudhe më të gjatë të moshës adulte, çka së bashku me rënien e fertilitetit çoi në zgjatjen e numrit të viteve të jetuara pa fëmijë në familje. Ndryshimet në vdekshmëri dhe fertilitet kanë modifikuar rrënjësisht kufizimet dhe shanset për mënyra të ndryshme të organizimit të familjes dhe jetesës (17,20). Megjithatë, kohët e fundit, sëmundje të reja, të tilla si epidemia e HIV/AIDS, kanë çuar në rritjen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë në disa rajone, duke çuar sërisht në ndikime dramatike në strukturën e familjeve dhe marrëdhënieve në familje (21-24).

Me rëndësi të madhe është dhe revolucioni në përdorimin e kontraceptivëve dhe lëvizja ndërkombëtare e planifikimit familjar që ka ndihmuar për përhapjen e përdorimit të kontraceptivëve në shkallë globale. Futja në përdorim e pilulave orale, kontraceptivëve me injeksion, implanteve dhe pajisjeve intra-uterine bëri të mundur uljen e jashtëzakonshme të lindshmërisë, e evidentuar në shumë vende të botës (25). Disa studiues madje mendojnë se, metodat e kontrollit të lindjeve dhe vetëbesimit që ato gjenerojnë në veçimin e aktivitetit seksual nga ai i ngjizjes së fëmijëve, kanë inkurajuar seksin jashtë martese, vonesën në kohë të martesave, rritjen e bashkëjetesës pa qenë të martuar dhe rritjen e niveleve të punësimit të femrave (26,27).

## 2.3 SHPJEGIMET IDEORE TË NDRYSHIMIT TË FAMILJES

Studiues të ndryshëm argumentojnë që, kornizat apo skemat/teoritë ideore ofrojnë modele për të përjetuar realitetin dhe për të jetuar me atë realitet (3,28). Si modele të realitetit, kornizat ideore ofrojnë perspektivat për të vëzhguar dhe kuptuar botën. Ato ofrojnë gjithashtu sisteme klasifikimi për të përshkruar botën, modele për interpretimin e variacionit dhe ndryshimit të sjelljeve dhe marrëdhënieve njerëzore, si dhe përkufizime të domethënies së elementeve të ndryshme të jetës sociale, ekonomike dhe familjare. Si modele për realitetin, sistemet ideore ofrojnë kornizat për të ndërvepruar dhe reaguar ndaj botës, duke përcaktuar kornizën për identifikimin e aspekteve të rëndësishme dhe të mira në jetë, çfarë është e pranueshme dhe morale, si dhe ndihmojnë për të përcaktuar motivimet në një kontekst të përbashkët, duke përshkruar si synimet finale ashtu edhe mekanizmat për t'i arritur ato. Pra, ato formojnë një sistem moral rregullash dhe gjykimesh për vlerësimin e qëllimeve dhe mjeteve.

Sistemet ideore përfshijnë gjithashtu dhe besimet rreth natyrës së botës dhe sesi ajo funksionon (3). Këto besime mund të variojnë në domethënien e tyre për çdo individ si dhe në stabilitetin e tyre në kohë. Sistemet ideore përfshijnë dhe vlera, duke përcaktuar se cilat mjete dhe qëllime janë të mira apo të dëshirueshme. Vlerat ofrojnë një hierarki për të zgjedhur midis qëllimeve dhe mjeteve të ndryshme duke u bërë baza e perferencave, ose e klasifikimit të qëllimeve, aktiviteteve dhe sjelljeve të ndryshme (3). Si të tilla, vlerat dhe preferencat janë elemente kryesore që përbëjnë bazën e motivimeve për sjellje dhe marrëdhënie të ndryshme. Vlerat dhe besimet janë të lidhura dhe me qëndrimet, të cilat janë mënyra të caktuara për t'iu përgjigjur ose vepruar ndaj njerëzve apo faktorëve të caktuar në një mënyrë të caktuar.

Përveç kësaj, besimet, vlerat dhe qëndrimet shpesh ndahen apo përqafohen nga shumë grupe midis komuniteteve, vendeve dhe me rritjen e globalizimit, edhe në botë. Ndërkohë që këto vlera, besime dhe qëndrime përqafohen nga individët, ato shndërrohen në norma sociale dhe standarde shoqërore. Këto norma sociale shpesh përkrahin apo frenojnë synime dhe mjete të caktuara, duke marrë kështu një karakter moral, sepse ato përcaktojnë dallimin e së drejtës nga e gabuara, të pranueshmes nga e papranueshmja. Megjithatë, sistemet ideore shpesh lejojnë një variacion të gjerë të asaj çka është e pranueshme (29,30), në shkallën se cilat sjellje konsiderohen si vullnetare apo të lejueshme (31), në vendosmërinë me të cilën mbrohen vlerat dhe besimet dhe në hapësirën për liri dhe zgjedhje individuale. Së fundmi, vlerat dhe normat kulturore mund të jenë kaq të ndryshme dhe të vlerësuara në mënyra kaq të ndryshme në shoqëri, saqë ato bëhen fokusi i kundërshtive të forta, të cilat mund të përshkallëzohen deri në përballje kulturore masive (32).

Një aspekt themelor i sistemeve ideore është aftësia për të ndryshuar: vlerat, besimet, qëndrimet, perferencat dhe motivimet nuk janë statike, as në nivelin individual, as në nivel grupi. Përkundrazi, këta faktorë ideorë mund të ndryshohen nëpërmjet disa mekanizmave. Në fakt mund të dalim në përfundimin se kornizat ideore në botë kanë ndryshuar në mënyrë dramatike dhe që këto ndryshime kanë pasur ndikime të jashtëzakonshme në vetë strukturën e familjes.

Faktorët ideorë janë të domosdoshëm për të kuptuar ndryshimet në strukturën e familjes (7,33-35). Ndryshimet në besimin fetar dhe sekularizmin janë përbërësit thelbësorë për shpjegimin e ndryshimeve të sjelljes së familjes në Eurpën Perëndimore (4,36). Ndryshimet thelbësore të vëna re në martesë, bashkëjetesë, lirinë seksuale, divorcin dhe lindjet e fëmijëve jashtë martese, të cilat i quajnë si tranzicioni i dytë demografik, janë përhapur përtej Europës Perëndimore drejt Europës Lindore.

Idetë dhe vlerat e familjes perëndimore, të cilat janë përhapur nëpër botë, kanë pasur ndikim të madh në ndryshimin e vlerave dhe sjelljeve të familjeve në shumë vende të botës përveç atyre perëndimore (37- 39). Vlerat dhe idetë perëndimore kanë penetruar në Afrikë në atë shkallë sa për të lejuar krijimin e modelit perëndimor të familjes, çka kompromenton seriozisht sistemet indigjene të familjes në Afrikë (7,40-43).

Modeli perëndimor i jetës familjare ka qenë i rëndësishëm jashtë perëndimit qoftë edhe pjesërisht, sepse ai është i mbrujtur me idetë e zhvillimit që kanë mbizotëruar mendimin perëndimor prej mijëra vjetësh dhe, në shekujt e fundit, janë përhapur dhe në shumë vende të tjera joperëndimore (7,35). Modeli i zhvillimit sugjeron që jeta sociale, ekonomike dhe familjare perëndimore qëndron në themel të progresit dhe zhvillimit; që këto aspekte të jetës perëndimore shërbejnë si ideale për shoqëritë joperëndimore; që jeta familjare perëndimore konsiderohet si shkak dhe si efekt i suksesit ekonomik dhe mirëqenies; dhe që liria dhe barazia janë të drejta themelore të njeriut. Përhapja në nivel botëror i këtyre ideve ka qenë thelbësore për ndryshimin e sistemeve të familjeve në të gjithë botën.

Modeli i zhvillimit dhe besimet që e shoqërojnë atë lidhur me faktin që familjet perëndimore janë superiore dhe çojnë drejt zhvillimit, dhe që liria dhe barazia janë të drejta bazë njerëzore, janë përhapur nëpërmjet shumë mekanizmave. Për shekuj me radhë akademikët perëndimorë kanë mësuar në shkolla dhe kanë përhapur këto ide, ndaj traktatet akademike të tyre janë shpërndarë në Europë dhe kudo gjetkë. Futja në përdorim dhe zgjerimi i edukimit në masë dhe i masmedias është shumë i rëndësishëm për përhapjen e ideve të reja rreth zhvillimit dhe modelit të familjes perëndimore. Përhapja e ideve brenda vendeve dhe midis tyre është lehtësuar dhe nga procesi i industrializimit dhe urbanizimit, siç e diskutuam më lart.

Ideja e zhvillimit dhe superioritetit të familjes perëndimore është përhapur aktivisht nëpërmjet lëvizjeve sociale dhe organizatave të ndryshme. Kristianizmi ka luajtur rolin e vet në përhapjen e këtyre ideve në Afrikë, për shembull (7,35,44). Ekspeditat europiane, pushtimi i territoreve dhe kolonizimi i tyre kanë pasur një ndikim të thellë në një pjesë shumë të madhe të botës nga vitet 1500 deri në vitet 1900, duke siguruar shtysën për përhapjen e ideve të ndryshme rreth zhvillimit dhe superioritetit të Perëndimit. Lëvizja për demokraci politike që ka influencuar botën për të paktën një çerek shekulli ishte gjithashtu një faktor i rëndësishëm për përhapjen e idealeve të lirisë dhe barazisë. Marksizmi dhe socializmi janë faktorë të tjerë që ndikuan në përhapjen e teorive të caktuara të zhvillimit dhe synimit për të krijuar një botë të re të karakterizuar nga forma të reja të familjes dhe të shoqërisë (45). Një rol të rëndësishëm ka luajtur dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe organizata të tjera ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare, të cilat kanë ndihmuar në krijimin dhe përhapjen e një kulture botërore, e cila përqafon idetë e zhvillimit individual dhe social, lirinë, barazinë dhe format perëndimore të familjes (46-50).

Lëvizje të tjera sociale si lëvizja për barazinë etnike dhe raciale, lëvizjet feminisite dhe lëvizja ndërkombëtare e planifikimit familjar kanë pasur një ndikim të fuqishëm gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar për mobilizimin e grupeve dhe organizatave në përhapjen e aspekteve të ndryshme të familjes perëndimore, veçanërisht të planifikimit familjar dhe fertilitetit të ulët.

Natyrisht, idealet perëndimore të zhvillimit, normat familjare dhe liria dhe barazia individuale nuk kanë janë pranuar lehtë në botë. Megjithëse në disa raste ato janë aplikuar lehtësisht, në shumicën e rasteve ato janë injoruar ose u është bërë mjaft rezistencë. Prandaj, ndërsa forma perëndimore e familjes është marrë si shembull nga shumë komunitete, mospranimi i saj ka qenë një forcë shtytëse për ndryshimin e strukturës familjare në shumë vende të tjera. Në mënyrë të natyrshme, rrethanat kulturore dhe historike të çdo vendi çojnë në variacione të rëndësishme të ndryshimeve në strukturën e familjeve në këto vende.

## 2.4 NDRYSHIMET NË STRUKTURËN E FAMILJES NË NIVEL BOTËROR

I ashtuquajturi "tranzicioni i dytë demografik" në shoqëritë perëndimore nënkupton rënien e vdekshmërisë dhe fertilitetit në shekullin XIX dhe XX, i ndjekur nga ndryshime të shumta në strukturën familjare në fundin e shekullit XX, përfshirë ndryshimet në mënyrën jofamiljare të jetesës dhe shkëputjen midis martesës dhe ngjizjes së fëmijëve. Shenjat karakteristike dalluese të tranzicionit të dytë demografik përfshijnë rritjen e niveleve të divorcit, rënien e nivelit të fertilitetit, rritjen e moshës së martesës, rritjen e numrit të individëve beqarë

apo që jetojnë vetëm, si dhe rritjen e numrit të individëve që bashkëjetojnë pa qenë të martuar. Këto aspekte po evidentohen në të gjitha llojet e shoqërive në botë. Vetëpërmbushja dhe artikulime të autonomisë janë synime ideore primare që ndiqen nga pjesa më e madhe e njerëzve në nivel global dhe këto, së bashku me faktorët strukturorë përcaktojnë drejtimin e ndryshimeve të strukturës familjare në botë.

Ka shumë mundësi që tranzicioni i dytë demografik të përhapet në të gjitha kulturat dhe shoqëritë në botë. Megjithatë është e vështirë të ndahet efekti i faktorëve strukturorë dhe atyre ideorë në shtyrjen e kohës së martesës dhe uljes së fertilitetit. Kjo nuk ka qenë asnjëherë diçka e thjeshtë. Për më tepër duhet të kuptojmë se masmedia po prodhon një "kulturë botërore" në të cilën autonomia individuale dhe vetaktualizimi po zë një vend dominues, dhe këto fakte sigurojnë motivet dhe justifikimet për instalimin e tranzicionit të dytë demografik. Përplasjet politike, fetare dhe ideologjike janë natyrisht të mundshme, por të paktën deri tani këto reagime nuk kanë qenë aq të forta sa të ndalojnë këto prirje.

## 2.5 STRUKTURA FAMILJARE NË EUROPË: EUROPA QENDRORE DHE LINDORE

### 2.5.1 Konteksti politik, social dhe ekonomik i vendeve të Europës Lindore

Përpara se të shqyrtojmë ndryshimet e strukturës familjare në Europë dhe Europën Perëndimore dhe krahasimin me Europën Qendrore dhe Lindore, do të paraqesim një përmbledhje të shkurtër të kontekstit politik dhe socio-ekonomik të Europës Lindore pas viteve '90, në mënyrë që të kuptojmë më mirë arsyet e ndryshimeve në strukturën familjare në këto vende.

Për më shumë se 40 vjet, komunizmi pati një ndikim shumë të fortë jo vetëm në nivelin e shoqërisë, por edhe në atë të familjes në vendet e Europës Lindore, ku shteti kishte kontroll të fortë mbi familjen. Shteti ndërhynte aq shumë në çështjet familjare saqë ai kontrollonte nevojat bazë dhe funksionet familjare të tilla si strehimi dhe sjelljet riprodhuese (duke ndaluar abortet dhe kontraceptivët, për shembull). Në fundin e viteve '80 dhe fillimin e viteve '90 u zhvilluan protesta të fuqishme sociale dhe politike në Europë, të cilat luajtën rol në tronditjen e komunizmit (51). Tranzicioni nga regjimi komunist drejt demokracisë u shoqërua në një gjendje e përgjithshme amullie, duke qenë se nuk kishte eksperienca të tjera në këtë fushë (52), shoqëruar me ndryshime të thella sociale, ekonomike dhe politike.

Kur filloi faza e transformimit, vendet e Europës Lindore ishin në pozicione të ngjashme pasi kishin dekada nën regjime të ngjashme politike dhe ekonomie

të centralizuar (52). Pas rënies së komunizmit filluan të shfaqen diferenca për shkak të zhvillimit të ndryshëm të ekonomive përkatëse dhe politikave nacionale (52,53). Problemi më i mprehtë për vendet ish komuniste ishte niveli i lartë i varfërisë, i cila kërkoi reforma të thella ekonomike, kryesisht privatizime të aseteve shtetërore (54). U rrit shumë papunësia, u rrit inflacioni dhe u ulën pagat, çka rriti pesimizmin dhe zhgënjimin në përgjithësi.

Në Europën Lindore, varfëria lidhet ngushtë me llojin e familjes ku familjet me një prind dhe ato me shumë fëmijë janë më të prekurat (55). Numri i fëmijëve është faktor shumë i rëndësishëm që ndikon në varfërinë e familjes. Kështu në vitin 1990, rreziku i varfërisë për adultët me katër osë më shumë fëmijë ishte rreth pesë herë më i lartë sesa i adultëve pa fëmijë, kurse në 1993 ky rrezik ishte dhjetë herë më i lartë (55). Ndryshimet ekonomike patën pasoja më negative mbi të rinjtë, nëpërmjet degradimit të karrierave për të cilat ata ishin edukuar gjatë komunizmit (56). Familjet e reja patën vështirësi të mëdha për t'u bërë të pavarura nga familja e origjinës. Mungesa e strehimit dhe çmimet e larta bënë që shumë të rinj të jetonin sërish me prindërit, duke i vënë të gjitha palët në presion të konsiderueshëm (57).

Zakonisht, përkeqësimi i kushteve të jetesës prek më shumë gratë sesa burrat në sektorin publik dhe privat. Diskriminimi i grave në tregun e punës në Europën Lindore ishte një vazhdimësi e modeleve të instaluara gjatë komunizmit (58), duke përfshirë paga më të ulëta dhe nivele më të larta papunësie. Në përgjithësi, ndryshimet historike, politike dhe ekonomike prekën të gjitha aspektet e jetës së njerëzve në Europën Lindore, përfshirë strategjitë e lidhura me punën dhe ekonomitë familjare, vlerat e marrëdhënieve sociale, modelet e jetës familjare dhe praktikat e rritjes së fëmijëve (54).

### 2.5.2 Ndryshimet në strukturën e familjes në Europë: Europa Qendrore dhe Lindore

Deri në fund të viteve '80, disa karakteristika të tranzicionit të dytë demorafik u duk se u kufizuan në Europën Perëndimore: incidenca e bashkëjetesës mbeti shumë e ulët në pjesët e tjera të Europës, kurse rritja e nivelit të lindjeve jashtë martese ishte zero ose shumë e ulët. Në vend të këtyre elementeve, adultët e rinj kryesisht qëndronin në shtëpitë e prindërve të tyre. Gjithashtu deri në vitet '90, modelet e mëparshme të martesave dhe fertilitetit vazhdonin të ishin të qëndrueshme në Europën Qendrore dhe Lindore. Por pesëmbëdhjetë vjet më parë, studiuesit mund të pohonin që tranzicioni i dytë demografik do të mbetej një fenomen i kufizuar vetëm në Europën Perëndimore dhe Veriore. Sidoqoftë, tiparet e tranzicionit të dytë demografik kishin filluar të shfaqeshin tashmë në komunitetet përtej oqeanit (si në Australi, Kanada, Zelandë të Re dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës), por ato nuk kishin mundur të kalonin në dy zonat gjeopolitike të tjera të kontinentit të vjetër.

Historikisht ka pasur ndryshime në modelet e martesave midis Europës Lindore dhe asaj Perëndimore. Deri në fillim të shekullit XX, modeli perëndimor karakterizohej nga martesa të vona, proporcione të larta të personave që mbeteshin beqarë ose pa fëmijë, nivele të larta të lindjeve jashtë martese dhe të bashkëjetesës (59). Këto karakteristika ishin të pazakonta për rajonin e Mesdheut. Kurse në Europën Lindore modeli i martesave karakterizohej nga martesa pothuajse universale, martesë dhe prindërim në moshë të re, proporcione shumë të ulëta të personave beqarë dhe pa fëmijë, si dhe nivele të ulëta të ngjizjes paramartesore, lindjeve jashtë martese dhe bashkëjetesës formale.

Ndryshime të mëdha demografike ndodhën në Europën Perëndimore duke filluar nga vitet '60, ku vendet skandinave morën kryesimin të ndjekur nga ato perëndimore dhe jugore gjatë viteve '70-'80, duke shfaqur zakonisht këto tipare: rënie të martesave dhe fertilitetit dhe rritje të bashkëjetesës, divorceve, lindjeve jashtë martesore dhe moshës mesatare të martesës së parë dhe lindjes së fëmijës së parë (60, 61). Në vendet ish komuniste të Europës, tendencat demografike ishin të ndryshme nga ato të Europës Perëndimore. Megjithatë, siç do ta shohim në vijim, duke filluar me proceset e tranzicionit në vitet '80 dhe '90, ndryshimet demografike po bëheshin të ngjashme me ato të vëna re në pjesën tjetër të Europës (62).

Për Europën Qendrore dhe Lindore, pamja ndryshoi në mënyrë rrënjësore dhe përfundimtare pas rënies së regjimeve komuniste në vitin 1989. Të gjithë karakteristikat e tranzicionit të dytë demografik u shfaqën në të njëjtën kohë: mosha në martesën e parë, e cila kishte mbetuar mjaft e re gjatë epokës së shkuar, filloi të rritej, u shfaq bashkëjetesa para martesore, dhe po kështu filluan të rriteshin përqindjet e lindjeve jashtëmartesore. Paralelisht me zhvillimet e tjera ndodhi një shtyrje dramatike në kohë e fertilitetit në të gjitha moshat dhe numrin e fëmijëve, duke çuar në precipitimin e indikatorëve të caktuar.

### 2.5.3 Martesa, lindja e fëmijëve, bashkëjetesa dhe divorci

Ritmi i martesave u ul shumë gjatë viteve '70 në të gjithë vendet Europiane me pak përjashtime, tendencë që u vu re dhe gjatë viteve '90 dhe 2000, sidomos midis vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore (63). Krahasuar me vendet perëndimore, gratë në vendet ish komuniste të Europës janë 3-4 vjet më të reja sesa koleget e tyre perëndimore në martesën e parë dhe e lindin fëmijën e parë 2-3 vjet më parë gjithashtu (63). Me rënien e fertilitetit u rrit numri i grave pa fëmijë gjithashtu. Për shembull, ndërsa në kohortin e vitit 1945 rreth 10-14% e grave nuk kishin fëmijë në Finlandë, Holandë dhe Spanjë, në kohortin e vitit 1965 ky proporcion arriti në 20% (64). Një tendencë e tillë u vu re dhe në Europën Lindore, megjithëse përqindjet e grave pa fëmijë ishin më të vogla se në perëndim (65). Një rritje e lindjeve jashtë martese u vu re në Europën

Qendrore dhe Lindore në vitet '90, ku në Estoni dhe Slloveni ky proporcion është i ngjashëm me ato në vendet skandinave, Francë dhe Angli (63). Këto prirje i detyrohen ndryshimeve të partneritetit si fëmijë të lindur nga çifte jo të martuar, apo nga gra që nuk jetojnë me babanë e fëmijës së tyre (66).

Ndryshime të mëdha ndodhën dhe për sa i përket bashkëjetesës. Në disa shoqëri europiane, martesa nuk konsiderohej më si një kusht i domosdoshëm për të qenë prind, duke çuar në rritjen e numrit të personave që zgjedhin këtë model, kryesisht të rinjtë. Në 1998, rreth 10% e të gjithë çifteve dhe rreth një e treta e çifteve të moshës 16-29 vjeç aplikonin bashkëjetesën në 15 vendet e Bashkimit Europian (63). Bashkëjetesa është më e lartë në vendet skandinave, Holandë dhe Angli ku gati gjysma e çifteve nën 30 vjeç bashkëjetojnë. Kurse në Europën Jugore, edhe pse ky proporcion po rritet, përsëri mbetet shumë i ulët krahasuar me Europën Perëndimore (më pak se 10% në Greqi dhe 15% në Portugali) (63). Në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, bashkëjetesa ka qenë diçka e pazakontë: gjatë viteve '80-'90 më pak se 5% e grave 25-29 vjeç aplikonin këtë model, kurse në Poloni, që karakterizohej nga një shoqëri shumë tradicionale, kjo shifër ishte më pak se 1%; kurse në Estoni dhe Sloveni, bashkëjetesa pranohej dhe nën regjimin komunist. Gjatë viteve '90 u vu re një rritje spektakolare e popullaritetit të bashkëjetesës, duke u kthyer në një mënyrë të zakonshme jetese midis të rinjve (65).

Roli i bashkëjetesës ndryshon midis shoqërive të ndryshme. Sipas studiuesve, ka katër lloje ideale bashkëjetese në Europë (67). Në disa shoqëri, si në Itali, Spanjë dhe Poloni, bashkëjetesa është një fenomen margjinal që nuk inkurajohet nga qëndrimet publike dhe politikat, por mund të nënkuptojë fillimin e martesës si në Belgjië, Çeki apo Hungari. Në Austri, Finlandë dhe Sllovaki, bashkëjetesa zakonisht i paraprin formimit të familjes më tepër sesa vetë martesës, duke përfunduar në martesë pak pas lindjes së fëmijës së parë, kurse në disa vende të tjera bashkëjetesa mund të jetë një alternativë e martesës dhe një përqindje e vogël e tyre përfundojnë në martesë, siç është rasti i Francës për shembull (67).

Në Europën Qendrore dhe Lindore, nivelet e fertilitetit total ranë nën 1.5 fëmijë dhe madje edhe nën 1.3 fëmijë. Kaq shumë u ulën këto nivele saqë u fut në përdorim një term i ri: "fertiliteti i ulët më i ulët" (68). Natyrisht që indikatorë të tillë mund të pësojnë ulje drastike në kontekstin e shtyrjeve të tilla në kohë të martesës dhe ngjizjes së fëmijëve. Megjithatë, shkalla me të cilën mund të ringrihen nivelet e fertilitetit, është e paqartë, kështu që edhe shkalla e rekuperimit të niveleve të fertilitetit në të ardhmen është sërish e paqartë. Të dhënat duket se mbështetin supozimin që fertiliteti do të vazhdojë të mbetet nën nivelin e zëvendësimit. Në vitin 2002, të gjitha vendet ish komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore kishin nivele të fertilitetit total nën 1.35 dhe madje në Ukrainë vlera e këtij indikatori ishte 1.1. Përjashtim bënin vetëm Shqipëria, më

një nivel fertiliteti total rreth 2.0, dhe Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi ku nivelet ishin rreth 1.75 (68).

Paralelisht me rënien e nivelit të martesave u vu re një rritje e njëkohshme e niveleve të divorcit në të gjitha vendet europiane, edhe pse në shkallë të ndryshme. Rritja e nivelit të divorceve ishte më e lartë dhe më e shpejtë në vendet skandinave dhe Angli, ku shifrat i tejkalonin vlerat mesatare të Europës Perëndimore (62). Vendet ish komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore përbëjnë një grup të veçantë për sa i përket divorceve. Disa prej tyre si Hungaria dhe Estonia janë të ngjashme me vendet skandinave, sepse niveli i divorceve është i lartë, sikurse ndodhi edhe në Çeki e Lituani gjatë viteve 2000, kurse në Poloni dhe Slloveni nivelet e divorceve janë më të ulëta se në Europën Perëndimore (63).

Variacionet në nivelet e divorcit mund t'i dedikohen ndryshimeve në legjislacion, si dhe kulturës mbizotëruese me diferenca të mëdha midis vendeve protestante dhe katolike. Në vendet protestante, divorci u legalizua që në fillim të shekullit XX (69) dhe këtu, si dhe në vendet skandinave ku divorci u legalizua qysh herët, u vërejt rritje e niveleve të divorcit. Kurse vendet katolike, ku divorci u legalizua relativisht vonë, kanë nivelet më të ulëta të divorceve. Për shembull, në Itali divorci u legalizua në vitin 1970, në Portugali në 1975, në Spanjë në 1981 e kështu me radhë (63). Kjo ndarje mbi baza kulturash fetare nuk është kaq e dukshme në vendet ish komuniste të Europës, pasi komunizmi këtu u përpoq ta shkëpuste martesën nga besimi fetar, duke nënkuptuar një legjislacion relativisht liberal në këtë drejtim (70). Kështu që variacionet janë të mëdha në këto vende.

## 2.6 TRANZICIONI I DYTË DEMOGRAFIK NË EUROPËN QENDRORE DHE LINDORE

Fillimisht, vetëm një numër i vogël studiuesish në ish vendet komuniste menduan që ky do të ishte fillimi i tranzicionit të dytë demografik në këto vende. Brezi i vjetër i demografëve ishte veçanërisht skeptik edhe rreth vetë këtij koncepti. Ata mbetën të bindur që këto shtyrje masive në kohë të martesave dhe lindjes së fëmijëve ishin pasoja ekskluzive të krizës ekonomike me të cilën u përballën vendet ish komuniste (71), një pikëpamje të cilën e kishte fillimisht dhe Komisioni Ekonomik për Europën i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në fakt, tranzicioni nga sistemi komunist drejt atij kapitalist ishte mjaft i dhimbshëm: ishte fundi i garantimit të punësimit të përjetshëm, rënia e nivelit të aktivitetit për gratë, rënie e theksuar e standardeve të jetesës, rënie e mbështetjes së shtetit për familjet, privatizime të sektorit të strehimit, si dhe në disa vende pati një rritje të dukshme të nivelit të varfërisë.

Megjithatë pati një rrymë të kundërt të demografëve të rinj, kryesisht nga Rusia (72,73) dhe Republika Çeke (74-76), të cilët menduan që nuk ishte përgjegjëse vetëm kriza në ndryshimet e evidentuara në strukturën e familjes, por që ndoshta po zhvilloheshin fazat e para të tranzicionit të dytë demografik. Në fakt pas vitit 1997, ekonomitë e disa vendeve ish komuniste po rimëkëmbeshin dhe po kështu po rriteshin të ardhurat për frymë. Por nuk u vu re ndonjë rikthim në modelet e mëparshme të martesave dhe as nuk u evidentua fundi i shtyrjes në kohë të lindjes së fëmijëve. Po kështu, rritja e qëndrueshme e lindjeve jashtë martesore, e cila për koinçidencë filloi përpara vitit 1989, vazhdoi të ekzistonte dhe madje edhe të përshpejtohej. Midis vendeve ish komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore, vetëm në pesë prej tyre nivelet e lindjeve jashtë martesore ishin nën 20% të të gjithë lindjeve në vitin 2002. Katër prej tyre kishin arritur tashmë nivelet e Europës Veriore me mbi 40% të të gjithë lindjeve (77). Pesëmbëdhjetë vjet më parë, ky nivel në këto vende ishte midis 3% dhe 15% dhe vetëm në ish Republikën Demokratike Gjermane ky nivel ishte në shifrën 34% në vitin 1985. Këto shifra në mënyrë të padyshimtë konfirmojnë ngjizjet e fëmijëve jashtë institucionit të martesës dhe që unionet e bashkëjetesës po përhapen me shpejtësi në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore.

Me sa duket, faktorët kulturorë dhe fetarë ndikojnë në lidhjen midis martesës dhe prindërimit. Përqindja e fëmijëve të lindur nga prindër jo të martuar është më e lartë midis vendeve ku tradita protestante është e fortë dhe më e ulët në vendet katolike dhe ortodokse, edhe pse midis këtyre të fundit ka diferenca të mëdha (65,78).

Konkluzioni është se vërtet kriza ekonomike ka ndikuar në destabilizimin e regjimeve demografike të mëparshme, por edhe që tranzicioni i dytë demografik kishte filluar përpara viteve '90, po vazhdon të zhvillohet ende, pra edhe në kushtet e rimëkëmbjes ekonomike të këtyre vendeve. Me fjalë të tjera, tranzicioni i dytë demografik në Europën Qendrore dhe Lindore po shfaqet si një tipar që do të qëndrojë aty për një kohë të gjatë, në mënyrë të ngjashme me atë ç'ka ndodhi në vendet perëndimore. Edhe një herë ky është një tregues karakteristik i ekonomive kapitaliste dhe kulturave që pranojnë dhe përqafojnë dominimin e autonomisë individuale.

## 2.7 TENDENCAT DHE VARIACIONET NË MODELET FAMILJARE

Shqyrtimi i të dhënave sugjeron që gjatë dekadave të fundit, interesi i Europës për martesën ka rënë dhe është rritur interesi për format alternative të marrëdhënieve afat-gjata. Martesat janë bërë më pak të qëndrueshme duke çuar në lloje të tjera familjesh dhe organizmi të jetës. Europianët kanë më pak fëmijë dhe familjet janë më të vogla. Rënia e fertilitetit dhe moshimi i popullatës janë çështje të mprehta në agjendën europiane, sepse lidhen me rënien e fuqisë ekonomike, politike dhe kulturore dhe rolit të Europës si një aktore në arenën ndërkombëtare (79).

Ndoshta tendenca më e qëndrueshme dhe më e përhapur në Europë është shtyrja në kohë e formimit të familjes. Por variacionet janë të mëdha dhe ato natyrisht që ndikohen dhe nga faktorë të tjerë si: niveli i edukimit, besimet fetare, klasa sociale dhe ekonomike dhe etnia (79). Ndarja lindje-perëndim ekziston sërisht për sa i përket martesës dhe lindjes së fëmijëve. Europiano-lindorët janë më të rinj sesa perëndimorët kur fillojnë të ndërtojnë familjen e tyre dhe ata e fillojnë jetën familjare duke u nisur nga martesa dhe jo nga bashkëjetesa siç ndodh në perëndim. Në këtë kuptim, ekziston dhe ndarja veri-jug, ku në vendet e Europës Jugore tipike ndodh fillimi i jetës familjare nëpërmjet martesës, kurse në Europën Veriore kjo është zëvendësuar nga bashkëjetesa. Dallime të tjera mund të bëhen dhe bazuar mbi nivelet e fertilitetit ku dallohet Europa Veriore dhe Perëndimore me nivele relativisht të larta të fertilitetit dhe ku në modë është modeli i familjes me dy fëmijë, dhe Europa Jugore dhe Qendrore-Lindore me nivele shumë të ulëta të fertilitetit dhe model familjeje me një fëmijë.

Në të gjithë Europën, gjithsesi, fertiliteti është ulur duke çuar në ndryshimin e strukturës familjare dhe familje më të vogla, kurse rritja e ritmit të divorceve ka rritur paqëndrueshmërinë e familjes.

Mund të dallohen katër grupe vendesh bazuar në modelet e familjes në Europën bashkëkohore: 1) grupi me nivele të larta fertiliteti/nivele të larta divorci, ku bëjnë pjesë vendet skandinave, Franca dhe Anglia; 2) grupi me nivele të ulëta fertiliteti/ nivele të larta divorci, ku bëjnë pjesë vendet ish komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore; 3) grupi me nivele të larta fertiliteti/ nivele të ulëta divorci, përfaqësuar nga Irlanda; dhe 4) grupi me nivele të ulëta fertiliteti/ nivele të ulëta divorci, ku bëjnë pjesë Europa Jugore dhe Sllovenia. Ka dy ekstreme në këto grupe: vendet skandinave (familje të brishta me shumë fëmijë) dhe vendet mesdhetare (familje të qëndrueshme me pak fëmijë).

Këto ndryshime në strukturën familjare mund të kenë efekte të ndryshme tek anëtarët e tyre. Anëtarët e tyre konsiderohen se u mungon qëllimi dhe synimet e qarta pa modelin trandicional të familjes të përbërë nga babai, nëna dhe fëmijët. Beqaria, mospasja e fëmijëve, shtyrja në kohë e lindjes së fëmijëve, prishja e marrëdhënieve dhe e familjes dhe modele komplekse jotradicionale

të familjes të tilla si: ribashkimi i familjeve, familjet me një prind dhe familjet ku prindërit janë të të njëjti seks, mendohet të shkaktojnë rreziqe emocionale, sociale, shëndetësore dhe financiare për njerëzit (80,81).

Por ka dhe zëra optimistë duke qenë se rritja e lirisë së zgjedhjes dhe aftësia për të marrë vendime të pavarura lidhur me jetën intime, ndoshta nuk e kanë dobësuar familjen, por e kanë bërë atë më demokratike (82). Megjithatë, pavarësisht rritjes së lirisë për të zgjedhur si ta jetojmë jetën tonë, zgjedhjet individuale varen shumë edhe nga konteksti social përkatës: struktura e një shoqërie të caktuar përcakton kufijtë e zgjedhjeve individuale duke e bërë lirinë e zgjedhjes diçka relative.

Ndryshimi i modeleve të familjes ka hapur debatin nëse familja si institucion qendror social e ka humbur rëndësinë e saj për individët dhe shoqërinë. Është e rëndësishme të kuptojmë se cilët elemente të shoqërisë mund të shkaktojnë ndryshimet në familje. Individët dhe familjet nuk jetojnë në boshllëk. Kontekstet dhe rrethanat politike, ekonomike, ligjore dhe kulturore dhe zhvendosja dhe ndryshimi i tyre ndikojnë jo vetëm sjelljen e individëve ndaj familjes, por dhe konceptin e shoqërisë për familjen dhe se si duhet të jetë ajo. Në fund të fundit nuk janë vetëm aspektet politike, ekonomike dhe ligjore ato që përcaktojnë rrethanat sociale. Procesi i globalizimit dhe integrimit europian përcaktojnë kushte ekonomike, politike dhe ligjore që reflektohen në realitetin social të vendeve europiane dhe atyre që aspirojnë të bëhen pjesë e saj.

## 2.8 NDRYSHIMI I STRUKTURËS FAMILJARE - IMPLIKIME PËR POLITIKAT SOCIALE

Siç e shqyrtuam më lart, mjaft aspekte të modeleve familjare dhe formimit të familjes kanë ndryshuar në mënyrë të jashtëzakonshme gjatë gjysmës së shekullit të kaluar. Ndryshimet më të rëndësishme konsistojnë në shtyrjen në kohë të martesës dhe lindjes së fëmijës së parë, ndryshime në preferencën e numrin e fëmijëve dhe hapësirën midis tyre, shtrirjen e bashkëjetesës dhe legjitimitetin e saj, si dhe në modelet e divorcit dhe rimartesave. Një numër gjithnjë e më i madh i grave po hyjnë në tregun e punës, më pak njerëz martohen ose martohen më vonë në kohë, më shumë njerëz divorcohen në një pikë të caktuar të jetës së tyre dhe rimartesat janë më të rralla, është rritur numri i personave të seksit të kundërt që bashkëjetojnë pa u martuar, si dhe numri i adultëve të të njëjtit seks që bashkëjetojnë (83).

Ndryshimi i strukturave familjare duhet të ndikojë në qëllimet dhe vlerat e mbrojtjes apo sistemeve të sigurimeve sociale gjithashtu. Por në përgjithësi, ndryshimet dramatike të modeleve familjare nuk janë reflektuar sa duhet në ndryshimet përktatëse të sistemeve të sigurimeve sociale. Le të marrim si

shembull fenomenin e divorcit. Problemi i divorcit ka të bëjë me numrin e fëmijëve që më pas jetojnë me vetëm njërin nga prindërit, si dhe kohëzgjatjen e kësaj gjendjeje, pasi këto mund të kenë implikime për politikat sociale. Të dhënat tregojnë që në vitin 1980, kishte rreth 1 milion familje me një prind në Angli, të cilat kujdeseshin për rreth 1 milion e gjysmë fëmijë. Në këtë mënyrë, një në tetë familje drejtohej nga një prind i vetëm, shumica e të cilëve ishin gra (84). Në vitin 2012, rreth 11% e gjithë familjeve në Angli drejtoheshin nga një prind i vetëm, duke përfaqësuar një rritje të qëndrueshme por domethënëse, që prej viti 1996 dhe në 91% të këtyre rasteve familja drejtohej nga gratë (85).

Kur flasim për divorcin, atëherë rëndësi marrin nevojat e fëmijëve në familjet me një prind dhe situata financiare e tyre (86). Në përgjithësi, familjet më një prind janë në situatë më të vështirë financiare krahasuar me familjet me dy prindër dhe mbështeten shumë më tepër tek përfitimet shtetërore dhe ato të skemës sociale për të mbijetuar (86). Të dhënat tregojnë që rreth dy të tretat e familjeve me një prind jetojnë në varfëri (86). Nga ana tjetër, rimartesa nënkupton që bashkëshortja tashmë nuk ka të drejtë të përfitojë më nga skema e sigurimeve sociale dhe në këtë mënyrë kjo vendos një barrë të rëndë mbi shpatullat e bashkëshortit (86).

Nga ana tjetër, duke qenë se gratë e moshuara përbëjnë një nga grupet më vulnerabël të shoqërisë, atëherë mënyra se si ky grup trajtohet nga sistemi i sigurimeve sociale mund të jetë një tjetër çështje madhore (83).

## 2.9 MIRËQENIA DHE POLITIKAT SOCIALE

Mirëqenia është një koncept i vështirë për t'u përkufizuar. Mirëqenia i referohet sigurimit kolektiv të mbështetjes financiare dhe shërbimeve për të përmirësuar cilësinë e jetës të anëtarëve të shoqërisë, politika të cilat përmblidhen nën termin "politika sociale", "sigurimet sociale" apo "mbrojtje sociale" (që është dhe termi më i përdorur në kontekstin europian) (87). Sot, mbrojtja sociale nënkupton ofrimin e mbështetjes financiare apo shërbimeve të ndryshme bazuar në parimin e sigurimit social kundër rreziqeve të caktuara, të cilat kërcënojnë mirëqenien e individit apo të shoqërisë (87). Ka qëndrime të ndryshme ndaj konceptit të mbrojtjes sociale. Sipas këndvështrimit Marksist, mbrojtja sociale shërbente për të legjitimuar marrëdhëniet sociale kapitaliste, kurse sipas lëvizjes feministe këto sisteme kanë synuar nënshtrimin e grave, duke instaluar rolin e tyre si persona që duhet të kujdesen për të tjerët (87). Prandaj, në ditët e sotme termi "të marrësh shërbime apo ndihmë sociale" ka një konotacion negativ.

Në përgjithësi, personat kanë akses ndaj shërbimeve të mbrojtjes sociale nëpërmjet rregulloreve që i japin atyre të drejtën për përfitime të caktuara të

cilat ofrohen nga sistemi i mbrojtjes sociale që operon në shtetet përkatëse. Duke qenë se sistemet e mbrojtjes sociale të shteteve të ndryshme janë themeluar mbi parime të ndryshme dhe kanë ndjekur rrugë të ndryshme zhvillimi, atëherë mekanizmat financues, shërbimet që ato ofrojnë dhe mbulimi me këto shërbime ndryshon në mënyrë rrënjësore midis kombeve të ndryshme (87).

Në shumë vende europiane, politikat e mbrojtjes sociale kanë ndryshuar dhe kanë marrë rëndësi gjithnjë e më të madhe në kontekstin e ndryshimeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me strukturën e familjes, dobësimin e modelit të familjes ku burri është ai që siguron të ardhurat dhe gruaja ajo që kujdeset për fëmijët, rënien e fertilitetit, moshimin e popullatës etj. Bazuar në aftësinë për të ruajtur standardin e jetesës, stratifikimin social dhe ndërveprimin e shtetit, tregut dhe familjes në ofrimin e mbrojtjes sociale, mund të dallohen tre tipe sistemesh të mbrojtjes sociale: ai liberal, konservativ dhe social-demokratik (88). Megjithatë, lëvizja feministe pati kundërshtimet e saj për këtë klasifikim, duke argumentuar që ai nuk merr parasysh problemet gjinore dhe rolin e familjes në ofrimin e mbrojtjes sociale (89,90), dhe si pasojë studiuesit ofruan klasifikime të tjera duke bërë dallimin midis sistemeve familjare dhe jofamiljare të mbrojtjes sociale/mirëqenies, ku sistemet jofamiljare janë ato ku përgjegjësitë për kujdes ofrohen nga sistemi shtetëror i mbrojtjes sociale ose nga tregu (88).

Politikat e mbrojtjes sociale janë të lidhura ngushtësisht me politikat e familjes, duke përfshirë kujdesin për të moshuarit dhe për adultët e tjerë që nga vitet '90. Mbrojtja sociale është një fenomen universal, por organizimi i saj dhe bashkëpunimi midis aktorëve të ndryshëm përgjegjës për ofrimin e saj ka qenë problematik në vendet europiane (91). Politikat tradicionale të mbrojtjes sociale shpesh kanë qenë njëdimensionale, duke u përqendruar vetëm në disa shërbime apo ofrues dhe duke lënë mënjanë shumë të tjerë. Por, për shkak të ndryshimeve të thella të strukturës së familjes dhe të popullsisë në Europë, modeleve të punësimit dhe sistemeve të mbrojtjes sociale, çështja e sistemeve fleksibile të mbrojtjes sociale është kthyer në një temë madhore në politikat europiane në ditët e sotme (91).

Mbrojtja sociale ka shumë dimensione, por ne do i referohemi përkufizimit të dhënë nga projekti SOCCARE i financuar nga Komisioni Europian (91), i cili studioi organizimin e mbrojtjes sociale në pjesë të ndryshme të Europës, duke u fokusuar në katër modele bazë të familjes: a) familjet me një prind, 2) familjet me dy prindër, 3) familjet e emigrantëve dhe 4) familjet me fëmijë të vegjël dhe të moshuar njëkohësisht. Sipas projektit SOCCARE, mbrojtja sociale përkufizohet si "Sigurimi i asistencës dhe mbikëqyrjes me qëllim mbështetjen e fëmijëve dhe adultëve në kryerjen e aktiviteteve të jetës së përditshme" (91). Mbrojtja sociale mund të marrë formën e punës së paguar ose jo të paguar (vullnetare), të ofruar nga profesionistët ose joprofesionistët, në sektorin publik apo privat (91).

## 2.10 POLITIKAT E MBROJTJES SOCIALE NË EUROPË

### 2.10.1 Politikat e familjes në Europë

Politikat e mbrojtjes sociale janë të lidhura ngushtë me rolin e familjes në shoqëri (92,93) dhe përfshijnë çështje të tilla delikate si: punësimin, transportin, ushqimin dhe politikat e edukimit (94,95). Motivet e politikave të mbrojtjes sociale përfshijnë, midis të tjerave, dhe motivet ekonomike apo social-politike që synojnë të kompensojnë direkt apo indirekt kostot e përgjegjësive familjare dhe të luftojnë varfërinë (93). Ligjvënësit kanë disa mjete në dispozicion për t'i arritur këto objektiva, duke përfshirë rregulloret apo legjislacionin, informacionin dhe financimin. Legjislacioni përfshin aspekte të familjes, lejet e ndryshme nga puna dhe ligjet për të drejta të barabarta për punësim. Informacioni mund të përfshijë programe mbështetëse për familjen dhe indikatorë të përformancës. Financimi përfshin kujdesin për fëmijët, pagesat e lejeve nga puna, pagesa direkte për fëmijët apo anëtarët e familjes, siguracionet sociale, lehtësimin e taksave dhe pagesat për strehim (91).

Në Europë mund të ravijëzohen disa lloje sistemesh të mirëqenies apo mbrojtjes sociale.

- Në vendet nordike, këto politika janë ndikuar shumë nga kisha protestante dhe qeveritë e majta, duke u fokusuar gradualisht në barazinë gjinore, pajtimin dhe integrimin e grave në tregun e punës nëpërmjet politikave jofamiljare (96). Kurse në aspektin legjislativ janë bërë përmirësime që reflektojnë ndryshimet e strukturës familjare, pasi çiftet që bashkëjetojnë (97) dhe çiftet e të njëjtit seks kanë të njëjtat të drejta, si dhe ata që janë martuar zyrtarisht (98). Kujdes i veçantë i kushtohet mirëqenies së fëmijëve. Pagesat financiare për familjen sigurohen nga taksat dhe ka bashkëpunim shumë të mirë midis qeverisë dhe organizatave joqeveritare (99).

- Në Europën kontinentale, politikat e mbrojtjes sociale janë influencuar nga kisha katolike, partitë e djathta kristiane dhe parimi i subsidiaritetit, që nënkupton marrjen e vendimeve politike në nivelin më të ulët të mundshëm dhe sa më pranë qytetarëve që të jetë e mundur (100). Në vendet ku aplikohen sigurimet sociale të tipit Bismarkian (si në Austri dhe Gjermani), mbrojtja sociale e fëmijëve dhe e grave varet ende nga martesa dhe lidhjet familjare (97). Këto vende dhe Luksemburgu kanë ministri të veçanta për çështjet e familjes, kurse Franca dhe Belgjika kanë politikat familjare më eksplicite dhe më të detajuara në Europë (97). Në aspektin legjislativ janë bërë përmirësime të ngjashme me vendet nordike (101), kurse bashkëpunimi i qeverisë me OJQ-të është jokonsistent. Shoqëria civile luan rol të madh në zbatimin e politikave, por ka rol të vogël në hartimin e tyre (99).

- Vendet me orientim anglo-amerikan të politikave sociale të tilla si: Malta, Anglia dhe Irlanda, përveç se karakterizohen nga ndërhyrje të dobëta të shtetit, mbështetje bazuar në nevojat, si dhe rol të madh të tregut kanë edhe dallime të rëndësishme. Kështu Malta dhe Irlanda kanë traditë më të fortë familjare krahasuar me Anglinë; në Irlandë mbrojtja e familjes zë vend në Kushtetutë dhe ka ministri të dedikuar për këto çështje, kurse divorci u legalizua vetëm në vitin 1996, por në Maltë është ende ilegal (97). Marrëdhëniet familjare nuk janë detyrë e shtetit dhe për pasojë ka mbështetje të madhe nga sektori privat dhe vullnetar (97). Pagesat financiare për familjen vijnë nga taksat në Angli dhe Irlandë, kurse në Maltë ka financim miks. Bashkëpunimi midis qeverisë dhe OJF-ve është më i vogël krahasuar me vendet nordike, por në Angli organizatat e shoqërisë civile janë të integruara në politikat e mbrojtjes sociale (99).

- Vendet mesdhetare (vendet e Europës Jugore, Portugalia etj.) kanë karakteristika të ngjashme me sistemet e Europës kontinentale me influenca të forta të kishës katolike. Për sa i përket legjislacionit, shteti siguron mbështetje vetëm kur burimet që rrjedhin nga obligimet familjare të rregulluara me ligj, shterojnë (97). Detyrimet e shtetit janë pjesë e kushtetutës në Spanjë, Greqi, Itali dhe Portugali, kurse autoriteti shpesh delegohet në nivelet lokale të qeverisjes, duke çuar në mospërputhje rajonale dhe fragmentim të këtij modeli (97). Pagesat për familjen zakonisht janë në nivel të ulët dhe ka bashkëpunim të dobët midis qeverisë dhe OJF-ve për këto çështje (99).

- Vendet ish komuniste të Europës përbëjnë një rast interesant, duke qenë se ata kanë përjetuar ndryshime dramatike në politikat sociale. Përpara LIIB, pjesa më e madhe e këtyre vendeve mbështeteshin në modelin Bismarkian dhe politikat sociale reflektonin të gjitha shenjat e modelit familjar. Pas viteve '90 dhe braktisjes së punësimit të centralizuar dhe mbulimin universal që ofrohej gjatë regjimit komunist, disa aspekte të politikave sociale ndryshuan rrënjësisht duke u rihartuar plotësisht në shumicën e rasteve (102). Të dhënat tregojnë se të gjitha vendet ish komuniste të Europës e braktisën modelin e politikave sociale jofamiljare dhe u përpoqën të zbatonin politikat familjare (97,103). Mbrojtja e familjes përmendet në kushtetutën e Hungarisë, Polonisë dhe Estonisë, kurse disa vende të tjera, si: Rumani, Sllovenia, Sllovakia dhe Letonia kanë ministri të posaçme për çështjet e familjes (104). Detyrimet ligjore të familjeve të mëdha janë të forta, detyrat e shtetit janë të dobëta dhe nuk ka politika eksplicite për familjen. Sllovenia, Çekia dhe Hungaria kanë legjislacion për partneritetin midis personave të të njëjti seks (101). Pagesat për anëtarët e familjes bazohen

tek taksat por zakonisht janë shumë të ulëta. Bashkëpunimi i qeverisë me OJF-të është mjaft i dobët dhe ende nën ndikimin e epokës komuniste. Megjithatë mund të themi se ky bashkëpunim po zhvillohet (99).

### 2.10.2 Politikat e kujdesit ndaj fëmijëve

Mbështetja për fëmijët ku përfshihen politikat për lejen nga puna, pagesat financiare dhe shërbime tjera, është tema më e studiuar në kuadër të politikave të mbrojtjes sociale (105,106). Arsyet për rëndësinë e kësaj teme janë të shumta, ndër të cilat mund të përmendim faktin që kjo ka qenë temë qendrore e lëvizjeve feministe dhe e problemit të barazisë gjinore. Edhe rritja e nivelit të punësimit të grave dhe barazisë gjinore gjatë jetës aktive ka përbërë një synim të qartë politik në shumë vende europiane (107,108).

### 2.10.3 Politikat e lejes nga puna

Në fund të shekullit XIX u zhvilluan politika të kufizuara të lejes pas lindjes dhe skemat e pagesave përkatëse në disa vende europiane për të mbrojtur shëndetin e nënës dhe të të porsalindurit. Përmirësime të mëdha ndodhën gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX. Këto politika u zhvilluan shumë dhe në drejtime të ndryshme gjatë viteve '70-'80 (109) dhe sot periudha e lejes pas lindjes varion nga tre muaj e gjysmë në rreth shtatë muaj, kurse masa e pagesës varion nga 70% në 100% të pagës që kishte gruaja kur ishte në punë (110). Përveç lejes së lindjes që e merr nëna, është futur dhe koncepti i lejes së lindjes së babait, por megjithatë kjo është e detyrueshme vetëm në Portugali. Zakonisht, leja e lindjes së babait varion nga dy deri në dhjetë ditë dhe pagesat janë njësoj si në rastin e nënës, megjithëse variacionet midis shteteve janë shumë të mëdha lidhur me këtë aspekt (111). Bazuar në lejen e babait për lindjen e fëmijës dhe nivelit të pagesës, shtetet mund të grupohen në katër modele: 1) leje e gjatë e babait dhe pagesa të larta (Gjermania, Finlanda, Norvegjia, Suedia, Spanja, Portugalia); 2) leje e shkurtër e babait dhe pagesa të larta (Franca, Greqia, Belgjika, Holanda, Hungaria, etj.); 3) leje e shkurtër e babait dhe pagesa të ulëta ose zero (Austria, Çekia, Irlanda, Estonia, Polonia, Italia, Australia, Anglia); 4) shtete ku nuk aplikohet leje e babait për lindje (Shtetet e Bashkuara të Amerikës) (111).

Sipas direktivave të Bashkimit Europian, të gjitha shtetet anëtare duhet të sigurojnë të paktën tre muaj leje lindjeje për prindërit (110). Kohëzgjatja e tyre varion nga nëntë muaj deri në tre vjet. Në disa vende, pagesat në këto raste varen nga të ardhurat ose paga, por në raste të tjera paguhet një tarifë fiksë. Këto leje krijojnë një periudhë vazhdimësie që karakterizohet nga nivele të ndryshme pagese sipas skemave të caktuara. Pothuajse të gjithë vendet europiane ofrojnë edhe kohë të papaguar për t'u kujdesur për fëmijën.

Faktorët që ndikojnë në politikat e ndryshme sociale që kanë të bëjnë me

lejen e prindërve nga puna, përfshijnë kushtet financiare dhe ligjore të çdo vendi, ndarja gjinore e punës, fakti nëse leja nga puna pranohet nga kultura e vendeve të caktuara, si dhe ekzistenca e politikave të duhura lidhur me nivelin e pagave dhe papunësisë (112).

### 2.10.4 Shërbimet e kujdesit ndaj fëmijëve

Ky është një tjetër aspekt i rëndësishëm i politikave sociale, i cili kontribuon në shumë drejtime, si për shembull në punësimin e grave, barazinë gjinore, nivelin e lindjeve dhe edukimin e hershëm.

Shërbimet e kujdesit ndaj fëmijëve ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme midis vendeve të Bashkimit Europian lidhur me mbulimin e tyre, mundësisë për të paguar për to dhe cilësisë së tyre (108,113,114;). Kështu, të dhënat sugjerojnë që midis fëmijëve deri në moshën dy vjeç përdorimi i shërbimeve të kujdesit për fëmijët varionte nga rreth 70% në Danimarkë, në 2% në Çeki dhe Poloni (108).

Shërbimet e kujdesit për fëmijët nën tre vjeç janë shumë të zhvilluara në vendet nordike, por shumë deficitare në vendet ish komuniste të Europës të tilla si: Çekia, Hungaria, Polonia, Sllovakia, etj. Kurse sistemet e kujdesit për fëmijët nga tre deri në moshën e arsimit të detyruar janë zgjeruar kudo. Me rëndësi është dhe niveli i shpenzimeve sociale për kujdesin e fëmijëve. Kështu, vendet nordike dhe Anglia shpenzojnë më shumë për fëmijët deri në dy vjeç krahasuar me moshat e tjera, kurse në vende të tjera ndodh e kundërta, veçanërisht në Hungari, Poloni dhe Sllovaki (114). Gjithashtu, vendet nordike shpenzojnë një pjesë më të madhe të Prodhimit të Brendshëm Bruto për shërbimet e kujdesit për fëmijët krahasuar me vendet e tjera europiane (114). Disa shtete si Holanda, Gjermania dhe Anglia po shkojnë drejt mbulimit të plotë të shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijëve, çka nuk mund të thuhet për një pjesë më të madhe të shteteve ish komuniste të Europës Lindore (108).

Megjithatë, edhe midis vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore ka mjaft variacione (115). Pas rënies së sistemit komunist e deri në vitin 2004, pjesa më e madhe e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore lëvizën drejt forcimit të aspekteve jofamiljare të politikave sociale të tyre. Në këtë mënyrë, këto vende klasifikohen në katër grupe: 1) vendet ish komuniste me politika sociale ku ka aspekte familjare, por këto janë të fshehura, jo të dukshme (Polonia për shembull); 2) shtete ku politikat sociale mbizotërohen nga aspektet familjare (Çekia, Sllovakia, Sllovenia); 3) vendet ku politikat sociale kanë mbështetje të gjithanshme (si në Lituani dhe Hungari, për shembull); dhe 4) mobilizim i theksuar i grave në tregun e punës si në Estoni dhe Letoni (115).

Tendenca e politikave sociale jofamiljare është shoqëruar edhe nga një tendencë tjetër që është quajtur "familjarizimi i ri". Kjo tendencë e vë theksin mbi zgjedhjen e prindërve dhe pagesat për kujdesin familjar përbëjnë instrumentin

kryesor politik për arritjen e saj (116). Finlanda dhe Franca i aplikuan këto pagesa fikse në vitet '80, ndjekur nga Norvegjia, Suedia dhe Gjermania në vitin 1998, 2008 dhe 2013, përkatësisht. Kjo politikë ka ngjallur kritika të ashpra, pasi mendohet që përbën barrierë për punësimin e grave dhe ul shanset e edukimit të barabartë, por megjithatë, studiues të tjerë argumentojnë se këto pagesa, së bashku me masat e tjera jofamiljare, mund të zgjerojnë zgjedhjet prindërore (117).

Të drejtat për shërbime të kujdesit ndaj fëmijëve po integrohen më ngadalë në politikat kombëtare të shteteve të ndryshme (108). Kështu, në Finlandë të gjithë fëmijët e moshës parashkollore kanë të drejtë të frekuentojnë kopshtet apo çerdhet publike, kurse vendet e tjera nordike, Gjermania dhe Anglia po synojnë drejt kësaj politike gjithashtu (108). Kurse në Poloni, Austri, Hungari dhe Qipro ofrohet falas dhe në mënyrë të detyrueshme arsimimi publik parashkollor (viti i fundit përpara moshës shkollore) (118).

### 2.10.5 Përfitimet financiare

Përfitimet financiare të përfshira në politikat sociale (në formën e pagesave direkte, pagesa për shërbime të caktuara apo politikës së taksave) bazohen nga orientimet ekonomike dhe social-politike të politikave sociale: familjet me fëmijë sjellin përfitime për shoqërinë, kanë kosto të larta, kapacitete të ulëta për gjenerimin e të ardhurave (për shkak të detyrimeve për t'u kujdesur për anëtarët e saj) dhe rrezik më të lartë për varfëri sesa shtëpitë pa fëmijë (114). Në pjesën më të madhe të rasteve, mbështjetja financiare jepet në formë direkte dhe më pak aplikohet pagesa për shërbime të caktuara ose lehtësim i taksave, edhe pse përfitimet jomonetare po rriten me ritme më të larta sesa rritja e pagesave direkte. Gjithashtu, më shumë peshë po marrin dhe përfitimet nga taksat (119). Në përgjithësi, shtetet e ndryshme preferojnë një nga politikat e disponueshme sesa një përzierje të tyre (120).

Pagesat financiare direkte janë politika sociale më e rëndësishme në shumicën e shteteve. Këto variojnë në lloje dhe përfshijnë pagesa të caktuara për çdo fëmijë/familje, pagesa për shkëputjen nga puna, mbështetje financiare për familjet me një prind, pagesa financiare direkte që shkojnë për kujdesin ndaj fëmijëve. Mund të ketë dhe pagesa për siguracionet sociale dhe për strehimin.

Pagesat për fëmijë ekzistojnë në të gjithë vendet e Bashkimit Europian, por nivelet e tyre variojnë së tepërmi (121), edhe pse në përgjithësi përfitimet financiare direkte u ulën gjatë viteve '90 në pjesën më të madhe të shteteve (119). Gjatë periudhës 2000-2005, shpenzimet publike që shkonin për pagesat direkte pësuan rritje në tetë vende të Bashkimit Europian (BE), në pesë prej tyre nuk ndryshuan, kurse në Çeki, Belgjikë, Francë, Finlandë, Holandë dhe Poloni ato pësuan rënie (119). Një rënie e konsiderueshme e pagesave direkte u vërejt në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore në vitet që pasuan rënien e

komunizmit, por më pas situata filloi të përmirësohej gradualisht.

Pagesat direkte paguhen në mënyra të ndryshme në vende të ndryshme. Për shembull, në disa shtete ato paguhen si përfitime universale, kurse në shtetet të tjera ato varen nga të ardhurat, mosha dhe numri i fëmijëve. Në pesë shtete të BE-së, e drejta e përfitimit të pagesave financiare direkte varet nga statusi i punësimit, kurse në nëntë shtete të tjera (pesë nga Europa Jugore dhe katër vende ish komuniste), ajo merret pas kontrollit të nivelit të të ardhurave (122). Në përgjithësi, shpërblimi monetar direkt i bazuar në nivelin e ulët të të ardhurave në Europën Jugore është parim i politikave sociale, kurse në vendet ish komuniste motivi i tij është për shkak të mungesës së burimeve financiare (122). Në pjesën më të madhe të shteteve të BE-së aplikohet pagesa direkte bazuar në numrin e fëmijëve, duke përfaqësuar në këtë mënyrë stimuj për rritjen e fertilitetit, por edhe faktin që familjet e mëdha përballen me vështirësi më të shumta (122).

Përfitimet financiare bazuar në taksa nuk janë të aplikuara shpesh. Me rritjen e nivelit të punësimit të grave filloi të aplikohej taksimi i diferencuar: në disa shtete me taksa më të ulëta për gratë e martuara apo që mbanin një familje, kurse lehtësimi i taksave i lidhur me fëmijët aplikohet në pothuajse të gjithë vendet e BE-së (121). Në fakt, në pjesën më të madhe të vendeve të zhvilluara, kontributi i familjeve me fëmijë në buxhetin e shtetit është më i ulët sesa ai i familjes të së njëjtës madhësi, por që nuk kanë fëmijë (114), duke konfirmuar faktin që këto familje ndihmonin nëpërmjet sistemit të taksimit si pjesë e politikave sociale të këtyre vendeve. Shumica e shteteve të BE-së gjithsesi aplikon të njëjtën normë taksimi si në rastet kur në familje ka vetëm një person që punon, ashtu dhe në ato raste kur të dy prindërit punojnë (114).

Politikat e mbrojtjes sociale kanë ndikim të fortë në varfërinë në terma afat-gjatë. Ato shtete ku mbështetja financiare është më e lartë, raportojnë nivelet më të ulëta të varfërisë. Më parë ne përmendëm që, sipas Esping-Andersen, sistemet e mirëqenies sociale ndahen në tre katogori. Në vijim, paraqitet një përshkrim më i detajuar i secilës prej këtyre kategorive:

- Sistemet social-demokratike ose nordike të mirëqenies sociale, të cilat bazohen në investime që promovojnë punësimin dhe rritjen, duke siguruar shërbimet sociale gjithëpërfshirëse për fëmijët dhe të moshuarit.

- Sistemet konservatore, korporatiste ose kontinentale të mirëqenies sociale, të cilët aplikojnë sisteme të siguracioneve sociale që ofrojnë mbrojtje të lartë për personat e përfshirë në skemë, ndërkohë që rregullojnë fuqimisht punësimin dhe tregun e punës. Këtu përfshihen Gjermania, Austria, Belgjika, Franca dhe Luksemburgu.

- Sistemet liberale ose anglo-saksone të mirëqenies sociale, të cilët kanë

pasur një tranzicion duke futur elemente të modelit të investimeve sociale. Gjithsesi në këto sisteme, nivelet e përfitimeve mbeten të ulëta. Ato mbështeten shumë në kontrollin e të ardhurave dhe mjeteve të jetesës dhe një pjesë e mirë e shërbimeve shtetërore janë privatizuar (88).

Vendet me regjime social-demokratike si vendet skandinave (nordike) për shembull kanë nivele të ulëta të varfërisë, kurse shtetet me politika liberale të mbrojtjes sociale (si SHBA, ku iniciativa i lihet tregut privat dhe ndërhyrja e shtetit është minimale), përjetojnë nivele të larta varfërie, e cila është e qëndrueshme (123). Megjithatë, kjo nuk është absolute. Për shembull, Anglia dhe SHBA klasifikohen si shtete me sisteme liberale të mirëqenies sociale, por ato kanë diferenca të mëdha (88). Kjo nënkupton që pjesa më e madhe e variacionit nuk shkaktohet nga lloji i sistemit të aplikuar, por më tepër influencohet nga faktorët strukturalë të tillë si: nevojat e shtëpisë, kapitali njerëzor i anëtarëve të saj, dinamikat e tregut të punës, shpërndarja e të ardhurave në vend dhe kontributet e faktorëve të tjerë socio-ekonomike të tillë si: klasa sociale, edukimi dhe statusi i punësimit (124).

Nga ana tjetër, politikat e mbrojtjes sociale janë shumë të rëndësishme për reduktimin e varfërisë së fëmijës, duke përcaktuar dhe tendencat e kësaj varfërie (125). Natyrisht, shtetet që shpenzojnë më tepër për sistemet e mbrojtjes sociale (duke përjashtuar pensionet), raportojnë nivelet më të ulëta të varfërisë së fëmijëve. Megjithatë, shtete të ndryshme që janë të ngjashme për sa i përket të ardhurave dhe që shpenzojnë përqindje të ngjashme të PBB-së të tyre për sistemin e mbrojtjes sociale, kanë pasur rezultatet shumë të ndryshme lidhur me nivelin e varfërisë së fëmijëve. Në përgjithësi, pagesat që bëhen në kuadrin e mbrojtjes sociale në BE, e reduktojnë rrezikun e varfërisë së fëmijëve me rreth 50% (125).

### 2.10.6 Mbrojtja sociale për të moshuarit

Gjendja e kujdesit ndaj të moshuarve në Europë është përshkruar në mënyrë të hollësishme në projektin e financuar nga Komuniteti Europian "Shërbimet në mbështetje të kujdestarëve familjarë të të moshuarve në Evropë" (126,127). Në mënyrë të përmbledhur, studimi raportoi që arsyet kryesore se përse anëtarët e familjes kujdeseshin për anëtarët më të moshuar të familjes, kishin të bënin më sëmundjet kronike, paaftësinë ose nevoja të tjera të të moshuarve. Motivimet për ofrimin e kujdesit ndaj të moshuarve përfshinin lidhjet emocionale, ndjenjën e detyrës dhe detyrimit ose fakti që nuk kishte alternativë tjetër. Gratë ishin personat që kujdeseshin më shpesh për të moshuarit dhe gjithashtu personat e moshuar që merrnin ndihmë ishin më shpesh gra (126,127). Në mbi gjysmën e rasteve, fëmijët e të moshuarve kujdeseshin për ta.

Nga ana tjetër, më pak se një e treta e kujdestarëve kishin përdorur një shërbim të kujdesit, kurse gati të gjithë të moshuarit e kishin bërë këtë gjatë

gjashtë muajve të fundit. Variacionet midis shteteve ishin shumë të mëdha. Barrierat kryesore për përfitimin e shërbimeve të mbështetjes sociale ishin shpërndarja e shërbimeve, veçanërisht në zonat rurale, procedurat burokraktike komplekse për të pasur akses, mbulimi i papërshtatshëm dhe refuzimi i të moshuarve për të pranuar shërbimet.

Studiuesit kanë shqyrtuar sesi ndikojnë shërbimet formale shtetërore të kujdesit në kujdesin e ofruar në familje (128). Përfundimi ishte se, ofrimi i shërbimeve shtetërore nuk e zvogëlonte nevojën për kujdesin familjar ndaj të moshuarve, madje rezultatet ishin në favor të "përgjegjësisë mikse", duke sugjeruar që në shoqëritë me shërbime të zhvilluara, kujdesi nga familja dhe shteti veprojnë së bashku (128). Kjo gjetje është në kontradiktë me atë të studiuesve të tjerë, të cilët kanë sugjeruar që kujdesi ndaj të moshuarve do orientohet drejt sektorit publik (129).

Lidhur me reduktimin e kostove, studimet tregojnë se pothuajse në të gjitha vendet kujdesi ndaj të moshuarve po orientohet në ambientet e shtëpisë, ofrimit privat dhe pagesave direkte me para në dorë. Kjo sepse mënyra sesi është organizuar dhe financuar kujdesi ndaj të moshuarve, ka çuar në diferenca të mëdha në krijimin e një tregu formal të këtij kujdesi (130). Për më tepër, modelet kombëtare të punësimit ravijëzojnë tiparet e tregut të punës lidhur me kujdesin ndaj të moshuarve, duke ndikuar në sasinë dhe cilësinë e ofertës së kujdesit, shkallës së ofrimit të tij dhe shkallën e varësisë ndaj kujdestarëve (130). Kështu që dy prirjet kryesore lidhur me kujdesin ndaj të moshuarve në Europë sot janë: së pari, privatizimi i kujdesit formal profesional, dhe së dyti, rifamiljarizimi i kujdesit me ose pa kompensim financiar nga ana e shtetit (131,132).

Në përfundim mund të themi që shërbimet formale apo shtetërore të kujdesit ndaj të moshuarve janë të rëndësishme për familjet në nevojë. Por shërbimet formale të kujdesit social janë të lidhura ngushtë me kujdesin joformal (familjar, të ofruar nga anëtarët e familjes). Por për këtë duhet të krijohen kushte të përshtatshme. Për shembull, anëtarëve të familjes që kujdesen për të moshuarit e tyre duhet t'u krijohen kushte që ata të jenë në gjendje të kombinojnë punën me kujdesin, njëkohësisht dhe në vazhdimësi. Nëse kushtet e punës dhe shërbimet nuk janë fleksibile, atëherë ky fleksibilitet do të gjenerohet nga burimet informale, që në të shumtën e rasteve bien mbi shpatullat e grave (133).

### 2.10.7 Politikat lokale të mbështetjes sociale

Zakonisht politikat e mbështetjes sociale dhe shërbimet e mbrojtjes sociale ofrohen dhe zbatohen në nivelin e qeverisjes lokale, duke i hapur rrugë variacioneve lokale në ofrimin e këtyre shërbimeve. Megjithatë, politikat sociale në nivel lokal janë shumë të vështira për t'u studiuar krahasuar me politikat në nivel kombëtar për shkak të larmishmërisë së madhe. Përveç kësaj, në pothuajse të gjithë vendet e BE-së, një rol të rëndësishëm komplementar në ofrimin e shërbimeve publike dhe ofrimin e mbështetjes për familjet luajnë dhe organizatat joqeveritare (134,135). Në nivel kombëtar, sistemet e mbrojtjes sociale janë të paharmonizuar në një shkallë të madhe, duke lënë shtigje për zhvillime të shumta të politikave lokale të mbrojtjes sociale. Në Francë, për shembull, vetë shteti promovon ndërhyrje lokale të llojeve të ndryshme, kurse në Gjermani dhe Itali, politikat sociale lokale drejtohen nga rajonet ose bashkitë, duke pasur një natyrë më fleksibile. Për shkak të këtyre përgjegjësive të pushtetit lokal, mbrojtja sociale që ata ofrojnë është emërtuar me termin "mbrojtja sociale lokale", që aplikohet gjerësisht në Gjermani dhe Suedi, kurse në Francë dhe Angli sistemi i mbrojtjes sociale është shumë i centralizuar (136). Megjithëse nuk ka studime krahasuese lidhur me politikat sociale në nivel lokal, politikat sociale dhe ndërhyrjet në nivel lokal po tërheqin një interes në rritje.

### 2.10.8 Masa financiare apo institucionale të mbrojtjes sociale?

Në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, shembja e regjimeve komuniste u shoqërua me ndryshime të thella edhe në politikat sociale. Përpara viteve '90, synimi kryesor i politikave sociale në këto vende ishte angazhimi në punë i grave duke çuar në zhvillimin e politikave dhe shërbimeve sociale universale për të ndihmuar harmonizimin e punës dhe familjes në këto vende ku përfshiheshin, për shembull, sigurimi i strehimit apo pagesat për lindjen e fëmijëve, veçanërisht në Rumani. Përfitimi ekonomik ofrohej kryesisht nëpërmjet përfitimeve për fëmijët, duke përbërë një burim të rëndësishëm të të ardhurave shtesë për shumë familje në vendet ish komuniste (137).

Gjatë periudhës së tranzicionit, shumë prej këtyre politikave u ndërprenë. Rritja e papunësisë, rënia e standardit të jetesës dhe problemet në financat kombëtare çuan në shkurtimin e shpenzimeve për shërbimet e mbrojtjes sociale. Në Çeki, Estoni, Hungari, Poloni, Rumani dhe Lituani u reduktua mbështetja financiare, u kufizuan përfitimet dhe u shtrënguan kriteret për marrjen e tyre, u reduktuan shërbimet publike të kujdesit ditor për fëmijët nën tre vjeç dhe u stimulua kujdesi në shtëpi për fëmijët, duke rishikuar skemat e largimit të përkohshëm nga puna (138). Vetëm në Slloveni, ndryshimi i regjimeve nuk u shoqërua me ndryshime drastike në politikat sociale.

Nga fundi i viteve '90, qeveritë e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore filluan të përmirësonin gradualisht shërbimet sociale, duke rritur pagesat për

fëmijët (Slloveni) apo aplikimin për herë të parë të pagesave për lindjen e çdo fëmije (Çeki), rritjen e kompensimit monetar (Hungari dhe Rumani), uljen e taksave për familjet me fëmijë (Estoni dhe Lituani) dhe skema të ndryshme ku përfshihet taksimi (Poloni) (138). Megjithatë, infrastruktura e dobët për ofrimin e kujdesit për fëmijët nën tre vjeç bëri që, modeli i kujdesit të ofruar në shtëpi të ishte dominues për gratë për të kombinuar punën me familjen. Për më tepër, kujdesi joformal (familjar) është ende shumë i përhapur në këto vende (138).

Politikat sociale që kanë të bëjnë me punësimin, përveç skemave të shkëputjes nga puna, kanë qenë të vakta në vendet ish komuniste të Europës. Shkëputja nga puna pas lindjes duke garantuar kompensim financiar të lartë (për personat e punësuar), është një praktikë që garantohet dhe që funksionon mirë në pjesën më të madhe të këtyre shteteve. Por pasi kjo periudhë mbaron vështirësitë ekonomike i detyrojnë të dy prindërit që të punësohen me kohë të plotë, duke nënkuptuar një sistem jofleksibël në kombinimin e punës me aspektet e kujdesit ndaj familjes. Për shembull, përqindja e grave me fëmijë që kanë mundësinë të punojnë me kohë të pjesshme në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, është shumë më i ulët sesa në vendet e Europës Perëndimore (138).

Politikat e mbështetjes sociale kanë ndjekur një trajektore të ndryshme në Europën Perëndimore. Rritja e punësimit të grave dhe nënave nxiti qeveritë e këtyre vendeve që të gjenin forma dhe politika sociale për harmonizimin e punës me detyrimet familjare të tyre. Garantimi dhe përmirësimi i përfitimeve të lejes pas lindjes, aksesi ndaj punës me kohë të pjesshme dhe rritja e vëmendjes ndal roleve të veçanta të burrave dhe grave në familje çoi në ndryshimin gradual nga modeli i familjes ku vetëm një anëtar punon, drejt modelit, ku burri dhe gruaja punojnë (138). Në këto vende, prindërit mund të kombinojnë lejen e lindjes me skema të ndryshme të punësimit me kohë të pjesshme. Natyrisht kohëzgjatja e kohës së lejes së paguar pas lindjes dhe skemat e punësimit me kohë të pjesshme variojnë nga njëri vend në tjetrin.

Siç e përmendëm, ofrimi i kujdesit publik për fëmijët nën tre vjeç është shumë mirë i organizuar në vendet nordike, kurse vendet e tjera të Europës Perëndimore ende janë mbrapa në këtë drejtim. Vendet nordike shpesh etiketohen si vendet ku janë realizaur përpjekjet më domethënëse dhe politkat sociale më gjithëpërfshirëse për të harmonizuar punën me detyrimet familjare (138). Kurse në vendet e tjera, fokusi kryesor ka qenë reduktimi i përjashtimit social dhe i varfërisë duke targetuar familjet me shumë anëtarë, si në Itali dhe Qipro. Pëfitimet janë selektive, të bazuar në testimin dhe kontrollin e nevojave dhe të ardhurave dhe ofrimi i shërbimeve është deleguar drejt pushteti lokal, OJQ-ve dhe kishave (138). Ofrimi i punësimit me kohë të pjesshme nuk është një politikë popullore ose e aplikuar gjerësisht në vendet e Europës Jugore.

Përfitimet financiare vazhdojnë të përbëjnë masën kryesore të mbështetjes sociale në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, kurse në Europën

Perëndimore përpjekjet janë përqendruar në zhvillimin e masave institucionale dhe kombinimin e punësimit me kohë të pjesshme dhe detyrimet familjare.

### *2.10.8.1 Qëndrimet e publikut për masat financiare dhe institucionale të politikave sociale*

Vendet me nivele shumë të ulëta të fertilitetit, dhe sidomos vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, duket se preferojnë më tepër masat financiare kundrejt atyre institucionale. Këto masa financiare përfshijnë ato që reduktojnë kostot e lindjes së fëmijës, pagesat në lindje dhe përmirësimin e kushteve të tërheqjes së përkohshme nga puna. Por edhe masat që kanë të bëjnë me taksat, janë të mirëpritura në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore. Kurse masat institucionale si përmirësimi i shërbimeve publike të kujdesit për fëmijët nën tre vjeç nuk konsiderohen aq të rëndësishme sa masat financaire në këto shtete (138). Përveç kësaj, publiku në Europën Qendrore dhe Lindore preferon të kujdeset për fëmijët në shtëpi, duke pasur parasysh që në këto vende lejohen nënat të rrinë në shtëpi për periudha relativisht të gjata, duke ruajtur vendin e punës edhe pse pagesa pas disa kohësh reduktohet shumë. Ndërhyrje të tjera që gjejnë mbështetje të gjerë publike në këto vende, janë dhe ato që kanë të bëjnë me lehtësimin apo sigurimin e strehimit (138).

Vendet me nivele të ulëta fertiliteti si Austria, Gjermania Perëndimore dhe Qipro favorizojnë më shumë masat institucionale të mbështetjes sociale krahasuar me ato financiare. Publiku këtu është shumë i interesuar për format e reja të mbështetjes sociale që rritin fleksibilitetin në punë dhe sidomos masat që favorizojnë punësimin me kohë të pjesshme. Në këto vende përmirësimi i kujdesit publik për fëmijët gjen gjithashtu mbështetje të gjerë dhe favorizohet kundrejt pagesës për prindërit që të kujdesen në shtëpi për fëmijët e tyre (138).

Në shtetet me nivel të moderuar të fertilitetit të tilla si: Belgjika, Finlanda dhe Holanda, politikat sociale që nxitin kujdesin në familje nuk janë popullore. Përkundrazi, përparësi marrin masat institucionale që kanë të bëjnë me çështjet e punës. Kurse midis masave me karakter financiar, mbështetje më të fortë kanë skemat që përmirësojnë kushtet e tërheqjes së përkohshme të punës dhe ato që kanë të bëjnë me taksimin, edhe në rastet kur pagesat financiare direkte janë mjaft të larta (si në Austri për shembull) (138). Kurse prindërit në përgjithësi favorizojnë masat financiare kundrejt atyre institucionale në pothuajse të gjithë vendet e Europës (138).

### 2.10.8.2 Faktorët që ndikojnë në preferencat për masat financiare apo institucionale të politikave sociale

Të dhënat sugjerojnë që rritja e moshës shoqërohet me ulje të preferencës për masat financiare dhe institucionale, kurse statusi i partneritetit nuk kishte ndonjë efekt të përcaktuar qartë. Në të gjitha vendet, gratë i vlerësonin më tepër masat financiare dhe institucionale krahasuar me burrat dhe diferencat ishin më të mëdha lidhur me masat institucionale, veçanërisht midis prindërve me një fëmijë në vendet me të nivele të ulëta ose të moderuara të fertilitetit (138). Gratë në përgjithësi janë shumë më në favor të politikave sociale që rritin fleksibilitetin në punë dhe përmirësojnë kujdesin ndaj fëmijëve.

Niveli i lartë i edukimit ishte i lidhur me pranueshmëri më të ulët të masës financiare midis personave pa fëmijë dhe atyre me fëmijë, por nga ana tjetër edukimi më i lartë shoqërohej me pranueshmëri më të lartë të masave institucionale. Të qenit i papunë duket se ka vetëm ndikim të kufizuar në pranueshmërinë e masave të ndryshme të politikave sociale. Punësimi shoqërohej me ulje të pranueshmërisë së masave financiare dhe rritje të pranueshmërisë së masave institucionale, por ky impakt ishte domethënës vetëm midis prindërve në vendet me nivel të moderuar të fertilitetit (138).

Interesant ishte ndikimi i madhësisë së pritshme të familjes në preferencat e masave të politikave sociale. Personat pa fëmijë por që dëshironin të kishin vetëm një fëmijë në të ardhmen, treguan më pak interes për masat institucionale të politikave sociale krahasuar me personat që do dëshironin të kishin më shumë fëmijë. Por interesi për masat financiare nuk u rrit kur kalohej nga familjet me 2-3 fëmijë në familjet me më shumë se tre fëmijë. Personat që dëshironin familje të madhe ishin më pak në favor të masave institucionale. Kurse midis personave që ishin prindër tashmë, madhësia e ardhshme e familjes nuk influenconte dukshëm në qëndrimet e tyre lidhur me masat e politikave sociale në vendet me nivel të ulët fertiliteti.

Kurse në vendet me nivel shumë të ulët të fertilitetit kishte mbështetje të gjerë për masat financiare të politikave sociale (138), duke nënvizuar edhe një herë që aspektet ekonomike janë shumë të rëndësishme për këto komunitete. Për shembull në Rumani, Hungari dhe Poloni, opinioni publik favorizonte së tepërmi përmirësimet e aspekteve financiare të politikave sociale. Në këto vende, përfitimet financiare dhe pagesa e lejes pas lindjes janë të ulëta, kështu që ka kërkesë të lartë për përmirësim të tyre. Masat institucionale, në anën tjetër, gjetën më pak mbështetje midis polakëve, sllovenëve, çekëve dhe lituanezëve. Kjo sugjeron që qeveritë e vendeve të Europës Lindore duhet të përpiqen më shumë për lehtësimin e kostove që lidhen me lindjen dhe rritjen e fëmijëve, duke përmirësuar situatën financiare të familjeve të tyre (138).

Në vendet perëndimore me nivel të ulët të fertilitetit, austriakët favorizonin më rrallë masat financiare dhe më shpesh ato institucionale krahasuar me

gjermanët. Kurse qëndrimet kundrejt masave të lidhura me taksat dhe atyre që reduktojnë kohën e punës ose që rritin fleksibilitetin në punë në përgjithësi, kishin mbështetje të fortë publike (138).

Në grupin e shteteve me nivel të moderuar të fertilitetit, masat financiare u mbështetën më shumë në Finlandë sesa në Holandë, kurse qëndrimet lidhur me masat institucionale ishin të ngjashme, çka është surprizuese në kontekstin e politikave sociale shumë të ndryshme në të dy këto vende. Megjithatë, në të dy vendet, midis masave institucionale mbështetje më të gjerë kishte për masat që rritin fleksibilitetin e organizimit të punës dhe atyre që nxitin punësimin me kohë të pjesshme (138).

### 2.10.9 Përmbledhje

Lidhur me politikat sociale në nivel europian, kombëtar dhe lokal mund të evidentohen këto prirje:

- Politikat e mbështetjes sociale lidhur me familjen po marrin rëndësi gjithnjë e më të madhe vitet e fundit me prirjen drejt masave institucionale.
- Politikat e lejes së përkohshme nga puna po synojnë gjithnjë e më tepër patnerët meshkuj për të arritur një ndarje më të barabartë të përgjegjësive të punës dhe familjes midis dy partnerëve.
- Shërbimet e kujdesit për fëmijët përbëjnë një ndër masat kryesore në politikat sociale dhe tendenca është lëvizja drejt institucionalizimit të kujdesit, defamiljarizimit dhe rritjes së profesionalizmit të kujdesit ndaj fëmijëve (116,139,140).
- Një ndër prirjet e ardhshme do jetë dhe globalizimi dhe ndërkombëtarizimi i kujdesit.
- Rritja e rëndësisë së qeverisjes lokale e cila do të marrë më shumë përgjegjësi dhe autonomi lidhur me çështje të rëndësishme të politikave sociale.
- Rritje e rolit të OJQ-ve dhe rrjetit të aktorëve të ndryshëm të përfshirë në politikat sociale.

## 2.11 SFIDAT E POLITIKAVE TË MBROJTJES SOCIALE

Sistemet e mbrojtjes apo mbështetjes sociale janë nën presion në shumë vende të botës, ku më shumë se gjysma e punonjësve dhe personave që varen prej tyre, nuk janë të përfshirë në këto skema. Përqindja e njerëzve që punojnë në sektorin informal apo që kanë punë të paqëndrueshme (punë rastësore, punë në shtëpi ose lloje të ndryshme të vetëpunësimit) është në rritje në vendet e zhvilluara dhe sidomos në vendet në zhvillim, duke krijuar rreziqe të reja për punonjësit (141).

Reformat e ndërmarra në vendet në zhvillim kanë çuar zakonisht në uljen e pagave në sektorin publik dhe privat, duke dobësuar bazën financiare të skemave të sigurimeve sociale dhe uljen e financimit për politikat sociale. Ky fakt së bashku me menaxhimin e keq të tyre ka çuar në uljen e besimit të publikut në to dhe në shtimin e grupeve të njerëzve që nuk kontribuojnë në skemat sociale. Nga ana tjetër, sfidat komplekse cenojnë efektivitetin e politikave të mbrojtjes sociale: krizat financiare, konfliktet e armatosura, epidemitë e ndryshme si HIV/ADIS, katastrofat natyrore, apo edhe reformat që synojnë tranzicionin nga ekonomia e centralizuar drejt ekonomisë së tregut (si në rastin e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore) shkaktojnë humbjen e punës, punësimin informal dhe pasiguri të strehimit dhe të të ardhurave (141).

Objektivi i skemave të mbështetjes sociale është sigurimi i aksesit në kujdesin shëndetësor dhe siguria e të ardhurave. Çdo njeri ka të drejtën e sigurisë apo mbështetjes sociale (141).Natyrisht, niveli i mbështetjes sociale ndryshon në vende të ndryshme. Mbështetja sociale mund të marrë forma të ndryshme, si për shembull:

- Mbështetje për kujdesin shëndetësor, duke synuar ruajtjen e shëndetit të punonjësve dhe trajtimin e atyre që sëmuren.
- Skemat e pensioneve të cilat lehtësojnë daljen e punonjësve të moshuar nga tregu i punës kur produktiviteti i tyre ka rënë tashmë.
- Pagesa direkte në rastin e sëmundjeve të caktuara, që u heq punonjësve të caktuar presionin për të punuar kur janë të sëmurë.
- Siguracionet apo përfitimet direkte pas lindjes së fëmijëve, që nxit riprodhimin e forcës punëtore dhe ruajtjen e shëndetit të nënës që është ekonomikisht aktive.
- Skemat e mbrojtjes ndaj dëmtimeve në punë, që parandalon sëmundjet apo lëndimet e lidhura me punën dhe trajtimin e punonjësve që preken prej tyre.

- Përfitime direkte financiare ose në shërbime (punësimi i asistuar dhe trajnimet për shembull) në rastin e papunësisë, që mbështet të papunët derisa të gjejnë një punë të përshtatshme.
- Përfitimet financiare ose në shërbime (kujdes për fëmijët nëpërmjet kopshteve publike, akses në edukimin bazë, etj.) për fëmijët e lindur (dhe përfitime të tjera financiare direkte kur prindi është i papunë), krijojnë kushte që familjet me fëmijë të kenë të ardhura për ushqimin dhe jetesën e përshtatshme të tyre (141).

Në vendet e zhvilluara sistemi i përfitimeve në rastin e papunësisë varion së tepërmi. Në disa shtete të tilla si: Austria, Danimarka, Belgjika, Franca, Gjermania, Finlanda, Holanda, Zvicra, etj., përfitimet e papunësisë janë në nivel të lartë dhe kohëzgjatje të madhe, si dhe ka sisteme mbështetëse për personat e papunë që i tejkalojnë afatet kohore të marrjes së këtyre përfitimeve. Kurse grupi tjetër i shteteve të zhvilluara (Kanada, Australi, SHBA, Angli, etj.) karakterizohen nga përfitime më të ulëta në rast papunësie (141).

Këto lloj përfitimesh sociale u vunë në zbatim në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore nga fundi i viteve '80 dhe fillimisht ishin mjaft bujare, por më pas u reduktuan në sasi dhe kohëzgjatje dhe një pjesë e vogël e të papunëve e përfitojnë atë.

### 2.11.1 Mungesa e mbulimit me shërbime sociale

Një pjesë e madhe e popullatës në botë nuk përfitojnë asnjë lloj shërbimi të mbrojtjes sociale ose mbulohet vetëm pjesërisht. Kjo është situata në pjesën më të madhe të vendeve në zhvillim dhe madje edhe në disa shtete të pasura, ku ka boshllëqe në rritje lidhur me mbulimin me shërbime të mbrojtjes sociale (141).

Personat që punojnë në sektorin informal nuk përfshihen në skemat e politikave sociale për një sërë arsyesh: vështirësia për të mbledhur kontribute nga ata dhe nga punëdhënësit e tyre, pamundësia e tyre për të paguar premiumet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe mungesa e dëshirës për ta bërë këtë në rastin kur shërbimet e skemës së shërbimeve sociale nuk iu përgjigjen nevojave të tyre bazike, ku përfshihet kujdesi shëndetësor, mosvlerësimi jo real i nevojës së tyre për pensione, njohuritë e pakta rreth skemave të mbrojtjes sociale dhe përfitimeve nga to, etj. (141).

Gjithashtu, mbulimi i dobët me shërbime të mbrojtjes sociale ekziston edhe në vendet ku një pjesë e madhe ose e konsiderueshme e popullatës së tyre është e punësuar në bujqësi, e cila konsiderohet si një sektor informal punësimi, veçanërisht në vendet në zhvillim (141). Sektori informal është i pranishëm në shkallë të ndryshme, në të gjithë sektorët e aktivitetit njerëzor, duke përfshirë punëtorë të të gjithë kategorive: të punësuarit, të vetëpunësuarit, ata që bëjnë

punë shtëpie, punonjësit e shtëpisë që nuk paguhen, etj. Informaliteti mund të jetë i pranishëm jo vetëm në ekonomitë e vogla, por mund të përfshijë sisteme të tëra të parregulluara të pagesave në të gjithë ekonominë, si në Brazil ku pothuajse gjysma e punonjësve në zonat urbane paguhen në mënyrë informale (141). Për arsye që kanë të bëjnë kryesisht me diskriminimin gjinor dhe kombinimit më të lehtë të punës me detyrimet në familje, në sektorin informal punësohet një përqindje më e madhe e grave.

Puna në sektorin informal, përveç mungesës së përfitimeve nga skemat e mbrojtjes sociale, karakterizohet nga pasiguria e vazhdueshme për vendin e punës dhe të ardhurat, si dhe nga rreziqe më të larta meqë aktiviteti zhvillohet në mjedise të parregullta.

### 2.11.2 Mënyra për zgjerimin e mbulimit me shërbime të mbrojtjes sociale

Studiuesit kanë identifikuar disa mënyra për lehtësimin e mungesës apo pamjaftueshmërisë së mbrojtjes sociale, e cila mund të vijë për shkak se këto politika janë të papërshtatshme, ose se janë bërë përpjekje të pamjaftueshme për zbatimin e tyre apo të kontekstit të ndërlikuar ekonomik, social dhe politik (141). Natyrisht, elementi i fundit në radhë është shumë i rëndësishëm dhe mund të përcaktojë suksesin apo dështimin e këtyre përpjekjeve. Konteksti politik dhe natyra e regjimit qeverisës duhet të jetë receptive për zgjerimin e këtyre politikave sociale; sistemi ekonomik duhet të jetë dinamik dhe kërkesa për punë të jetë e lartë, sepse kështu një numër më i madh njerëzish do të kërkojnë pagesa më të larta dhe sisteme më të mira të mbrojtjes sociale; pritshmëritë për sistemet e mbrojtjes sociale nuk duhet të jenë maksimale ose jorealiste, por të arsyeshme, duke synuar jo thjesht një shpërndarje të të ardhurave nga të pasurit tek të varfërit, por ofrimin e sigurisë sociale për njerëzit kur ata janë të sëmurë, të paaftë, të papunë, në pension, etj. dhe, së fundmi, publiku duhet të ketë besim tek politikat sociale të propozuara. Kjo varet nga administrimi eficient i sistemit dhe standarde të larta në menaxhimin e financave (141).

Disa nga mënyrat për zgjerimin e mbulimit të popullsisë me shërbimet të mbështetjes sociale po i përshkruajmë në vijim.

1) Zgjerimi i skemave ekzistuese të sigurimeve sociale.
2) Inkurajimi i mikrosigurimeve (kryesisht për punonjësit e sektorit informal).
3) Aplikimi i përfitimeve universale ose shërbimeve të financuara nëpërmjet taksimit të përgjithshëm.
4) Aplikimi dhe zgjerimi i përfitimeve bazuar në kontrollin e nevojave (asistenca sociale), që gjithashtu financohet nga taksat.

Në Shqipëri, një nga format më të aplikuara të mbrojtjes sociale është asistenca sociale. Në fakt, kjo formë mbrojtjeje sociale ekziston në pothuajse të gjithë vendet e zhvilluara. Ajo shërben për të reduktuar boshllëqet e krijuara nga skema e mbrojtjes sociale dhe për të lehtësuar varfërinë. Zakonisht asistenca sociale përfshin një numër të vogël kategorish të popullatës, zakonisht të moshuarit (141). Në vendet e zhvilluara, skemat e asistencës sociale janë përgjithësisht të keqfinancuara.

Asistenca sociale ka qëllim të mbështetë vetëm personat në nevojë absolute dhe identifikimi i këtyre të fundit mund të bëhet nëpërmjet vlerësimit apo kontrollit strikt të të ardhurave dhe indikatorëve të tjerë në mënyrë që këto shërbime t'i përfitojnë vetëm ata që kanë më shumë nevojë. Por në praktikë, situata është shumë ndryshe pasi asnjë kontroll nuk mund të jetë absolut. Kështu, disa njerëz i përfitojnë këto shërbime në mënyrë të padrejtë, veçanërisht në vendet me një shkallë të lartë të ekonomisë informale (si në rastin e Shqipërisë, për shembull). Këto gabime janë të rëndësishme, pasi jo vetëm që kushtojnë në terma financiare, por edhe sepse ato ulin besimin e publikut në sistemin e mbrojtjes sociale (141). Nga ana tjetër, asistenca sociale, kaq shumë e përhapur në Shqipëri, zakonisht dështon për t'i ardhur në ndihmë personave që vërtet kanë nevojë për të për këto arsye:

- Këta persona nuk duan të aplikojnë për asistencë sociale për shkak të stigmës së lidhur me të.
- Mund të mos jenë në dijeni të së drejtës së tyre për të përfituar asistencë sociale me ligj.
- Mund të kenë vështirësi për të aplikuar për përfitimin e asistencës sociale për shkak të procedurave të komplikuara apo që duan shumë kohë të realizohen.
- Asistenca sociale zakonisht preket në një shkallë të lartë nga liria apo fleksibiliteti administrativ, duke i hapur kështu rrugë favorizimeve të caktuara, klientelizmit (edhe politik) dhe diskriminimit (141).

Nga ana tjetër, sa më i rreptë kontrolli dhe kriteret për përfitimin e asistencës sociale, aq më shumë do dekurajohen njerëzit për të aplikuar për të, duke rrezikuar që personat që vërtet kanë nevojë të mos i marrin këto shërbime. Në rastin e vendeve të zhvilluara, mekanizmat vetëpërzgjedhës janë më të përshtatshëm sesa kontrolli strikt i të ardhurave dhe mjeteve të jetesës. Për më tepër, asistenca sociale bazuar në kontrollin e kritereve për përfitimin e saj ka dhe një mangësi tjetër, sepse ajo i dekurajon njerëzit që të kursejnë (ose nxit shpenzimin), nëse ata mendojnë që këto kursime do u zbriten nga asistenca sociale.

Sigurisht, asistenca sociale është shumë e dobishme për disa grupe të pambrojtura, siç janë fëmijët dhe të moshuarit. Asistenca sociale mund të jetë zgjidhja e vetme për vejushat që nuk kanë mundur të plotësojnë vitet e punës për të përfituar të drejtën e pensionit ose burrat e të cilave nuk janë përfshirë në skemat e siguracioneve. Kjo është edhe një mënyrë për të ndihmuar familjet e varfëra me fëmijë të vegjël, ndaj dhe në shumë vende ky lloj përfitimi lidhet me detyrimin që fëmijët të ndjekin shkollën (141).

Natyrisht, asnjë nga këto modele nuk duhet përjashtuar, në varësi të vendit ku aplikohen ato, por kombinimi i tyre do të varet nga konteksti kombëtar dhe strategjitë kombëtare përkatëse. Për më tepër, modeli i zgjedhur do të varet nga niveli i zhvillimit ekonomik dhe social të çdo vendi. Disa vende në zhvillim, kryesisht vendet me të ardhura të mesme, kanë krijuar dhe zhvilluar institucionet e tyre të mbrojtjes sociale. Në këto raste, synimi mund të jetë shtrirja e mbulimit të detyrueshëm për të gjithë ose pjesën më të madhe të popullatës, duke përdorur skemat ekzistuese të sigurimeve sociale, ose duke i modifikuar kriteret në përputhe me nevojat e grupeve të reja në nevojë në popullatën target. Kurse në vendet me të ardhura të ulëta do të duhet një kombinim i studiuar i elementeve të mësipërm për të arritur ndonjë progres në mbulimin e komuniteteve të tyre më shërbimet e mbrojtjes sociale (141).

## 2.12 POLITIKAT E MBËSHTETJES SOCIALE DHE VARFËRIA

Një nga qëllimet kryesore të politikave të mbrojtjes/mbështetjes sociale është reduktimi i varfërisë. Por a janë efektive këto politika? Kjo temë është bërë pjesë e debateve në rrethet shkencore pasi disa studiues janë të mendimit që politikat sociale e lehtësojnë varfërinë, kurse disa të tjerë mbeten skeptikë bazuar kryesisht në faktin që një pjesë shumë e vogël e të ardhurave shkon vërtet tek ata që kanë nevojë më shumë, ose ofrimi i ndihmës ekonomike redukton iniciativën e të varfërve, duke krijuar kështu një "kurth varfërie", ose argumentet që taksat e larta dhe përfitimet ekonomike reduktojnë rritjen ekonomike, duke e tejkaluar efektin e reduktimit të varfërisë.

Mjaft studiues mbështesin tezën që politikat e mbrojtjes sociale reduktojnë varfërinë. Disa argumente kundër sugjerojnë që politikat që rishpërndajnë të ardhurat, nuk mund të reduktojnë varfërinë, madje mund ta rritin atë (142). Tre mund të jenë arsyet për këtë. E para, zakonisht është shumë e vështirë që paratë të shpërndahen tek ata që vërtet kanë nevojë për to, pra tek të varfërit (143,144). Madje, më shumë të ngjarë ka që përfitimet qeveritare t'i përfitojnë klasa e mesme dhe e lartë sesa klasa e ulët. Kjo është e vërtetë për SHBA (145) dhe për vendet e tjera të industrializuara, ku sistemet e mbrojtjes sociale janë universale, pra nuk fokusohen veçanërisht tek të varfërit (88). Por megjithë këto

vështirësi dhe barriera, ajo pjesë e parave që arrin tek të varfërit, gjithsesi duhet të ketë ndonjë ndikim për reduktimin e varfërisë.

Arsyeja e dytë ka të bëjë me faktin që rishpërndarja e të ardhurave mund të nxitë varësinë nga përfitimet dhe për pasojë të rritë varfërinë në vend që ta ulë atë (143). Këta persona fillojnë të mësohen të jetojnë me paratë e qeverisë dhe nuk interesohen të gjejnë punë. Por këto para nuk mjaftojnë për të përmbushur normalisht të gjitha nevojat e këtyre njerëzve ose për t'i nxjerrë ata nga varfëria dhe kështu ata futen në kurth nga varfëria për shkak të kësaj politike sociale.

Kritika e tretë mbron idenë që politikat e mbështetjes sociale kanë efekt negativ në rritjen ekonomike, sepse taksimi progresiv dhe përfitimet e larta të ofruara nga qeveria reduktojnë investimet dhe punësimin, duke dështuar në uljen e varfërisë (146).

Nga ana tjetër ka argumente që politikat sociale mund të kenë efekte pozitive. Programet e aspekte të tjera të politikave sociale mund të përmirësojnë fleksibilitetin në punësim, duke lehtësuar procedurat e daljes në pension (88), ose mund të krijojnë vende të reja pune, duke mbështetur punësimin e grave dhe në këtë mënyrë tejkalojnë efektet negative që përmendëm më lart (147).

Megjithatë, studimet e të dhënave për pesëmbëdhjetë shtete të ndryshme tregojnë që politikat e mirëqenies sociale kontribuojnë për reduktimin e varfërisë (148). Në këtë mënyrë, çdo përqindje më shumë e PBB-së që shpenzohet për politikat sociale, mund të reduktojë nivelin e varfërisë absolute me 0.75% (148). Nga ana tjetër, niveli i pasurisë i një vendi të caktuar në një kohë të caktuar nuk garanton nivele të ulëta të varfërisë për brezin e ri gjithashtu (148). Gjithashtu, një tjetër studim evidentoi një lidhje të qartë negative, pothuajse lineare, midis nivelit të shpenzimeve për politikat e mbrojtjes sociale dhe nivelit të varfërisë midis adultëve jo të moshuar në 11 vende të industralizuara: SHBA, Irlanda, Italia, Kanadaja, Anglia, Holanda, Gjermania, Austria, Suedia, Belgjika, Finlanda (149). Të dhënat treguan se në SHBA, të cilat shpenzonin rreth 4% të GDP së tyre për politikat sociale në 2004, rreth 15% e adultëve nën 65 vjeç ishin të varfër krahasuar me Suedinë apo Holandën, ku përqindja e GDP-ve përkatëse dedikuar politikave të mbrojtjes sociale ishin rreth 14%, dhe përqindja e varfërisë midis adultëve nën 65 vjeç varionte nga rreth 6% në Suedi, në rreth 8% në Holandë (149). Në këtë analizë, shpenzimet monetare për politikat sociale përjashtonin shpenzimet për shëndetin, edukimin dhe shërbimet sociale dhe përfshinin të gjithë format e përfitimeve financiare direkte (me lekë në dorë), subvencionet për programet e tregut të punës dhe përfitime të tjera financiare direkte (149). Nga ana tjetër, me rritjen e përqindjes së punëtorëve me kohë të plotë që paguhen më pak se 65% e të ardhurave, rritej dhe përqindja e adultëve nën 65 vjeç që konsiderohen si të varfër (149). Autorët arritën në konkluzionin që SHBA-të duhet të rritin shpenzimet për politikat sociale dhe përfitimet për punonjësit me paga të ulëta në familjet me të ardhura të ulëta, në mënyrë që

të reduktojnë varfërinë në mënyrë efektive (149), bazuar në eksperiencat e vendeve të tjera (150,151). Gjithashtu, një tjetër studim evidentoi lidhjen midis sistemeve të ndryshme të politikave sociale dhe varfërisë (152). Për shembull, përqindja e të varfërve në sistemet social-demokratike, korporatiste, liberale, europiano-jugore, post-komuniste, korporatiste dhe post-komuniste liberale ishte: 10.3%, 13.0%, 19.4%, 18.7%, 13.7% dhe 19.9%, përkatësisht, kurse përqindja e personave të cenueshëm ekonomikisht në këto vende ishte, përkatësisht, 12.6%, 15.0%, 20.3%, 28.2%, 34.6% dhe 40.1% (152). Me fjalë të tjera, vendet që shpenzojnë një pjesë më të madhe të PBB-së së tyre për politikat e mbështetjes sociale, kanë një prevalencë më të ulët të varfërisë dhe të personave në rrezik varfërie (sistemet social-demokratike) krahasuar me vendet që shpenzojnë një përqindje më të ulët të PBB-së së tyre për shërbimet sociale (sistemet liberale dhe post-komuniste qofshin korporatiste apo të tipit liberal), ku përqindja e të varfërve dhe atyre në rrezik varfërie është dukshëm më e lartë (152).

## 2.13 POLITIKAT E MBROJTJES SOCIALE NË SHQIPËRI

### 2.13.1 Vështrim i shkurtër historik mbi Shqipërinë

Shqipëria është një vend i vogël i lokalizuar në Europën Jug-Lindore. Shqipëria shpesh konsiderohet si "rasti më i vështirë" i ndryshimit të regjimeve krahasuar me vendet e tjera ish komuniste të Eurpës Qendrore dhe Lindore. Rruga e gjatë, e vështirë dhe shpesh herë kaotike drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut e ka vendosur vendin në një situatë të disavantazhuar krahasuar me vendet e tjera ish komuniste për shkak të progresit të kufizuar në këto drejtime (154). Deficitet historike të vendit, si për shembull eksperienca e shkurtër si vend i pavarur dhe demokracisë, zhvillimi i ulët social dhe ekonomik, ndasi të thella politike dhe lidershipe autoritare, mund të shpjegojnë tranzicionin e zgjatur dhe të vështirë të Shqipërisë dhe problemet me të cilat përballet ajo sot (154). Natyrisht, arsyeja kryesore e këtyre tipareve të shoqërisë shqiptare duhet kërkuar në regjimin tepër të ashpër komunist që sundoi vendin për rreth 45 vjet me radhë, regjim i cili pengoi lindjen dhe zhvillimin e liderëve apo organizatave, të cilat do të kishin vizionin e duhur për të drejtuar vendin drejt demokracisë pas rënies së sistemit komunist (154).

Tani Shqipëria është në fazën e integrimit europian, duke nënkuptuar një sërë standardesh që duhen plotësuar dhe një sërë sfidash për t'u përballur. Megjithatë, problemet që përshkruam më sipër, vazhdojnë të dominojnë jetën sociale, ekonomike dhe politike në Shqipëri (154).

### 2.13.2 Indikatorët e tranzicionit të dytë demografik në Shqipëri

Në Shqipëri , duke filluar nga vitet '90 e këtej duket se janë krijuar kushtet e përshtatshme, strukturore dhe ideore, për instalimin e tranzicionit të dytë demografik dhe ndryshimin e strukturës së familjes, në mënyrë të ngjashme me vendet e tjera të Europës Qendrore dhe Lindore. Megjithatë, Shqipëria ka disa karakteristika specifike që e bëjnë atë një rast unik mes vendeve ish komuniste të Europës.

Ndryshimet strukturore në Shqipëri janë të jashtëzakonshme përpara dhe pas viteve '90, ku vendi përjetoi investime të mëdha duke ndikuar në përmirësimin e infrastrukturës së saj dhe rritjen galopante të numrit të mjeteve të transportit. Por sërish, infrastruktura energjdtike dhe e transportit në Shqipëri mbetet mjaft larg standardeve europiane (155,156).

Në periudhën e regjimit komunist u bënë përpjekje të mira për arsimimin e popullatës. Treguesit pozitivë në mbulimin e popullatës me aktivitete edukuese u evidentuan dhe në Censusin e vitit 2011, i cili raportoi se 96% e popullatës 10 vjeç e lart ndjekin shkollën në Shqipëri, kurse përqindja e personave mbi 10 vjeç që ndjekin studimet e larta, është rritur nga 5.5% në 2001 në rreth 11% në vitin 2011 (157).

Lidhur me urbanizimin dhe migrimin, Shqipëria përbën një rast të veçantë studimi. Duke trashëguar një infrastrukturë shumë të dobët nën regjimin komunist, ardhja e demokracisë u shoqërua me një "bum" të vërtetë ndërtimesh dhe zhvendosje masive të popullsisë nga zonat e thella drejt qyteteve të mëdha dhe nga qytetet drejt kryeqytetit, Tiranës. Sektori i ndërtimeve përbën një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik në Shqipëri dhe vazhdon të jetë një prej sektorëve më dinamikë, pavarësisht vështirësive të vëna re kohët e fundit (158). Në vitin 2011, ky sektor gjeneronte rreth 15% të PBB-së së Shqipërisë (158). Zhvillimi i këtij sektori, së bashku me atë të shërbimeve, kanë ndikuar në rritjen e nivelit të urbanizimit në Shqipëri.

Këto zhvillime ndikuan në mënyrat e prodhimit ekonomik, duke çuar në zhvendosje të mëdha të popullatës nga zonat rurale drejt zonave urbane, në kërkim të një jete më të mirë. Duhet theksuar së rënia e regjimit komunist u shoqërua me emigrim të popullatës në vende të tjera dhe migrim masiv të saj brenda vendit (159). Arsyeja kryesore për këtë ishte rënia e regjimit komunist dhe bashkë me të pushoi së ekzistuari dhe ndalimi i zhvendosjes së popullatës brenda dhe jashtë vendit. Për pasojë, migrimi ka përfaqësuar një ndër fenomenet më të rëndësishme sociale dhe ekonomike në Shqipëri gjatë dy dekadave të kaluara (159). Si rrjedhim, popullsia urbane në vitin 2011 në Shqipëri ishte rreth 54% duke shënuar për herë të parë përmbysjen e raportit të popullsisë urbane dhe rurale (157). Rritja e zonave urbane, rritja e popullsisë banuese në to dhe rritja e dendësisë së popullsisë u shoqëruan me organizime të reja të mënyrës së jetesës, të mërrëdhënieve dhe të komunikimit në përgjithësi.

Megjithëse vazhdon të mbetet një nga vendet më të varfëra në Europë,

Shqipëria ka bërë progres të dukshëm në rritjen e të ardhurave dhe nivelin e konsumit. Kështu, tani vendi klasifikohet midis vendeve me të ardhura të mesme (160). Sidoqoftë, një pjesë e madhe e ekonomisë së vendit është informale, duke qenë përgjegjëse për 36% të PBB-së në periudhën 1996-2012 (161). Ky është një detaj i rëndësishëm për sa i përket politikave të mbrojtjes sociale në Shqipëri, duke përfaqësuar njëkohësisht një problem madhor dhe një sfidë për këto politika, siç do ta studiojmë në vijim.

Treguesit shëndetësorë në Shqipëri janë relativisht të favorshëm. Jetëgjatësia e pritshme në lindje është rreth 77 vjeç (162), niveli i fertilitetit është në rënie të vazhdueshme nga 2.98 në vitin 2003 (163) në 1.6 në vitin 2008-2009 (164). Vdekshmëria foshnjore (8.7 për 1000 lindje të gjalla) dhe amtare (5.8 për 100,000 lindje të gjalla) është mjaft e ulët, duke iu referuar statusit socio-ekonomike të Shqipërisë (165). Peshën kryesore në strukturën e vdekshmërisë e zënë sëmundjet kardiovaskulare dhe tumorale, kurse peshën më të vogël e zënë sëmundjet infektive (166). Kurse përdorimi i kontraceptivëve vazhdon të mbetet i ulët në Shqipëri (164).

Shqipëria po përjeton përmirësime të shpejta në sistemet e komunikimit dhe transportit, duke shënuar ritmet më të shpejta të rritjes së mbulimit të vendit me shërbimin e internetit (155), si dhe përmirësime të jashtëzakonshme në sektorë të tjerë (167). Teknologjia e komunikimit është shumë moderne dhe teknologjia mobile e komunikimit është shumë e përhapur. Një arsye për këtë këto përmirësime të shpejta është dhe trashëgimia shumë e varfër e sistemeve të komunikimit dhe transportit nga periudha komuniste dhe më tej. Këto ndryshime kanë patjetër ndikimin e tyre në ndryshimin e pikëpamjeve dhe ideve të njerëzve për botën në përgjithësi dhe natyrisht edhe pikëpamjet e tyre për familjen, duke përfaqësuar faktorët ideorë në ndryshimet e mundshme në strukturën e familjes në Shqipëri.

Të gjithë elementet strukturorë dhe ideorë që përmendëm më sipër dëshmojnë për "modernizimin" e stilit të jetës në Shqipëri ose përafrimin e saj me stilin "perëndimor" të jetesës dhe dëshmojnë që tranzicioni i dytë demografik po ndodh dhe në Shqipëri. Kështu, numri i divorceve, një fenomen pak i njohur gjatë periudhës komuniste, është rritur në mënyrë të konsiderueshme vitet e fundit. Gjatë viteve të fundit ka pasur mesatarisht rreth 3500 divorce në vit. Për shembull, në vitin 2001, në çdo 100 martesa, 9.6 prej tyre perfundonin në divorc, kurse në vitin 2012 kjo shifër arriti në rreth 16 divorce për çdo 100 martesa, kurse ritmi mesatar i divorceve kundrejt martesave gjatë periudhës 2001-2012 ishte rreth 14.5% (168). Gjithsesi, këto shifra janë shumë më të ulëta se në SHBA (169) dhe Europë (170), ku afërsisht gjysma e martesave përfundojnë në divorce. Në Europë, numri mesatar i martesave për çdo 1000 banorë u ul nga 7.9 në vitin 1970 në 4.8 në vitin 2008, kurse numri i divorceve për 1000 banorë është dyfishuar gjatë kësaj periudhe: 1 divorc për 1000 banorë në vitin 1970 dhe 2 divorce për 1000 banorë në vitin 2008 (170).

Mosha mesatare e martesës ka shënuar rritje për të dyja gjinitë gjatë përiudhës 2001-2012, me luhatje të vogla, ku mosha mesatare e martesës për meshkujt dhe femrat ishte 29.1 vjeç dhe 23.5 vjeç, përkatësisht (168). Gjithashtu, ndërsa deri në moshën 34 vjeç ritmi i martesave është i ngjashëm midis femrave dhe meshkujve, në moshën mbi 34 vjeç meshkujt e martuar janë tre herë më shumë sesa femrat e martuara (168).

Numri i lindjeve ka shënuar ulje drastike gjatë periudhës 1990-2012. Kështu, ndërsa përpara viteve '90 ka pasur mesatarisht 80000-90000 lindje në vit, në vitin 2012 kjo shifër ishte në rreth 35000 (168). Niveli i aborteve në Shqipëri është i lartë dhe i krahasueshëm me vlerat mesatare në rajonin e Europës. Kështu në Shqipëri, INSTAT (168) dhe Instituti i Shëndetit Publik (171) raportuan që për vitin 2012 kishte 190 dhe 224 aborte për 1000 lindje të gjalla, përkatësisht. Këto shifra janë më të larta se në Itali, Slloveni dhe Malin e Zi (171). Megjithatë, mendohet që ka nënraportime të theksuara lidhur me numrin e aborteve. Po sipas Institutit të Shëndetit Publik, rreth 6% e aborteve kryhen midis grave beqare (171), por mendohet që kjo shifër të jetë shumë më e lartë.

Megjithëse nuk ka shifra zyrtare, fenomeni i bashkëjetesës, vecanërisht midis të rinjve, është në rritje në Shqipëri (172).

Bazuar në sa më lart, është e qartë që tranzicioni i dytë demografik është duke u zhvilluar në Shqipëri, duke sjellë me vete dhe ndryshimin e strukturës së familjes shqiptare. Natyrisht, këto ndryshime në strukturën e familjes duhet të shoqërohen me ndryshimet përkatëse dhe përshtatjen e politikave të përfshirjes dhe mbrojtjes sociale, në mënyrë që këto t'i përgjigjen më mirë realitetit të ri të krijuar.

## 2.13.3 Historiku i politikave të mbrojtjes/përfshirjes sociale në Shqipëri

### *2.13.3.1 Panoramë e përgjithshme*

Për të kuptuar më mirë situatën aktuale, na duhet të risjellim në vëmendje faktin që Shqipëria doli nga LIIB me një infrastrukturë krejtësisht të shkatërruar, e cila ishte jo dhe aq pasojë e vetë Luftës sesa një trashëgimi fatkeqe e zhvillimeve historike të pafavorshme të Shqipërisë, sidomos nën sundimin otoman. Pas instalimit të regjimit komunist, partia komuniste mori kontrollin e plotë të shtetit dhe të shoqërisë, duke zbatuar një model qeverisje të tipit rus, siç ndodhi në vendet e tjera të ish-Jugosllavisë (173).

Qeveria komuniste mori nën kontroll çdo aset të shtetit shqiptar. Në këtë kontekst, sipas studiuesve, vende si Shqipëria nuk kishin nevojë të ngrinin një politikë sociale "zyrtare" , sepse "mbrojtja sociale ishte e mbrujtur ose pjesë e natyrshme" e procesve të prodhimit, shpërndarjes dhe gjenerimit të të ardhurave, të cilat drejtoheshin në mënyrë të centralizuar nga shteti (176). Të gjitha burimet e prodhimit, përfshirë punën e çdo lloj zanati apo trajnimi,

viheshin në lëvizje dhe kontrolloheshin nga agjencitë e planifikimit të qeverisë në mënyrë që të kontribuonin në prodhimin social. Pjesëmarrja në proceset e prodhimit i jepte njerëzve të drejtën për të ndarë konsumin e produkteve si kur ishin ekonomikisht aktivë, ashtu edhe kur bëheshin joaktivë për shkak të moshës, sëmundjeve, paaftësive apo lindjes së fëmijëve (176). Shteti vendoste se çfarë duhej të prodhohej dhe se si do shpërndaheshin të drejtat e konsumit, duke përcaktuar nivelin e të ardhurave dhe çmimet (176). Aksesi në edukim ishte universal për të gjithë dhe falas në varësi të moshës, aftësive dhe natyrisht besnikërisë politike ndaj regjimit. Gjithashtu, aksesi ndaj shërbimeve mjekësore apo shërbimeve të tjera në popullatë ofrohej falas për të gjithë, duke qenë krejtësisht i pavarur nga aftësia blerëse e individit. Edhe strehimi sigurohej nga shteti (176). Në mënyrë interesante, aksesi ndaj shumë shërbimeve sociale, si për shembull kopshtet për fëmijët dhe aktivitetet në kohën e lirë organizoheshin nga institucioni ku njerëzit punonin. Këto institucione ofronin përfitime bujare, pasi financat e tyre nuk vareshin nga balanca midis kostove të prodhimit dhe të ardhurave nga shitja e produkteve përkatëse, por nga fondet që qeveria caktonte për pagat dhe mirëqenien e punonjësve (176). Pjesë e "detyrave" sociale ishte dhe punësimi i komanduar i njerëzve duke i caktuar nëpër institucionet, uzina, fabrika apo kooperativa të ndryshme, pavarësisht nevojave të prodhimit. Në këtë mënyrë, punësimi thjesht nuk lejohej të materializohej nga sistemi dhe çdo njeri që kishte dëshirë dhe ishte në gjendje të punonte mbahej në punë (176).

### *2.13.3.2 Historiku i bazave ligjore të mbrojtjes sociale në Shqipëri*

Zanafilla e masave ligjore të mbrojtjes sociale në Shqipëri daton qysh prej krijimit të shtetit shqiptar në vitin 1912 (177). Duke filluar që nga ky vit ka një larmi të madhe të akteve kushtetuese dhe akteve ligjore në fushën e sigurimeve shoqërore. Nën regjimin e mbretit Zog, këto akte ligjore rregullonin kryesisht skemat e pensioneve shtetërore fillimisht për forcat e armatosura dhe më pas për nëpunësit. Aty përcaktoheshin kriteret për përfitimin e pensionit civil sipas numrit të viteve të punës ose arritjes së një moshe të caktuar. Pas çlirimit, sistemi i sigurimeve shoqërore ndoqi modelin rus, duke rregulluar sigurimet shoqërore fillimisht për nëpunësit dhe funksionarët e shtetit, të ndjekur nga përfshirja në skemë e popullsisë që jetonte në qytet e më pas të popullsisë në zonat rurale. Që në vitin 1949, përfitimi i pensioneve bazohej në kritere të moshës, gjinisë, vjetërsisë dhe vështirësisë në punë (177).

Përmirësime të tjera ndodhën përgjatë viteve duke futur lehtësira për gratë që lindin 6 fëmijë ose më shumë, ndaj filluan të zbatoheshin politikat e pensioneve të pjesshme dhe ndryshime të tjera. Në vitin 1966, një ligj tjetër mbi sigurimet shoqërore parashikonte "...mbështetje me mjete materiale për jetesë në rast paaftësie për punë dhe pleqëri" gjithashtu (177). Ndryshime të tjera i jepnin të drejtë grave që kanë lindur fëmijë, të marrin leje nga puna deri në 7 javë duke u

paguar me 80% të pagës së tyre përpara lindjes. U parashikua dhënia e pensionit të invaliditetit, pensionit familjar dhe sigurime për lejen e barrës dhe lindjes.

Ndryshimi i sistemeve politike e ndryshoi situatën rrënjësisht. Në ekonominë e tregut nuk ka garanci që të ardhurat nga puna do të mjaftojnë për mbulimin e nevojave, nuk ka punë të garantuar ose puna e ofruar mund të paguhet shumë pak. Për më tepër, mallrat dhe shërbimet bazë për një jetë normale, si për shembull, strehimi dhe kujdesi shëndetësor, ose që janë vendimtare për të ardhmen e njerëzve, si për shembull edukimi i lartë, nuk janë të disponueshme për ata që nuk mund të paguajnë koston e tyre (176). Pra, ekonomia e tregut bart me vete rrezikun e përjashtimit social. Por, shoqëria është solidare, sepse është në interesin e saj sigurimi i mirëqenies më të lartë të mundshme të të gjithë qytetarëve të saj. Në këtë mënyrë lind nevoja për politika sociale dhe strategji për të lehtësuar efektet negative që sjell ekonomia e tregut. Në ndryshim nga ekonomitë e centralizuara ku vendimi për shpërndarjen e burimeve ishte vullnet politik, në ekonominë e tregut kjo shpërndarje bëhet në varësi të ekuilibrave midis blerësve dhe shitësve në treg. Në këtë rast, pjesa më e madhe e burimeve që do mbështesin reduktimin e përjashtimit social, do të merren nga sektori privat, edhe pse shteti mund të gjenerojë vetë disa të ardhura nëpërmjet aktiviteteve të strukturave prodhuese në pronësi të tij. Pra, vullneti politik, që në këtë rast përfaqëson vullnetin e shumicës së shoqërisë sepse bëhet fjalë për sisteme demokratike, mund t'i "detyrojë" qytetarët të paguajnë një pjesë të të ardhurave të tyre, në formën e taksave ose kontributeve, drejt fondeve ose strukturave të caktuara, si për shembull sistemi i sigurimeve shoqërore ose i sigurimeve të kujdesit shëndetësor (176). Kjo është forma sesi shoqëria në sistemet demokratike shpreh solidaritetin e saj me grupet me vulnerabël.

Në këtë kontekst është e kuptueshme që strategjitë dhe politikat e përfshirjes dhe mbrojtjes sociale në Shqipëri, ashtu siç i njohim sot, janë zhvilluar, për arsyet që parashtruam më lart, pas ndryshimit të sistemeve politike, kur realiteti i ri kërkonte ndryshimin dhe rimodelimin e sistemit të mbrojtjes sociale në përputhje me ndryshimet e kohës. Sistemi i sigurimeve shoqërore që njohim sot hyri në fuqi në vitin 1993, duke u bazuar në parimin e drejtësisë sociale. Për administrimin e skemës u krijua paraprakisht (në vitin 1992) Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) (177). Aktualisht skema është jofitimprurëse dhe mbron personat e punësuar në rast sëmundjeje, papunësie, barrëlindjeje, aksidenti në punë/sëmundjeje profesionale, pleqërie, invaliditeti apo humbje të mbajtësit të familjes dhe personat e tjerë ekonomikisht aktivë (të vetëpunësuarit dhe punëdhënësit) në rast barrëlindje, pleqërie, invaliditeti dhe humbje të mbajtësit të familjes, bazuar në parimin "pay-as-you-go", të përgjegjësisë individuale mbi risqet sociale dhe parimin e solidaritetit midis brezave (177). Skema financohet nga kontributet e derdhura në mënyrë të detyrueshme nga punëdhënësit, të punësuarit dhe të vetëpunësuarit, për sa kohë janë në

marrëdhënie pune. Pagesat e përfitimeve përfaqësojnë shuma parash që duhet të mbulojnë të paktën standardin minimal të jetesës. Megjithatë, ndryshimet shoqërore dhe ekonomike sollën futjen e elementeve të rinj në skemë duke përfshirë sigurimin vullnetar, suplementar dhe krijimin e instituteve private të pensioneve (177), praktika këto të aplikuara në vendet e tjera. Sigurimi vullnetar i lejon personat jo në marrëdhënie pune të përfshihen në skemë; sigurimi suplementar u krijon mundësi personave të caktuar (funksionarët e lartë, ushtarakët dhe subjektet private) të përfitojnë pensione në një masë më të madhe ose më parë sesa lejojnë kriteret. Përveç këtyre, ekzistojnë dhe pensionet e posaçme shtetërore, që përfitohen nga personat me kontribute të shquara për vendin (177).

Një tjetër zhvillim në drejtim të zbutjes së efekteve financiare të tranzicioneve të sistemeve politike dhe mbështetjes së grupeve në nevojë ishte dhe krijimi i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) në vitin 1994 (178). Sipas Nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: "Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti. Kushdo ka të drejtë për sigurim shëndetësor sipas procedurës së caktuar me ligj" (179). Ky nen hedh bazat e solidaritetit të shoqërisë shqiptare kundrejt personave në nevojë, duke siguruar kështu mbështetjen e shoqërisë për këto grupe lidhur me aspektet e mbrojtjes dhe promovimit të shëndetit.

Skema e sigurimeve shëndetësore në Shqipëri financohet nga personat ekonomikisht aktivë dhe persona të tjerë me të ardhura të rregullta nga pronësia, të cilët janë të detyruar të paguajnë kontributin përkatës në favor të sigurimeve shëndetësore. (180). Disa aspekte të aktivitetit të ISKSH-së janë me rëndësi të veçantë në kuadër të mbështetjes sociale. Këtu mund të përmendim faktin që shteti paguan kontributet e sigurimeve shëndetësore për personat jo aktivë ekonomikisht: për fëmijët, nxënësit, studentët me shkëputje nga puna, pensionistët, personat me paaftësi mendore dhe fizike, të papunët, personat që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe asistencë sociale, nënat me leje lindjeje, nënat shtatzëna, etj. (180). Aktivitete të tjera në funksion të mbrojtjes së grupeve vulnerabël janë dhe aktet për statusin e invalidit, ku mjekët ishin të detyruar t'i ofronin shërbim në shtëpi këtyre personave, rimbursimi i barnave për kategori të caktuara të grupeve vulnerabël të shoqërisë, trajtimi falas për personat me kontribut të shquar për historinë e vendit dhe aksesin në shërbimin shëndetësor për të sëmurët, që për arsye të ndryshme nuk shkojnë dot në qendrën shëndetësore përkatëse (180). Gjithashtu, ligji lë të hapur mundësinë për përfshirjen e kategorive të tjera të popullsisë për të cilat shteti duhet të paguajë sigurimet shëndetësore, në varësi të zhvillimeve të reja.

## 2.13.4 Strategjia e mbrojtjes/përfshirjes sociale në Shqipëri

Mbrojtja sociale në Shqipëri realizohet nëpërmjet një sërë komponentësh, strategjish, aktorësh dhe sektorësh. Shtyllat kryesore të mbrojtjes sociale përfshijnë pagesat financiare direkte, ofrimin e shërbimeve sociale, masat për përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël, sigurimet shoqërore dhe sigurimet shëndetësore (181).

Politika e përfshirjes apo mbrojtjes sociale në Shqipëri është një komponent i një kornize më të përgjithshme që emërtohet Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013, e cila harmonizon në një dokument të vetëm përspektivat për zhvillimin ekonomik dhe social të qëndrueshëm, në kuadër të integrimit në BE dhe realizimit të Objektivave të Mijëvjeçarit (181). SKZHI ravijëzon vizionin e zhvillimit të "një vendi me një nivel të lartë jetese, të integruar në strukturat europiane dhe euro-atlantike, demokratik dhe garant të lirive e të drejtave themelore të njeriut", duke synuar përfshirjen e gjerë të shoqërisë civile, komuniteteve vendore, të biznesit dhe grupet e interesit, strukturat akademike, shkencore e politike të vendit. SKZHI zëvendëson Strategjinë e mëparshme Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social, e cila kishte disa kufizime (181).

Një nga komponentët e SKZHI është dhe politika sociale, e cila synon rritjen e nivelit të punësimit si një mjet i fuqishëm për mbështetjen e rritjes ekonomike, kohezionit social dhe uljen e varfërisë, nëpërmjet një shërbimi fleksibël të punësimit, një sistemi të mbrojtjes sociale që identifikon në mënyrë të përshtatshme personat në nevojë dhe një sistem efektiv pensionesh, nxitjes së pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, një sistemi shëndetësor fleksibël kundrejt ndryshimeve demografike dhe një sistemi arsimor që siguron cilësi dhe përfshirjen e të gjithë fëmijëve në të (181).

Mbrojtja sociale është gjithashtu një komponent i rëndësishëm i SKZHI-së i trajtuar hollësisht në këtë dokument. Sipas SKZHI, financimi për aspektin kryesor të mbrojtjes sociale, ndihma ekonomike (NE) apo asistenca sociale u reduktua nga 0.8% në 0.4% të PBB-së në periudhën 2000-2005.

Përfitimi i ndihmës ekonomike është një proces me dy faza:

1) Fillimisht, pushteti qendror alokon burimet financiare në bllok për bashkitë dhe komunat, bazuar në nivelin përkatës të vlerësuar të varfërisë.

2) Njësitë vendore shpërndajnë ndihmën ekonomike për familjet në nevojë bazuar në përmbushjen e kritereve të caktuara (181).

Problemi kryesor është se niveli i mbulimit dhe i pagesave direkte financiare është mjaft i ulët (më pak se 15% e kufirit të varfërisë), duke ndikuar fare pak në lehtësimin e nivelit të varfërisë dhe duke i detyruar përfituesit të kërkojnë burime financiare shtesë (181).

Gjithashtu ofrohen shërbime rezidenciale dhe ditore për grupe të tjera

të pambrojtura si fëmijët jetimë, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e trafikimit, personat me probleme sociale, etj. Në kuadër të decentralizimit të kompetencave dhe përgjegjësive, po bëhen përpjekje për zhvillimin e shërbimeve në nivel komuniteti për t'i ardhur më mirë në ndihmë personave që jetojnë vetëm (181).

Strategjia e Mbrojtjes Sociale, sipas SKZHI-së, ka këto përparësi strategjike dhe politike:

1. Asistenca sociale si mjeti kryesor për reduktimin e varfërisë. Është e domosdoshme rritja e eficiencës së menaxhimit të programeve kryesore të pagesave financiare direkte nëpërmjet:

- Përmirësimit të informacionit për identifikimin më të përshtatshëm të familjeve në nevojë. Kjo do të bëhet në bazë të hartave të varfërisë, censusit dhe anketave në familje.

- Rritjes së mbulimit të nevojave të familjeve përfituese, duke synuar arritjen e nivelit të varfërisë për person, por si tavan do jetë pensioni minimal në shkallë vendi. Pagesa mujore e ndihmës ekonomike do indeksohet në përputhje me strukturën e familjes dhe të diferencuar sipas grupeve të ndryshme të anëtarëve të saj, si dhe në varësi të nivelit të varfërisë.

- Lehtësimi i procedurave për vlerësimin e familjeve kërkuese.

- Shtrirjes së kushtëzimit të përfitimit të ndihmës ekonomike nëpërmjet punës në të gjithë vendin, për rritjen e transparencës në shpërndarjen e fondeve, uljen e përfituesve abuzivë dhe rritja e të ardhurave për familjet që angazhohen me punë në komunitet.

- Përmirësimit të subvencionit të energjisë (181).

2. Kujdesi social, për ofrimin e shërbimeve për personat në nevojë në familje dhe komunitetet e tyre, nëpërmjet:

- Decentralizimit të shërbimeve sociale. Pushteti vendor do jetë përgjegjës për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve, kurse rregullat për përfitimin e shërbimeve do përcaktohen nga Ministria e linjës. Për këtë qëllim, qendrat e shërbimeve rezidenciale do kalojnë nën administrimin e pushtetit vendor, si dhe do të ngrihen shërbime të reja sociale në komunitet sipas nevojave.

- Rritja e bashkëpunimit me organizatat joqeveritare si ofrues të shërbimeve sociale dhe institucionalizimi i këtij bashkëpunimi nëpërmjet licensimit të tyre.

- Shndërrimi gradual i shërbimeve rezidenciale në shërbime të lëvizsshme në komunitet, duke ofruar alternativa për strehimin, trajtimin, edukimin dhe riaftësimin e personave në nevojë.

- Garantimit të cilësisë së shërbimeve sipas standardeve në fuqi (181).

3. Përfshirja sociale, për t'i mundësuar pjesëmarrje të barabartë në zhvillim grupeve vulnerabël të tillë si fëmijët, romët dhe personat me aftësi të kufizuar (PAK). Zhvillimi i qëndrueshëm do të mundësojë që fëmijët të kenë mundësi të mira për të filluar jetën. Strategjia Ndërsektoriale e Përfshirjes Sociale ka përparësi strategjike rritjen e mundësive të njerëzve për të krijuar të ardhura, lehtësimin e aksesit ndaj shërbimeve dhe ndihmën ndaj grupeve vulnerabël (181).

Për pikën e tretë ka disa dokumente strategjike, si vijon:
- Fëmijët: strategjia kombëtare e fëmijëve mbulon të gjithë aspektet e jetës së fëmijëve, duke i dhënë përparësi aktiviteteve që lehtësojnë varfërinë. Masat përfshijnë:
  - në fushën e drejtësisë: trajtim i veçantë i çështjeve penale të fëmijëve dhe përmirësimin e procedurave dhe kushteve në burgje për të miturit, përdorimi i gjerë i punonjësve sociale; ngritja e Institutit të Riedukimit të të Miturve;
  - në fushën e shëndetësisë: menaxhimi i integruar i pacientit;
  - në fushën e arsimit: ngritja e njësive profesionale në nivelin e pushtetit lokal për adresimin e pengesave të integrimit dhe zhvillimit të fëmijëve;
  - zbatimin e arsimit të detyrueshëm për të parandaluar punën e fëmijëve;
  - ngritja e njësive në nivelin e pushtetit lokal për sigurimin e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve (181).
- Romët: synohet rritja e bashkëpunimit dhe zbatimit të politikave që reduktojnë varfërinë për këtë grup pakice, uljen e diskriminimit dhe përmirësimin e integrimit, nëpërmjet:
  - regjistrimit të tyre për të mundësuar përfitimet nga shërbimet;
  - nxitjes për ndjekjen e shkollës fillore nëpërmjet mbështetjes për fëmijët që mësojnë gjuhën shqipe, ofrimin e mësuesve që flasin gjuhën rome dhe programe arsimimi për të rriturit;
  - ruajtjes së kulturës dhe traditave të tyre dhe fuqizimit të grave dhe vajzave rome;

- përmirësimin e aksesit të tyre në shërbimet sociale dhe ndihmën ekonomike;
- mbulimi i shpenzimeve të kujdesit shëndetësor dhe stimulimi i planifikimit familjar, imunizimit dhe kujdesit para dhe pas lindjes;
- mbështetja lidhur me strehimin dhe infrastukturën e bashkësive rome;
- aksesi i romëve në strukturat e rendit publik nëpërmjet rekrutimit të tyre.

- Personat me aftësi të kufizuara : synohet integrimi i politikave dhe masave që nxitin përfshirjen e PAK në të gjitha fushat e jetës, nëpërmjet:
  - lehtësimit të përdorimit të infrastrukturës dhe ndërtesave publike nga PAK;
  - zbulimit të hershëm dhe parandalimit të paaftësisë dhe harmonizimin e shërbimeve shëndetësore, shoqërore dhe programeve e proceseve mësimore;
  - lehtësimin e punësimit të PAK, mbrojtjen e tyre në punë dhe përfshirjen e tyre në trajnimet profesionale;
  - forcimin e kapaciteteve shtetërore dhe përmirësimi i legjislacionit në drejtim të politikave të lidhura me PAK (181).

4. Sigurimet shoqërore: në sistemin e mbrojtjes sociale bëjnë pjesë dhe sigurimet shoqërore, të cilat mbrojnë individët në rast të uljes së të ardhurave të tyre, në mënyrë që dhe ata të kenë një standard të caktuar të jetesës, përmirësimit të tij dhe akses ndaj shërbimeve bazë sociale dhe shëndetësore. SKZHI synon ristrukturimin e sistemit publik të pensioneve dhe nxitjen e zhvillimit të tregut financiar të sigurimeve shoqërore:

- kalimit nga sistemi njështyllësh në sistemin shumështyllësh të pensioneve dhe krijimin e kolonës së tretë të pensioneve;
- krijimit të klimës së favorshme për operimin e kompanive private në fushën e sigurimeve shoqërore;
- rritjes së besimit të publikut tek skemat private të pensioneve dhe nxitja e tyre për të marrë pjesë në këto skema;
- përmirësimit të kontrollit dhe rregullimit të këtyre kompanive dhe monitorimit të rregullt të gjendjes financiare të tyre, në mënyrë që investimet e publikut në to të jenë të sigurta;
- lidhjes më të mirë midis kontributeve dhe pensioneve dhe balancimit të skemës së pensioneve bazuar në kontribute;

- përmirësimit të administrimit të skemës së pensioneve në tërësi, etj (181).

5. Shëndetësia dhe sigurimet shëndetësore: në sistemin e mbrojtjes sociale bëjnë pjesë dhe sigurimet shëndetësore, të cilat mbrojnë individët në rast të shfaqjes së sëmundjeve apo ndihmojnë në rehabilitimin e tyre pas shfaqjes së sëmundjes apo për parandalimin e tyre. Masat që merren në këtë kuadër janë të shumëllojshme, duke përfshirë përcaktimin e kritereve për pjesëmarrjen në skemën e sigurimeve shëndetësore, ofrimi falas i shërbimeve më të domosdoshme të shëndetit publik, rimbursimi për koston e medikamenteve, pakësimi i pengesave financiare, gjeografike dhe kulturore për aksesin ndaj shërbimeve shëndetësore, baraspeshimi i shpërndarjes së shërbimeve shëndetësore sipas zonës gjeografike dhe numrit të popullatës, krijimin e një blerësi të vetëm të shërbimeve shëndetësore publike, duke synuar përmirësimin e financimit të sistemit dhe rritjes së sigurisë së tij, përmirësimi i administrimit të sistemit, etj. (181)

Megjithatë duhet theksuar se elemente të mbrojtjes sociale gjenden dhe në komponentë të tjerë të SKZHI-së, si për shembull në komponentin e barazisë gjinore dhe parandalimit të dhunës në familje, në komponentin që ka të bëjë me sportet dhe rininë dhe punësimin, të cilat në dokumentin strategjik të SKZHI-së përmblidhen nën termin "Politika sociale". Të gjithë këta komponentë synojnë rritjen e mirëqenies dhe të përfshirjes sociale të grupeve të caktuara, që janë dëshmi e parimeve të solidaritetit të shoqërisë (181).

Ndihma ekonomike (NE), siç e përmendëm, është një nga elementet kryesore për reduktimin e varfërisë së grupeve në nevojë. Kriteret për përfitimin e NE dhe masa e shpërblimit financiar në kuadër të NE është përcaktuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 787, datë 14.12.2005, për "Përcaktimin e kritereve të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike" (182). Kjo VKM ndjek udhëzimet e Nenit 10 të Ligjit Nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", që përcakton bazat e funksionimit dhe zhvillimit të mbrojtjes sociale në Shqipëri (183). Sipas Ligjit Nr. 9355, ndihma ekonomike mund të jetë e plotë ose e pjesshme. Po sipas këtij ligji, përfitues të ndihmës ekonomike janë:

- familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme;
- jetimët mbi 25 vjeç, të papunë, të cilët nuk janë në institucione ose nën kujdestari;
- prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë.

Midis kritereve për përfitimin e ndihmës ekonomike, me rëndësi është pika 10 e cila përjashton nga përfitimi i NE, familjet që kanë në përbërje të

tyrë qoftë dhe një anëtar të vetëm që "....është i punësuar, pronar i çdo lloj kapitali, përveç shtëpisë dhe tokës bujqësore, rastet (përveç arsyeve të studimit ose sëmundjes), që braktis dhe nuk shfrytëzon pronat apo burimet e tjera të jetës dhe që i shmanget qëllimisht punësimit" (182).
VKM nr. 787, datë 14.12.2005, përcakton masën e NE si vijon:

- për kryefamiljarin 2600 lekë në muaj;
- për anëtarët e familjes në moshë pune 2600 lekë në muaj;
- për çdo anëtar tjetër të familjes në moshë pune 600 lekë në muaj;
- për çdo anëtar tjetër të familjes në moshë pune (deri 18 vjeç) 700 lekë në muaj;
- në rast të lindjes së trinjakëve ose më shumë, dhe në rastin e fëmijëve jetim merret 3000 lekë në muaj për çdo fëmijë.

Pika 19 në këtë VKM thotë që "masa e plotë e ndihmës ekonomike, pavarësisht nga përbërja e familjes, nuk mund të jetë më e lartë se 7000 lekë në muaj" (182). Kjo pikë është me interes pasi ajo thotë që pavarësisht përbërjes së familjes, ka një tavan të NE-së. Duket se ka një mospërputhje midis masës së NE dhe pikës 19 në këtë VKM. Për shembull, një familje me trinjakë automatikisht ka të drejtë të marrë 9000 lekë në muaj, nëse plotësohen kushtet për përfitimin e ndihmës ekonomike, ndërkohë që pika 19 e kufizon këtë në 7000 lekë në muaj. Kurse në Strategjinë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale 2007-2013 theksohej që përfitimi i ndihmës ekonomike "bazohet në strukturën e familjes" ku kryefamiljari, të moshuarit dhe anëtarët me aftësi të kufizuara marrin 95% të pagesës bazë të papunësisë, anëtarët në moshë pune marrin 95% të pagesës së kryefamiljarit dhe anëtarët në moshë pune marrin 20% të pagesës së kryefamiljarit (184).

Një tjetër pikë intersante në VKM Nr. 787 është seksioni 4, i cili përshkruan kushtëzimin e NE me punë e shërbime në komunitet, duke theksuar që bashkitë apo komunat kanë të drejtë ta kushtëzojnë përfitimin e NE me punë e shërbime në komunitet, me kohë të plotë apo të pjesshme, për disa ditë në muaj. Natyrisht, nga ky detyrim përjashtohen personat me aftësi të kufizuara dhe ata mbi moshë pune (182). Në këtë rast, këta persona duhet të paguhen të paktën sa paga minimale në vend.

Nga shqyrtimi i informacionit të paraqitur më sipër mund të nxjerrim përfundimet se, sistemi rregullator i mbrojtjes sociale në Shqipëri është relativisht i plotë, duke pësuar ndryshime, amendime dhe përmirësime të vazhdueshme dhe të herëpashershme, nxitur nga ndryshimet e rrethanave demografike, sociale, ekonomike dhe politike të vendit dhe në përputhje me rekomandimet dhe eksperiencat ndërkombëtare. Megjithatë, një nga karakteristikat kryesore të tranzicionit në Shqipëri është fakti se, megjithë ekzistencën e një legjislacioni

relativisht të plotësuar dhe modern, problem madhor mbetet zbatueshmëria e ligjit (154).

Në këtë kuadër do të ishte me interes të studiohej skema e mbrojtjes sociale Shqipëri, duke u fokusuar në një nga rajonet e saj dhe më konkretisht në Durrës, si një ndër rajonet që ka përjetuar ndryshimet më të mëdha demografike, sociale dhe ekonomike në vend. Durrësi është një nga prefekturat kryesore të Shqipërisë, që ka pësuar ndryshime të mëdha gjatë 25 viteve të fundit si pasojë e fenomeneve të emigrimit dhe të migrimit të brendshëm, që rrjedhimisht kanë ndikuar në modifikimn e shoqërisë dhe problematikave të familjeve në këtë rajon, përveç problemeve ekonomike që peshojnë në çdo familje.

Sipas UNICEF, Qarku i Durrësit është një nga qarqet që ka përjetuar lëvizjet më të mëdha demografike kryesisht në vitet '90 me hapjen e "eksodit" , gjatë trazirave të vitit '97 (185) dhe në vitet në vazhdim. Sipas Open Data Albania, Durrësi dhe Tirana janë të vetmet qarqe ku popullisa kë pësuar rritje gjatë periudhës 2001-2013, duke u rritur me afërsisht 8% dhe 26%, përkatësisht, ndërkohë që në rang vendi popullsia u zvogëlua me 8.2% (186). Durrësi paraqet gjithashtu nivelin më të lartë të urbanizimit (78%) në vitin 2013, duke tejkaluar ritmet e Tiranës, kurse ritmi i rritjes së popullatës urbane ishte rreth 50% në periudhën 2001-2013 (186). Familjet e ardhura nga zonat rurale që gjenden kryesisht në periferi, ndryshimet demografike që ka pësuar vazhdimisht qyteti, bëjnë që Durrësi të ketë problematika sociale të shumëllojshme dhe të mprehta të cilat variojnë nga zona në zonë, nga familja në familje dhe sipas shtresave të caktuara shoqërore që karakterizojnë familjen shqiptare.

Censusi i vitit 2011 i paraqet të dhënat në nivel prefekture. Sipas Censusit, qarku i Durrësit është qarku i IV më i madh në vend bazuar në numrin e popullsisë banuese pas Tiranës, Fierit dhe Elbasanit (157). Po sipas Censusit, në Shqipëri rreth 6.7%, 5,7% dhe 2.9% e femrave dhe meshkujve 15 vjeç e lart dhe popullsisë 65 vjeç e lart, përkatësisht, kanë të paktën një aftësi të kufizuar dhe shifrat në qarkun e Durrësit janë të ngjashme me shifrat mesatare të vendit (157). Në vitin 2011, në Durrës kishte 1767 persona të divorcuar ose 8.7% të të gjithë personave të divorcuar në Shqipëri (157). Në qytetin e Durrësit ekziston vetëm një qendër rezidenciale për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke ofruar shërbime vetëm për 3% të 1215 fëmijëve në nevojë në këtë qytet (185).

Sipas INSTAT, Durrësi është një ndër qarqet me shkallën më të lartë të varfërisë në vend. Kështu, në vitin 2008 rreth 16.2% e popullsisë është e varfër krahasuar me mesataren e vendit prej 14.3% (187). Po sipas INSTAT-it, kufiri i varfërisë së publikuar në vitin 2008 ishte 4891 lekë për frymë në muaj (187). Duke pasur parasysh këtë shifër dhe masat e NE të përcaktuar në VKM Nr. 787, atëherë bëhet e qartë se, ndihma ekonomike mbulon vetëm 36% të nevojave të kufirit të varfërisë për një familje me 4 persona.

Në këtë kontekst, Durrësi është një rast interesant për studimin e efektivitetit

të ndihmës ekonomike në vendin tonë për shkak të specifikave të mësipërme. Për këtë arsye, qëllimi i studimit tonë ishte studimi i skemës së ndihmës ekonomike për përmbushjen e nevojave bazë të përfituesve të saj, evidentimi i barrierave potenciale që pengojnë aksesin në këtë shërbim, dhe eksplorimi i opinioneve të personave në nevojë lidhur me aspektet të ndryshme të kësaj politike, në mënyrë që të vlerësohet efektiviteti real i skemës së mbrojtjes sociale për zbutjen e varfërisë dhe lehtësimin e përjashtimit social, si dhe të jepen rekomandimet përkatëse për politikëbërësit dhe grupet e tjera të interesit.

KAPITULLI
3

# METODOLOGJIA E STUDIMIT

## 3.1 TIPI I STUDIMIT DHE METODA KËRKIMORE E PËRDORUR

Studimi është i tipit transversal (kros-seksional). Studimi është kryesisht i tipit kuantitativ, duke integruar një një kuadër sasior aspektet kuantitative me ato kualitative. Aspektet kuantitative të studimit evidentohen në analizat e thelluara statistikore, paraqitjen e shifrave absolute dhe përqindjet përkatëse, si dhe vlerat e domethënies statistikore. Ndërsa pjesa kualitative ka të bëjë me përftimin e opinioneve të pjesëmarrësve lidhur me një sërë aspektesh të tilla si rrethi shoqëror dhe familjar, pjesëmarrja në jetën politike dhe shkalla e besimit në disa kategori të nëpunësve të shtetit.

## 3.2 POPULLATA NË STUDIM DHE KAMPIONIMI

Kriteret e përfshirjes në studim ishin: përfitimi i NE në Bashkinë Durrës, në secilën prej ZNE-ve të kësaj Bashkie, pavarësisht gjinisë apo kohëzgjatjes së përfitimit të saj; personi i përfshirë në studim duhet të ishte 18 vjeç e lart. Pra, çdo person i kësaj moshe që paraqitej pranë ZNE-ve përkatëse gjatë muajit qershor 2014 për marrjen e shpërblimit financiar të ndihmës ekonomike, ishte një kandidat potencial për t'u përfshirë në studimin tonë. Ndihma ekonomike merret një herë në muaj, kështu që gjatë çdo muaji të vitit të gjithë personat kanë këtë të drejtë dhe detyrim të paraqiten pranë ZNE-ve përkatëse, për të deklaruar ndonjë ndryshim në strukturën familjare, apo për ndonjë ndryshim të statusit "i papunë" në "të punësuar". Ndërsa një herë në tre muaj, personat që marrin NE, duhet të paraqiten pranë zyrave përkatëse të NE në njësitë bashkiake ku bëjnë pjesë, për të sjellë të rinovuar dokumentin përkatës, që vërteton papunësinë e tyre ("Kartela e Punëkërkuesit"). Po në këtë peridhë që prezantohen pranë kësaj zyre, personat që marrin NE, plotësojnë edhe një formular ku deklarojnë gjendjen e tyre aktuale ekonomike, dokument ky, që në një moment të dytë përdoret nga administratorët e njësive bashkiake të NE për kontrolle të mundshme në terren, për të vërtetuar vërtetësinë e gjendjes aktuale të familjes në nevojë. Për këtë arsye, përzgjedhja e muajit qershor midis muajve të tjerë të vitit për mbledhjen e të dhënave ishte e qëllimshme, pasi do kishim një prezencë masive të të gjithë personave/ kryefamiljarëve që marrin NE pranë zyrës së NE në njësinë bashkiake përkatëse. Natyrisht, përzgjedhja e

çdo tremujori tjetër nuk do ndikonte në informacionin e përftuar, për arsyen e përmendur më lart.

**Kampionimi dhe llogaritja e madhësisë së kampionit:** Ne nuk dispononim listën paraprake të individëve të përfshirë në skemën e NE në Durrës. Për këtë arsye, në çdo ZNE-e të çdo njësie administrative të Bashkisë Durrës u intervistuan rreth 40 persona, përfitues të NE që janë pothuaj të gjithë anëtarët tek njësitë bashkiake Nr.1 dhe Nr. 2 dhe 60 persona të paraqitur në mënyrë të njëpasnjëshme në njësitë administrative Nr 3, 4 dhe 5. Në rastin se personi i paraqitur në këtë njësi refuzonte për të marrë pjesë në studim, atëherë kalohej tek personi i radhës që paraqitej në ZNE-në e njësisë përkatëse. Në mënyrë që të mos intervistoheshin dy persona nga e njëjta familje, subjektet u pyetën paraprakisht lidhur me këtë detaj.

**Popullata e studimit:** Popullata target e studimit ishin të gjitha familjet e përfshira në skemën ekonomike në Bashkinë Durrës në vitin 2014.

Bashkia Durrës ka pesë njësi administrative. Në secilën prej tyre funksionon një Zyrë e Ndihmës Ekonomike (ZNE). Sipas Bashkisë Durrës, numri i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike është rreth 400 familje në vit. Ky numër ndryshon çdo muaj për shkak se disa familje futen në skemën e ndihmës ekonomike e disa të tjera dalin prej saj. Për shembull, në muajin shkurt të vitit 2014, kishte gjithsej 399 familje në skemën e ndihmës ekonomike, kurse në mars 2014 kishte gjithsej 411 familje me 1199 individë në skemën e ndihmës ekonomike.

Kriteret e përfshirjes në studim ishin: përfitimi i ndihmës ekonomike në Bashkinë e Durrësit, në secilën prej ZNE-ve të kësaj Bashkie, pavarësisht gjinisë apo kohëzgjatjes së përfitimit të ndihmës ekonomike. Personi i përfshirë në studim duhet të ishte 18 vjeç e lart. Pra, çdo person, anëtar i një familjeje që merr NE, i kësaj moshe që paraqitej pranë ZNE-ve përkatëse gjatë muajit qershor 2014, ishte një kandidat potencial për t'u përfshirë në studimin tonë. Ndihma ekonomike merret një herë në muaj, kështu që gjatë çdo muaji të vitit të gjithë personat kanë këtë të drejtë dhe detyrim të paraqiten pranë ZNE-ve përkatëse, për të deklaruar ndonjë ndryshim në strukturën familjare, apo për ndonjë ndryshim të statusit nga "i papunë" në "të punësuar". Ndërsa një herë në tre muaj, personat që marrin NE, duhet të paraqiten pranë zyrave përkatëse të NE në njësitë bashkiake ku bëjnë pjesë, për të sjellë të rinovuar dokumentin përkatës që vërteton papunësinë e tyre ("Kartela e Punëkërkuesit"). Po në këtë peridhë që prezantohen pranë kësaj zyre, personat që marrin NE, plotësojnë edhe një formular ku deklarojnë gjendjen e tyre aktuale ekonomike. Dokument ky, që në një moment të dytë përdoret nga administratorët e njësive bashkiake të NE, për kontrolle të mundshme në terren, për të vërtetuar vërtetësinë e gjendjes

aktuale të familjes në nevojë. Për këtë arsye, përzgjedhja e muajit qershor midis muajve të tjerë të vitit për mbledhjen e të dhënave ishte e qëllimshme, pasi do kishim një prezencë masive të të gjithë personave/ kryefamiljarëve që marrin NE pranë zyrës së NE në njësinë bashkiake përkatëse. Natyrisht, përzgjedhja e çdo tremujori tjetër nuk do ndikonte në informacionin e përftuar, për arsyen e përmendur më lart.

Kriteret përjashtuese nga studimi: nga çdo familje mund të intervistohej vetëm një person. Në këtë mënyrë, çdo person i paraqitur pranë ZNE-ve përkatëse (përveç personit të parë të intervistuar) verifikohej nëse bënte pjesë në familje anëtarët e të cilave ishin intervistuar më parë. Gjithashtu, nga studimi u përjashtuan personat të cilët aplikonin për herë të parë për të përfituar ndihmë ekonomike. Arsyeja për këtë ishte se jo të gjithë ata që aplikojnë për të përfituar ndihmë ekonomike, kualifikohen për këtë të drejtë dhe në këtë mënyrë ishte e pamundur që studimi ynë të priste për kohën e nevojshme midis fazës së aplikimit dhe fazës së pranimit të kërkesës për përfitimin e ndihmës ekonomike.

**Kampionimi dhe llogaritja e madhësisë së kampionit:** Bazuar në të dhënat e Bashkisë Durrës lidhur me numrin e individëve në skemën e ndihmës ekonomike në mars të vitit 2014, ne llogaritëm madhësinë e përshtatshme të kampionit të mjaftueshme për evidentimin e lidhjeve të caktuara statistikore midis variableve. Për llogaritjen e madhësisë së kampionit u përdor programi WINPEPI (188), duke përdorur një sërë hipotezash socio-ekonomike të tilla si: niveli i edukimit dhe niveli i barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike (thjeshtësia e procedurave). Kështu u supozua që prevelanca e individëve që mendojnë se procedurat për përfitimin e skemës ekonomike janë të ndërlikuara (një ndër barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike) ishte 50%, nivel ky që maksimalizon madhësinë e kampionit. Gjithashtu, niveli i domethënies statistikore (gabimi alfa ose vlera e P-së) u caktua në 5% (dydrejtimore) dhe fuqia e studimit në 80%. Bazuar në këto supozime dhe madhësi konservative, u llogarit që madhësia minimale e kampionit ishte 260 persona (52 persona në çdo njësi administrative). Duke qenë se ne do intervistonim vetëm një person nga çdo familje, atëherë me këtë kampion ne përfaqësojmë më shumë se 50% të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike në Bashkinë e Durrësit.

Në këtë mënyrë,  u intervistuan në total 260 persona. Megjithatë, pas shqyrtimit të pyetësorëve, rezultoi që në 28 prej tyre kishte mangësi në plotësimin e variableve bazë të studimit. Për këtë arsye, këta individë u hoqën nga database, duke lënë 232 individë për analiza të thelluara. Në këtë mënyrë, niveli përfundimtar i pjesëmarrjes në studim ishte 89.2% (232/260).

## 3.3 MBLEDHJA E TË DHËNAVE

### 3.3.1 Instrumenti për mbledhjen e të dhënave

Mbledhja e të dhënave u mundësua nëpërmjet intervistimit ballë për ballë të individëve të përfshirë në studim nga intervistues të trajnuar për mbledhjen e të dhënave.

Gjithsej u trajnuan 5 intervistues (një intervistues në ZNE-në e çdo njësie administrative të Bashkisë Durrës).

Për mbledhjen e të dhënave u përdor një pyetësor me pyetje të hapura dhe të mbyllura (gjysmë i strukturuar), i cili eksploronte një sërë aspektesh që kanë të bëjnë me ndihmën ekonomike. Përpara aplikimit në shkallë të gjerë të pyetësorit, ai u aplikua në një numër të vogël subjektesh (20 individë/ kryefamiljarë të familjeve që marrin NE), që përfitonin ndihmë ekonomike gjatë muajit prill 2014, në mënyrë që të shqyrtohej paraprakisht vlefshmëria dhe besueshmëria e pyetësorit.

Bazuar në rezultatet e pre-testit u bënë një sërë ndryshimesh në pyetësor, duke përfshirë lënien e moshës dhe edukimit si variable të hapura numerike; për eksplorimin e perceptimeve të individëve të përfshirë në studim. Lidhur me nivelin e sinqeritetit të zyrtarëve të ndryshëm të shtetit dhe besimit tek ta u vendos të përdorej një shkallë Likert me 5-kategori në vend të shkallës me 3-kategori; u shtua numri i dimensioneve të adresuara nga pyetësori si p.sh., seksioni që ka të bëjë me rrjetin social dhe mbështjetjen tek miqtë në rast nevoje. Lidhur me 12 pyetjet të cilat ekploronin barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike, u llogarit koeficienti i qëndrueshmërisë së brendshme nëpërmjet testit të Cronbach's alpha. Kjo statistikë rezultoi në nivelin 0.770, duke përfaqësuar një qëndrueshmëri të brendshme të moderuar mirë.

Pyetësori përmbante disa seksione:

- Seksioni i parë përmbante pyetje të detajuara lidhur me të dhënat bazë socio-demografike dhe socio-ekonomike për individët e përfshirë në studim (gjinia, mosha, edukimi, përkatësia fetare, gjendja civile, statusi i punësimit, shtresa sociale, gjendja ekonomike dhe niveli i aktivitetit fizik).

- Seksioni i dytë synonte të hidhte dritë lidhur me gjendjen e vetëraportuar të shëndetit dhe sëmundjet kronike ekzistuese.

- Seksioni i tretë përfshinte pyetje lidhur me strukturën e familjes së individëve të përfshirë në studim (numrin e anëtarëve të familjes, numrin e fëmijëve nën 18 vjeç, të fëmijëve jetim, të anëtarëve të moshuar, të personave të paaftë, të papunë, të divorcuar).

- Seksioni i katërt përfshinte pyetje për eksplorimin e fuqizimit dhe pjesëmarrjes në jetën politike të lagjes/rajonit, duke mbledhur informacion lidhur me nivelin e lumturisë, kënaqësisë me gjendjen ekonomike, politikat sociale, politikat e qeverisë, pjesëmarrjen në mbledhje të këshillit bashkiak apo në votime, apo lidhur me perceptimet e individëve në studim lidhur me shkallën e sinqeritetit të funksionarëve të ndryshëm të shtetit.

- Seksioni i pestë përmbante pyetje lidhur me rrjetet sociale, duke përfshirë numrin e miqve dhe shokëve të ngushtë, si dhe numrin e personave ku individët mund të mbështeteshin në rast nevoje apo fatkeqësie.

- Seksioni i gjashtë përmbante pyetje për të eksploruar opinionin e pjesëmarrësve në lidhje me besimin që ata kanë tek funksionarët e ndryshëm të shtetit dhe nivelin e solidaritetit në komunitetin e tyre.

- Seksioni i shtatë eksploronte burimet më të rëndësishme të informacionit lidhur me punën e qeverisë, nëpërmjet pyetjeve të hapura.

- Seksioni i tetë përmbante pyetje lidhur me ndihmën ekonomike, duke eksploruar masën e saj, arsyet për përftimin e ndihmës ekonomike dhe efektivitetit të saj për mbulimin e nevojave bazë jetësore të pjesëmarrësve në studim. Gjithashtu, në këtë seksion përfshihen dhe pyetje rreth disa barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike, duke targetuar thjeshtësinë e procedurave, transparencën e tyre, numrin e dokumenteve të nevojshëm për marrjen e ndihmës ekonomike, pagesat nën dorë, ndikimin e prirjeve politike, abuzimet me ndihmën ekonomike, etj.

Të gjithë individëve të përfshirë në studim iu shpjegua qëllimi i studimit, detajet e tij dhe mënyra e intervistimit. Më pas, çdo individi që pranoi të merrte pjesë në studim, iu kërkua që të lexonte dhe nënshkruante deklaratën e miratimit të informuar të përgatitur për këtë qëllim.

## 3.4 PËRKUFIZIMI I NDRYSHORËVE NË STUDIM

**Mosha**

Përkufizimi operacional: mosha e subjektit në vite që nga lindja deri në momentin e studimit, siç raportohet nga vetë subjekti.

Shkalla e matjes: numerike, diskrete (mosha në vite të plota si p.sh., 18 vjeç, 19 vjeç, 20 vjeç etj.), e llogaritur në bazë të ditëlindjes. Për qëllimet tona ky variabël u rikodua në një variabël kategorik ordinal me katër kategori (≤35 vjeç, 36-45 vjeç, 46-55 vjeç, >55 vjeç).

**Vendbanimi**

Përkufizimi operacional: numri i viteve të edukimit të përfunduara nga subjekti, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: numerike, diskrete (vitet e plota të edukimit si psh, 4 vjet, 5 vjet, 8 vjet, etj). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (0-4 vjet, 5-8 vjet, >8 vjet).

**Përkatësia fetare**

Përkufizimi operacional: besimi fetar i individit, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, nominale (myslyman, katolik, ortodoks, tjetër).

**Përkatësia etnike**

Përkufizimi operacional: grupi etnik pjesë e të cilit është subjekti, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, nominale (shqiptare, rome, tjetër).

**Gjendja civile**

Përkufizimi operacional: gjendja civile e subjektit në studim, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, nominale (beqar, martuar, divorcuar, i/e ve).

**Statusi i punësimit**

Përkufizimi operacional: Statusi i punësimit të subjektit në studim në momentin e kryerjes së studimit, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, nominale (i/e vetëpunësuar, i/e papunë).

**Shtresa sociale**

Përkufizimi operacional: shtresa sociale e subjektit në studim, bazuar në nivelin e të ardhurave, arsimin dhe profesionin, sipas perceptimit të individit në studim dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (e ulët, e mesme, e lartë).

**Gjendja ekonomike**

Përkufizimi operacional: niveli i të ardhurave të individit në studim, sipas perceptimit të individit në studim dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (shumë e mirë, e mirë, mesatare, e keqe, shumë e keqe).

**Aktiviteti fizik**

Përkufizimi operacional: niveli i aktivitetit fizik të subjektit në studim, duke marrë parasysh aktivitetin fizik në punë, shtëpi dhe gjatë kohës së lirë, sipas perceptimit të individit në studim dh siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (i lartë, i mesëm, i ulët).

**Gjendja shëndetësore**

Përkufizimi operacional: gjendja shëndetësore e subjektit në studim, pavarësisht pranisë apo mungesës së sëmundjeve të ndryshme, sipas perceptimit të individit në studim dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (shumë e mirë, e mirë, mesatare, e keqe, shumë e keqe). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël kategorik ordinal me tre kategori (shumë e mirë ose e mirë, mesatare, e keqe ose shumë e keqe).

**Prania e sëmundjeve kronike**

Përkufizimi operacional: prania e sëmundjeve kronike (një ose më shumë probleme shëndetësore që kanë zgjatur, apo që pritet të zgjasin, për të paktën 6 muaj) në subjektet në studim, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Jetesë në familje apo vetëm**

Përkufizimi operacional: fakti nëse subjekti në studim jeton vetëm apo me familjen e tij/saj, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, nominale (me familjen, vetëm).

**Numri i anëtarëve të familjes**

Përkufizimi operacional: numri i anëtarëve në familjen e subjektit, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: mumerike, diskrete (numri i anëtarëve të familjes si p.sh., dy anëtarë, tre anëtarë, etj). Për qëllimet tona, personat që jetonin vetëm u konsideruan se "familje me një anëtar" dhe ky variabël u rikodua në një variabël kategorik ordinal (një anëtar, 2-3 anëtarë, 4 anëtare, >4 anëtarë).

**Prania e fëmijëve nën 18 vjeç në familje**

Përkufizimi operacional: fakti nëse në familjen ku jeton subjekti në studim, ka apo jo fëmijë nën 18 vjeç, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Prania e personave të paaftë në familje**

Përkufizimi operacional: fakti nëse në familjen ku jeton subjekti në studim, ka apo jo persona me paaftësi të lindur apo të fituar, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Prania e personave të moshuar në familje**

Përkufizimi operacional: fakti nëse në familjen ku jeton subjekti në studim, ka apo jo persona të moshuar, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Prania e personave të divorcuar në familje**

Përkufizimi operacional: fakti nëse në familjen ku jeton subjekti në studim, ka apo jo persona të divorcuar, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Prania e fëmijëve jetim në familje**

Përkufizimi operacional: fakti nëse në familjen ku jeton subjekti në studim, ka apo jo fëmijë jetim, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Prania e personave të papunë në familje**

Përkufizimi operacional: fakti nëse në familjen ku jeton subjekti në studim, ka apo jo persona të papunë, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Numri i personave të disavantazhuar në familje**

Përkufizimi operacional: numri i fëmijëve nën 18 vjeç, fëmijëve jetim, personave të paaftë, të moshuar, të papunë dhe të divorcuar në familjen e subjektit në studim, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: Numerike, diskrete (një person i disavantazhuar, dy pesona, etj.). Për qëllimet tona ky variabël u rikodua në një variablë të ri kategorik ordinal të emërtuar "familje vunerabël" me tre kategori (0-1 persona vulnerabël, 2-3 persona vulnerabël, >3 persona vulnerabël).

**Niveli i lumturisë**

Përkufizimi operacional: niveli i lumturisë së subjektit në studim me

gjendjen aktuale, sipas perceptimit të individit në studim dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (aspak i lumtur, jo i lumtur, mesatarisht, i lumtur, shumë i lumtur). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (aspak ose jo i lumtur, mesatarisht, i lumtur ose shumë i lumtur).

**Niveli i kënaqësisë me gjendjen ekonomike**

Përkufizimi operacional: niveli i kënaqësisë së subjektit në studim me gjendjen aktuale ekonomike të tij/saj, sipas perceptimit të individit në studim dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (aspak i këaqur, jo i kënaqur, mesatarisht, i kënaqur, shumë i kënaqur). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (aspak ose jo i kënaqur, mesatarisht, shumë i kënaqur ose i kënaqur).

**Niveli i kënaqësisë me politikat sociale**

Përkufizimi operacional: niveli i kënaqësisë së subjektit në studim me politikat sociale aktuale të qeverisë, sipas perceptimit të individit në studim dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (aspak i kënaqur, jo i kënaqur, mesatarisht, i kënaqur, shumë i kënaqur). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (aspak ose jo i kënaqur, mesatarisht, shumë i kënaqur ose i kënaqur).

**Niveli i dakordësisë me masat për reduktimin e varfërisë**

Përkufizimi operacional: niveli i dakordësisë së subjektit në studim me masat aktuale për reduktimin e varfërisë, sipas perceptimit të individit në studim dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (aspak i kënaqur, jo dakord, mesatarisht, dakord, shumë dakord). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (aspak ose jo dakord, mesatarisht, shumë dakord ose dakord).

**Niveli i aftësisë për të ndryshuar jetën**

Përkufizimi operacional: niveli i aftësisë së subjektit në studim për të ndryshuar jetën e tij/saj, sipas perceptimit të individit në studim dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (aspak i kënaqur, jo i aftë, mesatarisht, i aftë, shumë i aftë). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (aspak ose jo i aftë, mesatarisht, shumë i aftë ose i aftë).

**Pjesëmarrja në votime**

Përkufizimi operacional: fakti nëse subjekti në studim ka marrë pjesë ose jo në votimet e fundit, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Pjesëmarrja në mbledhjet e këshillit bashkiak**

Përkufizimi operacional: fakti nëse subjekti në studim ka marrë pjesë ose jo në mbledhjet e këshillit bashkiak gjatë vitit të fundit, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Pjesëmarrja në takime me politikanët e zonës**

Përkufizimi operacional: fakti nëse subjekti në studim ka marrë pjesë ose jo në takime me politikanët e zonës gjatë vitit të fundit, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Pjesëmarrja në protesta**

Përkufizimi operacional: Fakti nëse subjekti në studim ka marrë pjesë ose jo në protesta gjatë vitit të fundit, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Pjesëmarrja në fushata informuese ose politike**

Përkufizimi operacional: fakti nëse subjekti në studim ka marrë pjesë ose jo fushata informuese ose politike gjatë vitit të fundit, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Njoftimi i medias**

Përkufizimi operacional: fakti nëse subjekti në studim ka njoftuar median për probleme të ndryshme në zonë gjatë vitit të fundit, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Njoftimi i policisë**

Përkufizimi operacional: fakti nëse subjekti në studim ka njoftur policinë për probleme të ndryshme në zonë gjatë vitit të fundit, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Niveli i sinqeritetit të përfaqësuesve të qeverisë lokale**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me nivelin

e sinqeritetit të përfaqësuesve të qeverisë lokale, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (aspak të sinqertë, të pasinqertë, mesatarisht, të sinqertë, shumë të sinqertë). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (aspak ose jo të sinqertë, mesatarisht, shumë të sinqertë ose të sinqertë).

**Niveli i sinqeritetit të përfaqësuesve të kryeplakut**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me nivelin e sinqeritetit të kryeplakut të zonës, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (aspak të sinqertë, të pasinqertë, mesatarisht, të sinqertë, shumë të sinqertë). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (aspak ose jo të sinqertë, mesatarisht, shumë të sinqertë ose të sinqertë).

**Niveli i sinqeritetit të përfaqësuesve të mjekëve dhe infermierëve**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me nivelin e sinqeritetit të mjekëve dhe infermierëve lokalë, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (aspak të sinqertë, të pasinqertë, mesatarisht, të sinqertë, shumë të sinqertë). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (aspak ose jo të sinqertë, mesatarisht, shumë të sinqertë ose të sinqertë).

**Niveli i sinqeritetit të mësuesve**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me nivelin e sinqeritetit të mësuesve, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (aspak të sinqertë, të pasinqertë, mesatarisht, të sinqertë, shumë të sinqertë). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (aspak ose jo të sinqertë, mesatarisht, shumë të sinqertë ose të sinqertë).

**Niveli i sinqeritetit të punonjësve të policisë**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me nivelin e sinqeritetit të punonjësve të policisë, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (aspak të sinqertë, të pasinqertë, mesatarisht, të sinqertë, shumë të sinqertë). Për qëllimet tona, ky variabël u

rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (aspak ose jo të sinqertë, mesatarisht, shumë të sinqertë ose të sinqertë).

**Niveli i sinqeritetit të punonjësve të shërbimeve sociale**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me nivelin e sinqeritetit të punonjësve të shërbimeve sociale, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (aspak të sinqertë, të pasinqertë, mesatarisht, të sinqertë, shumë të sinqertë). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (aspak ose jo të sinqertë, mesatarisht, shumë të sinqertë ose të sinqertë).

**Numri i miqve aktualë**

Përkufizimi operacional: numri i miqve apo shokëve të ngushtë të subjekteve në studim, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: numerike, diskrete (një mik, dy miq, tre miq, etj).

**Numri i miqve ku mund të huani para**

Përkufizimi operacional: numri i miqve apo shokëve të ngushtë ku subjektet janë të sigurt që mund të huajnë para në rast nevoje, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (asnjë, 1-2 miq, 3-4 miq, >4 miq).

**Besimi tek fqinjët në rast nevoje**

Përkufizimi operacional: Opinioni i subjektit në studim lidhur me faktin nëse mund t'i besojë fqinjëve fëmijët në rast nevoje, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (padyshim po, ndoshta po, ndoshta jo, padyshim jo).

**Numri i miqve ku gjen mbështetje në rast fatkeqësie**

Përkufizimi operacional: numri i miqve apo shokëve të ngushtë ku subjektet janë të sigurt që mund të gjejnë mbështetje në rast nevoje, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (asnjë, 1-2 miq, 3-4 miq, >4 miq).

**Niveli i besimit tek zyrtarët e bashkisë**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me nivelin e besimit të tij/saj tek zyrtarët e bashkisë, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (aspak, pak, mesatarisht, i besoj, i besoj shumë). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (aspak ose pak, mesatarisht, i besoj ose i besoj shumë).

**Niveli i besimit tek punonjësit e shërbimeve sociale**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me nivelin e besimit të tij/saj tek punonjësit e shërbimeve sociale, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (aspak, pak, mesatarisht, i besoj, i besoj shumë). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (aspak ose pak, mesatarisht, i besoj ose i besoj shumë).

**Niveli i besimit tek qeveria qendrore**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me nivelin e besimit të tij/saj tek zyrtarët e qeverisë qendrore, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (aspak, pak, mesatarisht, i besoj, i besoj shumë). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (aspak ose pak, mesatarisht, i besoj ose i besoj shumë).

**Niveli i besimit tek punonjësit e policisë**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me nivelin e besimit të tij/saj tek punonjësit e policisë, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (aspak, pak, mesatarisht, i besoj, i besoj shumë). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (aspak ose pak, mesatarisht, i besoj ose i besoj shumë).

**Niveli i besimit tek mësuesit**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me nivelin e besimit të tij/saj tek mësuesit, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (aspak, pak, mesatarisht, i besoj, i besoj shumë). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (aspak ose pak, mesatarisht, i besoj ose i besoj shumë).

**Niveli i besimit tek mjekët dhe infermierët**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me nivelin e besimit të tij/saj tek mjekët dhe infermieret, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (aspak, pak, mesatarisht, i besoj, i besoj shumë). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (aspak ose pak, mesatarisht, i besoj ose i besoj shumë).

**Niveli i besimit tek të panjohurit**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me nivelin e besimit të tij/saj tek të panjohurit, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (aspak, pak, mesatarisht, i besoj, i besoj shumë). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (aspak ose pak, mesatarisht, i besoj ose i besoj shumë).

**Kohëzgjatja e përfitimit të ndihmës ekonomike**

Përkufizimi operacional: Koha gjatë së cilës subjekti ka përfituar ndihmën ekonomike që prej fillimit të saj deri në momentin e kryerjes së studimit, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: numerike, diskrete (numri i muajve apo i viteve). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël të ri kategorik ordinal me tre kategori (≤5 vjet, 6-10 vjet, >10 vjet).

**Arsyeja për marrjen e ndihmës ekonomike**

Përkufizimi operacional: arsyeja ose arsyet që e shtynë subjektin në studim të aplikonte për përfitimin e ndihmës ekonomike, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, nominale (opsione të hapura).

**Kërkimi i punës pas marrjes së ndihmës ekonomike**

Përkufizimi operacional: fakti nëse subjekti në studim ka kërkuar të punësohet që prej momentit të përfitimit të ndihmës ekonomike ose jo, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Mjaftueshmëria e ndihmës ekonomike**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me faktin nëse ndihma ekonomike mjafton për të mbuluar nevojat mujore, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Sa kohë zgjat efekti i ndihmës ekonomike**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me faktin se për sa kohë ndihma ekonomike mjafton për të mbuluar nevojat bazë, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, ordinale (një javë, dy javë, tre javë, katër javë).

**Niveli i ndihmës ekonomike**

Përkufizimi operacional: sasia e parave që individi në studim ose familja e tij përfitojnë në muaj nën siglën e ndihmë ekonomike, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: numerike, e vazhdueshme (sasia e parave në lekë).

**Burimi i të ardhurave nëse ndihma ekonomike nuk mjafton**

Përkufizimi operacional: burimet alternative të të ardhurave në rast se paratë nga ndihma ekonomike nuk mjaftojnë për të plotësuar nevojat bazë, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, nominale (opsione të hapura).

**Përjetimi i vështirësive për shkak të mungesës së të ardhurave**

Përkufizimi operacional: përjetimi nga subjekti në studim i vonesës së pagimit të qirasë, ndërrimit të vendbanimit, pasjes së familjarëve të sëmurë për të cilët nuk mund të siguronin kujdes mjekësor apo mos sigurimi i ushqimit të përditshëm, për shkak të mungesës së parave, siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike: thjeshtësia e procedurave**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me thjeshtësinë e procedurave për përfitimin e ndihmës ekonomike, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike: transparenca e procedurave**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me transparencën e procedurave për përfitimin e ndihmës ekonomike, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike: numri i dokumenteve**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me

përshtatshmërinë e numrit të dokumenteve për përfitimin e ndihmës ekonomike, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike: pagesa nën dorë**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me nevojën e pagesave nën dorë për përfitimin e ndihmës ekonomike, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike: "miku"**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me nevojën për të pasur "miq" për përfitimin e ndihmës ekonomike, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike: afatet kohore të procedurave**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me respektimin e afateve kohore të procedurave për përfitimin e ndihmës ekonomike, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike: abuzime me procedurat**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me ekzistencën e abuzimeve në procedurat për përfitimin e ndihmës ekonomike, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike: përfitimi i padrejtë**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me ekzistencën e rasteve të përfitimit të padrejtë të ndihmës ekonomike, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike: ndihma nga punonjësit socialë**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me faktin nëse punonjësit e shërbimit social e ndihmojnë atë për shpjegimin e procedurave të domosdoshme për përfitimin e ndihmës ekonomike, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike: gatishmëria nga punonjësit e shërbimit social apo të bashkisë**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me faktin nëse punonjësit e shërbimit social apo të bashkisë janë të gatshëm të japin informacion lidhur me kushtet për përfitimin e ndihmës ekonomike, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike: qartësia e informacionit**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me faktin nëse informacioni i servirur në media apo nga institucionet përkatëse lidhur me kushtet që duhen plotësuar për përfitimin e ndihmës ekonomike është i qartë, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike: prirjet politike**

Përkufizimi operacional: opinioni i subjektit në studim lidhur me faktin nëse prirjet politike ndikojnë në përfitimin e ndihmës ekonomike, sipas perceptimit të tij/saj dhe siç raportohet nga vetë ai/ajo.

Shkalla e matjes: kategorike, dikotomike (jo, po).

**Numri i barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike**

Përkufizimi operacional: numri i barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike, llogaritur në bazë të informacionit për barrierat individuale të raportuara nga subjektet në studim.

Shkalla e matjes: numerik, diskrete (asnjë barrierë, një barrierë, dy barriera, tre barriera, etj.). Për qëllimet tona, ky variabël u rikodua në një variabël kategorik ordinal me tre kategori (asnjë barrierë, 1-2 barriera, >2 barriera).

## 3.5 ANALIZA STATISTIKORE E TË DHËNAVE

Një sërë treguesish, tenkikash dhe testesh statistikore u përdorën për të përshkruar, vlerësuar dhe interpretuar të dhënat e disponueshme në këtë studim si dhe lidhjet (shoqërimet) midis variableve të ndryshme.

Për ndryshorët (variablet) numerike u raportuan madhësitë e prirjes qendrore (mesatarja aritmetike), madhësitë e dispersionit (shmangia standarde), si dhe vlera minimale dhe maksimale aty ku kjo aplikohej. Për ndryshorët kategorikë u raportuan numrat absolutë dhe përqindjet përkatëse.

Për vlerësimin e lidhjeve (shoqërimeve) midis variableve të ndryshme u përdorën teste statistikore në përshtatje me natyrën e variableve që marrin pjesë në një lidhje të caktuar. Në rastin kur variabli numerik është i shpërndarë

në mënyrë normale në popullatën e studimit (pra vlera mesatare, mediana dhe moda janë të përafërta me njëra tjetrën dhe kurba nuk është e zhvendosur shumë majtas apo djathtas apo shumë lart apo poshtë kurbës normale), atëherë për krahasimin e vlerave mesatare mes dy grupeve u përdor testi "t" i Studentit. Në rastin kur varibali numerik nuk i përmbushte kushtet e një shpërndarjeje normale, përdorëm një test tjetër që merr parasysh këtë situatë, siç është testi joparametrik Mann-Whitney U-test.

Për vlerësimin e shoqërimeve midis variableve kategorike u përdor testi statistikor hi katror. Ky test raporton vlerën e P-së, si dhe shkallët e lirisë.

Për përcaktimin e lidhjeve bivariate midis variableve numerike u përdor koeficienti i korrelacionit Spearman's rho. Ky test është superior ndaj procedurës Pearson, pasi është i përshtatshëm kur variablet janë të pastër numerike, por edhe në rastin kur variablet në studim kanë disa ose pak kategori. Ky test raporton koeficientin e korrelacionit dhe vlerën përkatëse të domethënies statistikore, vlerën e P-së. Koeficienti i korrelacionit varion nga -1 në +1; sa më i lartë koeficienti i korrelacionit, aq më e fortë është lidhja lineare midis dy variableve dhe sa më pranë zeros aq më e dobët është ajo. Kur koeficienti i korrelacionit është zero, atëherë dy variablet nuk janë të lidhur me njëri-tjetrin. Shenja "plus" ose "minus" tregon drejtimin e lidhjes – lidhje pozitive ose negative, përkatësisht.

Për të identifikuar faktorët kryesorë që shpjegojnë pjesën më të madhe të variacionit të vënë re lidhur me barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike, u përdor testit i Analizës së Faktorëve (Factor Analysis). Ky test lejon përcaktimin e peshës specifike që zë çdo komponent i përfshirë në analizë në shpjegimin e variancës së fenomenit të interesit dhe përcaktimin e çdo komponenti të veçantë. Kjo peshë shprehet në një mënyrë shumë të kuptueshme: në përqindje. Për të përcaktuar faktorët me ndikimin më të madh midis barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike, u ndërtuan disa modele në testin e analizës së faktorëve. Fillimisht u përcaktua ekstraktimi modeli i ekstraktimit të faktorëve, që ishte ai i komponentëve kryesorë (principal components). Më pas u kërkua ekstraktimi i vetëm atyre faktorëve eigenvaluet e të cilëve ishin >1. U përdor rrotullimi i tipit varimax për thjeshtësimin e interpretimit të rezultateve. Nga kjo procedurë u arri të ekstraktoheshin vetëm 3 komponentë. Meqë ne donim të nxirrnim më tepër komponentë, ateherë bëmë ri-përcaktimin e vlerës së eigenvalues duke e uler atë në >0.9. Duke përdorur të njëjtat parametra të modelit të ekstraktimit (principal components) dhe rrotullimit (varimax) u ribë testi i Analizës së Faktorëvë. Në këtë rast u arrit të ekstraktoheshin 4 komponentët kryesore të cilët shpjegojnë mbi 66% të variacionit të vënë re në barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike. Duke përdorur të dhënat e matriksit të komponentëve, matriksit të komponentëve të rrotulluar dhe matriksin e koeficientëve të rezultateve të komponentëve u arrit të identifikoheshin saktësisht cilët ishin

këta 4 komponentë që luajnë rol kryesor në barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Për të përcaktuar faktorët e lidhur me barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike u përdor në thelb testi ANOVA (analiza e variancës). Ky test u përdor për krahasimin e vlerave mesatare numerike mes më shumë se dy grupeve. Në SPSS kjo procedurë kryhet edhe përmes Modelit Linear të Përgjithshëm i cili mundëson kontrollin (axhustimin) për shumë ndryshorë (variable) të tjerë (numerike dhe/ose kategorike). Përdorimi i Modelit Linear të Përgjithshëm u bë i nevojshëm për të studiuar dhe krahasuar numrin mesatar të barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike sipas variableve demografikë, socio-ekonomikë, variableve që kanë të bëjnë me gjendjen shëndetësore dhe praninë e sëmundjeve kronike, numrin e personave të disavantazhuar në familje, kohëzgjatjen e përfitimit të ndihmës ekonomike dhe besimit tek nëpunës të ndryshëm të shteti.

Në mënyrë që të kontrollohej efekti i variableve të ndryshëm konfondues, u përdorën dy modele të Modelit Linear të Përgjithshëm. Variable konfonduese janë të gjithë ato variable të cilët, në mënyrë direkte apo indirekte, ndikojnë në lidhjen e interesit. Për këtë arsye, fillimisht u realizua lidhja univariate, pra krudo, bruto, apo e pa kontrolluar për asnjë faktor të mundshëm konfondues midis variableve të interesit (Modeli 1 në analizat e Modelit Linear të Përgjithshëm). Më pas, u kontrollua apo axhustua për gjininë, moshën, nivelin e edukimit, gjendjen shëndetësore dhe praninë e sëmundjeve kronike dhe gjininë, (Modeli 2 në analizat e Modelit Linear të Përgjithshëm). Në Modelin 2 është mbajtur konstant, është neutralizuar apo është kontrolluar edhe njëherazi efekti potencial konfondues i këtyre faktorëve. Ky përfaqëson dhe modelin tonë final, ku rezultatet janë të axhustuar për të gjithë faktorët potencialisht konfondues të përfshirë në studim.

Modeli Linear i Përgjithshëm raportoi këto parametra statistikorë:

a) Vlerën mesatare të parametrit në studim (në rastin tonë numrin mesatar të barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike).

b) Intervali i besimit 95% për vlerën mesatare (95%CI). Intervali i besimit 95% shpreh intervalin ku ne jemi të sigurt që gjendet vlera mesatare e raportuar në 95% të rasteve. Duke qënë se kampioni jonë prej 232 subjektesh ciftesh është një fraksion i popullatës referencë (N=1199), atëherë asnjëherë nuk jemi të sigurt që vlera mesatare e raportuar e barrierave të ndihmës ekonomike nga kampioni jonë është saktësisht po kaq dhe në popullatën referencë. Për këtë arsye raportohet Intervali i Besimit 95%, ku ne jemi të sigurt që ndodhet vlera jonë mesatare në 95% të rasteve.

c) Vlera e P-së apo e domethënies statistikore. Në thelb, P shpreh rolin që luan shansi në shpjegimin e lidhjes së vënë re midis variableve të ndryshme. Sa më e lartë vlera e P-së, aq më shumë luan rol shansi në shpjegimin e lidhjes

dhe aq më pak përmbushen kriteret e shkakësisë midis variableve në një lidhje statistikore. Me marrëveshje, një vlerë e P-së prej 5% ose më pak merret si tregues i domethënies statistikore.

d) Shkallët e lirisë. Shkallët e lirisë kanë kuptim të raportohen krahas vlerave të domethënies statistikore vetëm kur variabli i pavaruar ka më shumë se dy kategori. Kur variabli i pavarur ka dy kategori, shkallët e lirisë janë një dhe zakonisht kjo nuk raportohet.

Në të gjitha rastet u konsideruan si statistikisht sinjifikante (të përfillshme) vlerat e $P<0.05$. Kjo është dhe marrëveshja ndërkombëtare lidhur me vlerën e P-së, e cila nënkupton se një vlerë e P-së prej 5% ose më pak e përjashton në mënyrë të kënaqshme rolin e shansit si shpjegues së lidhjes statistikore të vërejtur.

Krahas tabelave, për paraqitjen grafike të të dhënave u përdorën bar-diagramet pasi natyra e të dhënave tona favorizonte përdorimin e kësaj teknikë (e përshtatshme për vizualizimin e të dhënave kategorike). Gjithashtu, u përdorën dhe grafikët në trajtë torte (pie charts).

E gjithë analiza statistikore e ta dhënave u krye me paketën statistikore SPSS (Statistical Package for Social Sciences), versioni 15.

## 3.6 KUFIZIMET E STUDIMIT

Studimi ynë ka disa kufizime. Së pari, në studimin tonë u përfshi rreth 50% e familjeve që përfitojnë ndihmë në Bashkinë e Durrësit në vitin 2014 (siç është shpjeguar në seksionin e metodologjisë). Gjithashtu, përzgjedhja e individëve nuk u bë në mënyrë rastësore, por u përfshinë në studim individët të cilët u paraqitën në mënyrë të njëpasnjëshme në zyrat e ndihmës ekonomike të njësive administrative përkatëse, derisa të plotësohej kuota e paracaktuar. Për këto arsye, kampioni ynë mund të vuajë nga gabimi sistematik i përzgjedhjes. Megjithatë, fakti që ky kampion mbulon rreth 50% të të gjitha familjeve nën skemën e ndihmës ekonomike në Bashkinë Durrës është një tregues në favor të minimizimit të biasit të përzgjedhjes.

Studimi ynë bazohet vetëm tek një kampion midis përfituesve të ndihmës ekonomike në Bashkinë Durrës. Për këtë arsye, gjetjet e studimit mund të përgjithësohen, në rastin më të mirë, vetëm për përfituesit e ndihmës ekonomike në Bashkinë Durrës, kurse përgjithësimi për të gjithë Shqipërinë mund të jetë problematik. Megjithatë, në mendojmë që këto rezultate mund të jenë përfaqësuese për të gjithë vendin, duke patur parasysh që Durrësi është një nga qytetet që ka përjetuar ndryshime të mëdha sociale dhe demografike gjatë 20 viteve të fundit, si pjesa më e madhe e rajoneve të vendit tonë. Gjithsesi, ky pohim duhet marrë me shumë rezerva.

Një tjetër kufizimi i studimit tonë vjen nga vetë natyra kros-seksionale e tij, e cila nuk lejon përcaktimin e qartë të sekuencës kohore midis eventeve. Prandaj, në studimin tonë e kemi të pamundur të saktësojmë nëse lidhjet e vërejtura janë shkakësore.

Gjithashtu, informacioni i marrë dhe i përdorur në studimin tonë e ka origjinën nga vetë-raportimi i subjekteve në studim. Për këtë arsye, ne nuk mund të përjashtojmë plotësisht biasin e informacionit. Nga ana tjetër, nuk ka arsye të besojmë për raportim të diferencuar midis grupeve në studim, gjë që dëshmon që keq-raportimi, në skenarin më të pafavorshëm, është i padiferencuar.

KAPITULLI

4

# REZULTATET E STUDIMIT

## 4.1 KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME TË SUBJEKTEVE NË STUDIM

Në studim morën pjesë 232 subjekte, nga të cilët 122 (52.6%) ishin femra. Shpërndarja e pjesëmarrësve në studim sipas karakteristikave socio-demografike bazë paraqitet në Tabelën 1 në vijim.

**Tabela 1. Shpërndarja e subjekteve sipas karakteristikave socio-demografike**

| Variabli | Total | Gjinia | | Vlera e P-së |
|---|---|---|---|---|
| | | Meshkuj (n=110) | Femra (n=122) | |
| **Mosha** (vite) | 46.5 ± 10.8 * | 47.7 ± 11.1 | 45.4 ± 10.5 | 0.045 ‡ |
| **Grup-mosha** | | | | |
| ≤35 vjeç | 36 (15.5) † | 13 (11.8) | 23 (18.9) | |
| 36-45 vjeç | 68 (29.3) | 33 (30.0) | 35 (28.7) | |
| 46-55 vjeç | 81 (34.9) | 33 (30.0) | 48 (39.3) | 0.020 ¶ |
| >55 vjeç | 47 (20.3) | 31 (28.2) | 16 (13.1) | |
| **Edukimi** (vite) | 7.4 ± 3.4 * | 7.5 ± 3.5 † | 7.3 ± 3.4 | 0.629 ‡ |
| **Niveli i edukimit** | | | | |
| 0-4 vjet | 49 (21.1) | 22 (20.0) | 27 (22.1) | |
| 5-8 vjet | 134 (57.8) | 62(56.4) | 72 (59.0) | 0.633 ¶ |
| >8 vjet | 49 (21.1) | 26 (23.6) | 23(18.9) | |
| **Përkatësia fetare** | | | | |
| Myslyman | 204 (87.9) | 96 (87.3) | 108 (88.5) | |
| Katolik | 7 (3.0) | 2 (1.8) | 5 (4.1) | 0.457 ¶ |
| Ortodoks | 18 (7.8) | 11 (10.0) | 7 (5.7) | |
| Tjetër | 3 (1.3) | 1 (0.9) | 2 (1.6) | |
| **Përkatësia etnike** | | | | |
| Shqiptare | 217 (93.5) | 104 (94.5) | 113 (92.6) | |
| Rome | 9 (3.9) | 5 (4.5) | 4 (3.3) | 0.281 ¶ |
| Tjetër | 6 (2.6) | 1 (0.9) | 5 (4.1) | |
| **Gjendja civile** | | | | |
| Beqar | 27 (11.6) | 10 (9.1) | 17 (13.9) | |
| Martuar | 131 (56.5) | 69 (62.7) | 62 (50.8) | 0.294 ¶ |
| Divorcuar | 68 (29.3) | 29 (26.4) | 39 (32.0) | |
| I/e ve | 6 (2.6) | 2 (1.8) | 4 (3.3) | |

* Vlera mesatare ± deviacionin standard. † Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa).

‡ Vlera e P-së sipas testit joparametrik Mann-Whitney U-test.

¶ Vlera e P-së sipas testit hi katror.

Mosha mesatare e pjesëmarrësve ishte 46.5 vjeç ± 10.8 vite. Mosha minimale në studim ishte 18 vjeç (1 rast) dhe mosha maksimale ishte 83vjeç (1 rast). Mosha mesatare e meshkujve ishte në mënyrë domethënëse më e lartë se ajo e femrave (Tabela 1), por nuk u vunë re ndryshime domethënëse lidhur me karakteristikat e tjera socio-demografike. Pjesëmarrësit kishin përfundur mesatarisht 7.4 vite edukimi formal, pjesa dërrmuese (87.9%) ishin myslimanë dhe të etnisë shqiptare (93.5%). Rreth një e treta e pjesëmarrësve ishin të divorcuar në kohën e kryerjes së studimit (Tabela 1).

Kurse Tabela 2 në vijim paraqet shpërndarjen e subjekteve në studim sipas karakteristikave socio-ekonomike, aktivitetit fizik, gjendjes së shëndetit dhe pranisë së sëmundjeve kronike.

**Tabela 2. Shpërndarja e subjekteve sipas karakteristikave socio-ekonomike**

| Variabli | Total | Gjinia | | Vlera e P-së |
|---|---|---|---|---|
| | | Meshkuj (n=110) | Femra (n=122) | |
| **Statusi i punësimit**<br>Vetëpunësuar<br>Papunë | 12 (5.2) *<br>220 (94.8) | 7 (6.4)<br>103 (93.6) | 5 (4.1)<br>117 (95.9) | 0.437 † |
| **Shtresa sociale**<br>E ulët<br>E mesme<br>E lartë | <br>210 (90.5)<br>21 (9.1)<br>1 (0.4) | <br>102 (92.7)<br>8 (.3)<br>0 (0.0) | <br>108 (88.5)<br>13 (10.7)<br>1 (0.8) | 0.418 † |
| **Gjendja ekonomike**<br>E mirë<br>Mesatare<br>E keqe<br>Shumë e keqe | <br>3 (1.3)<br>15 (6.5)<br>119 (51.3)<br>95 (40.9) | <br>2 (1.8)<br>7 (6.4)<br>59 (53.6)<br>42 (38.2) | <br>1 (0.8)<br>8 (6.6)<br>60 (49.2)<br>53 (43.4) | 0.786 † |
| **Aktiviteti fizik**<br>I lartë<br>I mesëm<br>I ulët | <br>10 (4.3)<br>114 (49.1)<br>108 (46.6) | <br>6 (5.5)<br>49 (44.5)<br>55 (50.0) | <br>4 (3.3)<br>65 (53.3)<br>53 (43.4) | 0.356 † |
| **Gjendja shëndetësore**<br>Shumë e mirë<br>E mirë<br>Mesatare<br>E keqe<br>Shumë e keqe | <br>8 (3.4)<br>50 (21.6)<br>85 (36.6)<br>65 (28.0)<br>24 (10.3) | <br>4 (3.6)<br>31 (28.2)<br>39 (35.5)<br>28 (25.5)<br>8 (7.3) | <br>4 (3.3)<br>19 (15.6)<br>46 (37.7)<br>37 (30.3)<br>16 (13.1) | 0.149 † |
| **Sëmundje kronike**<br>Jo<br>Po | <br>149 (64.2)<br>83 (35.8) | <br>75 (68.2)<br>35 (31.8) | <br>74 (60.7)<br>48 (39.3) | 0.232 † |

* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa). † Vlera e P-së sipas testit hi katror.

Pjesa dërrmuese e subjekteve në studim deklaruan se ishin papunë (94.8%), në gjendje ekonomike të keqe ose shumë të keqe (92.2%), dhe i përkisnin shtresës së ulët sociale (90.5%) në kohën e kryerjes së studimit (Tabela 2).

Afërsisht gjysma e pjesëmarrësve (46.6%) kryenin aktivitet të ulët fizik, 38.3% e tyre deklaruan gjendje shëndetësore të keqe ose shumë të keqe dhe një e treta (35.8%) kishin të paktën një sëmundje kronike (Tabela 2). Shpërndarja e këtyre karakteristikave midis meshkujve dhe femrave nuk kishte ndryshime domethënëse nga ana statistikore (P>0.005).

## 4.2 KARAKTERISTIKAT E FAMILJES TË SUBJEKTEVE NË STUDIM

Të dhënat lidhur me strukturën e familjes dhe praninë e anëtarëve të disavantazhuar paraqiten në Tabelën 3 në vijim.

**Tabela 3. Shpërndarja e subjekteve sipas strukturës së familjes**

| Variabli | Total | Gjinia | | Vlera e P-së |
|---|---|---|---|---|
| | | Meshkuj (n=110) | Femra (n=122) | |
| **Me kë jetoni** | | | | |
| Me familjen | 227 (97.8) * | 107 (97.3) | 120 (98.4) | 0.569 ‡ |
| Vetëm | 5 (2.2) | 3 (2.7) | 2 (1.6) | |
| **Numri i anëtarëve në familje** † | 4.91 ± 1.65 † | 3.95 ± 1.36 | 4.21 ± 1.87 | 0.599¶ |
| **Madhësia e familjes** | | | | |
| 1 anëtar (vetëm) | 5 (2.2) | 3 (2.7) | 2 (1.6) | |
| 2-3 anëtarë | 88 (37.9) | 39 (35.5) | 49 (40.2) | 0.269 ‡ |
| 4 anëtarë | 67 (28.9) | 38 (34.5) | 29 (23.8) | |
| >4 anëtarë | 72 (31.0) | 30 (27.3) | 42 (34.4) | |
| **Fëmijë nën 18 vjeç** | | | | |
| Jo | 88 (37.9) | 43 (39.1) | 45 (36.9) | 0.730 ‡ |
| Po | 144 (62.1) | 67 (60.9) | 77 (63.1) | |
| **Të paaftë në familje** | | | | |
| Jo | 199 (85.8) | 94 (85.5) | 105 (86.1) | 0.894 ‡ |
| Po | 33 (14.2) | 16 (14.5) | 17 (13.9) | |
| **Të moshuar në familje** Jo | | 91 (82.7) | | |
| Po | 195 (84.1) | 19 (17.3) | 104 (85.2) | 0.601 ‡ |
| | 37 (15.9) | | 18 (14.8) | |
| **Të divorcuar në familje** | | | | |
| Jo | 172 (74.1) | 82 (74.5) | 90 (73.8) | 0.893 ‡ |
| Po | 60 (25.9) | 28 (25.5) | 32 (26.2) | |
| **Fëmije jetim në familje** | | | | |
| Jo | 206 (88.8) | 99 (90.0) | 107 (87.7) | 0.580 ‡ |
| Po | 26 (11.2) | 11 (10.0) | 15 (12.3) | |
| **Të papunë në familje** | | | | |
| | 14 (6.0) | 8 (7.3) | 6 (4.9) | 0.452 ‡ |
| Jo | 218 (94.0) | 102 (92.7) | 116 (95.1) | |
| Po | | | | |
| **Familje vulnerabël** ¶ | | | | |
| 0-1 persona vulnerabël | 52 (22.4) | 25 (22.7) | 27 (22.1) | 0.858 ‡ |
| 2-3 persona vulnerabël | 154 (66.4) | 75 (67.3) | 80 (65.6) | |
| >3persona vulnerabël | 26 (11.2) | 11 (10.0) | 15 (12.3) | |

* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa). † Vlera mesatare ± deviacionin standard ¶ Vlera e P-së sipas testit jo-parametrik Mann-Whitney U-test. ‡ Vlera e P-së sipas testit hi katror.

Vetëm 2.2% e subjekteve në studim jetonin vetëm, kurse pjesa tjetër jetonte me familjen. Madhësia mesatare e familjes (midis subjekteve që jetonin në familje) ishte 4.9 persona ± 1.7 persona. Numri minimal i anëtarëve të familjes (midis subjekteve që jetonin në familje) ishte 2 dhe numri maksimal 15 (1 rast), kurse në rreth një të tretën e rasteve (31%) familja përbëhej nga më shumë se 4 anëtarë (Tabela 3). Fëmijët nën 18 vjeç, fëmijët jetim, persona të paaftë, të moshuar, të divorcuar dhe të papunë ishin të pranishëm në 62.1%, 11.2%, 14.2%,15.9%, 25.9% dhe 94% të familjeve të subjekteve në studim, përkatësisht. Në 22.4% të rasteve familjet e pjesëmarrësve nuk kishin asnjë person të disavantazhuar (kategoritë e përmendura më lart) ose kishin vetëm një anëtar të tillë, në 66.4% të rasteve në familje ishin të pranishëm 2-3 persona të disavantazhuar dhe në 11.2% numri i personave të disavantazhuar në familje ishte më i madh se tre (Tabela 3). Këto ndryshime midis meshkujve dhe femrave ishin jo domethënëse nga ana statistikore (P>0.005).




**Grafiku 1. Shpërndarja e subjekteve në studim sipas madhësisë së familjes së tyre**




**Grafiku 2. Shpërndarja e subjekteve në studim sipas pranisë së personave të disavantazhuar në familjet e tyre**




**Grafiku 3. Shpërndarja e subjekteve në studim sipas numrit të personave vulnerabël në familjen e tyre**

## 4.3 KËNAQËSIA ME GJENDJEN AKTUALE, FUQIZIMIN DHE PJESËMARRJEN

Të dhënat në vijim kanë të bëjnë me shpërndarjen e opinioneve të subjekteve lidhur me disa aspekte të kënaqësisë me gjendjen aktuale.

**Tabela 4. Opinionet e subjekteve lidhur me gjendjen aktuale, sipas gjinisë**

| Variabli | Total | Gjinia | | Vlera e P-së |
|---|---|---|---|---|
| | | Meshkuj (n=110) | Femra (n=122) | |
| **Niveli i lumturisë** * | 1.91 ± 0.84 † | 2.05 ± 0.86 | 1.78 ± 0.79 | 0.020 ¶ |
| **Sa i/e lumtur je** | | | | |
| Jo ose aspak i lumtur | 174 (75.0) ‡ | 76 (69.1) | 98 (80.3) | 0.142 § |
| Mesatarisht | 53 (22.8) | 31 (28.2) | 22 (18.0) | |
| Shumë ose i lumtur | 5 (2.2) | 3 (2.7) | 2 (1.6) | |
| **Niveli i kënaqësisë me gjendjen ekonomike** * | 1.75 ± 0.73 | 1.81 ± 0.74 | 1.68 ± 0.72 | 0.152 ¶ |
| **Kënaqur gj.ekonomike** | | | | |
| Jo ose aspak i kënaqur | 192 (82.8) | 88 (80.0) | 104 (85.2) | 0.291 § |
| Mesatarisht | 40 (17.2) | 22 (20.0) | 18 (14.8) | |
| Shumë ose i kënaqur | 0 (0.0) | 0 (0.0) | 0 (0.0) | |
| **Niveli i kënaqësisë me politikat sociale** * | 1.92 ± 0.75 | 2.11 ± 0.78 | 1.75 ± 0.68 | 0.001 ¶ |
| **Kënaqur politikat sociale** | | | | |
| Jo ose aspak i kënaqur | 183 (78.9) | 78 (70.9) | 105 (86.1) | 0.006 § |
| Mesatarisht | 45 (19.4) | 28 (25.5) | 17 (13.9) | |
| Shumë ose i kënaqur | 4 (1.7) | 4 (3.6) | 0 (0.0) | |
| **Niveli i dakordësisë me masat për reduktimin e varfërisë** * | 4.25 ± 0.95 | 4.30 ± 0.92 | 4.20 ± 0.97 | 0.431 ¶ |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Dakord me masat për reduktimin e varfërisë** | | | | |
| Jo ose aspak dakord | 14 (6.0) | 5 (4.5) | 9 (7.4) | 0.653 § |
| Mesatarisht | 22 (9.5) | 11 (10.0) | 11 (7.0) | |
| Shumë dakord ose dakord | 196 (84.5) | 94 (85.5) | 102 (83.6) | |
| **Niveli i fuqisë për të ndryshuar jetën** * | 2.78 ± 1.27 | 3.06 ± 1.25 | 2.53 ± 1.25 | 0.002 ¶ |
| **Aftësia për të ndryshuar jetën tuaj** | | | | |
| Jo i aftë ose aspak i aftë | 111 (47.8) | 40 (36.4) | 71 (58.2) | 0.004 § |
| Mesatarisht | 35 (15.1) | 20 (18.2) | 15 (12.3) | |
| Shumë i aftë ose i aftë | 86 (37.1) | 50 (45.5) | 36 (29.5) | |

* Matur në një shkallë nga 1 (aspak) në 5 (shumë). † Vlera mesatare ± deviacionin standard. ‡ Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa). ¶ Vlera e P-së sipas testit joparametrik Mann-Whitney U-test. § Vlera e P-së sipas testit hi katror.

Niveli mesatar i lumturisë, i matur në një shkallë nga 1 (kënaqësia minimale) në 5 (kënaqësia maksimale) ishte 1.91 ± 0.84, në mënyrë domethënëse më i lartë midis meshkujve (vlera mesatare 2.05) sesa midis femrave (vlera mesatare 1.78), (P=0.020). Tre të katërtat e subjekteve në studim nuk ishin aspak të lumtur ose ishin jo të lumtur në përgjithësi, 82.8% ishin jo të kënaqur ose aspak të kënaqur me gjendjen e tyre ekonomike dhe rreth katër të pestat e tyre (78.9%) ishin jo të kënaqur ose aspak të kënaqur me politikat sociale aktuale (Tabela 4). Në mënyrë domethënëse më shume femra sesa meshkuj ishin të pakënaqura me politikat sociale aktuale (85.2% vs. 80.0%, përkatësisht, P=0.006). Rreth gjysma e subjekteve në studim (47.8%) mendonin se ishin të paaftë ose aspak të aftë për të ndryshuar jetën e tyre ku proporcioni midis femrave që mendonin kështu ishte në mënyrë domethënëse më i lartë se ai i meshkujve (58.2% vs. 36.4%, përkatësisht, P=0.004) [Tabela 4].

Ndërkohë, rreth 85% e subjekteve në studim ishin dakort ose shumë dakort me faktin që qeveria duhet të marra masa për reduktimin e diferencave në të ardhurat e qytetarëve (Tabela 4).




**Grafiku 4. Shpërndarja e subjekteve sipas gjinisë dhe kënaqësisë me politikat sociale aktuale**

Të dhënat në vijim kanë të bëjnë me shpërndarjen e subjekteve lidhur me disa aspekte të kënaqësisë me gjendjen aktuale, sipas numrit të personave të disavantazhuar në familje.

**Tabela 5. Opinionet e subjekteve lidhur me gjendjen aktuale, sipas numrit të personave të disavantazhuar në familje**

| Variabli | Numri i anëtarëve të disavantazhuar në familje | | | Vlera e P-së |
|---|---|---|---|---|
| | 0-1 persona vulnerabël | 2-3 persona vulnerabël | >3 persona vulnerabël | |
| **Niveli i lumturisë** * | 1.90 ± 0.85 † | 1.97 ± 0.85 | 1.58 ± 0.64 | 0.087 ¶ |
| **Sa i/e lumtur je** | | | | |
| Jo ose aspak i lumtur | 40 (76.9) ‡ | 110 (71.4) | 24 (92.3) | 0.166 § |
| Mesatarisht | 10 (19.2) | 41 (26.6) | 2 (7.7) | |
| Shumë ose i lumtur | 2 (3.8) | 3 (1.9) | 0 (0.0) | |
| **Niveli i kënaqësisë me gjendjen ekonomike** * | 1.88 ± 0.76 | 1.75 ± 0.73 | 1.42 ± 0.64 | 0.031 ¶ |
| **Kënaqur gj.ekonomike** | | | | |
| Jo ose aspak i kënaqur | 40 (76.9) | 128 (93.1) | | 0.233 § |
| Mesatarisht | 12 (23.1) | 26 (16.9) | 24 (92.3) | |
| Shumë ose i kënaqur | 0 (0.0) | 0 (0.0) | 2 (7.7) | |
| | | | 0 (0.0) | |
| **Niveli i kënaqësisë me politikat sociale** * | 2.17 ± 0.83 | 1.87 ± 0.72 | 1.73 ± 0.67 | 0.016 ¶ |
| **Kënaqur pol.sociale** | | | | |
| Jo ose aspak i kënaqur | 37 (71.2) | 123 (79.9) | 23 (88.5) | 0.004 § |
| Mesatarisht | 11 (21.2) | 31 (20.1) | 3 (11.5) | |
| Shumë ose i kënaqur | 4 (7.7) | 0 (0.0) | 0 (0.0) | |
| **Niveli i dakordësisë me masat për reduktimin e varfërisë** * | 4.31 ± 0.98 | 4.29 ± 0.93 | 3.88 ± 0.95 | 0.113 ¶ |
| **Dakord me masat për reduktimin e varfërisë** | | | | |
| Jo ose aspak dakord | 3 (5.8) | 9 (5.8) | 2 (7.7) | 0.827 § |
| Mesatarisht | 4 (7.7) | 14 (9.1) | 4 (15.4) | |
| Shumë dakord ose dakord | 45 (86.5) | 131 (85.1) | 20 (76.9) | |
| **Niveli i fuqisë për të ndryshuar jetën** * | 3.30 ± 1.22 | 2.82 ± 1.31 | 2.40 ± 1.07 | 0.010 ¶ |
| **Aftësia për të ndryshuar jetën tuaj** | | | | |
| Jo i aftë ose aspak i aftë | 10 (38.5) | 68 (44.2) | 33 (63.5) | 0.012 § |
| Mesatarisht | 1 (3.8) | 26 (16.9) | 8 (15.4) | |
| Shumë ose i aftë | 15 (57.7) | 60 (39.0) | 11 (21.2) | |

* Matur në një shkallë nga 1 (aspak) në 5 (shumë). † Vlera mesatare ± deviacionin standard. ‡ Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa). ¶ Vlera e P-së sipas testit t të studentit. § Vlera e P-së sipas testit hi katror.

U vunë re diferenca statistikisht domethënëse midis numrit të personave të disavantazhuar në familje dhe nivelit të kënaqësisë me gjendjen ekonomike, politikat sociale aktuale dhe aftësinë për të ndryshuar jetën (Tabela 5). Kështu, me rritjen e numrit të personave të disavantazhuar në familje ulej dhe niveli mesatar i kënaqësisë nga 1.88 në familjet me 0-1 persona të disavantazhuar, në 1.75 dhe 1.42 në familjet me 2-3 dhe >3 anëtarë të disavantazhuar, përkatësisht, (P=0.031). E njëjta tendencë u vu re lidhur me nivelin e kënaqësisë me politikat sociale aktuale gjithashtu (niveli mesatar i kënaqësisë 2.17, 1.87 dhe 1.73, përkatësisht, P=0.016): 71.2% e familjeve me 0-1 anëtar të disavantazhur ishin jo të kënaqur ose aspak të kënaqur me politikat sociale aktule kundrejt 88.5% të familjeve me >3 anëtarë të disavantazhuar (Tabela 5). Po kështu, me rritjen e numrit të personave të disavantazhur në familje, ulej niveli i aftësisë për të ndryshuar jetën vetjake (niveli mesatar i aftësisë 3.30, 2.82 dhe 2.40, përkatësisht në familjet me 0-1, 2-3 dhe >3 anëtarë të disavantazhuar, përkatësisht, P=0.012) [Tabela 5].




**Grafiku 5. Shpërndarja e subjekteve sipas kënaqësisë me politikat sociale aktuale dhe numrit të personave vulnerabël në familje**

Të dhënat në vijim kanë të bëjnë me shpërndarjen e subjekteve lidhur me disa aspekte të pjesëmarrjes në jetën sociale dhe politike gjatë vitit të fundit, sipas gjinisë.

Mbi katër të pestat e subjekteve në studim (83.6%) kishin votuar gjatë zgjedhjeve të kaluara por në mënyrë domethënëse më pak femra sesa meshkuj kishin marrë pjesë në votim (78.7% vs. 89.1%, përkatësisht, P=0.033) [Tabela 6]. E njëjta tendencë gjinore u vu re lidhur me pjesëmarrjen në protesta apo në fushata informuese dhe/ose politike ku një përqindje në mënyrë domethënëse më e ulët e femrave morën pjesë në këto aktivitete krahasuar me meshkujt (Tabela 6). Pjesëmarrja në mbledhje të këshillit bashkiak, takime me politikanët e zonës, pjesëmarrja në fushata informuese/politike apo njoftimi i policisë në rast problemesh në zonë varionte nga 7.3% (njoftimi i policisë) në 15.1% (takime me politikanët e zonës).

**Tabela 6. Shpërndarja e subjekteve sipas pjesëmarrjes në aktivitete politike**

| Variabli | Total | Gjinia | | Vlera e P-së |
|---|---|---|---|---|
| | | Meshkuj (n=110) | Femra (n=122) | |
| **A votuat gjatë zgjedhjeve të kaluara** | | | | 0.033 † |
| Jo | 38 (16.4) | 12 (10.9) | 26 (21.3) | |
| Po | 194 (83.6) | 98 (89.1) | 96 (78.7) | |
| **Mbledhje e këshillit bashkiak** | | | | 0.151 † |
| Jo | 213 (91.8) | 98 (89.1) | 115 (94.3) | |
| Po | 19 (8.2) | 12 (10.9) | 7 (5.7) | |
| **Takim me politikanët e zonës** | | | | 0.211 † |
| Jo | 197 (84.9) | 90 (81.8) | 107 (87.7) | |
| Po | 35 (15.1) | 20 (18.2) | 15 (12.3) | |
| **Morët pjesë në protesta** | | | | 0.028 † |
| Jo | 214 (92.2) | 97 (88.2) | 117 (95.9) | |
| Po | 18 (7.8) | 13 (11.8) | 5 (4.1) | |
| **Morët pjesë në fushata informuese ose politike** | | | | 0.009 † |
| Jo | 207 (89.2) | 92 (83.6) | 115 (94.3) | |
| Po | 25 (10.8) | 18 (6.4) | 7 (5.7) | |
| **Njoftuat median për probleme në zonë** | | | | 0.437 † |
| Jo | 220 (94.8) | 103 (93.6) | 117 (95.9) | |
| Po | 12 (5.2) | 7 (6.4) | 5 (4.1) | |
| **Njoftuat policinë për probleme në zonë** | | | | 0.328 † |
| Jo | 215 (92.7) | 100 (90.9) | 115 (94.3) | |
| Po | 17 (7.3) | 10 (9.1) | 7 (5.7) | |

* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa). † Vlera e P-së sipas testit hi katror.




**Grafiku 6. Shpërndarja e subjekteve sipas pjesëmarrjes në evente të ndryshme**




**Grafiku 7. Pjesëmarrja e meshkujve dhe femrave në evente të ndryshme**

Të dhënat në vijim kanë të bëjnë me opinionin e subjekteve lidhur sinqeritetin e kategorive të ndryshme të punonjësve të shtetit.

Nuk u vunë re ndryshime statistikisht domethënëse lidhur me opinionet e meshkujve dhe fermrave lidhur me sinqeritetin e punonjësve të ndryshëm të shtetit (Tabela 7). Sipas opinioneve të subjekteve në studim, më të pasinqertë janë kryeplaku dhe përfaqësuesit e qeverisë lokale me përkatësisht 46.6% dhe 44% të pjesëmarrësve që mendojnë se ata janë pak ose aspak të sinqertë (Tabela 7). Ndërkohë, më të sinqertët rezultojnë punonjësit e shërbimeve sociale dhe mësuesit duke qënë se 81% dhe 67.7% e pjesëmarrësve mendonin së këto kategori janë të sinqertë ose shumë të sinqertë. Gjithsesi, rreth dy të tretat e pjesëmarrësve (58.2%) mendojnë që sinqeriteti i zyrtarëve të bashkisë ka mbetur njëlloj ose përkeqësuar në 19% të rasteve krahasuar me dy vjet me parë. Në mënyrë interesante, pjesa dërrmuese e subjekteve në studim mendonin që politikanët nuk i marrin parasysh aspak (59.1% e subjekteve e mendojnë këtë) ose i marrin pak parasysh (40.5% e subjekteve e mendojnë këtë) shqetësimet e ngritura prej tyre për probleme të ndryshme dhe një përqindje në mënyrë domethënëse më e lartë e femrave sesa e meshkujve mendojnë që politikanët nuk i marrin aspak parasysh shqetësimet e komunitetit gjatë marrjes së vendimeve (68% vs. 49.1%, përkatësisht, P=0.010) [Tabela 7].




**Grafiku 8. Shpërndarja e opinioneve rreth sinqeritetit të punonjësve të shtetit**

**Grafiku 9. Shpërndarja e opinioneve lidhur me shkallën që politikanët marrin parasysh shqetësimet e ngritura nga komuniteti, sipas gjinisë**

**Tabela 7. Opinionet e subjekteve lidhur me sinqeritetin e punonjësve të shtetit, sipas gjinisë**

| Variabli | Total | Gjinia | | Vlera e P-së |
|---|---|---|---|---|
| | | Meshkuj (n=110) | Femra (n=122) | |
| **Përfaqësuesit e qeverisë lokale** | | | | |
| Aspak ose pak të sinqertë | | | | |
| Mesatarisht | 102 (44.0) | 51 (46.4) | 51 (41.8) | 0.704 † |
| Shumë ose të sinqertë | 61 (26.3) | 29 (26.4) | 32 (26.2) | |
| | 69 (29.7) | 30 (27.3) | 39 (32.0) | |
| **Kryeplaku** | | | | |
| Aspak ose pak të sinqertë | 108 (46.6) | 53 (48.2) | 55 (45.0) | 0.641 † |
| Mesatarisht | 56 (24.1) | 28 (25.5) | 28 (23.0) | |
| Shumë ose të sinqertë | 68 (29.3) | 29 (26.4) | 39 (32.0) | |
| **Mjekët dhe infermierët** | | | | |
| Aspak ose pak të sinqertë | 48 (20.7) | 23 (20.9) | 25 (20.5) | 0.967 † |
| Mesatarisht | 63 (27.2) | 29 (26.4) | 34 (27.9) | |
| Shumë ose të sinqertë | 121 (52.2) | 58 (52.7) | 63 (51.6) | |
| **Mësuesit** | | | | |
| Aspak ose pak të sinqertë | 34 (14.6) | 14 (12.7) | 20 (16.4) | 0.678 † |
| Mesatarisht | 41 (17.7) | 21 (19.1) | 20 (16.4) | |
| Shumë ose të sinqertë | 157 (67.7) | 75 (68.2) | 82 (67.2) | |
| **Punonjësit e policisë** | | | | |
| Aspak ose pak të sinqertë | 54 (23.3) | 25 (22.7) | 29 (23.5) | 0.936 † |
| Mesatarisht | 38 (16.4) | 19 (17.3) | 19 (15.6) | |
| Shumë ose të sinqertë | 140 (60.3) | 66 (60.0) | 74 (60.7) | |
| **Puonjësit e shërb.sociale** | | | | |
| Aspak ose pak të sinqertë | 27 (11.6) | 13 (11.8) | 14 (11.5) | 0.866 † |
| Mesatarisht | 17 (7.3) | 7 (6.4) | 10 (8.2) | |
| Shumë ose të sinqertë | 188 (81.0) | 90 (81.8) | 98 (80.3) | |
| **Sa i marrin parasysh politikanët shqetësimet tuaja** | | | | |
| Aspak | 137 (59.1) | 54 (49.1) | 83 (68.0) | 0.010 † |
| Pak | 94 (40.5) | 55 (50.0) | 39 (32.0) | |
| Shumë | 1 (0.4) | 1 (0.9) | 0 (0.0) | |
| **Krahasuar me 2 vjet me parë, sinqeriteti i zyrtarëve të bashkisë** | | | | |
| Është përkeqësuar | | | | |
| Ka mbetur njëlloj | 44 (19.0) | 15 (13.6) | 29 (23.8) | 0.134 † |
| Është përmirësuar | 135 (58.2) | 67 (60.9) | 68 (55.7) | |
| | 53 (22.8) | 28 (25.5) | 25 (20.5) | |

* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa). † Vlera e P-së sipas testit hi katror.

## 4.4 RRJETET SOCIALE, BESIMI DHE SOLIDARITETI NË KOMUNITET

Të dhënat në vijim kanë të bëjnë me shpërndarjen e subjekteve sipas karakteristikave të rrjetit social dhe mbështetjes tek miqtë apo të njohurit në rast nevoje.

**Tabela 8. Mbështetja tek miqtë apo të njohurit në rast nevoje**

| Variabli | Total | Gjinia | | Vlera e P-së |
|---|---|---|---|---|
| | | Meshkuj (n=110) | Femra (n=122) | |
| **Sa miq keni aktualisht** | 3.1 ± 5.2 * | 3.7 ± 5.7 ‡ | 2.7 ± 4.6 | 0.268 ‡ |
| **Në sa miq mund të merrni borxh para'** | | | | 0.041¶ |
| Tek asnjë | 121 (52.2)† | 47 (42.7) | 74 (60.7) | |
| 1-2 miq | 87 (37.5) | 48 (43.6) | 39 (32.0) | |
| 3-4 miq | 14 (6.0) | 8 (7.3) | 6 (4.9) | |
| >4 miq | 10 (4.3) | 7 (6.4) | 3 (2.5) | |
| **Do ja besonit fëmijët fqinjëve në rast nevoje** | | | | 0.012 ¶ |
| Padyshim Po | 17 (7.3) | 14 (12.7) | 3 (2.5) | |
| Ndoshta Po | 21 (9.1) | 12 (10.9) | 9 (7.4) | |
| Ndoshta Jo | 26 (11.2) | 13 (11.8) | 13 (10.7) | |
| Padyshim Jo | 168 (72.4) | 71 (64.5) | 97 (79.5) | |
| **Në sa miq mund të mbështetesh në rast fatkeqësie** | | | | 0.041 ¶ |
| Tek asnjë | 119 (51.3) | 47 (42.7) | 72 (59.0) | |
| 1-2 miq | 85 (36.6) | 47 (42.7) | 38 (31.1) | |
| 3-4 miq | 22 (9.5) | 11 (10.0) | 11 (9.0) | |
| >4 miq | 6 (2.6) | 5 (4.5) | 1 (0.8) | |
| **Sa miq ju kanë kërkuar ndihmë vitin e fundit** | 0.64 ± 1.9 | 0.7 ± 2.3 | 0.6 ± 1.3 | 0.725 ‡ |
| **Sa e ndihmoni njëri-tjetrin në lagje** | | | | 0.912 ¶ |
| Gjithnjë ose shpesh | 30 (12.9) | 15 (13.6) | 15 (12.3) | |
| Ndonjëherë | 68 (29.3) | 33 (30.0) | 35 (28.7) | |
| Rrallë ose kurrë | 134 (57.8) | 62 (56.4) | 72 (59.0) | |

*Vlera mesatare ± deviacionin standard. †Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa).
**Vlera e P-së sipas testit jo-parametrik Mann-Ëhitney U-test. ¶Vlera e P-së sipas testit hi katror.




**Grafiku 10. Shpërndarja e opinioneve lidhur me mbështetjen tek miqtë në rast nevoje, sipas gjinisë**

Mesatarisht, subjektet në studim kishin 3.1 miq apo shokë të ngushtë, pa diferenca gjinore, edhe pse femrat kishin mesatarisht më pak miq sesa meshkujt (2.7 vs. 3.7, përkatësisht, P=0.268) [Tabela 8]. Megjithatë, diferenca statistikisht domethënëse u vunë re midis femrave dhe meshkujve lidhur me numrin e miqve ku mund të mbështeten në rast nevoje. Kështu, 60.7% e femrave por 42.7% e meshkujve deklaruan se nuk kishin asnjë mik ku të merrnin para borxh në rast nevoje (P=0.012). Gjithashtu, 90% e femrave deklaruan që ndoshta nuk do i linin fëmijët tek fqinjët në rast nevoje kundrejt 76% të meshkujve që deklaruan të njëjtën gjë (P=0.041) (Tabela 8). Gjithashtu, shumë pak miq i kanë kërkuar ndihmë subjekteve në studim gjatë vitit të fundit (mesatarisht 0.64 persona), pa diferenca domethënëse midis meshkujve dhe femrave. Rreth 60% e subjekteve deklaruan që banorët në lagje e ndihmojnë rrallë ose nuk e ndihmojnë kurrë njëri-tjetrin (Tabela8).

Të dhënat në vijim kanë të bëjnë me shpërndarjen e subjekteve sipas shkallës së besimit që ata kanë në kategori të ndryshme punonjësish apo njerëzish.

Paralelisht me rezultatet lidhur me sinqeritetin e punonjësve të shtetit, rreth 64% dhe 54% e subjekteve kishin vetëm pak ose aspak besim tek përfaqësuesit e qeverisë qendrore dhe lokale, përkatësisht (Tabela 9). Gjithashtu, besimin më të lartë subjektet e kishin tek punonjësit e shërbimeve sociale dhe mjekët ku 70.7% dhe 62.1% e tyre u shprehën se i besonin ose i besonin shumë këtyre kategorive të punonjësve (Tabela 9). Nuk u vunë re diferenca gjinore në nivelin e besimit të subjekteve në kategoritë ndryshme të punonjësve të shtetit.

**Tabela 9. Opinionet e pjesëmarrësve lidhur me besimin tek punonjësit e shteti**

| Variabli | Total | Gjinia | | Vlera e P-së |
|---|---|---|---|---|
| | | Meshkuj (n=110) | Femra (n=122) | |
| **Sa besim keni tek zyrtarët e bashkisë** | | | | |
| Aspak ose pak | 126 (54.3) * | 56 (50.9) | 70 (57.4) | 0.505 † |
| Mesatarisht | 44 (19.0) | 24 (21.8) | 20 (16.4) | |
| I besoj ose i besoj shumë | 62 (26.7) | 30 (27.3) | 32 (26.2) | |
| **Sa besim keni tek punonjësit e shërb.soc.** | | | | |
| Aspak ose pak | 48 (20.7) | 24 (21.8) | 24 (19.7) | 0.879 † |
| Mesatarisht | 20 (8.6) | 10 (9.1) | 10 (8.2) | |
| I besoj ose i besoj shumë | 164 (70.7) | 76 (69.1) | 88 (72.1) | |
| **Sa besim keni tek qeveria qendrore** | | | | |
| Aspak ose pak | 148 (63.8) | 62 (56.4) | 86 (70.5) | 0.029 † |
| Mesatarisht | 39 (16.8) | 19 (17.3) | 20 (16.4) | |
| I besoj ose i besoj shumë | 45 (19.4) | 29 (26.4) | 16 (13.1) | |
| **Sa besim keni tek policia** | | | | |
| Aspak ose pak | 85 (36.6) | 38 (34.5) | 47 (38.5) | 0.817 † |
| Mesatarisht | 20 (8.6) | 10 (9.1) | 10 (8.2) | |
| I besoj ose i besoj shumë | 127 (54.7) | 62 (56.4) | 65 (53.3) | |
| **Sa besim keni tek mësuesit** | | | | |
| Aspak ose pak | 51 (22.0) | 23 (0.9) | 28 (23.0) | 0.662 † |
| Mesatarisht | 38 (16.4) | 16 (14.5) | 22 (18.0) | |
| I besoj ose i besoj shumë | 143 (61.6) | 71 (64.5) | 72 (59.0) | |
| **Sa besim keni tek mjekët dhe infermieret** | | | | |
| Aspak ose pak | 45 (19.4) | 24 (21.8) | 21 (17.2) | 0.651 † |
| Mesatarisht | 43 (18.5) | 19 (17.3) | 24 (19.7) | |
| I besoj ose i besoj shumë | 144 (62.1) | 67 (60.9) | 77 (63.1) | |
| **Sa besim keni tek të panjohurit** | | | | |
| Aspak ose pak | 225 (97.0) | 104 (94.5) | 121 (99.2) | 0.039 † |
| Mesatarisht | 7 (3.0) | 6 (5.5) | 1 (0.8) | |

* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa). † Vlera e P-së sipas testit hi katror.




**Grafiku 11. Shpërndarja e subjekteve sipas besimit që kanë në kategori të ndryshme të punonjësve të shtetit, sipas gjinisë**

Në 94% të rasteve burimi kryesor i informacionit për të mësuar se cfarë bën qeveria ishte televizioni, pasuar nga gazetat në 17.7% të rasteve.

## 4.5 TË DHËNA LIDHUR ME NDIHMËN EKONOMIKE (NE)

Të gjithë subjektet në studim përfitonin ndihmë ekonomike (NE) në momentin e kryerjes së studimit. Kohëzgjatja minimale e përfitimit të NE ishte 1 muaj (3 raste) dhe ajo maksimale ishte 23 vjet (1 rast). Mesatarisht, subjektet në studim kishin 7.8 vjet që përfitonin ndihmën ekonomike, dhe femrat e përfitonin ndihmën ekonomike prej një kohe në mënyrë domethënëse më të gjatë krahasuar me meshkujt (8.8 vjet vs. 6.7 vjet, përkatësisht, P=0.006) [Tabel 10].

**Tabela 10. Shpërndarja e subjekteve sipas kohëzgatjes së përfitimit të ndihmës ekonomike**

| Variabli | Total | Gjinia | | Vlera e P-së |
|---|---|---|---|---|
| | | Meshkuj (n=110) | Femra (n=122) | |
| **Kohëzgjatja e NE** (vite) | 7.79 ± 5.58 * | 6.69 ± 5.03 † | 8.78 ± 5.87 | 0.006 ‡ |
| **Kohëzgjatja e NE** ʙ<br>≤5 vjet<br>6-10 vjet<br>>10 vjet | <br>100 (43.1) †<br>71 (30.6)<br>61 (26.3) | <br>58 (52.7)<br>30 (27.3)<br>22 (20.0) | <br>42 (34.4)<br>41 (33.6)<br>39 (32.0) | 0.015 ¶ |

* Vlera mesatare ± deviacionin standard. † Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa).
‡ Vlera e P-së sipas testit jo-parametrik Mann-Ëhitney U-test. ¶ Vlera e P-së sipas testit hi katror.

Tabela në vijim paraqet kohëzgjatjen e përfitimit të ndihmës ekonomike sipas variableve socio-demografikë dhe ekonomikë.

Mosha mesatare e personave rritej paralelisht me rritjen e kohëzgjatjes së përfitimit të ndihmës ekonomike (Tabela 11). Nga ana tjetër, u vu re një lidhje negative, domethënëse nga ana statistikore, midis nivelit të edukimit dhe kohëzgjatjes së përfitimit të ndihmës ekonomike. Kështu, proporcioni i personave me nivel të ulët arsimor (0-4 vjet edukim) midis personave me kohëzgjatje të përfitimit të NE ≤5 vjet, 6-10 vjet dhe > 10 vjet ishte 14%, 22.5% dhe 31.1%, përkatësisht, P=0.035) [Tabela 11]. Gjithashtu, u vu re një lidhje pozitive, statistikisht domethënëse, midis kohëzgjatjes së përfitimit të NE dhe numrit të personave vulnerabël në familje, lidhje negative me statusin e shëndetit dhe praninë e sëmundjeve kronike (Tabela 11).

**Tabela 11. Kohëzgjatja e përfitimit të ndihmës ekonomike sipas variableve të përzgjedhur**

| Variabli | Kohëzgjatja e përfitimit të ndihmës ekonomike | | | Vlera e P-së |
|---|---|---|---|---|
| | ≤5 vjet | 6-10 vjet | >10 vjet | |
| **Gjinia**<br>Mashkull<br>Femër | 58 (58.0) *<br>42 (42.0) | 30 (42.3)<br>41 (57.7) | 22 (36.1)<br>39 (63.9) | 0.015 ‡ |
| **Mosha** (vite) | 44.32 ± 11.79 † | 46.48 ± 8.36 | 50.09 ± 10.89 | 0.004 ¶ |
| **Grup-mosha**<br>≤35 vjeç<br>36-45 vjeç<br>46-55 vjeç<br>>55vjeç | 21 (21.0)<br>29 (29.0)<br>35 (35.0)<br>15 (15.0) | 7 (9.9)<br>28 (39.4)<br>23 (32.4)<br>13 (18.3) | 8 (13.1)<br>11 (18.0)<br>23 (37.7)<br>19 (31.1) | 0.029 ‡ |
| **Edukimi** (vite) | 8.17 ± 3.32 | 6.99 ± 3.48 | 6.66 ± 3.32 | 0.011 ‡ |
| **Niveli i edukimit**<br>0-4 vjet<br>5-8 vjet<br>>8 vjet | 14 (14.0)<br>58 (58.0)<br>28 (28.0) | 16 (22.5)<br>41 (57.7)<br>14 (19.7) | 19 (31.1)<br>35 (57.4)<br>7 (11.5) | 0.035 ‡ |
| **Gjendja civile**<br>Beqar<br>Martuar<br>Divorcuar<br>I/e ve | 14 (14.0)<br>68 (68.0)<br>16 (16.0)<br>2 (2.0) | 8 (11.3)<br>35 (49.3)<br>28 (39.4)<br>0 (0.0) | 5 (8.2)<br>28 (45.9)<br>24 (39.3)<br>4 (6.6) | 0.001 ‡ |
| **Persona vulnerabël** (numri) | 1.98 ± 0.94 | 2.39± 1.08 | 2.46 ±1.19 | 0.007 ‡ |
| **Numri i personave vulnerabël në familje**<br>0-1 persona<br>2-3 persona<br>>3 pesona | 28 (28.0)<br>67 (67.0)<br>5 (5.0) | 14 (19.7)<br>48 (67.6)<br>9 (12.7) | 10 (16.4)<br>39 (63.9)<br>12 (19.7) | 0.038 ‡ |
| **Statusi i shëndetit**<br>Shumë i mirë ose i mirë<br>Mesatar<br>I keq ose shumë i keq | 30 (30.0)<br>36 (36.0)<br>34 (34.0) | 18 (25.4)<br>31 (43.7)<br>22 (31.0) | 10 (16.4)<br>18 (29.5)<br>33 (54.1) | 0.039‡ |
| **Sëmundje kronike**<br>Jo<br>Po | 73 (73.0)<br>27 (27.0) | 44 (62.0)<br>27 (38.0) | 32 (52.5)<br>29 (47.5) | 0.028 ‡ |

* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa).† Vlera mesatare ± deviacionin standard.

‡ Vlera e domethënies statistikore sipas testit hi katror.

¶ Vlera e domethënies statistikore sipas testit t të studentit.




**Grafiku 12. Kohëzgjatja e përfitimit të ndihmës ekonomike sipas edukimit**




**Grafiku 13. Kohëzgjatja e përfitimit të ndihmës ekonomike sipas numrit të personave vulnerabël në familje**

Tabela në vijim paraqet arsyet për marrjen e ndihmës ekonomike dhe opinionin e pjesëmarrësve lidhur me aspekte të ndryshme të ndihmës ekonomike.

Arsyeja kryesore për të aplikuar për përfitimin e ndihmës ekonomike ishte papunësia me 66.8% të subjekteve që e deklaruan këtë, ndjekur nga gjendja e vështirë ekonomike (15.1%), invaliditeti (7.8%) dhe divorci (3.9%) [Tabela 12]. Më shumë femra sesa meshkuj raportuan divorcin si arsye për përfitimin e ndihmës ekonomike (6.6% vs. 0.9%, prëkatësisht) dhe kjo diferencë kishte domethënie statistikore në kufi (P=0.052). Nga ana tjetër, dy të tretat e subjekteve në studim (64.7%) kishin kërkuar të punësohen ndërkohë që merrnin ndihmën ekonomike (57.4% e femrav dhe 72.7% e meshkujve, P=0.015) [Tabela 12]. Në vijim të këtyre gjetjeve, më shumë femra (30.3%) sesa meshkuj (15.5%) janë dakord që të mos punojnë sepse ndjehen mire me ndihmën ekonomike që marrin (P=0.022) dhe më pak femra sesa meshkuj mendojnë që është e gabuar të vazhdosh të marrësh NE nëse ke mundësi të punësohesh, edhe pse puna e ofruar mund të mos të të pëlqejë shumë (Tabela 12). Po në vazhdën e këtyre gjetjeve, më shumë femra

sesa meshkuj mendojnë që qeveria duhet të rrisë nivelin e ndihmës ekonomike (36.1% vs. 30.9%, përkatësisht) por diferenca është jo domethënëse nga ana statistikore. Ndërkohë, 7.8% e subjekteve deklaruan se i paguanin siguracionet shoqërore dhe shëndetësore, nga të cilët 72.2% raportuan se këto ishin pjesë e paketës së NE dhe 27.8% deklaruan se i paguanin vetë (Tabela 12). Kjo gjetje është interesante pasi tregon që personat që marrin NE nuk janë në dijeni se ata janë të mbuluar nga shteti për këto aspekte.

**Tabela 12. Arsyet për marrjen e ndihmës ekonomike dhe opinionet e subjekteve lidhur me aspekte të ndryshme të ndihmës ekonomike**

| Variabli | Total | Gjinia | | Vlera e P-së |
|---|---|---|---|---|
| | | Meshkuj (n=110) | Femra (n=122) | |
| **Arsyeja për marrjen e NE** | | | | |
| Divorci | 9 (3.9) * | 1 (0.9) | 8 (6.6) | 0.052 ‡ |
| Fëmijë jetim | 2 (0.9) | 1 (0.9) | 1 (0.8) | |
| Gjendja ekonomike | 35 (15.1) | 14 (12.7) | 21 (17.2) | |
| Gjendja shëndetësore | 8 (3.4) | 4 (3.6) | 4 (3.3) | |
| Invaliditeti | 18 (7.8) | 11 (10.0) | 7 (5.7) | |
| Largimi nga puna | 5 (2.2) | 5 (4.5) | 0 (0.0) | |
| Papunësia | 155 (66.8) | 74 (67.3) | 81 (66.4) | |
| **A keni kërkuar të punësoheni ndërkohë** | | | | 0.015 ‡ |
| Jo | 82 (35.3) | 30 (27.3) | 52 (42.6) | |
| Po | 150 (64.7) | 80 (72.7) | 70 (57.4) | |
| **Sa dakord jeni me pohimin: Aktualisht do të preferoja që të MOS punoja në mënyrë që të kujdesem për familjen time apo sepse ndjehem mirë me ndihmën ekonomike që marr** | | | | |
| Shumë ose dakord | 54 (23.3) | 17 (15.5) | 37 (30.3) | 0.022 ‡ |
| Mesatarisht | 32 (13.8) | 15 (13.6) | 17 (13.9) | |
| Aspak ose jo dakord | 146 (62.9) | 78 (70.9) | 68 (55.7) | |
| **Sa dakord jeni me pohimin: Është e gabuar të vazhdosh të marrësh ndihmën ekonomike nëse ke mundësi të punësohesh, edhe pse puna e ofruar mund të mos të të pëlqejë shumë** | | | | |
| Shumë ose dakord | 148 (63.8) | 72 (65.5) | 76 (62.3) | 0.463 ‡ |
| Mesatarisht | 32 (13.8) | 17 (15.5) | 15 (12.3) | |
| Aspak ose jo dakord | 52 (22.4) | 21 (19.1) | 31 (25.4) | |
| **Sipas mendimit tuaj, qeveria duhet të:** | | | | 0.406 ‡ |
| Rritë nivelin e NE | 78 (33.6) | 34 (30.9) | 44 (36.1) | |
| Rritë shanset për punësim | 154 (66.4) | 76 (69.1) | 78 (63.9) | |
| **A paguani sig. shoqërore dhe shëndetësore** | | | | 0.471 ‡ |
| Jo | 214 (92.2) | 100 (90.9) | 114 (93.4) | |
| Po | 18 (7.8) | 10 (9.1) | 8 (6.6) | |
| **Nëse Po, si i paguani** † | | | | 0.814 ‡ |
| Vetë | 5 (27.8) | 3 (30.0) | 2 (25.0) | |
| Pjesë e paketës së NE | 13 (72.2) | 7 (70.0) | 6 (75.0) | |

* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa).

† Vetëm midis atyre që deklaruan se i paguajnë vetë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

‡ Vlera e P-së sipas testit testit hi katror.




**Grafiku 14. Shpërndarja e subjekteve sipas arsyeve për përfitimin e ndihmës ekonomike**

Tabela në vijim paraqet informacionin lidhur me opinionet e pjesëmarrësve, nëse ndihma ekonomike është e mjaftueshme për të plotësuar nevojat e tyre bazë dhe burimet alternative të të ardhurave në rast se ndihma ekonomike është e pamjaftueshme.

Të gjithë subjektet në studim mendojnë që NE nuk mjafon për të mbuluar nevojat e tyre të përditshme, dhe 89.2% e tyre mendojnë që NE mjafton vetëm për një javë kurse pjesa tjetër prej 10.8% mendon se ajo mjafton për maksimumi dy javë (Tabela 13). Masa e ndihmës ekonomike mujore varionte nga 3989 lekë në 20000 lekë, pa diferenca domethënëse midis meshkujve dhe femrave (Tabela 13). Edhe kjo gjetje është interesante pasi në legjislacion përcaktohet qartë se masa financiare maksimale e NE mujore është 7000 lekë, pavarësisht nga përbërja e familjes. Burimi kryesor për sigurimin e të ardhurave kur përfundojnë paratë e ndihmës ekonomike është marrja e parave hua e raportuar nga 60.3% e pjesëmarrësve, në mënyrë domethënëse më shumë meshkuj sesa femra (62.7% vs. 58.2%, përkatësisht, P=0.034). Ndërkohë, vetëm 12.1% e subjekteve në studim (17.3% e meshkujve dhe 7.4% e femrave) i siguronin të ardhurat që u duheshin duke punuar (kryesisht në të zezë) megjithëse pjesa dërrmuese e tyre dekluaruan se kanë kërkuar punë ndërkohë që janë në ndihmë ekonomike. Burimi tjetër madhor i sigurimit të të ardhurave shtesë ishte familja në 11.6% të rasteve (5.5% e meshkujve dhe 17.2% e femrave). Ndërkohë, vetëm 0.4% e pjesëmarrësve (1 mashkull) deklaroi që ishte angazhuar me punë sociale në komunitet për gjenerimin e të ardhurave shtesë (Tabela 13).

**Tabela 13. Opinionet e pjesëmarrësve lidhur me efektivitetin e NE për të mbuluar nevojat e përditshme**

| Variabli | Total | Gjinia | | Vlera e P-së |
|---|---|---|---|---|
| | | Meshkuj (n=110) | Femra (n=122) | |
| **A mjafton NE mujore për të mbuluar nevojat e përditshme** | | | | - |
| Jo | 232 (100.0) * | 110 (100.0) | 122 (100.0) | |
| Po | 0 (0.0) | 0 (0.0) | 0 (0.0) | |
| **NE mjafton për të mbuluar nevojat për** | | | | 0.040 † |
| 1 javë | 207 (89.2) | 103 (93.6) | 104 (85.2) | |
| 2 javë | 25 (10.8) | 7 (6.4) | 18 (14.8) | |
| **Sa është NE për familjen tuaj në muaj (lekë)** | | | | 0.408 ‡ |
| Vlera mesatare | 3989.61 | 3844.55 | 4121.49 | |
| Deviacioni standard | 2476.67 | 2223.38 | 2688.78 | |
| Vlera minimale | 1100 | 1100 | 1200 | |
| Vlera maksimale | 20000 | 20000 | 20000 | |
| **Nëse NE nuk mjafton, ku i gjeni paratë për të kaluar muajin?** | | | | 0.034 † |
| Duke huazuar para | | | | |
| Duke lypur | 140 (60.3) | 69 (62.7) | 71 (58.2) | |
| Duke punuar në të zezë | 6 (2.6) | 3 (2.7) | 3 (2.5) | |
| Ndihmë nga familja | 28 (12.1) | 19 (17.3) | 9 (7.4) | |
| Ndihmë nga të afërmit | 27 (11.6) | 6 (5.5) | 21 (17.2) | |
| Ndihmë nga të njohurit | 27 (1.6) | 11 (10.0) | 16 (13.1) | |
| Punë sociale në komunitet | 3 (1.3) | 1 (0.9) | 2 (1.6) | |
| | 1 (0.4) | 1 (0.9) | 0 (0.0) | |

* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa).

† Vlera e P-së sipas testit hi katror.

‡ Vlera e P-së sipas testit jo-parametrik Mann-Whitney U-test.




**Grafiku 15. Burimet alternative të të ardhurave kur ndihma ekonomike nuk mjafton**

Tabela në vijim paraqet informacionin lidhur me problemet konkrete të hasura nga pjesëmarrësit për shkak të pamjaftueshmërisë së mjeteve financiare, sipas gjinisë.

Në përgjithësi, proporcione të ngjashme të meshkujve dhe femrave kishin patur vështirësi për të paguar qiranë, energjinë elektrike dhe ujin, apo ishin detyruar të ndërronin vendbanim, nuk mund të paguanin kujdesin shëndetësor për familjarët e sëmurë apo nuk kishin siguruar dot ushqimin bazë gjatë vitit të fundit për shkak të mungesës së parave (Tabela 14). Të mësipërmet u deklaruan nga 70.7%, 28.4%, 65.1% dhe 89.2% e subjekteve në studim. Vlen për t'u përmendur shifra e fundit që tregon se 9 në 10 persona në skemën e ndihmës ekonomike kanë pasur raste që nuk kanë siguruar dot ushqimin bazë gjatë vitit të fundit për shkak të mungesës së parave, indikator i qartë i vështirësisë së këtyre familjeve dhe pamjaftueshmërisë së ndihmës ekonomike.

**Tabela 14. Opinionet e pjesëmarrësve lidhur me efektivitetin e NE për të mbuluar nevojat e përditshme, sipas gjinisë**

| Variabli | Total | Gjinia | | Vlera e P-së |
|---|---|---|---|---|
| | | Meshkuj (n=110) | Femra (n=122) | |
| **A keni vonuar pagesën e qirasë, energjisë elektrike apo ujit për shkak të mungesës së parave** | | | | |
| Jo | 69 (29.7) * | 34 (30.9) | 35 (28.7) | 0.712 † |
| Po | 163 (70.3) | 76 (69.1) | 87 (71.3) | |
| **A jeni detyruar të ndërroni vendbanim nga pamundësia për të paguar qiranë** | | | | |
| Jo | 166 (71.6) | 75 (68.2) | 91 (74.6) | 0.280 † |
| Po | 66 (28.4) | 35 (31.8) | 31 (25.4) | |
| **Keni pasur familjar të sëmurë, por nuk mund të paguanit për të** | | | | |
| Jo | 81 (34.9) | 35 (31.8) | 46 (37.7) | 0.348 † |
| Po | 151 (65.1) | 75 (68.2) | 76 (62.3) | |
| **Nuk keni siguruar dot ushqimin bazë për shkak të mungesës së parave** | | | | |
| Jo | 25 (10.8) | 11 (10.0) | 14 (11.5) | 0.717 † |
| Po | 207 (89.2) | 99 (90.0) | 108 (88.5) | |

* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa).

† Vlera e P-së sipas testit testit hi katror.




**Grafiku 16. Proporcioni i meshkujve dhe femrave që nuk kanë plotësuar dot nevojat bazë për shkak të mungesës së parave**

Tabela në vijim paraqet informacionin lidhur me problemet konkrete të hasura nga pjesëmarrësit për shkak të pamjaftueshmë së mjeteve financiare, sipas nivelit të edukimit.

U vunë re lidhje statistikisht domethënëse midis nivelit të edukimit dhe pamundësisë për realizimin e pagesave të caktuara për shkak të mungesës së parave. Kështu, me uljen e nivelit të edukimit u vu re një rritje statistikisht domethënëse e proporcionit të atyre që kanë vonuar pagesën e qerasë, që nuk kanë paguar dot kujdesin shëndetësor apo që nuk kan siguruar dot ushqimin bazë (Tabela 15). Për shembull, 59% e personave me >8 vjet edukim kishin vonuar pagesën e qirasë për shkak të mungesës së parave kundrejt 89.8% të atyre me 0-4 vite edukim, P=0.002 (Tabela 15).

**Tabela 15. Opinionet e pjesëmarrësve lidhur me efektivitetin e NE për të mbuluar nevojat e përditshme, sipas nivelit të edukimit**

| Variabli | Numri i viteve të edukimit të përfunduara | | | Vlera e P-së † |
|---|---|---|---|---|
| | 0-4 vjet | 5-8 vjet | >8 vjet | |
| **A keni vonuar pagesën e qirasë, energjisë elektrike apo ujit për shkak të mungesës së parave** | | | | |
| Jo | 5 (10.2) * | 44 (32.8) | 20 (40.8) | 0.002 † |
| Po | 44 (89.8) | 90 (67.2) | 29 (59.2) | |
| **A jeni detyruar të ndërroni vendbanim nga pamundësia për të paguar qiranë** | | | | |
| Jo | 32 (65.3) | 97 (72.4) | 37 (75.5) | 0.506 † |
| Po | 17 (34.7) | 37 (27.6) | 12 (24.5) | |
| **Keni pasur familjar të sëmurë por nuk mund të paguanit për të** | | | | |
| Jo | 7 (14.3) | 52 (38.8) | 22 (44.9) | 0.002 † |
| Po | 42 (85.7) | 82 (61.2) | 27 (55.1) | |
| **Nuk keni siguruar dot ushqimin bazë për shkak të mungesës së parave** | | | | |
| Jo | 0 (0.0) | 14 (10.4) | 11 (22.4) | 0.002 † |
| Po | 49 (100.0) | 120 (89.6) | 38 (77.6) | |

* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa).

† Vlera e domethënies statistikore sipastestit hi katror.




**Grafiku 17. Mosplotësimi i nevojave bazë për shkak të mungesës së parave sipas viteve të edukimit**

Tabela në vijim paraqet informacionin lidhur me problemet konkrete të hasura nga pjesëmarrësit për shkak të pamjaftueshmërisë së mjeteve financiare, sipas kohëzgjatjes së përfitimit së ndihmës ekonomike.

Mund të vihet re që lidhjet me kohëzgjatjen e përfitimit të ndihmës ekonomike ishin jo domethënëse nga ana statistikore (Tabela 16).

**Tabela 16. Opinionet e pjesëmarrësve lidhur me efektivitetin e NE për të mbuluar nevojat e përditshme, sipas kohëzgjatjes së përfitimit të ndihmës ekonomike**

| Variabli | Kohëzgjatja e përfitimit të ndihmës ekonomike | | | Vlera e P-së † |
|---|---|---|---|---|
| | ≤5 vjet | 6-10 vjet | >10 vjet | |
| **A keni vonuar pagesën e qirasë, energjisë elektrike apo ujit për shkak të mungesës së parave** | | | | |
| Jo | 34 (34.0) * | 22 (31.0) | 13 (21.3) | 0.224 † |
| Po | 66 (66.0) | 49 (69.0) | 48 (78.7) | |
| **A jeni detyruar të ndërroni vendbanim nga pamundësia për të paguar qiranë** | | | | |
| Jo | 73 (73.0) | 52 (73.2) | 41 (67.2) | 0.682 † |
| Po | 27 (27.0) | 19 (26.8) | 20 (32.8) | |
| **Keni patur familjar të sëmurë por nuk mund të paguanit për të** [A] | | | | |
| Jo | 42 (42.0) | 25 (35.2) | 14 (23.0) | 0.048 † |
| Po | 58 (58.0) | 46 (64.8) | 47 (77.0) | |
| **Nuk keni siguruar dot ushqimin bazë për shkak të mungesës së parave** [A] | | | | |
| Jo | 15 (15.0) | 7 (9.9) | 3 (4.9) | 0.129 † |
| Po | 85 (85.0) | 64 (90.1) | 58 (95.1) | |

* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa).

† Vlera e domethënies statistikore sipas testit hi katror.




**Grafiku 18. Mosplotësimi i nevojave bazë për shkak të mungesës së parave sipas kohëzgjatjes së përfitimit të ndihmës ekonomike (NE)**

## 4.6 BARRIERAT PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE (NE)

Tabelat në vijim paraqesin shpërndarjen e subjekteve në studim sipas barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Lidhur me barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike, 37% e subjekteve mendonin që procedurat nuk janë të thjeshta, 25% dhe 30% mendojnë që ato nuk janë transparente apo që sasia e dokumenteve është e papërshtatshme, 32% mendojnë që ka abuzime në këto procedura, 55% mendojnë që ka persona që e përfitojnë padrejtësisht ndihmën ekonomike, 5% dhe 11% mendojnë që duhet të paguash nën-dorë apo të kesh "mik" për të përfituar ndihmën ekonomike, 43% mendojnë që nuk respektohen afatet kohore të NE, 12% mendojnë që prirjet politike ndikojnë në përfitimin e NE, 20% dhe 33% mendojnë që punonjësit e shërbimit social nuk shpjegojnë procedurat e NE ose nuk janë të gatshëm të japin informacion rreth kushteve për përfitimin e NE, dhe 51% mendojnë që informacioni për NE në media është i paplotë ose jo i qartë dhe (Tabela 17). Shifra e fundit është më shume interes në kontekstin e gjetjes që burimi kryesor i informacionit për subjektet në studim është televizioni. Në përgjithësi, nuk u vunë re diferenca statistikisht domethënëse midis proporcioneve të meshkujve dhe femrave lidhur me barrierat e listuara më sipër me përjashtim të procedurave jo transparente (30.3% e femrave dhe 18.2% e meshkujve, P=0.032) dhe nevojës së "mikut" për përfitimin e ndihmës ekonomike (14.8% e femrave dhe 6.4% e meshkujve, P=0.040).

**Tabela 17. Barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike, sipas gjinisë**

| Barrierat për përfitimin e NE (1-6) | Total | Gjinia | | Vlera e P-së |
|---|---|---|---|---|
| | | Meshkuj (n=110) | Femra (n=122) | |
| **Procedura të thjeshta** | | | | |
| Jo | 86 (37.1) * | 35 (31.8) | 51 (41.8) | 0.116 † |
| Po | 146 (62.9) | 75 (68.2) | 71 (58.2) | |
| **Procedura transparente** | | | | |
| Jo | 57 (24.6) | 20 (18.2) | 37 (30.3) | 0.032 † |
| Po | 175 (75.4) | 90 (81.8) | 85 (69.7) | |
| **Sasi e përshtatshme dokumentesh** | | | | 0.435 † |
| Jo | 69 (29.7) | 30 (27.3) | 39 (32.0) | |
| Po | 163 (70.3) | 80 (72.7) | 83 (68.2) | |
| **Pagesë nën dorë për NE** | | | | |
| Jo | 221 (95.3) | 104 (94.5) | 117 (95.9) | 0.627 † |
| Po | 11 (4.7) | 6 (5.5) | 5 (4.1) | |
| **"Mik" për marrjen e NE** | | | | |
| Jo | 207 (89.2) | 103 (93.6) | 104 (85.2) | 0.040 † |
| Po | 25 (10.8) | 7 (6.4) | 18 (14.8) | |
| **Respektimi i afateve kohore për marrjen e NE** | | | | 0.189 † |
| Jo | 99 (42.7) | 42 (38.2) | 57 (46.7) | |
| Po | 133 (57.3) | 68 (61.8) | 65 (53.3) | |

* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa). † Vlera e P-së sipas testit hi katror.




**Grafiku 19. Proporcioni i meshkujve dhe femrave që mendojnë se aspektet e mësipërme janë barriera për përfitimin e ndihmës ekonomike (NE)**

**Tabela 17. Barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike, sipas gjinisë (vazhdim)**

| Barrierat për përfitimin e NE (7-12) | Total | Gjinia | | Vlera e P-së |
|---|---|---|---|---|
| | | Meshkuj (n=110) | Femra (n=122) | |
| **Abuzime në procedurat për marrjen e NE** | | | | 0.192 † |
| Jo | 159 (68.5) * | 80 (72.7) | 79 (64.8) | |
| Po | 73 (31.5) | 30 (27.3) | 43 (35.2) | |
| **Përfitimi i padrejtë i NE** | | | | 0.265 † |
| Jo | 105 (45.6) | 54 (49.1) | 51 (41.8) | |
| Po | 127 (54.7) | 56 (50.9) | 71 (58.2) | |
| **Punonjësit e shërb.social ndihmojnë për shpjegimin e procedurave** | | | | 0.455 † |
| Jo | 47 (20.3) | 20 (18.2) | 27 (22.1) | |
| Po | 185 (79.7) | 90 (81.8) | 95 (77.9) | |
| **Punonjësit e shërb.social/bashkisë janë të gatshëm të japin informacion për kushtet e marrjes së NE** | | | | 0.887 † |
| Jo | 77 (33.2) | 36 (32.7) | 41 (33.6) | |
| Po | 155 (66.8) | 74 (67.3) | 81 (66.4) | |
| **Informacioni i qartë në media për NE** | | | | 0.678 † |
| Jo | 113 (48.7) | 52 (47.3) | 61 (50.0) | |
| Po | 119 (51.3) | 58 (52.7) | 61 (50.0) | |
| **A ndikon prirja politike për marrjen e NE** | | | | 0.911 † |
| Jo | 204 (87.9) | 97 (88.2) | 107 (87.7) | |
| Po | 28 (12.1) | 13 (11.8) | 15 (12.3) | |

* Numri absolut dhe përqindja sipas kolonave (në kllapa).

† Vlera e P-së sipas testit hi katror.




**Grafiku 20. Proporcioni i meshkujve dhe femrave që mendojnë se aspektet e mësipërme janë barriera për përfitimin e ndihmës ekonomike (NE)**

## 4.7 NUMRI I BARRIERAVE PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE

Tabela në vijim paraqet të dhëna lidhur me numrin e barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike, sipas perceptimit të pjesëmarrësve.

Lidhur me numrin mesatar të barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike, ai ishte 3.5 ± 3.15 barriera (Tabela 19). Në 16.4% të rasteve subjektet nuk raportuan asnjë nga barrierat e listuara, në 16.8% të rasteve ata raportuan një barrierë, në 15.5% të rasteve dy barriera, në 11.6% të rasteve tre barriera dhe në 9.9% të rasteve raportuan 4 barriera. Megjithatë, mbi gjysma e subjekteve në studim (51.3%) raportuan të paktën tre barriera kurse 30.3% e tyre raportuan 5-12 barriera për përfitimin e ndihmës ekonomike, duke përbërë një shifër alarmante (Tabela 18).

**Tabela 18. Numri i barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike**

| Variabli | Frekuenca | Përqindja |
|---|---|---|
| **Numri i barrierave** | 3.50 ± 3.15 * | |
| **Numri i barrierave** | | |
| 0 (asnjë barrierë) | 38 | 16.4 |
| 1 barrierë | 39 | 16.8 |
| 2 barriera | 36 | 15.5 |
| 3 barriera | 27 | 11.6 |
| 4 barriera | 23 | 9.9 |
| 5 barriera | 19 | 8.2 |
| 6 barriera | 7 | 3.0 |
| 7 barriera | 5 | 2.2 |
| 8 barriera | 4 | 1.7 |
| 9 barriera | 23 | 9.9 |
| 10 barriera | 6 | 2.6 |
| 11 barriera | 3 | 1.3 |
| 12 barriera | 2 | 0.9 |
| **Numri i barrierave** | | |
| Asnjë barrierë | 38 | 16.4 |
| 1-2 barriera | 75 | 32.3 |
| >2 barriera | 119 | 51.3 |

* Vlera mesatare ± deviacionin standard.




**Grafiku 21. Shpërndarja e subjekteve në studim sipas numrit të barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike të identifikuar prej tyre**

Tabela në vijim paraqet koeficientët e korrelacionit, sipas Spearman, të numrit të barrierave të identifikuara për marrjen e ndihmës ekonomike me variablet numerike të përzgjedhur.

Lidhja midis numrit të barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike me edukimin ishte e moderuar (koeficienit i korrelacionit Speraman's rho = -0.319) [Tabela 19]. Gjitashtu, lidhje e moderuar u vu re dhe me nivelin e lumturisë në përgjithësi, ku me uljen e lumturisë rritej numri i barrierave (koeficienit i korrelacionit Speraman's rho = 0.262) kurse lidhjet me moshën, numrin e personave vulnerabël në familje dhe kohëzgjatjen e përfitimit të ndihmës ekonomike ishin të dobëta dhe jo domethënëse (Tabela 19).

**Tabela 19. Koeficientët e korrelacionit midis numrit të barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe variableve numerikë të përzgjedhur**

| Variabli | Numri i barrierave për përfitimin e NE | Vlera e P-së |
|---|---|---|
| **Mosha** (vite) | 0.067 † | 0.307 ‡ |
| **Edukimi** (vite) | -0.319 | <0.001 |
| **Statusi i shëndetit** * | 0.153 | 0.232 |
| **Numri personave vulnerabël në familje** | 0.114 | 0.083 |
| **Kohëzgjatja e përfitimit të NE** | 0.142 | 0.031 |
| **Lumturia** | 0.262 | <0.001 |

* I matur nga 1 (shumë i mirë) në 5 (shumë i keq).

† Koeficienti i korrelacioni Spearman's rho.

‡ Vlera e P-së për lidhjen statistikore përkatëse.

Kurse Tabela në vijim paraqet koeficientin e qëndrueshmërisë së brendshme (Cronbach's alpha) për 12 pyetjet e përdorura për vlerësimin e barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Pyetësori që eksploronte barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike tregoi qëndrueshmëri të brendshme të lartë (Cronbach's alpfa = 0.847) dhe koeficienti i korrelacionit split-half = 0.666, duke dëshmuar për bësueshmëri të lartë të instrumentit (Tabela 20).

**Tabela 20. Të dhënat lidhur me besueshmërinë e pyetjeve që eksplorojnë barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike**

| Variabli | Koeficienti i Cronbach's alpha | Koeficienti i korrelacionit split-half |
|---|---|---|
| **Numri i pyetjeve**<br>12 | 0.847 | 0.666 |

Tabela në vijim paraqet shpërndarjen e barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike sipas variableve të përzgjedhur.

Tabelat në vijim paraqet të dhëna të detajuara lidhur me numrin mesatar të barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike sipas variableve bazë socio-demografikë.

Femrat raportuan një numër më të lartë mesatar të barrierave krahasuar me meshkujt (3.81 vs. 3.15, përkatësisht) por diferenca është jo domethënëse (P=0.113) [Tabela 21]. U vu re një lidhje e qartë negative midis numrit mesatar të barrierave dhe nivelit të edukimit: midis personave me 0-4, 5-8 dhe >8 vite edukim numri mesatar i barrierave ishte 6.44, 2.78 dhe 2.51, përkatësisht (P<0.001) [Tabela 21]. Lidhje statistikisht domethënëse u vu rë dhe me statusin e shëndetit gjithashtu ku me përkeqësimin e statusit të shëndetit rritej dhe numri mesatar i barrierave (Tabela 21). Megjithëse për moshën dhe numrin e personave vulnerabël në familje nuk u arrit domethënia statistikore, tendencat ishin që që me rritjen e moshës dhe numrit të personave të disavantazhuar në familje të rritej dhe numri mesatar i barrierave të raportuara (Tabela 21).

**Tabela 21. Numri mesatar i barrierave për përfitimin e NE sipas karakteristikave të subjekteve në studim**

| Variabli | Numri i barrierave për përfitimin e NE | | | | Vlera e P-së për vlerën mesatare |
|---|---|---|---|---|---|
| | Vlera mesatare | Deviacioni standard | Vlera minimale | Vlera maksimale | |
| **Total** | 3.50 | 3.15 | 0 | 12 | |
| **Gjinia** | | | | | |
| Mashkull | 3.15 | 2.88 | 0 | 12 | 0.113 * |
| Femër | 3.81 | 3.36 | 0 | 12 | |
| **Grup-mosha** | | | | | |
| ≤35 vjeç | 3.41 | 3.40 | 0 | 11 | |
| 36-45 vjeç | 3.47 | 3.05 | 0 | 12 | 0.077 |
| 46-55 vjeç | 2.98 | 2.82 | 0 | 10 | |
| >55vjeç | 4.49 | 3.49 | 0 | 12 | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Niveli i edukimit**<br>0-4 vite<br>5-8 vite<br>>8 v vite | <br>6.44<br>2.78<br>2.51 | <br>3.56<br>2.46<br>2.62 | <br>0<br>0<br>0 | <br>12<br>10<br>11 | <0.001 |
| **Numri i personave vulnerabël në familje**<br>0-1 persona<br>2-3 persona<br>>3 pesona | <br>3.23<br>3.45<br>4.31 | <br>3.15<br>3.18<br>2.94 | <br>0<br>0<br>0 | <br>11<br>12<br>11 | 0.348 |
| **Statusi i shëndetit**<br>Shumë i mirë ose i mirë<br>Mesatar<br>I keq ose shumë i keq | <br>2.84<br>3.48<br>4.13 | <br>2.94<br>3.13<br>3.26 | <br>0<br>0<br>0 | <br>10<br>12<br>12 | 0.026 |
| **Sëmundje kronike**<br>Jo<br>Po | <br>3.31<br>3.84 | <br>3.16<br>3.11 | <br>0<br>0 | <br>12<br>11 | 0.216 |

* Vlera e P-së sipas testit t studentit.

Tabela 22 paraqet të njëjtin informacion si Tabela 21, por në këtë rast numri i barrierave është kategorizuar në nivele të veçanta (0 barriera, 1-2 barriera dhe>2 barriera), pra jo si variabël numerik për të patur një vizualizim më të qartë të situatës. Në përgjithësi tendencat, rezultatet dhe domethënia statistikore e tyre është e ngjashme me rezultatet e Tabelës 21.

**Tabela 22. Numri i barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike sipas variableve të përzgjedhur**

| Variabli | Numri i barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike | | | Vlera e P-së |
|---|---|---|---|---|
| | Asnjë barrierë | 1-2 barriera | >2 barriera | |
| **Gjinia**<br>Mashkull<br>Femër | <br>17 (44.7) *<br>21 (55.3) | <br>41 (54.7)<br>34 (45.3) | <br>52 (43.7)<br>67 (56.3) | 0.309 † |
| **Grup-mosha**<br>≤35 vjeç<br>36-45 vjeç<br>46-55 vjeç<br>>55vjeç | <br>8 (21.1)<br>9 (23.7)<br>15 (39.5)<br>6 (15.8) | <br>10 (13.3)<br>22 (29.3)<br>31 (41.3)<br>12 (16.0) | <br>18 (15.1)<br>37 (31.1)<br>35 (29.4)<br>29 (24.4) | 0.456 † |
| **Niveli i edukimit**<br>0-4 vjet<br>5-8 vjet<br>>8 vjet | <br>2 (5.3)<br>25 (65.8)<br>11 (28.9) | <br>9 (12.0)<br>46 (61.3)<br>20 (26.7) | <br>38 (31.9)<br>63 (52.9)<br>18 (15.1) | 0.001 † |
| **Numri i personave vulnerabël në familje**<br>0-1 persona<br>2-3 persona<br>>3 pesona | <br>10 (26.3)<br>27 (71.1)<br>1 (2.6) | <br>19 (25.3)<br>49 (65.3)<br>7 (9.3) | <br>23 (19.3)<br>78 (65.5)<br>18 (15.1) | 0.235† |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Statusi i shëndetit**<br>Shumë i mirë ose i mirë<br>Mesatar<br>I keq ose shumë i keq | 8 (21.1)<br>16 (42.1)<br>14 (36.8) | 22 (29.3)<br>35 (46.7)<br>18 (24.0) | 28 (23.5)<br>34 (28.6)<br>57 (47.9) | 0.016 † |
| **Sëmundje kronike**<br>Jo<br>Po | 26 (68.4)<br>12 (31.6) | 53 (70.7)<br>22 (29.3) | 70 (58.8)<br>49 (41.2) | 0.206 † |

* Numri absolut dhe përqindja sipas rrjeshtave (në kllapa).
† Vlera e domethënies statistikore sipas testit hi katror.




**Grafiku 22. Numri i barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike (NE) sipas nivelit të edukimit**

## 4.8 RËNDËSIA E LLOJEVE TË NDRYSHME TË BARRIERAVE PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE - REZULTATET E ANALIZËS FAKTORIALE

Tabelat në vijim paraqesin rezultatet e analizës faktoriale për identifikimin e faktorëve që kanë ndikimin më të madh në barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike nga subjektet  në studim.

Për sa i përket barrierave kryesore që ndikonin më shumë në përfitimin e ndihmës ekonomike, të dhënat e analizës faktoriale (Tabelat 23-26) treguan se katër barrierat me më shumë peshë janë ato që kanë të bëjnë me:

1. thjeshtësinë e procedurave;
2. transparencën e procedurave;
3. sasinë e dokumenteve që duhen plotësuar;
4. ofrimin e informacionit të qartë në media dhe institucionet përgjegjëse rreth kushteve për marrjen e ndihmës ekonomike.

Sipas analizës faktoriale, këta komponentë janë përgjegjës për rreth 66% të variacionit që vihet re lidhur me barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike (Tabelat 23-26).

**Tabela 23. Shpjegimi i variancës totale me anë të komponentëve të përfshirë në studim – rezultatet e analizës faktoriale**

| Variabli | Eigenvalues fillestare | | | Shumat e ngarkesave në katror, të rrotulluara | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Total | % e variancës | % kumulative | Total | % e variancës | % kumulative |
| **Komponenti** | | | | | | |
| 1 | 4.615 | 38.455 | 38.455 | 2.674 | 22.286 | 22.286 |
| 2 | 1.244 | 10.367 | 48.822 | 2.578 | 21.480 | 43.766 |
| 3 | 1.078 | 8.982 | 57.804 | 1.379 | 11.488 | 55.254 |
| 4 | .946 | 7.880 | 65.684 | 1.252 | 10.430 | 65.684 |
| 5 | .872 | 7.264 | 72.948 | | | |
| 6 | .739 | 6.160 | 79.108 | | | |
| 7 | .651 | 5.426 | 84.534 | | | |
| 8 | .475 | 3.957 | 88.492 | | | |
| 9 | .389 | 3.240 | 91.731 | | | |
| 10 | .362 | 3.015 | 94.747 | | | |
| 11 | .341 | 2.840 | 97.587 | | | |
| 12 | .290 | 2.413 | 100.000 | | | |

**Tabela 24. Matriksi i komponenteve – rezultatet e analizës faktoriale**

| Pyetjet për barrierat për përfitimin e NE | Komponentet | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 |
| A janë të thjeshta procedurat për marrjen e NE? | 0.693 | -0.154 | -0.505 | 0.007 |
| A janë transparente procedurat për marrjen e NE? | 0.800 | -0.099 | -0.667 | 0.124 |
| A është i arsyeshëm numri i dokumenteve që duhet të përgatisni për marrjen e NE? | 0.719 | 0.719 | -0.419 | 0.136 |
| A duhet të paguash nën dorë për marrjen e NE? | 0.294 | -0.154 | -0.505 | 0.007 |
| A duhet të kesh "mik" për marrjen e NE? | 0.397 | -0.099 | -0.266 | 0.124 |
| A respektohen afatet e përcaktuara kohore për marrjen e NE? | 0.312 | -0.194 | -0.419 | 0.136 |
| A ka abuzime në procedurat për marrjen e NE? | 0.757 | 0.627 | 0.220 | 0.487 |
| A ka njerëz që e përfitojnë në mënyrë të padrejtë NE? | 0.639 | 0.590 | -0.143 | -0.070 |
| A ndihmojnë punonjësit e shërbimit social për të sqaruar procedurat për marrjen e NE? | 0.760 | -0.059 | 0.228 | -0.442 |
| A janë punonjësit e bashkisë apo të shërbimit social të gatshëm për t'ju dhënë informacione lidhur me kushtet që duhet të plotësohen për marrjen e NE? | 0.694 | 0.000 | 0.196 | -0.199 |
| A është i plotë dhe i qartë informacioni i dhënë në media apo institucione të ndryshme rreth kushteve që duhen plotësuar për marrjen e NE? | 0.548 | 0.193 | 0.265 | -0.546 |
| A ndikojnë prirjet politike për marrjen e NE? | 0.361 | -0.221 | 0.217 | 0.008 |

**Tabela 25. Matriksi i komponenteve i rrotulluar – rezultatet e analizës faktoriale**

| Pyetjet për barrierat për përfitimin e NE | Komponentet | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 |
| A janë të thjeshta procedurat për marrjen e NE? | 0.834 | 0.165 | 0.245 | -0.087 |
| A janë transparente procedurat për marrjen e NE? | 0.762 | 0.322 | 0.731 | 0.143 |
| A është i arsyeshëm numri i dokumenteve që duhet të përgatitni për marrjen e NE? | 0.072 | 0.718 | 0.195 | -0.227 |
| A duhet të paguash nën dorë për marrjen e NE | -0.010 | 0.039 | 0.300 | 0.418 |
| A duhet të kesh "mik" për marrjen e NE | 0.083 | 0.127 | 0.176 | 0.317 |
| A respektohen afatet e përcaktuara kohore për marrjen e NE? | 0.614 | 0.181 | 0.337 | 0.030 |
| A ka abuzime në procedurat për marrjen e NE? | 0.334 | 0.603 | 0.184 | 0.109 |
| A ka njerëz që e përfitojnë në mënyrë të padrejtë NE? | 0.133 | 0.665 | 0.300 | 0.162 |
| A ndihmojnë punonjësit e shërbimit social për të sqaruar procedurat për marrjen e NE? | 0.464 | 0.651 | -0.078 | 0.170 |
| A janë punonjësit e bashkisë apo të shërbimit social të gatshëm për t'ju dhënë informacione lidhur me kushtet që duhet të plotësohen për marrjen e NE? | 0.321 | 0.663 | -0.216 | 0.394 |
| A është i plotë dhe i qartë informacioni i dhënë në media apo institucione të ndryshme rreth kushteve që duhen plotësuar për marrjen e NE? | 0.484 | 0.254 | -0.184 | 0.820 |
| A ndikojnë prirjet politike për marrjen e NE? | 0.198 | 0.125 | 0.629 | -0.032 |

**Tabela 26. Matriksi i koeficientëve të rezultateve të komponentëve – rezultatet e analizës faktoriale**

| Pyetjet për barrierat për përfitimin e NE | Komponentët | | | | Identifikimi i komponentëve | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 |
| Procedura jo të thjeshta | 0.819 | -0.173 | 0.121 | -0.192 | | | | |
| Procedura jo transparente | 0.327 | -0.083 | 0.727 | 0.011 | | | | |
| Sasi jo e përshtatshme dokumentash | -0.201 | 0.458 | 0.124 | -0.350 | | | | |
| Pagesë nën-dorë për NE | -0.103 | -0.120 | 0.141 | 0.221 | | | | |
| "Mik" për marrjen e NE | -0.084 | -0.053 | 0.544 | 0.178 | | | | |
| Afate kohore të papërshtatshme | 0.428 | -0.178 | 0.013 | -0.073 | | | | |
| Abuzime në procedurat për marrjen e NE | -0.058 | 0.310 | 0.048 | -0.051 | | | | |
| Përfitimi i padrejtë i NE | -0.182 | 0.336 | 0.160 | 0.003 | | | | |
| Punonjësit nuk shpjegojnë procedurat | 0.059 | 0.246 | -0.184 | 0.039 | | | | |
| Punonjësit nuk japin info për kushtet e NE | -0.033 | 0.279 | -0.313 | 0.273 | | | | |
| Informacioni jo i qartë në media për NE | 0.198 | -0.046 | -0.273 | 0.742 | | | | |
| Ndikimi i prirjeve politike për marrjen e NE | 0.019 | -0.032 | 0.493 | -0.142 | | | | |

## 4.9 LIDHJA (SHOQËRIMI) I NUMRIT TË BARRIERAVE PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE ME FAKTORËT E PËRZGJEDHUR- REZULATET E MODELIT LINEAR TË PËRGJITHSHËM

Tabela në vijim paraqesin rezultatet e Modelit Linear të Përgjithshëm për përcaktimin e lidhjes (shoqërimit) të numrit të barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike me variablet e përzgjedhur.

Pas kontrollit të efektit konfondues të gjinisë, moshës, nivelit të edukimit, statusit të shëndetit, pranisë së sëmundjeve kronike, numrit të personave të disavantazhuar në familje dhe kohëzgjatjes së përfitimit të ndihmës ekonomike, rezultoi se niveli i edukimit ishte i lidhur në mënyrë statistikisht domethënëse me numrin e barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike kurse lidhjet me faktorët e tjerë ishin jo domethënëse nga ana statistikore (Tabela 27).

Kështu, pas kontrollit të efekteve konfonduese, personat me 0-4 vjet edukim raportuan mesatarisht 6.5 barriera për përfitimin e ndihmës ekonomike, personat me 5-8 vjet edukim raportuan mesatarisht 3 barriera dhe ata me mbi 8 vjet edukim raportuan mesatarisht 2.9 barriera për përfitimin e ndihmës ekonomike (P<0.001) [Tabela 27]. Megjithëse lidhja e numrit të barrierave me faktorët e tjerë rezultoi jo domethënëse nga ana statistikore, tendenca sugjerojnë që femrat, personat mbi 55 vjeç, personat me gjendje të keqe shëndetësore, ata me sëmundje kronike dhe personat me mbi 3 anëtarë të disavantazhuar në familje përjetojën mesatarisht më shumë barriera krahasuar me kolegët e tyre (Tabela 27).

**Tabela 27. Lidhja (shoqërimi) i numrit të barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike me variablet demografikë dhe socio-ekonomikë; vlerat mesatare të numrit të barrierave sipas Modelit Linear të Përgjithshëm**

| Variabli | Modeli 1 § | | Modeli 2 ‡ | |
|---|---|---|---|---|
| | Vlera mesatare (95% CI) * | Vlera e P-së | Vlera mesatare (95% CI) | Vlera e P-së |
| **Gjinia** | | | | |
| Mashkull | 3.2 (2.6-3.7) | 0.113 | 3.8 (3.1-4.5) | 0.055 |
| Femër | 3.8 (3.3-4.4) | | 4.5 (3.9-5.2) | |
| **Grup-mosha** | | 0.077 (3) † | | 0.370 (3) † |
| ≤35 vjeç | 3.4 (2.4-4.4) | 0.123 | 3.9 (2.8-4.9) | 0.213 |
| 36-45 vjeç | 3.5 (2.7-4.2) | 0.087 | 4.2 (3.4-4.9) | 0.310 |
| 46-55 vjeç | 3.0 (2.3-3.7) | 0.009 | 3.8 (3.1-4.5) | 0.084 |
| >55 vjeç | 4.5 (3.6-5.4) | referencë | 4.8 (3.8-5.7) | referencë |
| **Niveli i edukimit** | | <0.001 (2) | | <0.001 (2) |
| 0-4 vjet | 6.4 (5.7-7.2) | <0.001 | 6.5 (5.7-7.4) | <0.001 |
| 5-8 vjet | 2.8 (2.3-3.3) | 0.554 | 3.0 (2.4-3.5) | 0.963 |
| >8 vjet | 2.5 (1.7-3.3) | referencë | 2.9 (2.0-3.8) | referencë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Statusi i shëndetit** | | 0.026 (2) | | 0.326 (2) |
| Shumë i mirë ose i mirë | 2.8 (2.2-3.5) | 0.007 | 3.7 (3.4-5.2) | 0.177 |
| Mesatar | 3.5 (2.7-4.3) | 0.216 | 4.3 (3.0-4.5) | 0.929 |
| I keq ose shumë i keq | 4.1 (3.5-4.8) | referencë | 4.4 (3.7-5.0) | referencë |
| **Sëmundje kronike** | | | | |
| Jo | 3.3 (2.8-3.8) | 0.216 | 4.0 (3.4-4.6) | 0.430 |
| Po | 3.8 (3.2-4.5) | | 4.3 (3.5-5.1) | |
| **Familje vulnerabël** ¶[4] | | 0.348 (2) | | 0.321 (2) |
| 0-1 persona vulnerabël | 3.2 (2.4-4.1) | 0.156 | 3.7 (2.9-4.6) | 0.139 |
| 2-3 persona vulnerabël | 3.5 (2.9-4.0) | 0.203 | 4.0 (3.4-4.5) | 0.192 |
| >3persona vulnerabël | 4.3 (3.1-5.5) | referencë | 4.7 (3.6-5.9) | referencë |
| **Kohëzgjatja e përfitimit** | | 0.020 (2) | | 0.097 (2) |
| **të NE** | 2.9 (2.3-3.7) | 0.008 | 3.6 (2.8-4.3) | 0.080 |
| ≤5 vjet | 3.3 (2.7-3.9) | 0.024 | 4.4 (3.7-5.2) | 0.991 |
| 6-10 vjet | 4.4 (3.7-5.2) | referencë | 4.4 (3.6-5.2) | referencë |
| >10 vjet | | | | |

* Numri mesatar i barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe intervali i besimit 95% (në kllapa).

† Vlera e P-së dhe shkallet e lirisë (ne kllapa).

§ Modeli 1: i pa-axhustuar (kontrolluar) për asnjë faktor. Vlerat mesatare bruto.

‡ Modeli 2: i axhustuar (kontrolluar) njekohesisht për për të gjithë faktorët e paraqitur në tabelë

Tabela në vijim paraqesin rezultatet e Modelit Linear të Përgjithshëm për përcaktimin e lidhjes (shoqërimit) të numrit të barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike me besimin tek nëpunësit e ndryshëm të shtetit Shqiptar.

Ndërkohë, lidhjet midis numrit të barrierave dhe nivelit të besimit tek punonjësit e kategorive të ndryshme të shtetit ishin domethënëse nga ana statistikore edhe pas kontrollit të efekteve konfonduese të gjinisë, moshës, nivelit të edukimit dhe gjendjes shëndetësore (Tabela 28). Kështu, personat që kishin pak ose aspak besim tek përfaqësuesit e bashkisë raportuan mesatarisht 4.6 barriera krahasuar me 3 barriera të raportuar nga personat që besojnë shumë tek këta punonjës ($P<0.001$) [Tabela 28]. Në përgjithësi, personat që besonin pak ose aspak tek punonjësit e shërbimeve sociale, përfaqësuesit e qeverisë qendrore, policia, mësuesit apo tek mjekët raportuan mesatarisht 5.6, 4.4, 4.9, 5.2 dhe 5.2 barriera krahasuar me personat që besojnë shumë në këto kategori punonjësisht dhe që raportuan mesatarisht 3.4, 3.2, 3.3, 2.7 dhe 3.6 barriera, përkatësisht (Tabela 28). Të gjitha këto diferenca ishin domethënëse nga ana statistikore.

**Tabela 28. Lidhja (shoqërimi) i numrit të barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomikeme besimin në punonjësit e shtetit; vlerat mesatare të numrit të barrierave sipas Modelit Linear të Përgjithshëm**

| Variabli | Modeli 1 § | | Modeli 2 ‡ | |
|---|---|---|---|---|
| | Vlera mesatare (95% CI) * | Vlera e P-së | Vlera mesatare (95% CI) | Vlera e P-së |
| **Besim tek zyrtarët e bashkisë** | | <0.001 (2) † | | <0.001 (2) |
| Aspak ose pak | 4.3 (3.8-4.8) | <0.001 | 4.6 (4.2-5.2) | <0.001 |
| Mesatarisht | 2.8 (1.9-3.7) | 0.372 | 3.2 (2.4-4.0) | 0.686 |
| I besoj ose i besoj shumë | 2.3 (1.5-3.1) | referencë | 3.0 (2.3-3.7) | referencë |
| **Besim tek punonj.shërb.sociale** | | <0.001 (2) | | <0.001 (2) |
| Aspak ose pak | 5.2 (4.3-6.0) | <0.001 | 5.6 (4.8-6.3) | <0.001 |
| Mesatarisht | 4.9 (3.5-6.2) | 0.005 | 5.0 (3.8-6.2) | 0.010 |
| I besoj ose i besoj shumë | 2.8 (2.4-3.3) | referencë | 3.4 (2.9-3.8) | referencë |
| **Besim tek qeveria qendrore** | | 0.001 (2) | | 0.020 (2) |
| Aspak ose pak | 3.9 (3.4-4.4) | 0.007 | 4.4 (3.9-4.9) | 0.017 |
| Mesatarisht | 3.0 (2.0-4.0) | 0.453 | 3.4 (2.5-4.3) | 0.799 |
| I besoj ose i besoj shumë | 2.5 (1.6-3.4) | referencë | 3.2 (2.4-4.1) | referencë |
| **Besim tek policia** | | 0.001 (2) | | 0.001 (2) |
| Aspak ose pak | 4.4 (3.8-5.1) | <0.001 | 4.9 (4.3-5.5) | <0.001 |
| Mesatarisht | 3.8 (2.4-5.2) | 0.189 | 4.1 (2.9-5.3) | 0.258 |
| I besoj ose i besoj shumë | 2.8 (2.3-3.4) | referencë | 3.3 (2.8-3.8) | referencë |
| **Besim tek mësuesit** | | 0.001 (2) | | 0.001 (2) |
| Aspak ose pak | 4.6 (3.8-5.5) | 0.017 | 5.2 (4.4-6.0) | 0.004 |
| Mesatarisht | 3.4 (2.9-3.9) | 0.026 | 3.9 (3.4-4.4) | 0.013 |
| I besoj ose i besoj shumë | 2.2 (1.2-3.2) | referencë | 2.7 (1.8-3.6) | referencë |
| **Besim tek mjekët** | | <0.001 (2) | | 0.004 (2) |
| Aspak ose pak | 5.1 (4.2-6.0) | <0.001 | 5.2 (4.3-6.0) | 0.001 |
| Mesatarisht | 3.3 (2.3-4.2) | 0.717 | 3.9 (3.0-4.7) | 0.540 |
| I besoj ose i besoj shumë | 3.1 (2.6-3.6) | referencë | 3.6 (3.1-4.1) | referencë |

* Numri mesatar i barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe intervali i besimit 95% (në kllapa).

† Vlera e P-së dhe shkallet e lirisë (ne kllapa).

§ Modeli 1: i pa-axhustuar (kontrolluar) për asnjë faktor. Vlerat mesatare bruto.

‡ Modeli 2: i axhustuar (kontrolluar) njekohesisht për moshën, gjininë, edukimin dhe gjendjen shëndetësore.

KAPITULLI
5

# DISKUTIMI

Rishikimi i literaturës ndërkombëtare dhe kombëtare dhe gjetjet e studimit tonë ofruan një panoramë të qartë të ndryshimeve të strukturës së familjes në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar, si dhe politikave të mbështetjes dhe mbrojtjes sociale që ofrohen në këto vende, sipas përqasjes historike dhe në drejtim të evoluimit të tyre për t'iu përshtatur ndryshimeve të strukturës familjare. Ky kuadër logjik na lejon që të analizojmë më hollësi efektivitetin e ndihmës ekonomike në vendin tonë bazuar në gjetjet e studimit aktual dhe krahasimit të tyre me raportet e mëparshme vlerësuese të ndihmës ekonomike dhe politikave sociale në Shqipëri. Për më tepër, të dhënat e disponueshme na lejuan të realizojme vlerësimin e politikave të mbrojtjes sociale në Shqipëri dhe krahasimin me vendet e rajonit, duke u ndalur kryesisht në vendet ish komuniste të Europës Jug-Lindore, për shkak të ngjashmërive me vendin tonë, siç është përshkruar gjerësisht në hyrjen e këtij punimi shkencor. Së fundmi, gjendja aktuale e politikave shëndetësore në Shqipëri është diskutuar në kuadrin e tendencave të politikave sociale në Europë, bashkësi në të cilën vendi ynë shpreson të anëtarësohet në të ardhmen. Ky diskutim paraqitet në detaje në seksionet në vijim.

## 5.1 VLERËSIMI I EFEKTIVITETIT TË NDIHMËS EKONOMIKE NË VENDIN TONË

Për sa i përket politikave të mbrojtjes sociale, duket se Shqipëria zotëron një kuadër të kënaqshëm ligjor, në përputhje me standardet europiane. Në këtë mënyrë, në vendin tonë ekziston një kornizë e përgjithshme, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) (181) e cila përcakton qartë që politikat e mbrojtjes sociale janë çështje thellësisht ndërsektoriale, të cilat kërkojnë koordinim dhe bashkërendim të aktiviteteve dhe masave në mënyrë që të arrijnë objektivat e caktuara. Në dokumentin e SKZHI-së mund të identifikohet një numër institucionesh të cilat në mënyrë direkte apo indirekte ndikojnë në mbrojtjen sociale të grupeve të disavantazhuara të shoqërisë. Kështu, institucionet e lidhur drejtëpërdrejtë me politikat e mirëqenies sociale dhe zbatimin e tyre janë Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (ish Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta), Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Brendshme (lidhur

me decentralizimin e pushtetit vendor dhe rolin e madh që ky pushtet ka në zbatimin e politikave të mbrojtjes sociale) (181). Ndërkohë, edhe ministritë e tjera luajnë rolin e tyre në zbatimin e politikave të mbrojtjes sociale pasi aktivitetet janë të ndëvarura. Në terma globale, Ministria e Financave, e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, apo Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës apo dhe ministritë e tjera janë gjithashtu të rëndësishme pasi sigurojnë terrenin e përshtatshëm për zbatimin e politikave të mbrojtjes sociale. Për shembull, Ministria e Financave siguron stabilitetin makro ekonomik, Ministria e Zhvillimit Ekonomik krijon stabilitetin mikro ekonomik dhe kushtet e përshtatshme për zhvillimin e jetës ekonomike. Një kontekst i stabilizuar ekonomik është një parakusht për zbatimin e politikave të mbrojtjes sociale në një vend të caktuar. Edhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës luan rolin e saj në politikat e mbrojtjes sociale sepse në mënyrë direkte apo indirekte ajo ndikon në formëzimin e infrastrukturës e cila merr parasysh edhe kërkesat e komuniteteve të disavantazhuara të cilat mbështeten nga politikat sociale, siç mund të jenë përsonat me aftësi të kufizuara.

Përgjatë kohës, legjislacioni lidhur me politikat e përfshirjes dhe mbrojtjes sociale është plotësuar duke synuar përputhshmërinë me frymën Europiane. Megjithatë, pavarësisht legjislacionit relativisht të plotë në fuqi, a është efektiv ai për mbrojtjen sociale të grupeve në nevojë dhe për reduktimin e varfërisë në Shqipëri?

Në Strategjinë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale 2007-2013 jepet informacion lidhur me efektivitetin e ndihmës ekonomike për reduktimin e varfërisë dhe problemeve që ka hasur kjo skemë deri tani. Sipas këtij dokumenti, skema e ndihmës ekonomike has vështirësi për identifikimin e familjeve të varfëra për shkak të pasaktësisë së regjistrimit në gjendjen civile të popullatës migruese, duke cuar në raste kur ndihma ekonomike mund të përfitohet dy herë nga i njëjti person ose raste kur personat që u takon ndihma ekonomike nuk mund ta marrin atë (184). Një tjetër problem ka të bëjë me numrin e madh të dokumentave që duhet të plotësohet për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe burokracia e tepruar për plotësimin e tyre, kombinuar me presionet për pagesa të jashtëligjshme dhe lëvizjet e shpeshta të administratorëve lokalë (184). Procedurat e ndërlikuara që duhet të ndiqen për përfitimin e ndihëms ekonomike si dhe numri i papërshtatshëm (i madh) i tyre u evidentuan midis katër faktorë kryesorë që kontribuojnë në barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe uljen e efektivitetit të saj edhe në studimi tonë, bazuar në analizën fakoriale. Kjo do të thotë që, pavarësisht se ky problem njihej prej vitesh nga vendim marrësit dhe politikë bërësit (të paktën që në vitin 2005), sërisht fenomeni ekziston aktualisht duke u kthyer në një ndër barrierat për përfitimin e ligjshëm të ndihmës ekonomike në vendin tonë.

Gjithashtu, një tjetër problem i vënë re lidhur me nivelin e ndihmës ekonomike është që masa e shpërblimit financiar është tepër e ulët (184). Ky fakt, i kombinuar me mbulimin e ulët me këtë shërbim dhe vështirësinë për të përcaktuar një nivel objektiv të varfërisë, ka bërë që efektiviteti i programit të ndihmës ekonomike në reduktimin e varfërisë së grupeve në nevojë të jetë shumë i vogël (184). Ky problem u evidentua shumë qartë dhe në studimin tonë ku 100% e pjesëmarrësve deklaruan se ndihma ekonomike nuk mjafton për të mbuluar nevojat e përditshme. 90% e pjesëmarrësve në studimin tonë deklaruan se ndihma ekonomike mujore që ata përfitojnë mjafton vetëm për një javë kurse 10% deklaruan që ajo mund të mjaftojë për dy javë, gjithmonë duke kursyer dhe duke u kufizuar në maksimum. Nga ana tjetër, vlen të përmendim edhe një herë gjetjen që rreth 90% e subjekteve në studim kishin patur vështirësi për të siguruar ushqimin gjatë vitit të fundit për shkak të mungesës së parave, duke treguar sërisht pamjaftueshmërinë e ndihmës ekonomike aktuale për të plotësuar nevojat e përditshme bazë. Një ndër faktorët që kanë cuar në këtë situatë është fakti që masa e ndihmës ekonomike asnjëherë nuk është indeksuar në përputhje me rritjen e pagës bazë të papunësisë dhe në përgjithësi kriteri që llogarit masën e ndihmës ekonomike sa 2.5 herë të pagës bazë të papunësisë nuk është zbatuar (184). Megjithëse u bënë përpjekje për indeksimin e masës së ndihmës ekonomike nëpërmjet Vendimeve të Këshillit të Ministrave, këto rritje ishin shumë të vogla duke mos reflektuar ritmin e rritjes së pagës bazë të papunësisë (184). Në këtë mënyrë është e qartë që legjislacioni në fuqi në Shqipëri në përgjithësi nuk zbatohet siç duhet.

Duket se ka një mospërputhje midis nivelit të varfërisë dhe numrit të familjeve në nevojë të deklaruar zyrtarisht. Për shembull, ndërsa INSTAT-i e klasifikon qarkun e Durrësit si një ndër qarqet me shkallën më të lartë të varfërisë në vend në vitin 2012, me 16.2% të kryefamiljarëve të konsideruar si të varfër duke lënë pas vetëm qarkun e Kukësit, Fierit dhe Lezhës (187), rezulton që në këtë qark gjendet numri më i vogël i familjevë në skemën e ndihmës ekonomike në shkallë Republike, me vetëm 1411 familje të tilla të cilat përbëjnë vetëm 1.3% të të gjitha familjeve që trajtoheshin me ndihmë ekonomike në vend në vitin 2013 (189). Arsyet e këtyre mospërputhjeve mbeten për tu studiuar në të ardhmen.

Një tjetër barrierë kryesore lidhur me përfitimin e ndihmës ekonomike është fakti që informacioni i ofruar në media apo institucionet përgjegjëse për të nuk është i qartë, i plotë ose është i pamjaftueshëm. Kjo pikë meriton vëmendje të vecantë pasi burimi kryesor i informacionit, siç u shprehën pjesëmarrësit në studimin tonë, lidhur me aktivitetin e qeverisë, është televizioni, d.m.th. media. Gjithashtu, raporti vlerësues i SKZHI evidentoi faktin që në nivelin lokal ka mungesë të ndërgjegjësimit lidhur me koordinimin ndërinstitucional dhe sinergjinë për marrjen e masave për grupet që janë në rrezik për përjashtimin

social duke rezultuar në dhënien jo të barabartë të përfitimeve atyre që kanë nëvoje për to (190). Për më tepër, ky raport konkludon që SKZHI ka qënë më tepër efektive në nivelin kombëtar sesa në atë lokal (190). Por, janë strukturat lokale ato që realisht dhe praktikisht bëjën shpërndarjen e ndihmës ekomike dhe shërbimeve të tjera në kuadër të mbrojtjes sociale në Shqipëri. Janë strukturat lokale ato që duhet të japin informacionin kryesor lidhur me përfitimet e skemës së ndihmës ekonomike, kushtet që duhet të përmbushen për të përfituar nga kjo skemë, masat e përfitimit në terma ekonomikë, dhe detaje të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale në varësi të tyre. Duke qënë se vetë strukturat lokale janë relativisht të paqarta lidhur me funksionet e tyre dhe lidhjen apo varësinë me institucione të tjera atëherë është e kuptueshme që dhe informacioni i dhënë për përsonat e interesuar mund të lërë për të dëshiruar, duke u perceptuar si një ndër barrierat kryesore për përfitimin e ndihmës ekonomike nga personat në nevojë. Për më tepër, strukturat lokale nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrje, planifikim apo hartimin e buxhetit lidhur me mbrojtjen sociale dhe si pasojë ato nuk kanë stimuj të mjaftueshëm për tu angazhuar siç duhet (190). Këto detaje ndikojnë që performanca e strukturave lokale në shpërndarjen e përfitimeve të mbrojtjes sociale të jetë jo optimale duke ndikuar në çdo aspekt të paketës së mbrojtjes sociale, përfshirë informacionin lidhur me ndihmën ekonomike. Aq më rëndësi merr ky detaj në kontekstin e zbulimit të lidhjeve të forta midis nivelit të edukimit të pjesëmarrësve dhe numrit të barrierave të identifikuara në studimin tonë. Madje, ne evidentuam në studimin tonë që edukimi ishte faktori i lidhur më fort dhe në mënyrë domethënëse me barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike edhe pas kontrollit të një sërë faktorësh konfondues. Rreth 80% e pjesëmarrësve në studimin tonë kishin përfunduar 8 vite shkollë ose më pak kurse 22% kishin përfunduar 4 vjet shkollë ose më pak. Në përgjithësi, grupet në ndihmë ekonomike janë të disavantazhuar në shumë drejtime, përfshirë dhe edukimin, siç e kemi shqyrtuar në hyrje të këtij punimi shkencor. Prandaj, duke qënë se këto grupe kanë një nivel mesatar edukimi më të ulët krahasuar me grupet e tjera të shoqërisë, atëherë është e domosdoshme që informacioni i servirur për çdo aspekt të politikave të mbrojtjes sociale të jetë jo vetëm i plotë dhe i qartë, por edhe i formuluar në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshmë për pjesëtarët e këtyre grupeve të shoqërisë. Në këtë mënyrë, në perceptimin e informacionit akual në media apo institucionet përgjegjëse si barrierë për përfitimin e ndihmës ekonomike apo shërbimeve të tjera të mbrojtjes sociale ndikojnë ndërgjegjësimi dhe motivimi i ulët i strukturave lokale dhe niveli i ulët arsimor i ndividëve në nevojë. Nëse përmirësimi i nivelit arsimor të disa grupeve të popullatës është një politikë afat-gjatë, ajo që mund të bëhet në terma imediate është thjeshtimi i gjuhës së përdorur në media lidhur me aspektet të ndryshme të mbrojtjes sociale dhe shpërndarja e tyre në mënyrë më intensive në organet e medias dhe strukturat lokale përgjegjëse për

këto aspekte. Megjithatë, fakti që në përgjithësi strukturat menaxhuese në nivel lokal shpesh janë inekzistente (190), mund të vështirësojë përpjeket edhe për përmirësimin e mënyrës së servirjes së informacionit për personat në nevojë.

Rreth një e treta e subjekteve në moshë pune (18-65 vjeç) në studimin tonë pohuan që nuk kishin kërkuar të punësohen ndërkohë që janë nën mbulimin e skemës së ndihmës ekonomike, gjë që u pohua nga më shumë femra (42.6%) sesa meshkuj (27.3%). Kjo gjetje mund të reflektojë rezultatet e studimeve ndërkombëtare, disa nga të cilët sugjerojnë që një ndër disavantazhet e skemës së ndihmës ekonomike mund të jetë rreziku për t'i mbajtur personat në nevojë larg tregut të punës pasi ata mund të "mësohen" me gjendjen aktuale, duke u bërë pjesë e të ashtuquajturit "kurth i varfërisë" (143,191,192). Megjithatë, kjo është karakteristikë e shteteve politikat sociale të të cilave janë "bujare" duke ofruar pagesa të larta dhe shërbime të shumta mbështetëse për të disavantazhuarit (192,193). Këto janë shtetet e tipit social-demokratik sipas Esping-Andersen (88), ku bëjën pjesë vendet Nordike të cilat karakterizohen nga shërbime të gjera publike dhe transferime financiare bujare drejt familjeve duke u bazuar në de-familjarizimin e shërbimeve sociale, siç e kemi shpjeguar në hyrjen e këtij punimi shkencor.

Megjithatë, këto përfundime janë kritikuar së tepërmi kohët e fundit sepse ato bazohen në studime në shkallë të vogël dhe i referohen disa dekadave më parë (194) dhe madje studime të tjera sugjerojnë që politikat sociale krijojnë stimuj për rritjen e punësimit midis personave që përfitojnë mbështetje sociale dhe jo e anasjellta (195). Në fakt, vetëm një pjesë e vogël e të papunëve përfitojnë ndihmë ekonomike. Për shembull, është evidentuar që në pjesën më të madhe të shteteve më pak se gjysma e të papunëve përfitojnë nga shërbimet e mbështetjes sociale ndërsa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës rreth një e treta e të papunëve të regjistruar përfitonin nga paketa e ndihmës ekonomike (195). Në Shqipëri një përqindje shumë e vogël e të papunëve të regjistruar në zyrat e punësimit përfitojnë nga ndihma ekonomike: nga 143947 të papunë të regjistruar në tremujorin e katërt të vitit 2014 vetëm 7446 prej tyre ose 5.1% përfitonin pagesë papunësie (189). Ky fakt bën që ndihma ekonomike të jetë edhe më e vogël nga c'mund të japë përshtypjen.

Këto të dhëna, së bashku me faktin që në Shqipëri skema e ndihmës ekonomike është mjaft e kufizuar, e pamjaftueshme dhe me ndikim të vogël në reduktimin e varfërisë, bëjnë që ndihma ekonomike të mos jetë faktor në vetvete për largimin e personave të disavantazhuar nga tregu i punës apo mbajtjen e këtyre personave larg punës. Fakti që rreth një e treta e personave në nevojë (në moshë pune) në studimin tonë nuk kërkon të punësohet edhe pse ndihma ekonomike e ofruar nga programi i mbrojtjes sociale është e pamjaftueshme mund të lidhet dhe me faktorë të tjerë. Për shembull, në rast se personi e braktis në mënyrë vullnetare një punë të caktuar, ose ai/ajo refuzon të bëjë një punë

të caktuar që atij/asaj nuk i pëlqen, atëherë ai nuk ka të drejtë të përfitojë nga paketa e ndihmës ekonomike (194,196). Ky kriter është artikuluar së fundmi dhe nga Ministri i Punës në Shqipëri i cili është shprehur se "Nëse dikujt i ofrohet një vend pune, që mund ta bëjë, që i ka aftësitë ta bëjë dhe e refuzon, sepse preferon ndihmën ekonomike, ata persona nuk do të marrin më ndihmë ekonomike dhe ato para ua japim atyre që janë realisht nevojtarë" (197). Sipas tij, mbetet detyrë e zyrave të ndihmës ekonomike për të evidentuar këto raste dhe për t'i përjashtuar këta individë nga skema e ndihmës ekonomike. Të dhënat anektodike dëshmojnë së në Shqipëri njerëzit kanë "preferenca" të caktuara për punën që mund të bëjnë duke mos preferuar punë "të rëndomta". Kjo mbështetet indirekt edhe në gjetjet e studimit tonë ku rezultoi që vetëm një person ishte i angazhuar në punë sociale në komunitet si një burim alternativ i gjenerimit të të ardhurave kur paratë e ndihmës ekonomike nuk mjaftojnë. Natyrisht, puna sociale në komunitet në përgjithësi konsiderohet si "e rëndomtë" dhe rrjedhimisht pak njerëz angazhohen në të. Fakti që ndihma ekonomike shoqërohet me stigëm është i njohur dhe në literaturën ndërkombëtare (198). Shumë njerëz refuzojnë ndihmën edhe pse gjenden në një situatë të pafavorshme ekonomike. Ndërsa ky mund të jetë fakt pozitiv sepse pengon njerëzit të bëhen pjesë e ndihmës ekonomike (duke lehtësuar buxhetin e shtetit), nga ana tjetër kjo mund të bëjë që punëdhënësit të mos preferojnë të punësojnë këta persona "me pretendime" (198). Sa më të larta të jenë nivelet e stigmës që shoqërojnë ndihmën ekonomike, aq më shumë frenohen njerëzit për të përfituar nga kjo skemë pavarësisht gjendjes së tyre të vështirë ekonomike. Si pasojë, nuk është e habitshme që niveli i stigmës kundrejt politikave sociale është i lidhur pozitivisht me nivelin e varfërisë dhe papunësisë (198). Stigma kundrejt skemës së ndihmës ekonomike mund të jetë një faktor vendimtar (përvec kritereve ligjore që përcaktojnë të drejtën për të përfituar nga skema e ndihmës ekonomike) që ndikon në përqindjen shumë të vogël të të papunëve të cilët janë përfshirë në këtë skemë në Shqipëri (vetëm 5.1% e tyre, siç e pamë më lart) në një kohë që në arenën ndërkombëtare kjo shifër është shumë më e lartë.

Studimet në Irlandë tregojnë që pjesa më e madhe e personave që humbin punën marrin ndihmë ekonomike që është sa gjysma e pagës së tyre kur ishin të punësuar (199). Kjo do të thotë që njerëzit mund të rrisin të ardhurat e tyre nëse punojnë dhe jo e anasjellta, duke hedhur poshtë besimin që njerëzit përfitojnë më shumë para duke qënë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike sesa duke punuar. Një rishikim i gjerë i literaturës së mbi 100 studimeve të ndryshme lidhur me politikat e mbrojtjes sociale dhe efektit të tyre në punësim arriti në përfundimi që këto politika nuk stimulojnë papunësinë (200). Ky përfundim u arrit dhe nga studiues të tjerë (201), duke hedhur poshtë idenë se njerëzit e lënë punën apo nuk duan më të punojnë në mënyrë që të marrin përfitimet e skemës së ndihmës ekonomike (196). Pjesa më e madhe e skemave

të ndihmës ekonomike ofrojnë pagesa financiare shumë më të vogla se paga mesatare kështu që vetëm punonjësit me paga më të ulëta mund të marrin ndihmë ekonomike të përafërt me pagën e tyre kur ishin në punë (195). Pra, ka stimul për të kërkuar punë dhe jo për të mos punuar. Nga ana tjetër, rregullat në fuqi përjashtojnë shumë të papunë nga përfitimet e skemës së ndihmës ekonomike (195). Madje, përfituesit e ndihmës ekonomike mund t'i përdorin paratë e paketës për të kërkuar punë në mënyrë me efektive (202). Nga ana tjetër, të jesh në marrëdhënie pune nënkupton zhvillimin e kontakteve sociale me të tjerët ndërsa papunësia shpesh karakterizohet nga izolimi, humbja e kontakteve sociale dhe identitetit personal (203), vetëbesim i ulët dhe mungesë shprese (204) dukë dëshmuar se ka dhe arsye jo-financiare se përse njerëzit dëshirojnë të punësohen (194). Studimet tregojnë se ri-punësimi shoqërohet me përmirësime të dukshme të shëndetit mendor dhe fizik dhe kënaqësisë nga jeta (204) ndërsa papunësia shoqërohet me përkeqësim të shëndetit mendor dhe fizik, si dhe ulje të kënaqësisë nga jeta, shoqëria dhe familja (205).

Në studimin tonë, duket se femrat janë më të rrezikuara për të rënë në "kurthin e varfërisë". Fakti që më shumë femra nuk kanë kërkuar punë ndërkohë që janë nën mbulimin e skemës së ndihmës ekonomike është në përputhje me gjetjet e tjera të studimit tonë që sugjerojnë se një përqindje më e madhe e femrave (30.3%) sesa e meshkujve (15.5%) janë dakort që të mos punojnë sepse ndjehen mirë me ndihmën ekonomike që marrin apo janë të mendimit që qeveria duhet të rrisë nivelin e NE sesa të rrisë shanset për punësim. Gjithashtu, femrat kishin mesatarisht 9 vjet nën mbulimin e skemës së ndihmës ekonomike krahasuar me rreth 7 vjet midis meshkujve. Edhe gjetjet e tjera të studimit reflektojnë një "apati" më të madhe të femrave krahasuar me meshkujt. Kështu, rreth 64% e femrave në studim mendojnë që nuk janë aspak të afta të ndryshojnë jetën e tyre krahasuar me 44% të meshkujve që pohuan të njëjtën gjë. Po kështu, në mënyrë domethënëse më shumë femra sesa meshkuj janë të pakënaqura me politikat sociale aktuale, gjë që përputhet me përqindjen më të lartë të tyre që kërkojnë rritjen e ndihmës ekonomike për "përmirësimin" e gjendjes sesa synojnë rritje të punësimit. Nga ana tjtër, rreth një në 5 gra mund të mbështeten tek familja për të siguruar të ardhura kur këto nuk mjaftonë krahasuar me rreth 6% të meshkujve që pohuan të njëjtën gjë. Në këtë mënyrë, të gjithë argumentat në studimin tonë sugjerojnë që ky efekt negativ i skemës së ndihmës financiare është më i shprehur tek femrat. Kjo është në përputhje me rolin e disavantazhuar të femrës në shoqërinë shqiptare, në një sërë drejtimesh të tilla si përfaqësimi politik, diskriminim në tregun e punës, etj. Në përgjithësi, femrat në Shqipëri janë të nën-përfaqësuara në proceset vendim-marrëse, të nën-paguara dhe të papuna në një shkallë më të madhe sesa meshkujt për të gjitha grup-moshat (206) dhe ato vuajnë pasojat e dhunës së meshkujve (207). Femrat janë të nën-përfaqësuara në nivelet e larta politike, edhe pse janë vënë

re përmirësime me kalimin e kohës. Kështu, numri i deputeteve femra në parlamentin Shqiptar ka shënuar rritje nga 7.1% në vitet 2006-2009, në 16.4% në vitet 2010-2011, në 20% në vitin 2014 (208) kurse në nivel ministerial rreth 11% e tyrë ishin femra në vitin 2008 kurse në vitin 2014 numri i ministrave femra është 6 midis 19 ministrave (ose rreth 32%) (përjashtuar kryeministrin dhe zv/kryeministrin) [209]. Në nivelin lokal pjesëmarrja e femrave është shumë më e ulët. Kështu në zgjedhjet lokale të vitit 2003 vetëm 4% e kandidatëve që fituan për kryetarë bashkie ishin femra dhe vetëm 2% e kandidatëve që fituan për kryetarë komune ishin femra (207). Barazia gjinore lë për të dëshiruar dhe pjesëmarrja dhe influenca e femrave në proceset e vendim-marrjes nuk është përmirësuar sa duhet (2010). Sipas INSTAT-it, femrat janë të diskriminuara në tregun e punës dhe marrin një pagesë më të ulët për të njëjtën punë të kryer, krahasuar me meshkujt (168). Për më tepër, femrat përballen me dhunën nga meshkujt në Shqipëri. Edhe pse të dhënat zyrtare janë të kufizuara, shtypi i ditës është i mbushur me lajme të dhunimit të femrave në Shqipëri. Studime të shoqata të ndryshme në vend sugjerojnë që dhuna ndaj grave është mjaft e përhapur (207), me rreth 40% te femrave që kanë pësuar dhunë fizike në mënyrë të rregullt, kryesisht nga bashkëshorti, sidomos në zont rurale (207). Përvec dhunës fizike, femrat përballen me dhunën në vendin e punës gjithashtu, por raportimet janë të pakta për shkak të mosbesimit në efektivitetin e strukturave përkatëse dhe frikës së humbjes së vendit të punës. Këto fenomene mund t'i kenë rrënjët në varfërinë dhe procesin e zgjatur të tranzicionit që po përjeton Shqipëri, duke bërë që strukturat e shoqërisë dhe shoqëria në përgjithësi të mos jetë e konsoliduar. Tregues të tjerë të pozicionit të disavantazhuar dhe të tërhequr të femrave, të evidentuar në studimin tonë, janë dhe pjesëmarrja më e ulët e tyrë në votime apo në aktivitetet të tjera shoqërore apo politike krahasuar me meshkujt. Ndërsa kjo mund të jetë një pritje e përgjithshme në shoqërinë Shqiptare, siç e vumë në dukje më lart, fakti që kjo është prezente edhe midis personave që mbulohen nga skema e ndihmës ekonomike i vendos femrat e këtij grupi në një pozicion akoma më të disavantazhuar për shkak të specifikave apo barrierave shtesë që hasin këto grupe të komunitetit të tilla si niveli i ulët i edukimit, gjendje shëndetësore e pafavorshme, etj.

Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013 janë futur disa elemente në favor të adresimit në mënyrë specifike të fuqizimit të grave dhe vajzve. Kështu, një nga qëllimet dhe përparësitë stratgjike të SKZHI-së është dhe "krijimi i mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në jetën ekonomike, politike dhe sociale, ndërsa dhuna në familje do të parandalohet: do të rritet shkalla e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës" (181). Ky është një zhvillim pozitiv pasi shënon herën e parë që çështja e fuqizimit të grave dhe vajzave vihet ndër prioritete strategjike të qeverisë Shqiptare.

Duhet theksuar që cështja e fuqizimit të grave nuk është një problem vetëm i shoqërisë Shqiptare por përbën një cështje qendrore dhe aktuale të politikave sociale edhe në vendet e zhvilluara gjithashtu (211). Kështu, edhe në vendet e Europës Perëndimore dhe në Amerikën Veriore gratë janë më të disavantazhuara në tregun e punës krahasuar me meshkujt, edhe pse situata është përmirësuar rrënjësisht që pas fundit të Luftës së II Botërore. Edhe në këto vende ka diferenca në nivelin e të ardhurave midis femrave dhe meshkujve ku mesatarisht të ardhurat vjetore të femrave të moshës 15 vjeç e lart në Irlandë ishin sa 65% e të ardhurave vjetore të meshkujve, në Norvegji 71%, në Angli 74%, dhe në SHBA 68% (211). Diferencat midis shteteve janë të mëdha.

Duhet të theksojmë gjithashtu se politikat sociale dhe ndërhyrjet e tjera të tipit politik, të tilla si legjislacioni që garanton shanse të barabarta për punësim për shembull, mund të jenë të vetmit mjete për të influencuar në punësimin e grave dhe, rrjedhimisht në fuqizimin e mëtejshëm të tyre. Pse politikat që stimulojnë punësimin e grave janë të rëndësishme për fuqizimin e tyre? Sepse në përgjithësi, aksesi në të drejtat e qytetarisë është bazuar historikisht tek puna e paguar (212,213). Fillimisht, të drejtat e qytetarisë ju njohën meshkujve, sepse ata angazhoheshin në punë të paguar, kurse femrat, të cilat në përgjithësi nuk punonin, konsideroheshin si qytetare të dorës së dytë. Meshkujt fituan të drejtat e tyre sociale, të tilla si e drejta e pensionit dhe sigurimet e papunësisë, bazuar në punën e paguar kurse aksesi i grave në këto përfitime ndërmjetësohej nga marrëdhënia e tyre me burrat (212,213). Kjo gjë po ndryshon tashmë, me angazhimin gjithnjë e më të madh të femrave në tregun e punës. Në këtë mënyrë, e drejta për të punuar është një aspekt i rëndësishëm i qytetarisë (211). Një pohim i tillë merr rëndësi edhe më të madhe në rastin e vendit tonë: politikat që synojnë punësimin e grave, si një grup i disavantazhuar krahasuar me burrat, do të përmirësonin gjendjen e tyre në çdo drejtim dhe do t'i bënin ato pjesë të politikave sociale dhe përfitimeve nga këto politika edhe në vendin tonë. Aq më e rëndësishme bëhet kjo sfidë në kuadrin e gjetjeve të studimit tonë që sugjerojnë se gratë janë shumë më "apatike" krahasuar me meshkujt në pothuajse të gjitha aspektet e jetës politike dhe ekonomike, kanë vetëbesim shumë më të ulët dhe gjithashtu kanë më pak besim tek punonjësit e ndryshëm të shtetit për përmirësimn e gjendjes aktuale. Në studimin tonë, femrat raportuan një numër mesatar më të lartë të barrierave për aksesin ndaj ndihmës ekonomike krahasuar me meshkujt (4.5 barriera dhe 3.8 barriera, përkatësisht, Tabela 27), gjë që dëshmon edhe një herë se brenda grupit më të disavantazhuar të shoqërisë sonë femrat përbëjnë sërisht pjesën më vulnerabile të tij. Kjo gjendje është e papranueshme: femrat, të cilat kanë më shumë nevojë për të përfituar nga politikat e mbrojtjes sociale, për shkak të situatës së tyre të disavantazhuar për shkaqe të ndryshme historike, politike dhe sociale, hasin më tepër barriera për të përfituar nga skema e ndihmës ekonomike!

Duke qëndruar në këtë linjë diskutimi, një tjetër gjetje interesante e studimit tonë ishte fakti që për shumicën (60%) e pjesëmarrësve në studim, burimi kryesor i gjenerimit të të ardhurave, duke qënë se ndihma ekonomike nuk mjafton, ishte marrja e parave hua dhe vetëm 12% e subjektve në studim kishin tentuar të punonin për të siguruar të ardhura shtesë! Kjo mënyrë reagimi nga ana e subjekteve në nevojë ka një logjikë të varfër ekonomike: marrja hua e parave nuk duket të jetë një strategji efektive pasi këto para duhet të kthehen në një moment të caktuar në të ardhmen. Ky element mund të jetë i rëndësishëm për të shpjeguar gjendjen aktuale të familjeve në nevojë në Shqipëri. Faktorët shpjegues të këtij "mentaliteti" mund të jenë të shumtë por nuk ishte objektiv i këtij punimi shkencor thellimi në këtë aspekt, të cilin ne nuk e prisnim. Për mendimin tonë, situata duhet të ishte ndryshe: personat me të ardhura të pakta ekonomike duhet të mbështeten më shumë në kërkimin e punës per gjenerimin e të ardhurave sesa tek marrja e huave, që rëndojnë edhe më tej gjendjen e tyre. Në fakt, rreth dy të tretat e subjekteve në studim pohuan se kishin kërkuar të punësohen ndërkohë që ishin në skemën e ndihmës ekonomike dhe, fakti që 60% e subjekteve janë detyruar të marrin hua për të përballuar nevojat e përditshme sugjeron që ata kanë qënë të pasuksesshëm në gjetjen e një pune. Në vija të përgjithshme, kjo sugjeron që, përtej iniciativës individuale, politikat sociale të nxitjes së punësimit nuk kanë qënë efektive apo nuk kanë patur ndikim tek ky grup i disavantazhuar i popullatës. Duke qënë se ndër objektivat strategjikë të SKZHI është dhe punësimi dhe përfshirja sociale, atëherë është e domosdoshme që politikat sociale të bëjnë shumë më tepër për punësimin e kësaj shtrese të shoqërisë si një mënyrë efektive për nxjerrjen e tyre nga varfëria (181).

Fakti që një e treta e subjekteve në skemën e ndihmës ekonomike në studimin tonë deklaruan se nuk kanë kërkuar punë gjatë periudhës që marrin ndihmë ekonomike mund të shpjegohet me dërgesat e parave nga familjarët e tyre në emigracion, një dukuri shumë e përhapur kjo në vendin tonë. Vlerësohet se rreth 25% e popullsisë dhe 35% e forcës aktive për punë kanë emigruar jashtë vendit në kërkim të një jetë më të mirë. Ndërkohë, mbi 65% e familjeve në Shqipëri deklaruan se marrin dërgesa parash nga të afërmit e tyre që jetojnë jashtë vendit (214). Janë pikërisht këto dërgesa që kanë dekurajuar pjesëmarrjen e mjaft individëve në tregun e punës (214).

Nga ana tjetër, ne evidentuam që sa më ulët niveli i besimit tek zyrtarët e ndryshëm të shtetit, aq më i lartë ishte numri mesatar i barrierave të hasura për përfitimin e ndihmës ekonomike (Tabela 28). Kjo ishte një tendencë e qartë në të gjitha katogoritë e punonjësve të shtetit të shqyrtuara (Tabela 28). Kjo gjetje është me rëndësi të vecantë sepse ajo dëshmon që ka një lidhje të ngushtë midis perceptimit të përgjithshëm apo imazhit që qytetarët në nevojë kanë për qeverinë dhe nëpunësit e shtetit dhe aksesit të tyre në shërbimet dhe përfitimet

e paketës së mbrojtjes sociale. Shpjegimi i kësaj lidhjeje të evidentuar mund jetë si vijon: kur qytetarët kanë pak besim tek strukturat e shtetit, atëherë ata janë më pak të motivuar për të kërkuar të drejtat e tyre pasi mendojnë që ligji nuk zbatohet dhe janë procedurat korruptive apo të paligjshme ato që mbizotërojnë. Në fakt, raporte të ndryshme nënvizojnë kulturën e korrupsionit që mbizotëron në Shqipëri (154,215;). Korrupsioni gërryen besimin e shoqërisë tek strukturat ligjore dhe ndikon relativisht më shumë tek grupet vulnerabël sesa tek pjesa tjetër e shoqërisë (216). Sipas Bankës Botërore "analizat tregojnë se të varfërit paguajnë një përqindje më të madhe të të ardhurave të tyre në akte korruptive krahasuar me të pasurit" dhe "korrupsioni është ndër pengesat madhore për zhvillimin ekonomik dhe social (217). Në studimin tonë, vetëm 5% e subjekteve pohuan që duhen kryer "pagesa nën-dorë" në mënyrë që të përfitosh ndihmën ekonomike. Megjithatë, ne mendojmë që mund të ketë nën-raportim të këtij fenomeni pasi intervistat u kryen pranë ambjenteve të zyrave të ndihmës ekonomike në njësitë përkatëse adminstrative të Bashkisë Durrës dhe kjo mund të ketë frenuar pjesëmarrësit të shprehen në mënyrë të sinqertë lidhur me këtë pikë delikate. Po në këtë linjë është komenti jonë lidhur me faktin që rreth 12% e subjekteve në studim u shprehën së bindjet politike ndikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike. Të dhënat anektodike sugjerojnë që ndikimi politik për përfitimin e ndihmës ekonomike duhet të ketë qënë i konsiderueshëm, por subjektet në studim janë rezervuar të shprehen për këtë cështje "sensitive" pranë ambjenteve ku përfitohet pagesa financiare e ndihmës ekonomike.

Gjithsesi, fakti që niveli i besimit të qytetarëve në nevojë tek zyrtarët e qeverisë qendore dhe lokale është i ulët dhe lidhja e evidentuar midis nivelit të besimit midis numrit të barrierave të hasura për përfitimin e ndihmës ekonomike mund të jetë një mundësi e mirë për të ndërhyrë në mënyrë efektive në kuptimin që forcimi i strukturave shtetërore dhe i llogaridhënies do të rikthejë besimin e publikut tek këto institucione duke përmirësuar në vijimësi perceptimin e tyre tek këto struktura, forcuar motivimin e tyre për të patur akses ndaj përfitimeve dhe duke ulur barrierat për përfitimin e tyre.

Përsa i përket masës së shpërblimit financiar për familjet në nevojë, në Strategjinë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale 2007-2013 pohohet që ndihma ekonomike bëhet në përputhje me strukturën familjare (184), kurse VKM Nr. 787 pohon se ndihma ekonomike, pavarësisht nga përbëja e familjes, nuk mund të jetë më e lartë se 7000 lekë në muaj (182). Tabela 29 në vijim paraqet pagat mesatare për person për çdo familje që ka marrë ndihmë ekonomike gjatë tremujorit të 4 të vitit 2013 (189). Vihet re pagesa për person është 2600 lekë në muaj (në familjet me një person), duke respektuar në këtë mënyrë udhëzimet e VKM Nr. 787 (182).

Megjithatë, me rritjen e numrit të pjesëtarëve të familjes vihet re një ulje progresive e pagesës mesatare për person, duke kaluar në 1633 lekë për çdo anëtar në familjet me dy persona, në 1200 lekë në muaj për çdo anëtar në familjet me 3 persona, dhe më pas në 1147, 1088 dhe 879 lekë në muaj për person për familjet me 4, 5 dhe 6 anëtarë përkatësisht (Tabela 29).

**Tabela 29. Fondi mesatar mujor i ndihmës ekonomike sipas madhësisë së familjes në Bashkitë e vendit, tremujori IV 2013**

| Madhësia e familjes | Familje gjithsej në Bashki | Fondi i ndihmës ekonomike në Bashki (në 000 lekë) | Pagesa mesatare për çdo familje (në 000 lekë) | Pagesa mesatare për çdo anëtar të familjes (në 000 lekë) |
|---|---|---|---|---|
| Me 1 pjesëtar | 3573 | 9400 | 2.631 | 2.631 |
| Me 2 pjesëtarë | 4649 | 15187 | 3.267 | 1.633 |
| Me 3 pjesëtarë | 7376 | 26549 | 3.599 | 1.200 |
| Me 4 pjesëtarë | 12273 | 56301 | 4.587 | 1.147 |
| Me 5 pjesëtarë | 7720 | 41997 | 5.440 | 1.088 |
| Me 6 pjesëtarë | 2902 | 15310 | 5.276 | 0.879 |
| Me >6 pjesëtarë | 1762 | 9654 | 5.479 | E papërcaktuar |

Burimi: INSTAT. Buletin statistikor tremujor. 4-2013. E disponueshme në: http://www.instat.gov.al/media/235312/buletini_statistikor_4_2013_.pdf (Konsultuar në Gusht 2014)

Nëse shohim ndryshimet relative (Tabela 30), vihet re fare lehtë që rritja relative e pagesës mesatare për familje nuk i përgjigjet ritmit të rritjes relative të madhësisë së familjeve. Për shembull, kur kalohet nga familja me 1 anëtar në atë me dy anëtarë, madhësia e familjes është rritur me 100% kurse pagesa mesatare përkatëse për familjen me dy anëtarë është rritur me vetëm 24.17%. Familjet me 6 anëtarë përfaqësojnë një rritje prej 500% të madhësisë së familjes kundrejt familjeve me 1 anëtar por rritja relative përkatëse e pagesës mesatare nga ndihma ekonomike është vetëm 100.53% (Tabela 30).

**Tabela 30. Rritja (në %) e pagesës mesatare për person kundrejt rritjes (në %) të madhësisë së familjeve në Bashkitë e vendit , tremujori IV 2013**

| Madhësia e familjes | Pagesa mesatare për çdo familje (në 000 lekë) | Pagesa mesatare për çdo anëtar të familjes (në 000 lekë) | Rritja (në %) e madhësisë së familjes (kundrejt familjes me 1 anëtar) | Rritja (në %) e pagesës së ndihmës ekonomike për familje (kundrejt familjeve me 1 antëar) | Përqindja e plotësimit të nevojave për frymë kundrejt kufirit të varfërisë prej 4891 lekë/frymë |
|---|---|---|---|---|---|
| Me 1 pjesëtar | 2.631 | 2.631 | Referencë | Referencë | 53.79% |
| Me 2 pjesëtarë | 3.267 | 1.633 | 100% | 24.17% | 33.39% |
| Me 3 pjesëtarë | 3.599 | 1.200 | 200% | 36.81% | 24.53% |
| Me 4 pjesëtarë | 4.587 | 1.147 | 300% | 74.37% | 23.45% |
| Me 5 pjesëtarë | 5.440 | 1.088 | 400% | 106.78% | 22.24% |
| Me 6 pjesëtarë | 5.276 | 0.879 | 500% | 100.53% | 17.97% |
| Me >6 pjesëtarë | 5.479 | E papërcaktuar | E papërcaktuar | E papërcaktuar | E papërcaktuar |

Burimi: INSTAT. Buletin statistikor tremujor. 4-2013. E disponueshme në: http://ëëë.instat.gov.al/media/235312/buletini_statistikor_4_2013_.pdf (Konsultuar në Gusht 2014)

Kuptohet që këto pagesa janë krejtësisht të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat bazë, vecanërisht të familjeve me shumë anëtarë. Kufiri tavan i përcaktuar nga VKM Nr. 787 prej 7000 lekësh në muaj duket së është zbatuar me rigorozitet, por ky vendim ndoshta ka bërë që skema e ndihmës ekonomike të mos jetë fleksibile dhe të mos i përgjigjet nevojave të familjeve në nevojë. Sipas të dhënave nga Tabela 29, një familje me 6 anëtarë merr mesatarisht 5200 lekë në muaj ose 879 lekë për person në muaj. Ndërkohë, kufiri i varfërisë i përcaktuar nga INSTAT është 4891 lekë për përson në muaj (187). Ndërkohë, ndihma ekonomike plotëson rreth 54% të nevojave të kufirit të varfërisë për familjet me 1 person (2631 lekë / 4891 lekë), dhe më pas duke filluar me familjet me dy persona e lart niveli i kompensimit relativ kundrejt kufirit të varfërisë pëson ulje drastike. Kështu, për familjet me dy persona ndihma ekonomike plotëson 33% (1633 lekë / 4891 lekë) të nevojave të kufirit të varfërisë për person, për familjet me tre anëtarë kjo vlerë arrin në rreth 25% (1200 lekë / 4891 lekë), 23% për person (1147 lekë / 4891 lekë) në familjet me 4 anëtarë, 22% për person (1088 lekë / 4891 lekë) për familjet me 5 anëtarë dhe vetëm 18% për person kur bëhet fjalë për familjet me 6 anëtarë (879 lekë/4891 lekë). Në studimin tonë, subjekte referuan që pagesa maksimale mujore që merrte familja e tyre ishte rreth 20000 lekë, duke reflektuar jetesën në shtëpi të mëdha me dy-tre kurora njëkohësisht.

Në këtë mënyrë, ne konkludojmë që pagesa e ndihmës ekonomike bëhet sipas strukturës së familjes vetëm në mënyrë matematikore duke nënkuptuar që familjet me më shumë anëtarë marrin më shumë para' vetëm në terma absolutë. Por, familjet me më shumë anëtarë marrin gjithnjë e më pak para' nga skema e ndihmës ekonomike me rritjen e numrit të anëtarëve të tyre, siç dëshmohet në Tabelën 30. Prandaj, skema aktuale e ndihmës ekonomike do të thonim që nxit familjet me anëtarë unik dhe krijon stimuj negativë për familjet e mëdha. Në këto kushte, ne mendojmë që skema e ndihmës ekonomike duhet të korrektohet me urgjencë duke reflektuar nevojat reale të familjeve në nevojë. Në terma reale ndihma ekonomike aktuale është krejtësisht e pamjaftueshme për të plotësuar nevojat bazë, sidomos të familjeve me shumë anëtarë, dhe efektet e saj për nxjerrjen e këtyre personave nga varfëria do të thonim se janë minimale, në mos inekzistente. Një nivel i tillë i ndihmës ekonomike në teori duhet të nxiste personat e prekur që të kërkojnë punë dhe të punësohen sa më parë në mënyrë që të rrisin të ardhurat e tyre. Por, siç e pamë më lart, politikat sociale aktuale kanë qënë të pafuqishme për të siguruar punë për këtë kategori personash dhe, si pasojë, rreth 60% e personave në ndihmë ekonomike janë të detyruar të marrin para' hua duke u zhytur më tej në kurthin e varfërisë.

## 5.2 VLERËSIMI I POLITIKAVE TË MBROJTJES SOCIALE NË SHQIPËRI DHE RAJON

Shqipëria është një vend i cili po përjeton të gjithë karakteristikat e ndryshimeve strukturore dhe ideore të familjes duke dëshmuar se tranzicioni i dytë demografik po ndodh edhe në vendin tonë, siç e përshkruam në hyrjen e këtij punimi shkencor. Nuk ka dyshim që këto zhvillime duhet të shoqërohen nga ndryshime në të gjitha fushat e jetës, përfshirë politikat e mbrojtjes sociale, në mënyrë që vendi t'i përgjigjet me sukses sfidave të reja të kohës.

Shqipëria mbetet ende një vend në tranzicion, me ekonomi të brishtë dhe një nivel të lartë të ekonomisë informale. Megjithatë, përpjekje të mëdha po bëhen për përmirësimin e situatës dhe përafrimin me standardet europiane, gjë që është edhe më e rëndësishme në kontekstin kur Shqipëria në 24 qershor 2014 mori zyrtarisht statusin e vendit kandidat për në Bashkimin Europian (218). Në këtë kuadër, janë bërë përpjekje për përafrimin e politikave të mbrojtjes sociale në përputhje me politikat Europiane. Kështu, SKZHI është një dokument strategjik ku Strategjia e Përfshirjes Sociale dhe Strategjia e Mbrojtjes Sociale janë përbërës integralë të saj duke u fokusuar mbi varfërinë dhe rreziqet e përjashtimit social (214).

Sistemi publik i mbrojtjes sociale ofron mbulim për një kategori të kufizuar të personave në nevojë duke përfshirë të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe fëmijët jetimë duke u bazuar në kontributet e derdhura nga punëdhënëist dhë punëmarrësit. Ky sistem funksionon mirë në kushtet e një ekonomie me shkallë të lartë formaliteti, që nuk është rasti i Shqipërisë (214). Ndryshimet e familjes në kuadër të tranzicionit të dytë demografik kanë vënë në pikëpyetje përshtatshmërinë e sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri për të arritur standardet minimale të mbështetjes sociale (214). Ne evidentuam nëpërmjet studimit tonë që, aktualisht, këto politika janë të papërshtatshme prandaj ka lindur nevoja për futjen e skemave të reja të mbrojtjes sociale për personat në nevojë (214).

Ndihma ekonomike synon garantimin e standardeve minimale të jetesës. Përveç kësaj, ka dhe përfitime për personat me aftësi të kufizuar, rimbursime të pjesshme të faturave të energjisë elektrike dhe shërbime sociale në qendrat rezidenciale dhe ditore (214). Aktualisht, në bazë të analizës së situatës dhe opinioneve të subjekteve në studimin tonë, ndihma ekonomike nuk e ka plotësuar synimin e saj për garantimin e standardeve minimale të jetesës duke qenë se ajo mbulon një pjesë shumë të vogël të nevojave të kufirit të varfërisë, sidomos në rastin e familjeve me shumë anëtarë. Përjashtimi social në vendin tonë i detyrohet kryesisht varfërisë, qeverisjes së dobët, mos zbatimit të ligjit, korrupsionit dhe politikave sociale jo në përputhje me gjendjen aktuale (214). Në këtë mënyrë, politikat e mbrojtjes sociale në Shqipëri u vijnë vetëm pjesërisht

në ndihmë grupeve më të disavantazhuar të shoqërisë sonë që janë fëmijët në nevojë, të moshuarit, gratë, personat me aftësi të kufizuara, të papunët, dhe pakicat etnike si romët dhe egjiptianët (214).

Aktualisht, raportet vlerësuese të politikave të mbrojtjes sociale në Shqipëri evidentojnë disa aspekte problematike të tyre. Për shembull, një pjesë shumë e madhe e të papunëve në Shqipëri nuk kualifikohen ose nuk kanë të drejtë të përfitojnë sigurimin e papunësisë pasi kjo kushtëzohet vetëm për ata që kanë paguar kontribute sociale gjatë vitit të fundit të punësimit të tyre (214). Siç e pamë, vetëm 5% e të papunëve të regjistrua në Shqipëri kualifikohen, bazuar në rregullat aktuale, për të përfituar pagesën e sigurimit të papunësisë. Shqyrtimi i raporteve të ndryshme sugjeron që bashkëpunimi dhe integrimi i institucioneve që merren me politikat e mbrojtjes sociale dhe ofrimin e këtyre shërbimeve në komunitet duhet të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme (214). Moskoordinimi dhe mungesa e ndërgjegjësimit lidhur me ndarjen e përgjegjësive midis institucioneve bëhet pengesë për mos marrjen e përfitimeve atyre që u takojnë, ndërlikimin e panevojshëm të procedurave për marrjen e ndihmës ekonomike dhe dhënien e papërshtatshme të informacionit lidhur me skemat e mbrojtjes sociale tek palët e interesuara.

Është sugjeruar të krijohet një skemë e re për mbrojtjen e familjes dhe fëmijëve në vecanti (214), në përputhje me ndryshimet e tranzicionit të dytë demografik në vendin tonë. Cështja e nivelit të ulët arsimor të personave në nevojë dhe lidhja e fortë midis arsimimit dhe barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike të evidentuar në studimin tonë kërkon ndërhyrje energjike në mbështetje të familjeve në nevojë, prindërve dhe fëmijëve (214). Sugjerohet që edukimi është një element kyç për reduktimn e varfërisë dhe fuqizimin e personave të disavantazhuar (138). Ky detaj, siç e përmendëm, u vu në dukje në mënyrë shumë të qartë në studimin tonë. Që këtej, lind nevoja për përmirësimin e nivelit arsimor të popullatës në tërësi, por edhe të grupeve vulenrabël, si një strategji afat-gjatë për përmirësimin e situatës së grupeve të disavantazhuara të shoqërisë.

Nevoja për përshtatjen e skemave të mbrojtjes sociale vjen dhe nga fakti që gratë po punësohen gjithnjë e më tepër në sektorin informal ose kryejnë aktivitete familjare të papaguara, si për shembull përkujdesjen për të moshuarit dhe fëmijët në familje (214). Prandaj, përfitimet duhet të përfshijnë dhe familjet dhe fëmijët "si si pjesë e sistemit të sigurimeve shoqërore ose asistencës sociale dhe shërbimeve" (214). Këtu mund të zërë vend debati që sollëm në vëmendje në hyrje të këtij punim shkencor, lidhur me mënyrën e përshtatshme për ta bërë këtë: masa financiare apo institucionale për t'ju përshtatur ndryshimeve në strukturën e familjes. Gjithsesi, mbetet detyrë e politikbërësve dhe vendimarrësve, të cilët, bazuar mbi opinionet e grupeve të interesit dhe ekspertëve, mënyrës së financimit të sistemit dhe kontekstit ekonomik, social

e kulturor të vendit tonë të vendosin për njërin apo tjetrin drejtim apo për një kombinim të të dy metodave. Bazuar në literaturë, dhe në tendencat e vëna re në vendet ish-komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore (138) të ngjashme me Shqipërinë, ku kujdesi në familje për anëtarët e tjerë të familjes është ende një praktikë dominuese dhe e mbrujtur në kulturën aktuale, ne sugjerojmë që masat financiare do të ishin më të përshtatshme në rastin e vendit tonë. Këtë përfundim e bazojmë edhe në faktin që infrastruktura e ofrimit të shërbimeve sociale në institucione të ndryshme në vendin tonë lë shumë për të dëshiruar.

Për sa i përket vendeve ish komuniste të rajonit (ish-federatave Jugosllave), ato karakterizohen, në ndryshim nga Shqipëria, nga sisteme të mbrojtjes sociale të zhvilluara mirë dhe të konsoliduara që në vitet '60 (219). Sistemet e mbrojtjes sociale ndryshojnë shumë midis këtyre vendeve, por në përgjithësi përfitimet janë reduktuar si pasojë e konfliketeve dhe krizave ekonomike dhe nivelet e larta të ekonomisë informale. Megjithatë, kohët e fundit janë shfaqur tendenca për zhvillimin e strategjive të integruara të mbrojtjes sociale por problemi kryesor është, si dhe në Shqipëri, zbatimi i dobët i legjislacionit relativisht të plotë në fuqi dhe monitorimi dhe vlerësimi i pamjaftueshëm i efektivitetit të këtyre sistemeve (219). Në këtë kontekst, studimi ynë ka meritën se vlerësoi në mënyrë objektive efektivitetin e skemës së ndihmës ekonomike në një rajon të Shqipërisë, duke shërbyer si një argumentim shtesë për nevojën e përmirësimeve dhe ndryshimeve rrënjësore që duhet të bëhen në skemat e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale në vendin tonë.

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor karakterizohen nga struktura qeverisjeje shumë komplekse, ku nivelet qendrore dhe lokale shpesh luftojnë për më shumë autoritet (219). Me përjashtim të Bosnjes dhe Hercegovinës, sistemi i qeverisjes ka mbetur shumë i centralizuar në vendet e tjera të këtij rajoni. Përpjekjet për decentralizim kanë rezultuar në probleme të shumta në drejtim të sigurimit të gjithëpërfshirjes së palëve apo aktorëve për ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes sociale për shkak të paqartësisë së kompetencave, mungesës së ndërgjegjësimit dhe planifikimit jo të përshtatshëm (219). Si në Shqipëri, ashtu dhe në vendet e rajonit përfshirja e Organizatave jo-Fitim Prurëse (NGO) në shërbimet e mbrojtjes sociale është vetëm sporadik.

Përfitimet financiare, natyra e tyre dhe kriteret për t'i përfituar ato variojnë nga njëri shtet në tjetrin. Në përgjithësi, ekziston një skemë bazë e ndihmës sociale bazuar mbi vlerësimin e të ardhurave, e cila aplikohet vetëm kur kryefamiljari/rja është e papunë ose kur familja ka fëmijë të vegjël në varësi (219). Në Shqipëri dhe Kosovë nuk aplikohen skemat e përfitimit për fëmijët. Pagesat e papunësisë aplikohen në të gjithë rajonin, përvec Kosovës, por rregullat e shumta për ta përfituar atë përjashtojnë shumë të papunë nga kjo skemë (219).

Një tjetër karakteristikë për vendet e rajonit është lidhja e papërshtatshme midis shërbimeve sociale me shërbimet shëndetësore dhe arsimore për fëmijët (219). Në Shqipëri dhe Kosovë kujdesi rezidencial për fëmijët dhe ata nën moshën 3 vjeç është shumë më pak i zhvilluar krahasuar me vendet e tjera të rajonit kurse reforma e shërbimeve sociale në këto vende nuk është bërë mbi baza sistemike por në shkallë të vogël (219). Në përgjithësi, shërbimet sociale për personat me aftësi të kufizuara udhëhiqet ende nga një perspektivë e fortë mjekësore duke cuar në mbi-popullimin e qendrave rezidencale me këta persona. Për më tëpër, perspektiva mjekësore bën që përfitimet të jenë më tepër në formën e ndihmës mjekësore sesa të mbështjetjes për këta personave dhe përgatitjes së tyre për të hyrën në sistemin arsimor apo në tregun e punës (219). Sigurimet shëndetësore në Shqipëri janë të kufizuara dhe një pjesë e madhe e popullatës nuk mbulohet nga siguracionet shëndetësore. Për më tepër, në të gjithë rajonin sistemi shëndetësor është i fokusuar mbi kujdesin mjekësor duke mos i kushtuar vëmendjen e duhur kujdesit shëndetësor parësor, parandalimit të sëmundjeve dhe promocionit të shëndetit. Reformat pjesërisht të suksesshme në sistemin shëndetësor kanë rritur pabarazitë sociale, ekonomike dhe rajonale. (219).

Një studim lidhur me rolin e qeverisjes në zhvillimin e politikave të mirëqenies sociale evidentoi të dhëna shumë interesante në rastin e Shqipërisë (220). Sipas këtij studimi, zyrtarët e Qeverisë dhe nëpunësit civilë në Shqipëri kishin një botëkupim tepër të ngushtë të politikave sociale si disiplinë, duke mos marrë në konsideratë faktin që politikat sociale mund të kontribuojnë në debatin për shpërndarjen e burimeve dhe duke i konsideruar politikat aociale si çështje ekskluzive të Ministrisë së Punës. Gjysma e të anketurave mendonte që politikat aociale nuk ekzistojnë në Shqipëri, kurse një e treta e tyre i konsideronin atë si çështje të zyrtarëve të nivelit të lartë dhe jo detyrë e nëpunësve civilë (220). Gjetjet vijojnë më tej duke sugjeruar që, megjithëse ishte e qartë që politikat sociale po zbatoheshin aktualisht, të anketuarit pretendonin se nuk ishin në dijeni të tyre. Për shembull, megjithëse programe të mirëqënies po zbatoheshin ndërkohë në edukimin shëndetësor, ato nuk konsideroheshin të lidhur me politikat sociale (220). Ndërgjegjësimi i ulët lidhur me politikat sociale mund të jetë një tjetër faktor që shërben si barrierë për reformimin e skemës aktuale dhe përshtatjen e saj në përputhje me nevojat e ndryshimeve të strukturës familjare, ekonomike dhe sociale në vendin tonë.

## 5.3 TENDENCAT E POLITIKAVE SOCIALE NË EUROPË

Sistemet e politikave të mbrojtjes sociale dhe përfshirjes sociale kanë pësuar reforma të konsiderueshme edhe në vendet e tjera të Europës, duke filluar nga mesi i viteve '90. Në vijim do të paraqesim shkurtimisht tendencat kryesore të këtyre reformave. Shtysat kryesore për reformimin e sistemeve të mirëqënies sociale në Europë kanë qënë faktorët e jashtëm (si për shembull, globalizimi) dhe faktorët e brendshëm, si për shembull, moshimi i popullatës, ngadalësimi i rritjes ekonomike siç është rasti i krizës financiare botërore, e cila së fundmi preku dhe Eurozonën, nivelet e larta dhe të qëndrueshme të papunësisë, ndryshimet drastike të strukturës familjare në kuadër të *tranzicionit të dytë demografik*, rregullat dhe kufizimet e shpenzimeve midis vendeve anëtare të Bashkimit Europian, etj. (221-223).

Përpara se të shtjellojmë tendencat e reformave të sistemeve të mirëqënies sociale në disa vende të zhvilluara të Eurpës, është rasti të rikujtojmë edhe një herë klasifikimin e sistemeve të mirëqënies sociale sipas Esping-Andersen në tre kategori: sistemi social-demokratik (me përfaqësues vendet Nordike), sistemi konservativ (me përfaqësues Gjermaninë dhe Francën) dhe sistemi liberal (me përfaqësues Anglinë) (88). Megjithë larminë e madhe të reformave dhe masave të ndërmarra në vende të ndryshme, në përgjithësi ato janë përpjekur t'i përshtasin sistemet e tyre në varësi të ndryshimeve ekonomike, demografike dhe kufizimeve financiare. Shtyllat kryesore të reformës në politikat e mirëqënies sociale ishin sistemi i pensioneve, kujdesi shëndetësor, papunësia dhe familja (224-226).

Përsa i përket sistemit të pensioneve, në disa raste fokusi ishte në rritjen e moshës së pensionit, në raste të tjera ndryshimi i llogaritjes së pensionit ose zbatimin e skemave suplementare dhe/ose komplementare të pensionit. Në shumë prej shteteve u aplikuan të gjithë këta elementë por në disa raste vetëm njëra prej tyre u zbatua. Kështu, rritja e moshës së pensionit u zbatua në Gjermani, kurse në Suedi nuk u lejua dalja në pension përpara moshës së përcaktuar. Në Gjermani gjithashtu u aplikua ndryshimi i mënyrës së llogaritjes së pensioneve. Në Gjermani dhe Angli një pjesë e barrës së sigurimit shoqëror u zhvendos drejt skemave komplementare apo suplementare (224-226). Por kishte dhe raste kur masat e marra cuan në rritjen e shpenzimeve të lidhura me pensionet si në Portugali ku me ndryshimet e bëra më shumë persona u përfshinë në skemën e sigurimeve.

Lidhur me përpjekjet për kufizimin e shpenzimeve të lidhura me papunësinë, u aplikua ndryshimi i kritereve për përfitimin e kësaj mbështetjeje. Kështu, periudha gjatë të cilës personat kanë të drejtë të përfitojnë nga mbështetja financiare për papunësinë u kufizua në Suedi dhe Gjermani, por u rrit në Francë kurse masa e përfitimit financiar u ul në Gjermani, Spanjë dhe

Angli. Në përgjithësi, të gjitha vendet filluan të zbatonin kushte më strikte për pagesat financiare për papunësinë (224-226).

Lidhur me reformat në sistemin e kujdesit shëndetësor, u morën masa për të reduktuar shpenzimet shëndetësore publike duke rritur bashkë-pagesën nga përdoruesit ose duke stimuluar përdorimin e medikamenteve xhenerike (si në Gjermani, Francë, Suedi, dhe Greqi) kurse në shtete të tjera u lehtësua aksesi ndaj kujdesit shëndetësor dhe u zgjerua mbulimi me shërbime të kujdesit shëndetësor (Angli, Francë, Itali). Kurse Suedia ndërmori ri-organizimin e sistemit të kujdesit shëndetësor duke e decentralizuar atë (224-226).

Në përgjithësi në të gjithë vendet u vunë rë përmirësime të mbulimit dhe sasisë së përfitimit në favor të familjeve dhe fëmijëve (në pagesë financiare ose në shërbime), si dhe rritje të përfitimeve sociale për grupet e disavantazhuara si në Francë, Angli dhe Greqi, duke rritur financimin e politikave sociale nëpërmjet taksimit (224-226).

Në përgjithësi, nga fillimi i viteve '90 deri në mesin e viteve 2000, shpenzimet mesatare Europiane për mbrojtjen sociale u rritën ku kontributet sociale përbënin burimin kryesor të financimit në disa shtete kurse disa shtete të tjera rritën financimin e këtyre politikave nga buxheti i shtetit. Përfitimet nga skema e mbrojtjes sociale, në formën e pagesave financiare apo shërbimeve, u kombinuan në mënyra të ndryshme në këto vende duke rezultuar në shtete që ofronin pagesa financiare të larta dhe shërbime sociale të larta (si në Suedi), pagesa financiare të larta dhë shërbime sociale të ulëta (si në Itali) dhe grupi i tretë i vendeve i karakterizuar nga pagesa financiare të ulëta dhe shërbime sociale të kufizuara (si në Greqi dhe Angli). Megjithatë, trendi i përgjithshëm ishte që rritja në ofrimin e shërbimeve sociale ishte më e lartë sesa rritja në pagesa direkte financiare (224-226).

Në përmbyllje, mund të konkludojmë që, edhe në vendet e zhvilluara të Europës Perëndimore, çështja e politikave të mirëqënies sociale është një çështje e hapur. Këto politika nuk janë rigide por synojnë t'i përshtaten zhvillimeve ekonomike, sociale dhe politike të shoqërive përkatëse në tentativë për të ofruar mbrojtjen maksimale të mundshme në kontekstin e rrethanave lokale. Edhe pse pjesë e një Unioni ekonomik dhe financiar, masat e ndërmarra nga shtete të ndryshme të Europës janë shumë të ndryshme dhe të larmishme duke konfirmuar edhe një herë se nuk ka një sistem ideal të politikave të mbrojtjes sociale i cili të funksionojë në çdo vend dhe në çdo kohë. Fusha e politikave sociale është një çështje dinamike, ku eksperimentimi është veçse në fillimet e tij në përpjekje të gjetjes së formulave sa më efektive.

Natyrisht, nuk mund të pritet që vendet e Europës Qendrore dhe Lindore dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë dhe Shqipërinë, të implementojnë sistemin ideal për to sa hap e mbyll sytë. Vitet e gjata të tranzicionit kanë dëshmuar që ky është një proces kompleks, që kërkon durim dhe gjykim të

shëndoshë. Edhe pse sistemet e mirëqënies sociale në Europë janë në zhvillim të vazhdueshëm, vendet ish-komuniste kanë shumë për të mësuar nga eksperienca e tyre. Për më tepër, vendimet e ardhshme lidhur me politikat sociale në këto vende duhet të marrin në konsideratë eksperiencën e vendeve të tjera, rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë dhe rezultatet e kërkimit shkencor në nivel kombëtar në vendet përkatëse.

KAPITULLI
6

# PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

## 6.1. PËRFUNDIME

Studimi aktual lidhur me efiktivitetin e skemës së ndihmës ekonomike në një prej rajoneve kryesore të Shqipërisë, dhe më konkretisht për vlerësimin e barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike në kontekstin e ndryshimeve të familjes Shqiptare midis individëve nën skemën e ndihmës ekonomike të përfshirë në studim në qershor 2014 ofroi, për herë të parë, një tablo të detajuar lidhur me këto çështje në vendin tonë.

Studimi ynë është ndër studimet e pakta, në mos studimi i vetëm, i cili ofron informacione tepër të detajuara lidhur me profilin e individëve përfitues të ndihmës ekonomike në vendin tonë. Studimet e tjera të përafërta me studimin tonë janë përqëndruar më tepër në referimin e kuadrit ligjor mbi të cilin bazohen politikat e përfshirjes dhe mbështetjes sociale në vendin tonë dhe një tablo deskriptive të karakteristikave kryesore të personave përfitues të ndihmës ekonomike. Kurse në studimin aktual në përdorëm një qasje tjetër, duke filluar me arsyet për ndryshimin e strukturës së familjes në përgjithësi dhe përshkrimin e tendencave kryesore të këtyre ndryshimeve në botë, rajon dhe vendet të ngjashme me vendin tonë, si një pikënisje për të kuptuar politikat sociale aktuale dhe tendencat kryesore të ndryshimeve që kanë pësuar dhe po pësojnë ato në përgjigje të ndryshimit të strukturës së familjes. Gjithashtu, në nuk u përqëndruam në përshkrimin shterues të kuadrit ligjor dhe detajeve të tij lidhur me politikat sociale dhe përfitimet prej skemave të mbështetjes sociale duke ofruar në vend të kësaj një tablo të parimeve të përgjithshme dhe shtyllave kryesore mbi të cilat bazohen politikat e përfshirjes sociale në Shqipëri. Studimi ynë është i vetmi studim në dijeninë tonë i cili raporton të dhëna lidhur me barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike në Shqipëri, duke ndërmarrë përdorur testet statistikore robuste për evidentimin e barrierave kryesore për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe peshës specifike të këtyre barrierave. Për më tepër, barrierat për përfitimin e ndihmës ekonomike u analizuan në varësi të shumë faktorëve socio-demografikë dhe socio-ekonomikë të pjesëmarrësve, si dhe lidhur me nivelin e besimit të tyre tëk zyrtarët e ndryshmë të shtetit, duke kontrolluar njëkohësisht për efektin konfondues të shumë faktorëve në mënyrë që të gjeneronim të dhëna më reale. Në dijenin tonë, asnjë studim tjetër në vend nuk ka ndërmarrë një përqasje të tillë për hulumtimin e barrierave për

përfitimin e ndihmës ekonomike dhe faktorëve të lidhur me të. Nga ana tjetër, ne shqyrtuarm dhe aspekte të tjera të individëve dhe familjeve nën skemën e ndihmës ekonomike , të tilla si rrjeti social, fuqizimi, solidariteti, pjesëmarrja në jetën politike,opinionet e tyre lidhur me sinqeritetin e nëpunësve të ndryshëm të shtetit dhe aspekte të tjera, të cilat, në opinionin tonë, janë të rëndësishme për të kuptuar gjendjen reale të grupeve në nevojë në vendin tonë dhe, në këtë kontekst, për të vlerësuar efektivitetin e ndihmës ekonomike.

Ndërkohë, shqyrtimi shumë i pasur i literaturës ndërkombëtare më cilësore dhe koherente hodhi dritë lidhur me perspektivat ndërkombëtare të tranzicionit të familje, arsyet pse kanë ndodhur dhe po ndodhin këto ndryshime në nivel global, rajonal dhe duke u përqëndruar sidomos tek vendet ish-komuniste të Europës Qendore dhe Lindore, të cilat janë të ngjashme me Shqipërinë përsa i përket kontekstit politik, social dhe ekonomik, tendencat e martesës, bashkëjetesës dhe divorcit, tendencat dhe variacionet në modelet familjare në Europë dhe vendet ish-komuniste të bllokut të Lindjes, implikimet e ndryshimit të strukturës familjare për politikat sociale dhe përshkrimin e tyre në Europë dhe vendet e tjera ish-komuniste, sfidat ndaj politikave të mbrojtjes sociale, mënyrat për rritjen e mbulimit me shërbimet e mbrojtjes sociale dhe efektivitetin e politikave sociale për reduktimin e varfërisë.

Përveç kësaj, ne përshkruam, në rend kronologjik, historikun e politikave të mbrojtjes sociale në vendin tonë, duke ofuar pikësëpari një përshkrim shumë të shpejtë lidhur historinë e Shqipërisë në mënyrë që të kuptojmë më mirë bazat politike, kulturore, sociale dhe ekonomike të gjendjes aktuale të politikave të mbrojtjes sociale në Shqipëri, për të kaluar në shqyrtimin në detaje të indikatorëve tregues të tranzicionit të dytë demografik në vendin tonë, fillimet e politikave të mbrojtjes sociale në vendin tonë dhe historikun e bazës ligjore mbi të cilat janë bazuar ato, për të kaluar në përshkrimin e politikave dhe strategjive aktuale të përfshirjes, mbrojtjes dhe mbështetjes sociale në Shqipëri duke u bazuar në Strategjitë Kombëtare dhe Ligjet përkatëse.

Shqyrtimi mjaft i gjerë i literaturës bashkëkohore ndërkombëtare dhe kombëtare ndihmoi për të sjellë një tablo të plotë të ndryshimeve që ka pësuar dhe po pëson familja Europiane dhe familja Shqiptare si dhe një përshkrim të saktë të ndryshimit dhe përshtatjes së politikave sociale në varësi të këtyre ndryshimeve, dhe, bazuar në analizat shkencore dhe rezultatet e tyre, u mundësua vlerësimi i efektivitetit të skemës së ndihmës ekonomike në Shqipëri. Përvec kësaj, është rishikuar i gjithë informacioni i disponueshëm në vendin tonë lidhur me politikat sociale dhe efektivitetin e këtyre politikave duke

plotësuar në këtë mënyrë panoramën e përgjithshme lidhur me këtë fushë si në arenën ndërkombëtare ashtu dhe në vendin tonë.

Konkulzionet mund të përmblidhen si vijon:

- Familja, si entitet, ka pësuar ndryshime thelbësore të cilat e kanë zanafillën në rënien e vdekshmërisë dhe fertilitetit në shekullin e 19-të dhe 20-të në shoqëritë Perëndimore të ndjekur nga ndryshime të shumta në strukturën familjare në fundin e shekullit të 20-të, përfshirë ndryshimet në mënyrën jo-familjare të jetesës dhe shkëputjen midis martesës dhe ngjizjes së fëmijëve.

- Këto ndryshime janë shkaktuar nga faktorët strukturorë (ndryshimi i mënyrave të prodhimit ekonomik, ndryshimi i mënyrës së organizmit të jetesës duke u angazhuar më shumë në aktivitete jashtë shtëpisë, përhapja e edukimit, urbanizimi dhe migrimi, rritja e të ardhurave dhe konsumit, përmirësimi i rrjeteve të komunikimit dhe transportit dhe shfaqja e teknologjive të reja) dhe faktorët ideorë, të cilët reflektojnë ndryshimin e mentalitetit të njerëzve (ku cështja e autonomisë personale zë vend qendror) dhe botëkuptimit të tyre lidhur me familjen dhe të gjitha çështjet e lidhura me të, në përputhje me shkallën e shtrirjes së ndryshimeve strukturore.

- Promotori i ndryshimeve të familjes është bota Perëndimore, dhe më pas, me shtrirjen e ndryshimeve strukturore edhe në pjesën tjetër të globit, këto ndryshime po prekin dalëngadalë pothuajse të gjithë vendet.

- Në vendet Perëndimore, dhe në shkallë të ndryshme dhe në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore dhe më gjerë, po vihet re i ashtuquajturi "tranzicioni i dytë demografik" i karakterizuar nga rritja e nivelve të divorcit, rënia e niveleve të fertilitetit, rritja e moshës së martesës, rritja e numrit të individëve beqarë apo që jetojnë vetëm, rritja e individëve që bashkëjetojnë pa qënë të martuar dhe rrita e numrit të fëmijëve të ngjizur jashtë institucionit të martesës.

- Ndryshimi në strukturën e familjes ka diktuar ndryshime dhe përshtatje përkatëse të politikave sociale në përputhje me këto ndryshime dhe në përpjekje për të adresuar sfidat e reja. Skemat e politikave sociale sot janë në tranzicion të vazhdueshëm në përpjekje për të gjetur ekuilibrin midis sistemeve familjare dhe jo-familjare të shërbimeve sociale duke adresuar

politikat e kujdesit ndaj fëmijëve, të lejes nga puna, përfitimet financiare, mbrojtjen sociale për të moshuarit dhe çështjet lokale të mbështjet sociale. Zgjedhja e njërës apo tjetrës formë bazohet në kulturën dhe kontekstin politik, social dhe ekonomik të çdo vendi.

- Në përgjithësi, masat institucionale janë zbatuar nga vendet e zhvilluara dhe me një infrastrukturë të mirë të shërbimeve publike. Ndërkohë që në vende e Europës Qendrore dhe Lindore janë aplikuar më tepër masat financiare për mbështjen sociale në grupet në nevojë për shkak të mungesës së infrastrukturës së përshtatshme dhe kapaciteteve për zgjerimin e masave institucionale. Edhe në Shqipëri vihet re i njëjti fenomen.

- Nuk ka dyshime që politikat sociale, të zbatuara siç duhet, ndihmojnë në reduktimin e varfërisë dhe nxitjen e pjesëmarrjes së individëve në nevojë në tregun e punës.

- Në Shqipëri janë të pranishëm të gjithë elementët e tranzicionit të dytë demografik, si dhe ndryshimet strukturore dhe ideore, të cilët dëshmojnë për "modernizimin" e stilit të jetës në Shqipëri ose përafrimin e saj me stilin "Perëndimor" të jetesës. Këto ndryshime janë shoqëruar dhe po shoqërohen me ndryshimin gradual të strukturës së familjes në Shqipëri, duke u përafruar me familjen e tipit Perëndimor.

- Fillimet e politikave të mbrojtjes sociale në Shqipëri janë shumë më të vonshme krahasuar me vendet e rajonit, duke datuar qysh me krijimin e shtetit Shqiptar në vitin 1912. Gjatë periudhës komuniste, nuk kishte politikë sociale "zyrtare" sepse "mbrojtja sociale ishte e mbrujtur ose pjesë e natyrshme" e procesve të prodhimit, shpërndarjes dhe gjenerimit të të ardhurave të cilat drejtoheshin në mënyrë të centralizuar nga shteti. Megjithatë, mbrojtja sociale realizohej në disa nivele dhe ishte e orientuar ndaj grupeve të ndryshme të shoqërisë.

- Strategjitë dhe politikat e përfshirjes dhe mbrojtjes sociale në Shqipëri, ashtu siç i njohim sot, datojnë në vitin 1993 me krijimin e Sistemit të Sigurimeve Shoqërore bazuar në parimin e drejtësisë sociale. Përgjatë viteve, kuadri ligjor i politikat sociale në përputhje me idealet dhe parimet Europiane. Por, megjithë kuadrin relativisht të plotë ligjor, zbatimi i tij mbetet një ndër problemet themelore në vendin tonë.

- Subjektet nën skemën e ndihmës ekonomike kanë karakteristika

disavantazhuese: nivel i ulët i edukimit, shkallë e lartë e papunësisë, nivel i ulët ekonomik, angazhim i ulët në aktivitet fizik, prevalencë e lartë e gjendjes shëndetësore jo të mirë, prani lartë e fëmijëve nën 18 vjeç dhe të papunë në familjet përkatëse, nivel i ulët i lumturisë në përgjithësi, nivel i ulët i kënaqësisë me politikat sociale aktuale, niveli i ulët i besimit në vetë për ndryshimin e gjendjes aktuale, pjesëmarrje e ulët në aktivitete politike dhe shoqërore, mbështjetje e ulët tek miqtë apo shokët në rast nevoje, nivele të larta mosbesimi vecanërisht tek zyrtarët e qeverisë qendrore dhe lokale dhe nivele të larta të pamundësisë për pagesën e qerasë, kujdesit shëndetësor apo ushqimit bazë për shkak të mungesës së parave.

- Në përgjithësi, femrat dhe pjesëtarët e familjeve më një numër më të lartë të përsonave të disavantazhuar i kishin më të disfavorshme indikatorët e mësipërm krahasuar me meshkujt dhe pjesëtarët e familjeve me numër të vogël të personave të disavantazhuar, përkatsisht. Në mjaft raste, ndryshimet ishin domethnëse nga ana statistikore.

- Arsyet kryesore për përfitimin e ndihmës ekonomike ishin papunësia, invaliditeti dhe divorci.

- Barrierat kryesore për përfitimin e ndihmës ekonomike ishin: procedurat jo të thjeshta, procedurat jo transparente, numri i madhe i dokumenteve që duhen plotësuar dhe informacioni jo i plotë dhe jo i qartë i servirur në media apo institucionet përgjegjëse rreth kushteve dhe kritereve për përfitimin e ndihmës ekonomike, duke qënë përgjegjëse për rreth 70% të të gjithë vështirësive që hasin subjektet në nevojë kur aplikojnë për përfitimin e ndihmëse ekonomike. Burokracia në procedurat e ndihmës ekonomike është një problem i evidentuar edhe më parë, por mesa duket nuk janë marrë masat e duhura për reduktimin e kësaj barriere.

- Informacioni jo i qartë dhe/ose jo i plotë në media apo institucione të ndryshme lidhur me kriteret për përfitimin e ndihmës ekonomike është një tjetër barrierë madhore për përfitimin e saj. Duke qënë se strukturat e qeverisjes lokale nuk kanë stimujt e duhur për t'u angazhuar në cështjet e mbrojtjes sociale, si dhe janë relativisht të paqarta lidhur me funksionet e tyre dhe lidhjen apo varësinë me institucione të tjera përsa i përket mbrojtjes sociale, atëherë përformanca e strukturave lokale në shpërndarjen e përfitimeve të mbrojtjes sociale është jo optimale duke ndikuar edhe në dhënien e informacionit lidhur me ndihmën ekonomike.

- Faktori madhor i lidhur në mënyrë statistikisht domethënëse me numrin e barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike ishte niveli i edukimit të subjekteve në nevojë: sa më i ulët niveli i edukimit, aq më i lartë numri mesatar i barrierave të hasura për përftimin e ndihmës ekonomike.

- Masa e përfitimit financiar nën skemën e ndihmës ekonomike është tepër e ulët për përballimin e nevojave mujore bazë dhe për 90% të rasteve ajo mjafton vetëm për një javë. Pagesa financiare e ndihmës ekonomike nuk është indeksuar asnjëherë në bazë të rritjes së pagesës minimale të papunësisë, duke vazhduar të qëndrojë në nivelet e përcaktuara nga VKM e vitit 2005.

- Pagesa e ndihmës ekonomike bëhet sipas strukturës së familjes vetëm në mënyrë "matematikore" duke nënkuptuar që "familjet me më shumë anëtarë marrin më shumë para' vetëm në terma absolutë". Por, familjet me më shumë anëtarë marrin gjithnjë e më pak para' nga skema e ndihmës ekonomike për çdo anëtar të familjes me rritjen e numrit të anëtarëve të tyre. Në terma reale ndihma ekonomike aktuale është krejtësisht e pamjaftueshme për të plotësuar nevojat bazë, sidomos të familjeve me shumë anëtarë, dhe efektet e saj për nxjerrjen e këtyre personave nga varfëria se janë minimale, në mos inekzistente.

- Burimi kryesor për gjenerimin e të ardhurave shtesë ishte huamarrja e parave për rreth dy të tretat e subjekteve në studim, kurse një në 10 raste i gjeneronin paratë nëpërmjet punës ose familjes, përkatësisht.

- Ka pak gjasa që përfitimet aktuale nga skema e ndihmës ekonomike të stimulojnë personat në nevojë të qëndrojnë nën këtë skemë dhe të mos kërkojnë punë. Në fakt, në studimin tonë, personat në nevojë në Shqipëri qëndrojnë për një kohë të gjatë në skemën e ndihmës ekonomike (mesatarisht 8 vjet) ku femrat dhe personat me arsim të ulët tentojnë të qëndrojnë më gjatë në skemë. Megjithatë, përfitimet nga ndihma ekonomike janë tepër të ulëta dhe si pasojë është "më tërheqëse" të punosh se sa qëndrosh në këtë nivel të ardhurash. Fakti që përsonat qëndrojnë gjatë në skemë, gjenerojnë para nëpërmjet marrjes hua dhe janë ende të papunë pavarësisht përpjekjeve të tyre për tu punësuar, sugjeron që politikat sociale kanë dështuar në misionin e tyre për nxitjen e punësimit të këtij grupi të disavantazhuar të popullatës.

- Rreth një e treta e personave nën skemën e ndihmës ekonomike dëshirojnë të qëndrojnë në këtë skemë duke sugjeruar që ndoshta stigma

lidhur me ndihmën ekonomike bën që këta persona të "frenohen" dhe të mos kërkojnë të punësohen në punë që ja sugjerojnë zyrat e punësimit dhe të cilat ata mund të mos i parapëlqejnë. Fakti që vetëm një person në 232 të intervistuar deklaroi se ishte i angazhuar në punë sociale në komunitet për gjenerimin e të ardhurave shtesë mbështet sugjerimin tonë. Megjithatë, edhe dërgesat e parave nga të afërmit jashtë vendit mund të shpjegojnë një pjesë të kësaj gjetjeje.

- Në shkallë vendi, vetëm 5.1% e të papunëve të regjistruar përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike. Rregulloret në fuqi janë tepër strikte duke kufizuar në maksimum personat që kanë të drejtë të përfitojnë nga kjo skemë, gjë që pakëson së tepërmi mbulesën e saj.

- Femrat janë më të rrezikura sesa meshkujt për të mbetur në "kurthin e varfërisë" në Shqipëri pasi ato janë më "apatike", kanë më pak vetëbesim në forcat e veta, janë më pak të kënaqura me politikat sociale aktuale, mbështeten më shpesh tek familja e tyre krahasuar me meshkujt duke bërë që ato të qëndrojnë më gjatë në skemën e ndihmës ekonomike duke reduktuar shancet e tyre për të dalë nga varfëria. Ky konkluzion është në përputhje me rolin e disavantazhuar të grave krahasuar me burrat në përgjithësi në vendin tonë.

- Legjislacioni akual lidhur me politikat e mbrojtjes sociale ka disa elemente në favor të adresimit në mënyrë specifike të fuqizimit të grave dhe vajzve, nëpërmjet krijimit të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në jetën ekonomike, politike dhe sociale dhe mbrojtjen e tyre nga dhuna. Megjithatë, siç u evidentua nga studimi ynë, këto politika fuqizuese kanë patur pak ose aspak ndikim në këtë drejtim.

- Pjesëmarrja në punën e paguar është një element thelbësor i qytetarisë dhe një mjet i fuqishëm për fuqizimin e grave pasi puna e paguar krijon akses në një sërë të drejtash. Prandaj, politikat që synojnë punësimin e grave do të kishin një ndikim të konsiderueshëm për fuqizimin e këtij grupi të disavantazhuar të shoqërisë sonë.

- Niveli i ulët i besimit tek punonjësit e shtetit ishte i lidhur në mënyrë statistikisht domethënëse me një numër mesatar më të lartë të barrierave të hasuar për përfitimin e ndihmës ekonomike duke dëshmuar për një lidhje të ngushtë midis perceptimit të përgjithshëm që qytetarët në nevojë kanë për qeverinë dhe nëpunësit e shtetit dhe aksesit të tyre në shërbimet dhe përfitimet e paketës së mbrojtjes sociale. Mosbesimi në

strukturat e shtetit bën që njerëzit (dhe sidomos njerëzit më vulnerabël) të jenë më pak të motivuar për të kërkuar të drejtat e tyre.

## 6.2 REKOMANDIME

Bazuar në rezultatet dhe konkluzionet e këtij punimi shkencor, ne rekomandojmë si vijon:

- Ndryshimi i strukturës së familjes në Shqipëri sugjeron fuqimisht ndryshimin e politikave të mirëqënies, përfshirjes dhe mbrojtjes sociale në mënyrë që këto t'i përgjigjen nevojave të ndryshuara të familjeve Shqiptare dhe të jenë në përputhje me realitetin e ri të krijuar.

- Strategjitë aktuale të politikave sociale nuk duhet të jenë gjithëpërfshirëse vetëm në "letër" dhe për t'i treguar partnerëve Europianë që "formalisht" e zotërojmë bazën e duhur ligjore por ato duhet të jenë efektive dhe të kenë impakt real në grupet target të tyre. Në sugjerojmë që të zbatohen sa më parë ligjet dhe kuadri ligjor në fuqi në mënyrë që t'i vihet në ndihmë në terma konkretë grupeve në nevojë.

- Duke qënë se përsonat nën skemën e ndihmës ekonomike në Shqipëri janë të disavantazhuar në mënyrë shumë dimensionale, atëherë në sugjerojmë që përpjekjet për përmirësimin e gjendjes së tyre nuk mund të jenë të izoluara por kërkojnë bashkërendim të politikave ekonomike dhe sociale dhe bashkëpunim të ngushtë të niveleve qeverisëse dhe institucioneve përkatëse.

- Boshllëku që ekziston midis qeverisë qendrore dhe lokale (në terma të fondeve dhe infrastrukturës së munguar për ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes dhe mbështetjes sociale në nivel lokal) dhe c'orientimi i strukturave vendore lidhur me përgjegjësitë e tyre dhe/ose cështjet e varësisë më strukturat përkatëse dhe/ose motivimin e tyre duhet të zgjidhen sa më shpejt në mënyrë që të rritet cilësia e shërbimeve të mbrojtjes dhe mbështetjes sociale dhe shkalla e mbulimit të tyre.

- Ne sugjerojmë që të merren masa serioze për adresimin e barrierave kryesore që kufizojnë aksesin e njerëzve në nevojë në skemën e ndihmës ekonomike duke bërë të gjitha përpjekjet e duhura për thjeshtimin e procedurave, rritjen e transparencës së tyre dhe reduktimin e volumit të madh të dokumentave që duhen plotësuar për përfitimin e ndihmës ekonomike.

- Institucionet që lidhen në mënyrë direkte apo indirekte me politikat apo shërbimet e mbrojtjes/mbështetjes sociale, si dhe media, duhet të bëjnë përpjekje më serioze për transmetimin tek grupet e interesuara të informacionit të duhur, të plotë dhe të qartë lidhur me kushtet dhe kriteret për përfitimin e ndihmës ekonomike. Vecanërisht ky rekomandim është i vlefshëm për strukturat e pushtetit lokal të cilat janë përgjegjëse për shpërndarjen e ndihmës ekonomike dhe ofrimin e shërbimeve të tjera sociale.

- Në mënyrë që strukturat lokale të kryejnë siç duhet funksionet e tyre lidhur me shërbimet sociale, ato duhet të motivohen, përtej stimujve financiarë, që të marrin pjesë në diskutimin e politikave të mbrojtjes sociale dhe të jenë pjesë e procesit të vendim-marrjes si një mënyrë për t'i motivuar më tej këto struktura. Në këtë kuadër, ne sugjerojmë dhe trajnimin e punonjësve të strukturave lokale në mënyrë që ata t'i adresojnë më mirë disa nga problemet e evidentuar në këtë studim, siç janë gatishmëria për shpjegimin e procedurave dhe kushteve për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe servirja e informacionit në mënyrë të qartë dhe të plotë.

- Duke qënë se edukimi rezultoi një faktor kyç i lidhur në mënyrë statistikisht domethënëse me hasjen e barrierave për përfitimin e ndihmës ekonomike, atëherë ne sugjerojmë që të gjenden mënyra për përmirësimin e edukimit në grupet në nevojë. Ndërsa kjo mund të jetë një politikë afat-gjatë e çdo qeverie, ajo që mund të bëhet në terma imediatë është ofrimi i trajnimeve specifike për pjesëtarët e familjeve në nevojë në mënyrë që të rriten aftësitë e tyre për të kuptuar procedurat e lidhur me ndihmën ekonomike. Në mënyrë alternative, ne sugjerojmë që të thjeshtohet në maksimum gjuha e përdorur për servirjen e informacionit lidhur me ndihmën ekonomike apo politika të tjera sociale tëk grupet target të popullatës. Kjo përpjekje do të kërkojë anazhimin e ekspertëve të fushave përkatëse.

- Duke qënë se femrat janë një grup shumë vulnerabël midis përsonave të disavantazhuar atëherë sugjerohet që të stimulohet në maksimum përfshirja e tyre në punësim, si një strategji efektive për nxjerrjen e tyre nga kurthi i varfërisë dhe nga gjendja e plogët në të cilën ndodhen. Kjo nënkupton nevojën për zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe strategjive kombëtare lidhur me fuqizimin e grave dhe vajzave.

- Për shkak se masa e ndihmës ekonomike aktualisht bëhet sipas strukturës së familjes vetëm në mënyrë "matematikore", duhet që kjo gjendje të ndryshojë sa më shpejt dhe masa e ndihmës ekonomike të jepet në përputhje me strukturën reale të familjeve në nevojë, duke u indeksuar sipas rregullave në fuqi.

- Për shkak se politikat sociale aktuale kanë dështuar për të angazhuar personat në nevojë në tregun e punës, duhet të bëhen të gjitha përpjekjet që kjo gjendje të përmirësohet duke synuar punësimin e personave në nevojë si një masë efikase për t'i larguar ata nga varfëria dhe për të përmirësuar kontaktet e tyre sociale, shëndetin mendor e fizik të tyre.

- Duhet të ndërmerren fushata ndërgjegjësues lidhur me ndihmën ekonomike dhe punën sociale në komunitet, për t'i çliruar njerëzit në përgjithësi dhe personat në nevojë në veçanti, nga stigma lidhur me punën në komunitet. Një gjë e tillë do lehtësonte punësimin personave në nevojë duke përmirësuar gjendjen financiare të tyre.

- Ne sugjerojmë që të rishikohen kriteret sipas të cilave të papunët e regjistruar përfitojnë pagesë financiare nga skema e ndihmës ekonomike në mënyrë që të rritet mbulesa me këto shërbime, si një alternative e përkohshme për të lehtësuar gjendjen e tyre deri në sigurimin e punësimit.

- Niveli i ulët i besimit të përsonave në nevojë tek zyrtarët e qeverisë qendrore dhe lokale sugjeron marrjen e masave të menjëherrshme për forcimin e shtetit ligjor dhe zhdukjen e korrupsionit, duke kthyer besimin dhe motivimin e qytetarëve tek strukturat shtetërore. Një gjë e tillë do të lehtësonte së tepërmi barrierat që personat në nevojë hasin për përfitimin e ndihmës ekonomike, bazuar në rezultatet e studimit tonë.

- Për shkak të mospërputhjeve midis nivelit të varfërisë së raportuar për qarqe të ndryshme të vendit dhe familjeve në nevojë që trajtohen në çdo qark (për shembull, Durrësi është midis qarqeve me nivelin më të lartë të varfërisë por numri i familjeve në nevojë që trajtohen me ndihmë ekonomike zë vetëm 1% të të gjitha familjeve që trajtohen me ketë skemë në vend!), lind nevoja për saktësimin e këtyre të dhënave në nivel kombëtar.

# REFERENCAT


1. Arnett JJ. The psychology of globalization. American Psychologist, 2002; 57(10), 774–783.
2. Cherlin A. Marriage, divorce, remarriage. Cambridge, 1990. MA: Harvard University Press.
3. Thornton A, Young-DeMarco L. Four decades of trends in attitudes toward family issues in the United States: The 1960s through the 1990s. Journal of Marriage and the Family, 2001; 63(4): 1009–1037.
4. Lesthaeghe R. (Ed.). Meaning and choice: Value orientations and life course decisions. 2002. The Hague: Netherlands Interdisciplinary Demographic Institute.
5. Barber JS. Ideational influences on the transition to parenthood: Attitudes towards childbearing and competing alternatives. Social Psychology Quarterly, 2001; 64(2):101–127.
6. Meek RI. Social science and the ignorable savage. 1976. Cambridge, UK: Cambridge University Press.
7. Thornton A. Reading history sideways: The fallacy and enduring impact of the developmental paradigm on family life. 2005. Chicago: University of Chicago Press.
8. Thornton A, Fricke T, Yang LS, Chang, JS. Theoretical mechanisms of family change. Në: Thornton A, Lin HS, (Eds.). Social change and the family in Taiwan. 1994. Chicago: University of Chicago Press.
9. Macaulay C. Letters on education. 1974. New York: Garland.
10. Cleland J. The effects of improved survival on fertility transition: An iconoclastic view. Population Studies, 2001; 41(1), 5–30.
11. Diamond N. Women and industry in Taiwan. Modern China, 1979; 5(3):317–340.
12. Hareven TK. Family time and industrial time. 1982. New York: Cambridge University Press.
13. Thornton A, Lin HS. Social change and the family in Taiwan. 1994. Chicago: University of Chicago Press.
14. Wirth L. Perspectives on Urbanism as a way of life. American Journal of Sociology, 1938; 44(1):1–24.
15. Korbin FE. The fall of household size and rise of the primary individual in the United States. Demography, 1976; 13:127–138.
16. Smith RM. Fertility, economy, and household formation in England over three centuries. Population and Development Review, 1981; 7(4):595–622.
17. Ruggles S. The transformation of American family structure. American Historical

Review, 1994; 99(1):103–128.
18. Easterlin R. Birth and fortune: The impact of numbers of personal welfare. 1980. Chicago: University of Chicago Press.
19. Inglehart R. Moderization and postmodernization: Cultural, economic and political change in 43 societies. 1997. Princeton, NJ: Princeton University Press.
20. Watkins SC, Menken JA, Bongaarts J. Demographic foundations of family change. American Sociological Review, 1987; 52(3):346–358.
21. Knodel J. Older people and AIDS: Quantitative evidence of the impact in Thailand. Social Science and Medicine, 2001; 52(9):1313–1327.
22. Wachter KW, Knodel JE, VanLandingham M. AIDS and the elderly of Thailand: Projecting familial impacts. Demography, 2002; 39(1):25–41.
23. Knodel J. The economic consequences for parents of losing an adult child to AIDS: Evidence from Thailand. Social Science and Medicine, 2004; 59(5):987–1001.
24. Clark SJ. Demographic impacts of the HIV epidemic and consequences of population-wide treatment of HIV for the elderly: Results from microsimulation. 2005. Washington, DC: National Academy of Sciences.
25. Westoff CF, Ryder NB. The contraceptive revolution. 1977. Princeton, NJ: Princeton University Press.
26. Goldin C, Katz LF. Career and marriage in the age of the pill. American Economic Review, 2000; 90(2):461–465.
27. Bailey MJ. More power to the pill: The impact of contraceptive freedom on women's lifecycle labor-force participation. Working paper (No. 04-WG01). 2004. Vanderbilt University.
28. Fricke T. Marraige change as moral change: Culture, virtue, and demographic transition. Në: Jones GW, Douglas RM, Caldwell JC, D'Souza RM. (Eds.). The continuing demographic transition. 1997. Oxford, UK: Oxford University Press.
29. Marini MM. Age and sequencing norms in the transition to adulthood. Social Forces, 1984; 63(1):229–234.
30. Hannerz U. Cultural complexity. 1992. New York: Columbia University Press.
31. Taylor C. Philosophy and the human sciences. 1985. Cambridge, NY: Cambridge University Press.
32. Hunter JD. Culture wars: The struggle to define America. 1991. New York: Basiç Books.
33. Chesnais JC. The demographic transition: Stages, patterns, and economic implications. 1992. Oxford, UK: Oxford University Press.
34. Mason KO. Explaining fertility transitions. Demography, 1997; 34(4):443–454.
35. Thornton A. The developmental paradigm, reading history sideways, and family change. Demography, 2001; 38(4):449–465.
36. Lesthaeghe R. A century of demographic and cultural change in Western Europe: An exploration of underlying dimensions. Population and Development

Review, 1983; 9(3):411–435.

37. Caldwell J. Theory of fertility decline. 1982. London: Academic Press.
38. Freedman R. The contribution of social science research to population policy and family planning program effectiveness. Studies in Family Planning, 1987; 18(2):57–82.
39. van de Kaa DJ. Anchored narratives: The story and findings of a half century of research into the determinants of fertility. Population Studies, 1996; 50(3):389–432.
40. Watkins SC. Local and foreign models of reproduction in Nyanza Province, Kenya. Population and Development Review, 2000; 26(4):725–759.
41. Caldwell JC, Hanumantha R, Caldwell P. The causes of demographic change: Experimental research in South India. 1988. Madison: University of Wisconsin Press.
42. Abu-Lughod, L. Feminist longings and postcolonial conditions. Në: Abu-Lughod L, (Ed.). Remaking women: Feminism and modernity in the Middle East. 1998. Princeton, NJ: Princeton University Press.
43. Ahearn LM. Invitations to love: Literacy, love letters, and social change in Nepal. 2004. Ann Arbor: University of Michigan Press.
44. Yount KM. Symbolic gender politics, religious group identity, and the decline in female genital cutting in Minya, Egypt. Social Forces, 2004; 82(3):1063–1090.
45. Nisbet RA. (Ed.). History of the idea of progress. 1980. New York: Basiç Books.
46. Meyer JW, Boli J, Thomas GM, Ramirez FO. World society and the nation-state. American Journal of Sociology, 1997; 103(1):144–181.
47. United Nations. Convention on consent to marriage, minimum age for marriage and registration of marriages. General Assembly Resolution 1763 A (XVII). 1962. New York: Oxford Press.
48. United Nations. Convention on the elimination of all forms of discrimination against women: General Assembly Resolution 34,180. 1979. New York: Oxford Press.
49. United Nations Development Program. Human development report 2001: Making technology work for human development. 2001. New York: Oxford Press.
50. United Nations Development Program. Human development report 2002: Deepening democracy in a fragmented world. 2002. New York: Oxford Press.
51. Gal S, Kligman G. Reproducing gender: Politics, publics and everyday life after socialism. 2000. Princeton, NJ: Princeton University Press.
52. Roberts K, Clark SC, Fagan C, Tholen J. Surviving post-communism: Young people in the former Soviet Union. 2000. Cheltenham, UK: Edward Elgar.
53. Mestrovic SG. The Balkanization of the West: The confluence of postcommunism and postmodernism. 1994. London: Routledge.
54. Szalai J. From informal labor to paid occupations: Marketization from below in

Hungarian women's work. Në: Gal S, Kligman G. (Eds.), Reproducing Gender: Politics, Publics and Everyday Life After Socialism. 2000. Princeton, NJ: Princeton University Press.

55. Nauck B, Joos M. Child poverty in East Germany – The interaction of institution transfer and family type in the transformation process. Në: Silbereisen RK, von Eye A, (Eds.). Growing Up in Times of Social Change 1999. Berlin: Gruyter.
56. Morris EW. Household responses to major economic change in Poland: A theoretical framework. Journal of Family and Economic Issues, 1998; 19(3):199–220.
57. Robila M, Krishnakumar A. The role of children in Eastern European families. Children & Society, 2004; 18(1):30-41.
58. Daskalova K. Women's problems, women's discourses in Bulgaria. Në: Gal S, Kligman G. (Eds), Reproducing Gender: Politics, Publics and Everyday Life After Socialism. 2000. Princeton, NJ: Princeton University Press.
59. Hajnal J. European Marriage Patterns in Perspective. Në: Glass VD, Eversley DEC. (Eds.), Population in History. 1965. Chicago: Aldine Publishing Company.
60. Lesthaeghe R. The Second Demographic Transition in Western Countries: An Interpretation. Në: Oppenheim K, Mason K, Jensen AM. (Eds), Gender and Family: Change in Industrialized Countries. 1995. Oxford: Clarendon Press.
61. Billari F. Partnership, Childbearing and Parenting: Trends of the 1990s. Në: Macura M, Maçdonald AL, Haug W. (Eds.), The New Demographic Regime: Population Challenges and Policy Responses. 2005. New York and Geneva: United Nations.
62. Philipov D, Dorbritz J. Demographic Consequences of Economic Transition in Countries of Central and Eastern Europe. Population studies No. 39. 2003. Council of Europe.
